

**ISSN 2304-2664**

*Kryeredaktor*

Prof. Dr. ADRIAN CIVICI

*Redaktor*

Dr. LAVDOSH AHMETAJ

*Bordi*

Prof. Asoc. Dr. QAMIL TALKA

Prof. Asoc. Dr. SIRI HANAJ

Dr. ZEF PREÇI

Dr. NEVILA XHINDI

Dr. NATASHA AHMETAJ

Dr. SELO KUCA

Dr. SELMAN LAME

Dr. VERONIKA DURMISHI

Dr. LLAMBRINI SOTA

*Botues*

UNIVERSITETI PAVARËSIA VLORË

BULEVARDI VLORË-SKELE

PO.BOX 4358 AL-9401 VLORË

ALBANIA

WWW.UNIPAVARESIA.EDU.AL



# Përmbajtja

## ✦ DREJTËSI

<i>Uillsonianizmi dhe politika europiane në shqipëri 1918-1920.....</i>	<i>5</i>
	<b>Dr. Lavdosh AHMETAJ</b>
<i>Zhvillimi i të drejtës procedurale administrative në shqipëri dhe ndikimi i të drejtës europiane. Aktualitete dhe perspektiva.....</i>	<i>22</i>
	<b>PhD. Alma Faskaj-Vokopola Dokt. Anila Fega-Dhamo</b>
<i>Criminal offenses of the environment.....</i>	<i>34</i>
	<b>PhD. Elvana Çiçolli</b>
<i>Drejtësia shqiptare dhe procesi i integritimit evropian.....</i>	<i>43</i>
	<b>Dokt. Jeta Goxha</b>
<i>Raporti midis hapësirës urbane dhe lirive politike.....</i>	<i>53</i>
	<b>Mnd. Lindita Liçaj Ma. Eriola Cakrani (Hoxha)</b>
<i>Ligji, politika dhe zgjedhjet e sistemit zgjedhor në Shqipëri. ....</i>	<i>60</i>
	<b>Dokt. Urjana Çuri</b>

## ✦ EKONOMI

<i>Dukuri të recesionit ekonomik dhe qasjet efiçente në qeverisje .....</i>	<i>91</i>
	<b>Dokt. Florian Miti</b>
<i>Përfitueshmëria dhe risku në bankat e nivelit të dytë RAST STUDIMI CREDINS SHA. ....</i>	<i>97</i>
	<b>Klodiana Dautaj, Msc</b>
<i>Roli i marketingut në mjedisin konkurrues të porteve detare .....</i>	<i>113</i>
	<b>Dokt. Merita Murati Dokt. Sonila Berdo</b>
<i>Kontributi i turizmit në zhvillimin e qëndrueshëm dhe ndikimet ekonomike, mjedisore dhe sociale të tij.....</i>	<i>123</i>
	<b>Veronika Durmishi, Phd</b>

## ◆ SHOQERORE

*Rikonceptimi i metodës së mësimdhënies nëgjuhën shqipe nga forma globale në atë fonologjikeapo rrokjzim .....136*

**Dokt. Darina Minga**

*Dimensioni europian i mësimdhënies së historisë në shkollë nga riprodhimi në interpretim të fakteve dhe ngjarjeve historike .....145*

**Dokt. Desara KARAJ**

*Përdorimi i produkteve me qasje të lirë në bibliotekat universitare .....151*

**Erena HASKA , MnD**

*Organizimi dhe menaxhimi i auditorit universitar .....164*

**Dokt. Esmeralda Birçaj**

**Dokt. Julejda Gërxihi**

*Shpellat e velçës, si një vendbanim i hershëm, përkasin kulturës së neolitit të vonë .....177*

**Gëzim Llojdia**

*Diplomacia shqiptare pas viteve 90 dhe disa çështje rajonale .....186*

**Dokt. Kreshnik Rushiti**

*Shkolla, laicizimi dhe edukimi.....190*

**Dokt. Siri Hoxha**

*Uillsonianizmi dhe politika europiane  
në shqipëri 1918-1920*

---

■ Dr. Lavdosha AHMETAJ

---

**Abstract.** *Issues of this paper reflect the crisis of Europe and doctrine of balancing the forces immediately after the First World War, time which brought to light the Wilson's doctrine, based on the natural law principle, the state formation, for each national though is weak in the economic point of view. Seen in this philosophy, the analysis is focused on the following principal areas:*

**Firstly,** *British delegation was of the opinion that Himara, Gjirokastra, Delvina, Saranda were completely Greek in language and feelings, and the Florence Protocol had caused objections by Greek propaganda, and the Albanian southern population wanted the unification with Greece. However, on the other hand, the British felt that Leskovik districts, Kolonje and Korca comprised the majority of Albanian ethnicity.*

**Secondly,** *the Italian delegates brought to the commission arguments related to the population composition of the discussed regions. They referred to statistics compiled by the Austro-Hungarian consulate in Janina, but also to the Italian recent statistics, in 1918.*

*From the comparison of the relevant documents resulted that the downsizing of Muslim “explained the persecution of Epirote regime” that by changing the religious physiognomy, aimed to change the composition of ethnic. It seems that the Italian delegation was closer to the truth.*

***Third,** French diplomacy, defined as the basic criterion in resolving the Albanian issue only the religious element, although religious conflicts— according to her—had not been in the nature of Epirus, but that did not mean that religious propaganda should not encourage from outside. Therefore the religion division was seen as the only solution. Muslims were supposed to be on the Albanian side, while Christians to take the side of Greece. Also according to this delegation, a basic issue to pay high attention was the “Road to Saranda”*

***Fourth,** while Wilson in the Memorandum of April 14, 1919, demanded autonomy for different countries, who had once been an integral part of the Austro-Hungarian Empire and according to his view the faith of various population of these regions should be left in their hand to decide their faith and political relations.*

**P**ër të përfunduar traktatet e paqes me vendet që kishin humbur luftën dhe për të organizuar më mirë interesat e tyre të pasluftës, të prirura nga këto interesa, pesë fuqitë e mëdha fituese bënë të mundur organizimin e Konferencës së Paqes, e cila u çel më 18 janar 1919 në Paris<sup>1</sup>. Anglia, Franca, SHBA, Japonia dhe Italia u munduan me të gjitha mjetet diplomatike dhe politike të ndikonin tek njëra-tjetra për interesat përkatëse. Kështu, shtetet kryesorë, të cilëve u dëgjohej më shumë zëri, por dhe me më shumë interesa se të tjerët, e

---

1 - Ishte agim i vranët dhe i ftohtë, me flokë bore që zbrisnin si ujëvarë e palosen në gurët kallkan të kalldrëmit. Për ditë me radhë Parisi veçse ka ndier drithmat e pritjes së kësaj dite shumë të dëshiruar, kur udhëheqësit e botës, ose të paktën ata të botës fitimtare, do të mbledheshin për t'ia nisur detyrës së hartimit të një marrëveshjeje për paqen, që do tu imponohej të mundurve. Në Ke d'Orse, ndërtesa e stolisur e Ministrisë së Jashtme të Francës, e cila sheh nga lumi Seine, pregatitej për mbledhjen e parë plenare të bisedimeve të paqes, kanë filluar qysh para zbardhjes së vonë të kësaj dite dimri e këtij mëngjezi të akullt . Ndërtesa e rrethuar me kangjella të rënda, me majat e praruara në hekurat e lartë llamburiste nga dritat. Brenda sallës së madhe, Salë de la Paix me dritaret gjashtë metra të larta, punëtorët kishin ngritur një tryezë gjigande në trajtë U-je, ku çdo delegat do të gjente vendin e vet. Në krye do të zinin vend kryeministri francez Zhorzh Klemanso dhe Presidenti Puankare, të cilët në krah do të kishin Presidentin Udrou Uillon me delegacionin e SHBA-së, në të djathtë, dhe kryeministrin britanik Dejvid Llojd Xhorxh me delegacionin e tij, në të majtë. Një vëzhgues, korrespondent i agjensisë Associated Press, Charles Thomson vuri re një veçori delikate, se kishte të pranishëm dy presidentë - Puankareja dhe Uillsoni, nëntë kryeministra. Në këtë pikë Konferenca ishte në kontrast të madh me Kongresin e Vjenës, ku perandorë mbretër përcakttonin fatet e Europës. (David A. Andelman “Paqe e Rrënuar, Versajë 1919, dhe çmimi që paguajmë sot”, Tiranë 2008, f. 28 (Le Debut).

trajtuan çështjen shqiptare si një monedhë këmbimi midis tyre për të ruajtur të pacënuara interesat përkatëse: “në bazë të interesave të tyre të përgjithshme”<sup>1</sup>.

Me formimin e Komitetit për çështjen greke e shqiptare, në shkurt të vitit 1919, pretendimet territoriale greke gjetën mbështetjen e plotë të Anglisë dhe Francës, si dhe përkrahjen e pjesshme nga SHBA. Diplomatët francezë dhe anglezë kërkuan të ndryshonin kufijtë politikë të Shqipërisë së Jugut duke favorizuar Greqinë. Organi drejtues kryesor i Konferencës së Paqes, Këshilli i Kryetarëve të Qeverive dhe ministrave të Punëve të Jashtme, vendosi në mbledhjen e tij të 4 shkurtit 1919 që të caktohej një komision i posaçëm për shqyrtimin e rivendikimeve greke. Komisioni do të përbëhej nga përfaqësitë e katër Fuqive: SHBA, Anglia, Franca, Italia.

Që në fillim të punimeve të Konferencës të bën përshtypje formimi i menjëhershëm i komisionit për të shqyrtuar kërkesat greke. Kështu, sipas një “raporti përmbledhës”<sup>2</sup>, në formën e komisioneve për çështjen greke u zhvilluan punimet nga 12 shkurti deri më 21 mars 1919, përkatësisht në 12 seanca. Pra, duket se interesat e këtyre Fuqive të Mëdha ishin të paracaktuara që të zgjidhnin pretendimet greke.

Çështjet që kishin të bënin me kufirin jugor të Shqipërisë u diskutuan në debate të zgjatura, përkatësisht në 7 seanca të Komisionit, prej 12 shkurtit deri në 6 mars<sup>3</sup>. Që në seancën e parë të 12 shkurtit u përcaktuan dukshëm edhe qëndrimet e përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha. Ky diskutim nisi me shpjegimet që bëri Venizellosi lidhur me pretendimet e vjetra mbi Shqipërinë e Jugut. Kryetari që udhëhiqte seancën, francezi Zhyl Kambon, pasi bëri disa vlerësime të përgjithshme mbi çështjen e racave dhe përzierjen e tyre në Lindje, vuri theksin në territoret e ish Perandorisë Osmane. Ai, si bazë për gjykimin e çështjes mendonte se duhet të merrej përkatësia fetare: “Kisha ishte ajo që karakterizonte kombësinë”<sup>4</sup>.

Ndërsa përfaqësuesit e tjerë francezë Gout (Gut) dhe Laroche (Larosh) mbajtën një qëndrim të drejtpërdrejt, pa ndonjë përpunim diplomatik.

---

1 - *Historia e Shqipërisë*, 1986, f. 193.

2 - *Arben Puto - Historia diplomatike e çështjes shqiptare*, Tiranë 2003, f. 227.

3 - AMPJ. *Letër e M. Konicës, M. Turtullit e M. Frashërit drejtuar Presidentit të Konferencës së Paqes në Paris. Dosja nr. 10, 14 prill 1919, dokumenti 739 (frëngjisht), kopje.*

4 - AQSH. *Momorandum që iu dërgua Presidentit të Konferencës së Paqes në Paris, Klemansosë, më 20 korrik, prej z. Kristo Dako, M. Grameno: Të drejtat dhe kërkimet e Shqipërisë për independencë dhe tërësinë e vendit. Fondi Kristo Dako, dosja nr. 7, 18 janar 1919, viti 1918-1920, f. 108 (kopje) e daktilografuar.*

Ata mbajtën haptazi anën e pretendimeve territoriale greke. Në vazhdën e ballafaqimit të pikëpamjeve të ndryshme, përfaqësuesit francezë sollën argumente në favor të pikëpamjeve greke, duke u ndalur veçanërisht tek formimi i “autonomisë vorio-epirote”<sup>1</sup> të Zografosit si një demonstrim të dëshirave të popullit të këtyre trevave për t’u bashkuar me Greqinë.

Por këto trajtime kishin ndeshur me diskutimet e pjesëtarëve të tjerë të Komisionit, të cilët ishin të mendimit se qeveria epirote nuk përfaqësonte dëshirat e popullit jugor të Shqipërisë. Në këto treva, sipas përfaqësuesit italian, ishin bërë masakra nga më çnjerëzoret, duke organizuar shpërnguljet me forcë të popullsisë nga trevat e tyre.

Në këtë seancë dallon qëndrimi disi i tërhequr i përfaqësuesit anglez, Sir Eyre Crowe (Eir Krou). Ai foli mbas një heshtje të gjatë, duke thënë se do të shprehej pasi të priste rezultatet që do të dilnin pas një trajtimi të hollësishëm të çështjes. Por ai shtoi se “krijohet përshtypja se në këto krahina ka një ndjenjë simpatie fare të qartë, sidomos në bregdet, në favor të Greqisë”<sup>2</sup>.

Në këtë mbledhje u shfaqën në përgjithësi një këmbim paraprak idesh dhe pikëpamjesh, por, në të vërtetë, u dalluan dy grupime: njëri i përfaqësuar nga delegatët francezë dhe anglezë, të cilët dukeshin qartas në mbështetje të interesave greke, tjetri kundër këtyre qëndrimeve e që u shpreh hapur nga përfaqësuesi amerikan Day (Dej). Ai deklaroi se e kishte të vështirë të pranonte mundësinë e zgjedhjes sipas variantit të propozuar nga Venizellosi për çështjen e kufijve, sepse, sipas mendimit të tij, kufijtë politike nuk përkojnë me kufijtë etnikë.

De Martino, përfaqësuesi i Italisë, u paraqit si njohës i mirë i problemit, duke sjellë një sërë argumentesh që kundërshtonin kërkesat greke. Ai duket se ishte më afër trajtimit real të çështjes kur, ndër të tjera, mendonte se kombësia shqiptare nuk mund të përcaktohej lehtë, dhe feja në Shqipëri nuk ishte një element përcaktues: “Në veri ka katolikë që janë shqiptarë, - vinte ai në dukje - sikurse në jug të fesë ortodokse. Lidhur me statistikën, ne vëmë në dispozicion të komisionit disa punime të kryera tani së fundmi nga autoritetet italiane që pushtojnë krahinën që kërkohet nga grekët. Bashkohem me vërejtjen e bërë nga delegacionet amerikane dhe angleze; duhet së pari të dëgjojmë jo vetëm të interesuarit, por edhe personat që kanë udhëtuar në këto vise dhe që janë në gjendje të shprehin një opinion serioz dhe të pranueshëm”<sup>3</sup>.

---

1 - Më 2 mars 1914 në Gjirokastrë, ish ministri i jashtëm i qeverisë së Athinës, J. Zografos, krijoi një qeveri të përkohshme të Vorioepirit si mekanizëm për të rishtruar edhe njëherë në arenën ndërkombëtare çështjen e pretendimeve greke në jugun e Shqipërisë.

2 - Po aty.

3 - Arben Puto - Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare pas Luftës së Parë Botërore. Vëll. III (1919-1926), Tiranë 2001, f. 116.



Trajtimi i çështjes mori karakter më të dukshëm për faktin se në Komision bënte pjesë edhe Kastoldi, i cili mbrojti pikpamjen se, duhej përjashtuar kriteri fetar si element bazë i kombësisë, duke ngarkuar Komisionin të bazohej para së gjithash tek gjuha. Procesverbalet dhe hartat u përcaktuan mbi këtë bazë, në shpjegimin e tendencave, të cilat tregonin ndryshimin e raporteve midis popullsisë me besim ortodoks dhe asaj me besim mysliman.

Ndërsa në seancën e dytë, më 18 shkurt 1919, delegacioni amerikan iu referua “një vije të hequr në një hartë të veçantë”<sup>1</sup>. Kjo vijë kishte si fillësë dy parime:

- Parimi i parë, kishte për synim të ruante rrugët e komunikimit për shqiptarët dhe grekët. Të parët kishin si drejtim Vlorën, ndërsa të dytët rrugën drejt Janinës.

- Parimi i dytë, kishte për qëllim të ndante kufijtë e dy popujve sipas përbërjes së popullsisë.

Por delegacioni amerikan duket se, nëpërmjet disa argumenteve të shprehur me anë shifrash, dilte në konkluzionin se popullsia e veriut shqiptar ishte tërësisht shqiptare, ndërsa pjesën jugore ai ia njihte Greqisë, e këtu është fjala për Gjirokastrën. Por delegatët e SHBA e kishin të vështirë të ishin kategorikë. Pra, ishte e nevojshme, sipas delegacionit, që edhe për interesa më të përgjithshme të mos i jepet asgjë Greqisë pa e studiuar problemin në tërësinë e vet.

Delegacioni anglez ishte i mendimit se Himara, Gjirokastra, Delvina, Saranda ishin plotësisht greke nga gjuha dhe ndjenjat, dhe Protokollin e Firences kishte shkaktuar kundërshtime nga propaganda greke, dhe popullsia jugore shqiptare dëshironte bashkimin me Greqinë. Por, nga ana tjetër, anglezët mendonin se në rrethet e Leskovikut, Kolonjës dhe Korçës etnia shqiptare përbënte shumicën.

Duke rezervuar opinionin se, do të ishte e pamundur të mbahej përsëri kufiri i Protokollit të Firences. Kjo thjesht për shkak të kundërshtimit që kishte gjetur ky kufi nga propaganda greke jashtë Shqipërisë. Për rrjedhojë, ata bazoheshin në argumentin se kishte një pjesë të rëndësishme të Shqipërisë së Jugut që dëshironte bashkimin me Greqinë. Vija që ata dëshironin ishte një kombinim i dëshirave dhe interesave të popullsisë shqiptare dhe të asaj greke.

Delegatët e Italisë sollën në komision argumente që lidheshin me përbërjen e popullsisë së krahinave që diskutoheshin.

---

<sup>1</sup> - AQSH. Fondi Kristo Dako, dosja nr. 7, viti 1918-1920, f. 1. Studim i Nikolla Ivanajt: Mandati mbi Shqipërinë.

Për këtë ata iu referuan statistikave të hartuara nga konsullata austro-hungareze në Janinë, por edhe statistikave më të freskëta, atyre italiane të vitit 1918. Nga krahasimet e dokumenteve përkatës dilte se pakësimi i elementit mysliman “shpjegohet me persekutimet e regjimit epirot”<sup>1</sup> që, nëpërmjet ndryshimit të fizionomisë fetare, synonte të ndryshonte përbërjen e vet strukturës etnike. Duket se delegacioni italian ishte afër të vërtetës. Ja si e konceptonte këtë çështje atasheu teknik i delegacionit italian në Paris: “Unë nuk mohoj që në distriktin e Gjirokastrës ka një popullsi greke prej 15.000 frymësh; por ajo gjendet e lidhur me një masë prej 152.497 shqiptarësh”<sup>2</sup>. Këtu shqetësimi qëndron në lakueshmërinë e një dëshire për të ndryshuar dhe për të “ngatërruar cilësinë greke me atë të ortodoksisë”<sup>3</sup>.

Por, sipas Kastoldit, ishte e pamundur të ndryshohej fizionomia etnike, sepse të gjithë myslimanët ishin në mënyrë të padiskutueshme shqiptarë, dhe të krishterët nuk ishin pa diskutim grekë. Delegacioni italian mbronte kufijtë politikë të vendosur në vitin 1913 dhe që i afroreshin më shumë një ndarjeje të drejtë midis Shqipërisë dhe Greqisë. Kjo vijë kufitare i përgjigjej arsyeve etnike dhe vetëm ajo mund të siguronte një paqe të qëndrueshme. Ndërsa delegacioni francez e konsideronte një “ogur të mirë” krijimin e një shumice në përbërjen e Komisionit, për të bërë të mundur përcaktimin e një prej krahinave më të rëndësishme, siç ishte ajo e “Epirit të veriut”, gjithnjë në favor të Greqisë.

Sipas diplomacisë franceze, kriteri bazë në zgjidhjen e çështjes duhet të ishte vetëm elementi fetar<sup>4</sup>, megjithëse konfliktet fetare – po sipas saj - nuk kishin qenë në natyrën e trevës epirote, gjë që nuk do të thoshte që propaganda fetare të mos nxitej nga jashtë. Prandaj, zgjidhjen e problemit e shikonin në ndarjen fetare. Ata që ishin myslimanë duhej të ishin në anën e Shqipërisë, ndërsa ata që ishin të krishterë të kalonin në anën e Greqisë. Po sipas këtij delegacioni, një problem thelb të cilit i duhej kushtuar vëmendja e duhur ishte “rruga e Sarandës”<sup>5</sup>.

Në seancën e 26 shkurtit 1919 denigrimi i çështjes shqiptare ishte edhe më i rëndë. Kryetari shtroi çështjen nëse duhej dëgjuar delegacioni shqiptar, me të cilin barazonte dhe përfaqësuesit e “qeverisë vorio-epiriote”. Ndërsa francezët gjykuan se nuk kishte një delegacion zyrtar shqiptar, përderisa nuk ekzistonte një qeveri shqiptare e njohur.

---

1 - *Po aty.*

2 - AMJ. Viti 1919, dosja nr. 5, fleta 28 (frëngjisht).

3 - AMJ. Viti 1919, dosja nr. 5, fleta 30 (frëngjisht).

4 - *Arben Puto - Historia e diplomacisë shqiptare. Tiranë 1986, f. 218.*

5 - *Arben Puto - Historia e diplomacisë shqiptare - Tiranë 1986, f. 283.*

Kishte, sipas tij, vetëm një qeveri fakti, “e cila nuk mund të vihet në pozita të barabarta me qeverinë greke”<sup>1</sup>. Pas kundërshtimit të delegacionit amerikan, i cili kërkoi që të dëgjohej edhe delegacioni shqiptar

Ishte me rëndësi fakti që përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha dëgjuan edhe zërin e shqiptarëve. Ky është një moment historik që duhet vlerësuar, sepse ky është një ndër hapat e parë në angazhimin diplomatik të faktorit shqiptar për rimëkëmbjen e shtetit pas Luftës së Parë Botërore. Pikërisht kjo është fillesa e një beteje diplomatike për shpëtimin e Shqipërisë nga copëtimi i mundshëm.

Në seancën e 4 marsit 1919 delegacioni amerikan për krahinën që shtrihej midis Drinos dhe Vjosës bënte lëshime, me qëllim që vija e sugjeruar nga Amerika të takohej me vijën e propozuar nga Franca dhe Anglia. Ishte fjala për Gjirokastrën, që delegacioni amerikan kishte pranuar t’i lihej Greqisë. Ndërsa për vijën kufitare drejt veriut ishte kategorik, duke mos pranuar vijën e propozuar nga delegacioni francez për të përfshirë qytetin e Korçës<sup>2</sup>.

Kurse delegacioni anglez pranonte që në trevat e diskutueshme, kishte elementë shumë të rëndësishëm shqiptarë nga pikëpamja e numrit. Ai mendonte se duhet të adaptohej një politikë në përshtatje me interesat e këtyre trojeve, në mënyrë që “të mbështesim kërkesat greke”<sup>3</sup> edhe nëse ndodhte që popullsia të mos kishte dëshirën e bashkimit me Greqinë. Sepse, pavarësisht arsyeve të tjera, “nuk duhet të harrohet - vazhdonte delegacioni anglez - aftësia e madhe asimiluese e popullit grek”<sup>4</sup>.

Delegacioni italian, duke përsëritur se Proklamata e Gjirokastrës kishte të bënte me një mbrojtje në kushtet e luftës, e konsideroi atë një akt të çastit të një autoriteti ushtarak. Por delegacioni italian gjeti mundësinë të shpaloste programin e vet për Shqipërinë në rrethana të reja në një kohë të re, lidhur me kujdesin e një fuqie tjetër mbi Shqipërinë, vetëm e vetëm përse i përket marrëdhënieve të jashtme. Në këtë fokusim politika italiane i referohej Traktatit të fshehtë të Londrës, i cili e ngarkonte Italinë me përfaqësimin e Shqipërisë në marrëdhëniet e jashtme<sup>5</sup>.

Ndërsa seanca e 6 marsit 1919 kishte ballafaquar pikëpamjet e Fuqive të Mëdha për problematikën që kishte mbartur çështja e “Epirit të Veriut”. Delegacioni italian krahasonte popullsinë e kësaj treve midis myslimanëve dhe të krishterëve, e cila ishte në favor të myslimanëve dhe njëherësh, s’mungonte ndjenja kombëtare shqiptare e pjesës më të madhe të popullsisë së krishterë.

---

1 - *Po aty*.

2 - *Arben Puto - Historia e diplomacisë shqiptare. Tiranë 1986, f. 292.*

3 - *Albania, Worcester, janar 1920, f. 2.*

4 - *Arben Puto - Historia e diplomacisë shqiptare. Tiranë 1986, f. 298.*

5 - *Arben Puto - Historia e diplomacisë shqiptare. Tiranë 2003, f. 300.*

Dhe se shqiptarët e kishin “treguar mëse një herë lidhjet e tyre me idenë kombëtare dhe me gjuhën”<sup>1</sup>.

Ndërsa, sipas delegacionit britanik dhe francez, statistikat që ishin bërë nuk jepnin “një kriter të besueshëm për dëshirat e popullsisë që trajtojnë”<sup>2</sup>, ato, sipas tyre, ishin bazuar vetëm në të dhënat e fesë dhe të gjuhës, të parat ishin të pafavorshme për shqiptarët, kurse të dytat nuk ishin të drejta për grekët. Dhe kishin treguar impresion ndaj shpjegimeve të Venizellosit dhe Karapanos. Delegacioni i Shteteve të Bashkuara të Amerikës mendonte se nuk mund të pranonte si një provë të mjaftueshme historinë e trazirave të shtetit shqiptar, të cilat ishin nxitur nga të huajt. Përkundrazi i kishte bazuar konkluzionet mbi raportet e vëzhguesve dhe të statistikave që ata dispononin.

Ishte një seancë konkluduese përsa i përket kufirit midis Shqipërisë dhe Greqisë. Nëpërmjet raportit përmbledhës, duket se kishte të bënte me një trajtim tendencioz të çështjes së kufirit shqiptaro-grek, trajtuar sipas formulimit që ishte futur në modë nga Fuqitë e Mëdha, “Epiri i Veriut”, gjë që favorizonte interesat e politikës greke.

Në fund të seancës, kryetari theksoi se Këshilli i Lartë fillimisht e kishte ngarkuar Komisionin me shqyrtimin e çështjes shqiptare. Në këtë kuadër, delegati britanik Krou rekomandoi që Komisioni duhet të ndërpriste punimet përsa i përket Shqipërisë së Veriut. Ai e gjeti të udhës t’i referohej Traktatit të fshehtë të Londrës, i cili parashikonte kontrollin italian, por “linte të hapur problemin nëse kjo pjesë e Shqipërisë do t’i jepej Jugosllavisë apo Italisë”<sup>3</sup>. Për rrjedhojë, trajtimi i delegacionit anglez ishte një çështje që kishte të bënte me kufijtë e ardhshëm të Italisë, dhe për pasojë duhet t’i kalonte për vendim Këshillit të Lartë.

Një tjetër çështje ishte ajo e statusin të Shqipërisë pas lufte. Ajo u prek tërthorazi jo më pak se një herë në kohën e debatit mbi kufirin jugor, ku të tërheq vëmendjen fakti se Fuqive të Mëdha u vinte për shtat përpunimi i një koncepti paragjykses, duke bërë fjalë për paaftësinë e shqiptarëve për vetëqeverisje. Për pasojë, u fol për vendosjen e saj nën kujdesin e një fuqie.

---

1 - Arben Puto, *Çështja shqiptare në Aktet Ndërkombëtare pas Luftës së Parë Botërore, III, Tiranë 2001, f. 202 - Në mbështetje të këtyre argumenteve, Delegacioni italian sjell edhe një botim francez. Ministria e Luftës (Komisioni i gjeografisë pranë Shërbimit gjeografik të Ushtrisë) ka botuar në 1915, një broshurë me titull “Shënime për Shqipërinë dhe Malin e Zi”, që konfirmon pikëpamjen italiane. Broshurës i bashkangjitet edhe një hartë, e cila bën fjalë për racat dhe fenë dhe sipas saj banorët grekë formojnë vetëm dy grupe të vogla në rrethet e Gjirokastër e të Delvinës dhe kjo i përgjigjej krejt së vërtetës” (Delegacioni italian lidhur me Epirin e Veriut). Shtojca II. Po aty, f. 203.*

2 - Po aty, f. 197.

3 - Po aty.

Mendohej se për këtë do të ishte më e përshtatshme Italia. Këtij problemi nuk iu shmang edhe delegacioni zyrtar, duke e konsideruar vendosjen e kujdesit “si një mjet për t’i shpëtuar një cungimi të ri të tokave shqiptare në dobi të shteteve fqinjë”<sup>1</sup>. Pra ishte duke u përcaktuar më qartë koncepti i mandatit, si një formë e kontrollit që Fuqitë e Mëdha do të vendosnin mbi disa prej ish- kolonive në Afrikë. Kjo ishte një gjë e papranueshme për shqiptarët. Në mënyrë të menjëhershme, ata iu përgjigjën “se Shqipëria do të pranonte vetëm një kujdestar që do ta ndihmonte atë të hidhte hapat e parë në rrugën e mëvetësisë”<sup>2</sup>.

Ndërsa Uillsoni në Memorandumin e 14 prill 1919, kërkonte autonomi për shtete të ndryshme që kishin qenë dikur pjesë përbërëse të Perandorisë Austro-Hungareze dhe “vështrimi im është se tani u duhej lënë popujve të ndryshëm të këtyre rajoneve që të vendosin se si do të jetë fati i tyre dhe raportet e tyre politike. Dhe ata duke gëzuar simpatinë e mbarë botës, zgjodhën të drejtohen si shtete të pavarura”<sup>3</sup>. Dhe më poshtë vazhdonte se do të bihej dakort që fortifikimet e ndritura për motive ushtarake në ishujt e “bregdetit lindor të Adriatikut do të shkatërrohen përfundimisht duke pasur garanci ndërkombëtare, se çarmatimi do të kryhet në mbikqyrjen e Lidhjes së Kombeve”<sup>4</sup>. Nëpërmjet këtyre konkluzioneve Italia siguronte rregullimin e padrejtësive historike që kishte hequr nga Austro-Hungaria dhe nga një varg transaksionesh të padrejta.

Memorandumi rekomandonte një politikë të re në arkipelagun e Adriatikut dhe në bregun lindor të këtij deti ku “gjendeshin grupime që përmbanin elementë të konsiderueshëm të popullsisë italiane, por zotimet me të cilat shtetet e reja po futeshin në familjen e kombeve, do të sigurojnë fortas lirinë, zhvillimin dhe të gjitha të drejtat e arsyeshme të pakicave kombëtare ose racore”<sup>5</sup>. Dhe në sigurinë e këtyre rregullimeve do të qëndronte autoriteti i Lidhjes së Kombeve, kështu do të evitohej gabimi që do të konsistonte në krijimin në lindje të Italisë “të fqinjëve armiq dhe do të ushqente frymën e padrejtësisë”<sup>6</sup> që kishte trazuar paqen në Europë dhe provokimin e konflikteve. Ndërsa në takimin e Pashiçit me Uillsonin në 17 prill 1919, jugosllavët e shprehën hapur politikën e tyre nëpërmjet sloganit “Ballkani për ballkanasit”, sepse sipas tyre, do të bënin të mundur largimin e interesave italiane nga Shqipëria.

---

1 - AMJ. Viti 1919, dosja 10, f. 48-49.

2 - Muin Çami - Lufta e popullit shqiptar 1918-1920, v. II, f. 219-220.

3 - *La Question Adriatique - Recueil de documents officiels - Paris 1920 - Imprimerie Typographique 3, rue de pondichery, 3(xve), f. 44.*

4 - *vepër e përmendur, f. 46 (memorandum de President Willson a la Delegation italienne, du 14 avril 1919).*

5 - *Po aty, f. 46.*

6 - *Po aty, f. 47.*

Duke e parë në këtë fokus, politika jugosllave ishte munduar të fitonte mbështetjen e Uillsonit lidhur me bashkimin doganor, politik dhe ushtarak të Jugosllavisë me Shqipërinë. Por, duke parë pozitën e Italisë dhe të Jugosllavisë, mund të thuhet se Italia ishte e njohur si faktor politik më me influencë në Ballkan dhe me interesa më të gjera, ndërsa shteti jugosllav nuk mund të ishte i njëjtë me rolin e Italisë.

Në këto kushte, më 23 prill 1919 Uillsoni deklaronte themelimin e një paqeje të definuar qartë, në funksion të një “rendi të ri të së drejtës dhe drejtësisë”, për më tepër që Konferenca në Paris kishte vendosur paqen me Austrinë. Uillsoni shtonte se “nuk mund t’i kërkojmë asaj të vendosë mbi parime të tjera, një bazë të re për pavarësinë e të drejtën e shteteve që fillimisht përbënin Perandorinë Austro-Hungareze, dhe një tjetër për grupin e shteteve ballkanike<sup>1</sup>”, dhe vija që shënohej nga Traktati i Londrës ndiqte në mënyrë të parregullt një numër të madh ishujsh të bregdetit lindor të Adriatikut, nuk ishte për faktin se në këta ishuj dhe bregdet, ndodheshin grupime popullatash me gjak italian. Por ishte e nevojshme që Italia duhej të kishte një pikë mbështetje në mesin e kanalave të Adriatikut lindor për të siguruar kufijtë e bregdetit të vet lindor nga ndonjë agresion i mundshëm austro-hungarez. Atëherë në kushtet e mbasluftës, kur kjo fuqi ushtarake nuk ekzistonte më, sipas Uillsonit, plani i ri që kishte për qëllim të vendoste “rendin e ri në Europë dhe ka për qendër Lidhjen e Kombeve<sup>2</sup>” nënkuptonte se shtetet e reja që do të formoheshin në këtë rajon do të pranonin kufizimin e armatimit, që do të evitonte dhe do ta bënte të pamundur agresionin.

Megjithatë atmosfera në Konferencën e Paqes ishte tensionuar midis Italisë dhe SHBA për shkak se Italia ish duke iu cënuar interesat e saj në Adriatik. Në këtë angazhim të SHBA për zgjidhjen e problemeve që kishin në Konferencë, duke u munduar të përjashtonte rregullat e vjetra diplomatike, ajo i kishte bërë thirrje Italisë që “ajo (Italia) të vendoste të rrethohej tani e tutje nga vende miq, t’u tregonte popujve të çliruar sërish ndenjta më fisnike të shpirtmadhësisë bujare e miqësore dhe parapëlqimin për drejtësi në vend të interesit të ngushtë<sup>3</sup>”. Ndërsa Franca dhe Anglia, të prirura të mbështesnin shtetin e Jugosllavisë dhe pastaj ta përdornin atë si kundërpeshë ndaj Italisë, nuk u dhanë përkrahje të plotë pretendimeve italiane në Adriatikon Lindor. Sikurse i shkruante Forin Ofisit anëtar i delegacionit anglez në Konferencë,

---

1 - *Po aty, f. 48 (Declarations du President Willson sur la questin de Adriatique , du 23 avril 1919).*

2 - *Po aty, f. 50.*

3 - *Po aty, f. 50.*

Krou, Jugosllavia do të përdorte Shqipërinë si një levë “në mënyrë krejt legjitime për të shkëputur konçesione nga Italia”<sup>1</sup>. Jugosllavia për të nxjerrë përfitime nga një copëtim i mundshëm i Shqipërisë, në maj-qershor 1919 i kishte paraqitur Fuqive të Mëdha notën ku kërkonte që kufiri shqiptaro-jugosllav të kalonte në Drinin e Zi deri në bashkimin e tij me Drinin e Bardhë dhe që andej të ndiqte rrjedhën e tij deri në Adriatik. Kurse dy notat e tjera, të 27 majit dhe 10 qershorit, përsërisnin alternativën “në rast se Italia do të ishte e pranishme në Shqipëri, Jugosllavia do të ushtronte të drejtën e saj për të aneksuar territoret shqiptare në anën e djathtë të Drinit”<sup>2</sup>.

Në 30 maj 1919 koloneli Hauz e ftoi delegacionin serbo-kroato-slloven në një takim, ku morën pjesë anëtarët e delegacionit amerikan, me përjashtim të Presidentit Uillon. Me këtë rast delegacioni amerikan komunikoi një projekt për zgjidhjen e çështjes së Adriatikut. Pika kryesore e këtij projekti qëndronte në krijimin e një shteti të përkohshëm të pavarur, që do të ishte një shtet tampon midis Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve e Sllovenëve dhe Mbretërisë Italiane. Fati përfundimtar i këtyre territoreve do të zgjidhej me plebishtin pas pesëmbëdhjetë vjetësh. Në shtyp ky projekt u quajt “Projekti Tardie”<sup>3</sup>. Koloneli Hauz i deklaroi shprehimisht delegacionit serbo-kroato-slloven se projekti nuk vinte nga Presidenti Uillon. Por nëqoftëse shteti serbo-kroato-slloven dhe Italia do të binin dakort mbi bazën e këtij projekti, Presidenti nuk do ta kundërshtonte.

Në fund të qershorit 1919 kishte mbaruar faza e parë e Konferencës së Paqes, në të cilën u trajtua çështja e Adriatikut Verior që kishte rezultuar në

konfliktin italo-jugosllav në Konferencë<sup>4</sup>. Në fakt, në zonën e Adriatikut Jugor çështja shqiptare shfaqet përsëri në skenë. Ministri i jashtëm Tomaso Titoni, i cili sa kishte zënë postin, hyri përnjëherë në marrëveshje me kryeministrin grek Venizellos dhe arriti të nënshkruante një traktat më 29 korrik 1919. Ky traktat bënte të mundur që Italia të hiqte dorë nga kundërshtimi i pretendimeve të hershme greke mbi Shqipërinë Jugore, dhe Greqia të ishte e lirë në pretendimet e saj. Të dy shtetet angazhoheshin të përkrahnin njëri-tjetrin në Konferencën e Paqes që Italia të siguronte mandatin mbi shtetin shqiptar dhe Greqia “Vorio Epirin”.

---

1 - *Historia e Shqipërisë III – Tiranë 1986, f. 199.*

2 - *Arben Puto - Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare V, III, Tiranë 2001, f. 239.*

3 - *vepër e përmendur, f. 52, (Le project Tardieu).*

4 - *I vazhdoi punimet në nivel më të ulët, në rangun e ministrave të jashtëm për Anglinë, Francën, ndërsa SHBA u mjaftua me një përfaqësues. Çështjet diskutoheshin por duhet të merrnin miratimin e eprorëve në Londër, Romë, Uashington. (Arben Puto "Shqipëria Politike", Tiranë 2009, f. 200).*

Por kjo lëvizje midis dy shteteve fqinje të Shqipërisë, në dukje e veçuar, e kishte bërë efektin e saj. Anglia dhe Franca, të shqetësuara për çështjen e jugut të Adriatikut, që mund t'u dilte nga influenza, i shtuan presionet kundrejt SHBA dhe për rrjedhojë ishte arritur memorandumi i përbashkët anglo-franko-amerikan në 9 dhjetor 1919. Fuqitë e Mëdha përcaktuan një formulë të re të përbashkët anglo-franko-amerikane<sup>1</sup>. Aty i kushtohej një vëmendje e veçantë problemit shqiptar dhe Italia bënte të mundur realizimin e planit të saj për Shqipërinë.

Sipas këtij memorandumi, Italia do të merrte mandatin mbi Shqipërinë nëpërmjet Lidhjes së Kombeve. Fuqitë nënshkruese “njihnin pavarësinë e shtetit shqiptar”<sup>2</sup>, por nga ana tjetër shtohej se Shqipëria duhej të kishte nevojë për këshillat dhe ndihmën administrative të Fuqive të Mëdha.

---

*1 - I njohur si Memorandumi anglo-franko-amerikan, Paris 9 dhjetor 1919, në lidhje me përcaktimin e shtetit të ardhshëm shqiptar. Shkëpusim nga ky memorandum pjesët që lidhen me kufijtë dhe mandatin italian:*

*“...5. Italisë do t'i jepet nga Lidhja e Kombeve mandati për administrimin e shtetit të pavarur të Shqipërisë. Këtij memorandumi i bashkangjitet një projekt mbi formën e këtij mandati, ashtu siç mendojnë tre përfaqësuesit e poshtëshënuar. Kufijtë e Shqipërisë në veri dhe në lindje do të jenë ata që janë përcaktuar nga Konferenca e Londrës më 1913. Kufiri i jugut do të vendoset me anë bisedimesh. Megjithatë, për të mos e vonuar rregullimin e përgjithshëm të këtij problemi me anë bisedimesh, mund të zbatohet përkohësisht kjo marrëveshje e hollësishme:*

*- Greqia do të pushtojë tokat që shtrihen në perëndim dhe në jug të vijës së demarkacionit që kalon pikat vijuese (jepen hartat e shtatmadhorisë austriake): Nga mali Tomba, që ndodhet në kufirin lindor të Greqisë, në drejtim të veriperëndimit, gjatë majës së malit Nëmërçkë deri në Vjosë. Së këndejmi duke ndjekur rrjedhën e këtij lumi nëpër Tepelenë dhe Mirë, deri në kuotën 98; së këndejmi në drejtim të jugut, duke kaluar nëpër fshatrat Lopës-Martaloz dhe Dhëmban; së këndejmi, duke kaluar nëpër kuotat 1840 dhe 1225, deri në pikën e vendosur rreth 3 kilometra në juglindje të kuotës 1225; së këndejmi në drejtim të veriperëndimit, duke kaluar menjëherë në veri të Poljanit; së këndejmi në drejtim të juglindjes deri në kuotën 1669; së këndejmi në drejtim të perëndimit dhe të veriperëndimit deri në kuotën 2025; së këndejmi në drejtim të jugperëndimit, deri në kuotën që ndodhet menjëherë në jug të Aspri Rugës.*

*- Trekëndëshi i përfshirë midis vijës që shkon nga kuota 98 mbi lumin Vjosë (midis Babës dhe Sinanajt) deri në liqenin e Maliqit, në verilindje; vija që shkon nga veriu në jug të liqenit të Maliqit deri në kufirin grek dhe vija e demarkacionit e përmendur më sipër do të përcaktohen përfundimisht mbas bisedimeve të mëtejshme që do të zhvillojnë midis tyre nga njëra anë tre përfaqësuesit aleatë të poshtëshënuar, dhe Italia e Greqia nga ana tjetër; tre përfaqësuesit aleatë do të veprojnë në emër dhe për llogari të Shqipërisë.*

*- Qyteti i Vlorës së bashku me hinterlandin me të vërtetë të domosdoshëm për mbrojtjen dhe zhvillimin e tij, do të kalojnë në sovranitetin e plotë të Italisë...*

*Nënshkruar Zh. Klemanso, Frank Polk dhe Ejr A. Krou. (Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar 1918-1920, përmbledhje dokumentesh).*

*2 - La Postione Adriatika 1919-1920, Milano, f. 14.*



Për pasojë, sipas tyre, vetë pozita gjeografike dhe kapacitetet ekonomike të Shqipërisë e përcaktonin Italinë në pozicionin e fuqisë kujdestare. Kurse, në mënyrë më të drejtpërdrejtë, memorandumit shprehej hapur që Italia të merrte në sovranitet të plotë Vlorën dhe hinterlandin e saj.

Favor shumë i madh i bëhej Greqisë, duke parashikuar që çështja e kufijve jugorë të lihej e hapur dhe të ishte objekt i diskutimeve të mëtejshme, duke e quajtur këtë një rregullim të përkohshëm. Por disa koncesione i njiheshin edhe shtetit serbo-kroato-sloven, të cilit i liheshin mundësi për të ndërtuar dhe shfrytëzuar rrugën hekurudhore në veri të Shqipërisë, shoqëruar me një kontroll në lumin e Bunës. Pra, në thelb, ky memorandum nuk ndryshonte shumë nga traktatet e para Luftës së Parë Botërore.

Ai duket se ka një zhvillim të papritur sepse mbante edhe firmën e Uillonit dhe shija më e hidhur e tij, ishte se rikthehej edhe një herë teza e papjekurisë së shqiptarëve për të formuar shtet, gjë që, për pasojë, legjitimonte ndërhyrjen e faktorit ndërkombëtar.

Ndërkaq, memorandumit anglo-franko-amerikan të 9 dhjetorit 1919, politika italiane nuk vonoi dhe iu përgjigj me një memorandum në 3 janar 1920, ku kërkonte liri veprimi si në problemin e kufijve dhe në çështjen e mandatit<sup>1</sup>. Aty vëmendja e Italisë përqëndrohej në dy elementë: së pari, në krye të forcave të rendit do të viheshin funksionarë të fuqisë mandatore; së dyti, Italia do të mbante trupat e saj në Shqipëri për një periudhë pesëvjeçare.

Por çështja do të merrte një kthesë të re pas marrëveshjes së 14 janarit 1920 mes kryeministrit italian Niti, atij britanik Llojd Xhorxh dhe atij francez Klemanso. Ndërkohë që në këtë marrëveshje nuk mori pjesë përfaqësuesi amerikan. Qëllimi i kësaj marrëveshje ishte rregullimi i “çështjes së Adriatikut” dhe përqëndrohej në problemet që ndanin Romën me Beogradin. Sipas saj, Italia do të merrte nga Lidhja e Kombeve mandatin mbi Shqipërinë, pjesa veriore e saj i kalonte Jugosllavisë, duke përfshirë Shkodrën, Shëngjinin dhe luginën e Drinit, ndërsa jugu me Korçën e Gjirokastrën i jepeshin Greqisë. Me këtë marrëveshje çështja shqiptare merrte goditjen më të rëndë dhe territori i Shqipërisë ndahej midis tre shtetesh fqinjë dhe ajo humbiste pavarësinë.

Kjo marrëveshje solli krizën në marrëdhëniet mes delegacionit amerikan dhe atyre britanik e francez, për shkak të qëndrimeve të ndryshme në lidhje me të ashtuquajturën “çështje e Adriatikut”, çështje e cila që herët përbënte një konflikt të mprehtë dhe të veçantë mes fuqive.

---

*1 - Protektorati është një lidhje vartësie më e qëndrueshme sesa mandati, ai vendoset me marrëveshje dypalëshe midis fuqive të mëdha (protektore) dhe shtetit të vogël (i protektuar). Arben Puto, E drejta ndërkombëtare publike, f. 124-127.*

Ajo kishte të bënte me ndarjen e influencave pas Luftës së Parë Botërore dhe vinte përballë njëra-tjetrës Italinë dhe Jugosllavinë.

Meqenëse kjo çështje lidhej dhe ndikonte drejtpërdrejtë mbi fatin e Shqipërisë, po ndalemi më gjerësisht në trajtimin e saj. Projekti i 14 janarit ishte varianti më i papërshtatshëm për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare. Në kundërshtim me të ishte edhe Jugosllavia, e cila vendosjen e ushtisë italiane në Shqipëri e shikonte si një problem të madh për kufijtë e saj jugorë. Ndërsa Trumbiçi në mes të janarit 1920, i shqetësuar, mendonte se, po të vihej në zbatim projekti i 14 janarit, Shqipëria ishte e destinuar të bëhej pikënisje për aksione ofensive kundër Jugosllavisë. Ndërsa në 20 janar 1920 qeveria jugosllave propozonte që “administrimi i Shqipërisë t’i lihej një qeverie vendase pa ndërhyrjen e një fuqie të huaj”<sup>1</sup>. Megjithatë, Beogradi jepte dhe alternativën tjetër “nëqoftëse kjo zgjidhje nuk do të pranohej dhe, për pasojë, do të vendosej përsëri copëtimi i tokave shqiptare, Jugosllavia do të kërkonte pjesën e saj në kufirin verior”<sup>2</sup>.

Qeveria amerikane nëpërmjet memorandumit të 20 janar 1920, drejtuar Llojd Xhorxhit dhe Klemansosë, bënte vërejtje se nuk do të njihte asnjë vendim që do të binte ndesh me politikën amerikane dhe problemet e krijuara duhej të rregulloheshin nëpërmjet rrugës diplomatike. Ndërsa kryeministrat e Francës dhe Anglisë u përgjigjën më 22 janar, përgjigje e cila konsistonte në justifikimin e tyre në lidhje me administrimin e Italisë, Jugosllavisë dhe Greqisë, se nuk ishin hartuar ende, por më me interes ishte fakti se përgjigjia theksonte që nuk do të liheshin pa u marrë parasysh edhe ndjenjat dhe interesat e ardhshme të popullit shqiptar<sup>3</sup>.

Ndërsa Uillsoni në 10 shkurt 1920 i drejtohej kryeministrave të Francës dhe Anglisë, duke iu kujtuar edhe një herë qëndrimin e tij në Konferencën e Paqes dhe ndalej në akordin e 14 janarit, i cili e vlerësonte si një rikthim tek Traktati i Fshehtë të Londrës dhe në mënyrë të hapur nuk respektonte elementët e drejtësisë, dhe konsideronte se parimi themelor për të cilin SHBA kishte luftuar, ishte që asnjë qeveri nuk kishte të drejtë të vendoste përkatësinë politike të një populli të caktuar. Ndërsa Qeveritë e Francës dhe Anglisë ishin munduar të justifikoheshin me paaftësinë e shqiptarëve për t’u vetëqeverisur dhe përgjegjësia duhet t’u jepej Jugosllavisë dhe Italisë.

---

1 - Arben Puto, “Shqipëria Politike”, Tiranë 2009, f. 204.

2 - Po aty, f. 204.

3 - *La Question -Recueil de documents officiels- Paris 1920, Imprimerie Tipographique, 3, rue de pondichery, (3 xve), f.118*

Uillsoni, nëpërmjet notës së 25 shkurtit 1920, kishte hedhur një qëndrim edhe më të fortë për mbrojtjen e Shqipërisë, duke sqaruar se ndarja e Shqipërisë në tri pjesë, ashtu si ishte parashikuar nga marrëveshja franko-angleze, mund të pranohej nga Jugosllavia. Por qeveria amerikane kundërshtonte „një zgjidhje që mund të dëmtojë shqiptarët për t’iu bërë qejfin jugosllavëve, sa dhe një zgjidhje që mund të cënonte interesat e Jugosllavisë në përfitim të Italisë“<sup>1</sup>.

Më 26 shkurt 1920 kryeministrat e Francës dhe Anglisë vinin në dijeni Presidentin Uillson se hiqnin dorë nga formulat e mëparëshme dhe kërkonin ndihmën e Presidentit që të merrte pjesë në përpilimin e një propozimi zyrtar, në mënyrë që të detyronin qeveritë e Italisë dhe Jugosllavisë të afroheshin në marrëveshje mbi konceptin e mohimit të të gjithave propozimeve të mëparshme. Ndërsa më 6 mars 1920, Uillsoni rekomandonte që tu lihej qeverive jugosllave dhe italiane që të zgjidhnin vetë kufirin midis tyre, por nuk anashkalohej çështja shqiptare. Duke deklaruar se nuk mund të pranonte asnjë plan, nëpërmjet të cilit mund t’i jepej Jugosllavisë një kompensim territorial në pjesën veriore të Shqipërisë për të zëvendësuar ndonjë pjesë që mund t’i shkëputej asaj gjatë<sup>2</sup>.

Pra, Shqipëria ishte vendi ku u nyjëzuan dhe u diferencuan nga njëri-tjetri dy sisteme të kundërt dhe për këtë po i referohemi Henri Kisinger që, sipas tij, filozofia e liderit politik europian nuk kishte kategori mendimi për të kuptuar pikëpamje Uillsoniane, të cilat ishin prodhuar, në një botë politike pa nacionalizma<sup>3</sup>. Për ta konceptuar me emirikisht anaizën e shkencore të kohës, që jemi duke analizuar po i referohemi Uillsonit përmes disa ideve të hedhura në Kongresin Amerikan përpara se të rrugëtonte për në Konferencën e Paqes në Paris:

1. Rregulli përfundimtar duhet të mbështetet mbi atë çka përbën drejtësinë e vërtetë për çdo rast të veçantë dhe ndreqjet të jenë shumë të sakta, në mënyrë që të përfitohet një paqe përfundimtare.

2. Popujt dhe provincat nuk duhet të këmbehen më midis qeverive sikur të jenë kope ose figura shahu, madje edhe kur bëhet fjalë për këtë skakierë të diskutuar përgjithmonë që quhet ekuilibër forcash.

3. Përkundrazi çdo rregullim territorial që ndodh për shkak të kësaj lufte, duhet të kryhet në interes dhe për dobinë e madhe të këtyre popujve në fjalë. Jo si klauzolë e thjeshtë e rregullimit apo kompromisit ndërmjet ambicieve të shteteve rivalë.

---

1 - Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare, v. III, 1919-1926, Tiranë 2001, f. 249.

2 - *La Question Adriatique –Recueil de documents officiels- Paris 1920*, 3, rue de Pondichery, 3(xve) f, 1552-155

3 - *La Question Adriatique – recueil de documents official - Paris 1920, Imprimerie Typographique 3, rue de pondichery, 3 (xve), f. 49 (Woodrow Willson).*

4. Duhet të kënaqen sa më mirë të gjitha aspiratat kombëtare të mirëpërcaktuara, duhet të shmanget futja e elementëve të rinj përçarës dhe antagonistë apo të përjetësohet ajo që ekzistonte dhe që nuk do ta linte pa dëmtuar një ditë paqen e Europës dhe të botës në përgjithësi.

Si konkluzion mund të themi se, Europa politikisht ishte duke përjetuar krizën institucioneve politike, për shkak se, ishte bazuar në një doktrinë politike së cilës i kishte kaluar koha, për rrjedhojë institucionet e brendshme europiane dhe rendi i saj ndërkombëtar nuk bazoheshin në teori politike që niseshin nga mirësia thelbësore e njeriut. Ato më tepër ishin krijuar për të vënë egoizmin politik në shërbim të një të mire më të lartë. Për pasojë logjike politika europiane nuk predikonte natyrën paqësore të shteteve, por prirjen e tyre për luftë, e cila ose duhet të dekurajohej ose të ekuilibrohej.

## ***Bibliografia***

### *Burime arkivore:*

- AQSH i RSH. Fondet: Anselmo Lorecchio, Luigj Gurakuqi, Mihal Turtulli, Mehmet Konica, Luigj Bumçi, Kristo Dako, Fan Noli, Kostë Çekrezi; Fondi i Qeverisë së Durrësit.

- Arkivi i Ministrisë së Jashtme të Republikës së Shqipërisë.

- Arkivi i Institutit të Historisë: Fondi i Arkivit të Vjenës.

### *Dokumente të botuara:*

- Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar 1918-1920 (Përmbledhje dokumentesh) I, Tiranë: Akademia e Shkencave, 1975.

- Nosi, Lef, Dokumente Historike 1918-1924, Tiranë: Onufri, 1925.

- Puto, Arben, Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare pas Luftës së Parë Botërore, vëll. III, 1918-1926, Tiranë: Albin, 2001.

- Qeveria e Përkohshme: Shqipëria përballë Konferencës së Paqes, Paris, Ble i Parë, Roma: Tipografia Cooperativa Sociale, 1919.320

- Qeveria e Përkohshme, Shqipëria përballë Konferencës së Paqes, Paris, Ble i Dytë, Roma: Tipografia Cooperativa Sociale, 1921.

- Xhanini, Amadeo, Italia në Konferencën e Paqes (Diskutime e dokumente), Romë: 1921 (Përkthim në dorëshkrim).

*Literatura:*

- Adriaticus, La question Adriatique, Paris: Imprimerie Typographique, 1920.
- Anastasi, Aurela, Historia e të drejtës kushtetuese në Shqipëri (1912-1939), Tiranë: Pegi, 2007.
- Andelman, David A., Paqe e rrënuar, Tiranë: Toena, 2008.
- Aref, Mathieu, Shqipëria, Tiranë: Plejad, 2007.
- Armstrong, Heaton, Gjashtë muaj mbretëri 1914 (kujtme), Tiranë: Albin, 2001.
- Bourcart, Jacques, Shqipëria dhe Shqiptarët, Tiranë: Dituria, 2004.
- Kruja, Mustafa, Anthologji historike (Shkrime e përkthime), Elbasan: Eugen, 2001.
- Kujtime dhe Këngë popullore për luftën çlirimtare të viteve 1918-1920, Tiranë: USHT, 1970.
- Makmilan, Margaret, Paris 1919, Tiranë: Plejad, 2006.
- Meta, Beqir, Federata Panshqiptare “Vatra”, Tiranë: Globus R., 2002.
- Milo, Paskal, Shqipëria dhe Jugosllavia, Tiranë: Enciklopedike, 1992.
- Mousset, Albert, Shqipëria përballë Europës, Tiranë: Dituria, 2004.
- Naska, Kaliopi, Këshilli Kombëtar 1920, Tiranë: Drejtoria e Arkivave, 2000.
- Poper, Karl, Mjerimi i historicizmit, Tiranë: Dituria, 1996.
- Procaci, Guliano, Historia e Italisë, Tiranë, Toena, 2000.
- Puto, Arben, Historia diplomatike e çështjes shqiptare, Tiranë: Albin, 2003.
- Puto, Arben, Shqipëria Politike 1912-1939, Tiranë: Toena, 2009.
- Selmani, Hysen, Nga Notimet e Zogut I, Mbretit të Shqiptarëve, Tiranë, Kristalian-HK, 2008.
- Silajxhiç, Haris, Shqipëria dhe SHBA në arkivat e Uashingtonit, Tiranë: Dituria, 1999.
- Swire, Joseph, Shqipëria. Ngritja e një Mbretërie, Tiranë: Dituria, 2005.
- Shuflaj, Milan, Serbët dhe Shqiptarët, Tiranë: Toena, 2004.
- Stumpf, Samuel, Filozofia, Historia, Problemet, Tiranë: Toena, 2001.
- Tako, Piro, Luigj Gurakuqi, Tiranë: 8 Nëntori, 1980.
- Telford, Çarls, Pesë vjet në Shqipëri (1908-1913), Tiranë: Q.SH.S. Amerikano-Britanike, 2003.
- Tittoni, Tomaso, Questioni del giorno, Milano: Fratelli Trevers, 1928.32
- Vlora, Eqerem, Kujtime, vëll. II, 1912-1935, Tiranë: Shtëpia e librit dhe e komunikimit, 2001.
- Vlora, Ismail Qemal, Kujtime, Tiranë: Grand Prind, 2007.

- Wiliams, Xhorxh, Shqiptarët, Tiranë: Argeta, 1999.

*Periodikët e kohës:*

- Gazeta Albania, Worcester 1918-1920, 1921 (lidhje).
- Gazeta Dielli, Boston 1918-1920, 1921 (lidhje).
- Gazeta Kuvendi, Romë 1918, 1919, 1920 (lidhje).
- Gazeta Opinga, Tiranë 1919, 1920 (lidhje).
- Gazeta Shqiptari i Amerikës, 1920, 1921, 1922, 1923 (lidhje).
- Revista The Adriatic Review, Boston 1918, 1919, 1920 (lidhje).

*Zhvillimi i të drejtës procedurale administrative  
në Shqipëri dhe ndikimi i të drejtës europiane.  
Aktualitete dhe perspektiva*

---

■ *PhD. Alma FASKAJ-VOKOPOLA*

---

■ *Dokt. Anila FEGA-DHAMO*

---

**Abstract.** *There are many factor that indicate important relation between the implementation of the procedural right and the evolution of european law.*

*When the universal concept of the administrative procedural law burned the European community isn't created yet. So, the meaning of administrative procedural law has changed evidently in the legislation and jurisprudence of community member's.*

*The evolution of administrative procedural law in all European community member indicate clearly that exist a broad consensus in order to guarantee effective procedural rights. The procedural principles are including in the legislation of the community member and in *acquis comunitaire* too.*

*Having regard of the integration process in European Union this paper is intended to give the impact in our legislation of the European Administrative law.*

**L**egjislacioni ynë i brendshëm nuk njeh në mënyrë të drejtpërdrejtë termin *e drejtë procedurale administrative*. Ky term, duke hequr një paralele me të drejtën procedurale civile dhe penale, përfshin tërësinë e hapave formalë, të parashikuar në ligj, të cilët një organ duhet të respektojë gjatë procesit të vendimmarrjes.

Si rregull, një vendimmarrje administrative duhet të kalojë nëpër disa hapa, të cilët organi vendimmarrës duhet t'i njohë para se të fillojë procedurën. Në vendet demokratike tre janë qëllimet që synohet të arrihen nëpërmjet procedurave administrative:

- të garantojë të drejtat e individëve përmes zbatimit të parimit të ligjshmërisë;

- të parashikojë garanci formale për mbrojtjen e interesit publik përmes transparencës në vendimmarrjen me impakt publik dhe duke parashikuar gjithashtu kontrollin mbi këtë vendimmarrje dhe,

- së fundmi, të krijojë kushtet për investime dhe zhvillim ekonomik, duke parashikuar garanci që çdo vendim do të respektojë parimin e sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme<sup>1</sup>.

## **Kodi i procedurave administrative<sup>2</sup>, një ligj i specifikuar “për procedimin”**

Analiza e procedurës administrative pa dyshim shtron për zgjidhje një sërë çështjesh. Ndër to, cila do të jetë mënyra e rishikimit të një akti administrativ nga gjykata, duke patur parasysh një analogji të dukshme dhe ndarje gjithashtu midis të drejtës materiale dhe procedurale?

Përgjigja e kësaj pyetjeje na motivon për të filluar analizën, por sigurisht dhe synimi është që të jemi sa më të saktë në përgjigjen përfundimtare që do të japim.

Në parantezë, evidentojmë një ndryshim lehtësisht të dukshëm midis të drejtës procedurale, ku bazohet gjykimi i një mosmarrëveshjeje administrative, dhe të drejtës procedurale administrative. Ndryshimi del në pah në fakt, se e drejta procedurale për gjykimin e një mosmarrëveshjeje administrative i ofron gjykatës një standart për të vlerësuar dhe për të “peshuar” sjelljen e subjekteve të treta, ndërkohë që e drejta procedurale është një normë sjelljeje

---

<sup>1</sup> - Wolfgang Rusch, Montenegro Budva, 26-27 mars 2009, “Administrative procedure in EU member states”, Paper në “Conference on public administration reform and european integration”.

<sup>2</sup> - Në vijim KPA.



për gjykatën<sup>1</sup>.

Nga ana tjetër, për administratën, së bashku e drejta procedurale dhe materiale përfaqësojnë norma të detyrueshme sjelljeje<sup>2</sup>. Pra, administrata është në të njëjtën kohë subjekt vendimmarrës dhe “palë”, në një konflikt, i cili potencialisht mund të mos shkojë në gjykatë<sup>3</sup>.

Realisht situata mbetet për t’u analizuar me kujdes në rastet e procesit vendimmarrës të administratës publike. Kjo për faktin se në disa raste ligjet procedurale përmbajnë norma materiale dhe e kundërta rregulla materiale gjenden në norma procedurale.

Me qëllimin për të gjetur një vijë të qartë demarkacioni, duhet të arrijmë të kuptojmë drejt atë që nënkupton secila prej tyre.

Normat procedurale përcaktojnë mënyrën se si duhet të zhvillohet procesi vendimmarrës. Në këtë kontekst, është një marrëdhënie e pavarur midis administratës dhe subjekteve private të së drejtës.

## Drejt një kuptimi “funktionale” të administratës publike

Institutet e procedimit administrativ gjejnë një rregullim së pari në dispozitat e KPA dhe sigurisht dhe në ligjet e posaçme.

Cili është vendi që ligjvënësi ynë e vë këtë Kod në raport me detyrueshmërinë për ta zbatuar dhe konkretisht cilat janë subjektet, kur dhe për çfarë këto të fundit duhet t’i referohen parashikimeve ligjore të bëra në këtë akt? Është qartësisht e kuptueshme se subjektet e të drejtës publike kanë detyrimin e respektimit të parimeve të sanksionuara në ligj, pra pjesë e të drejtës publike.

Por ajo që konstatojmë në nenin 1 të KPA<sup>4</sup> dhe që mund të konsiderohet

---

1 - Schwarze. J: *European Administrative Law*, 1992, fq. 1173.

2 - *Ibid.*

3 - *Ibid.*

4 - *Neni 1 i KPA parashikon: “Dispozitat e këtij Kodi zbatohen nga të gjitha Organet e Administratës Publike gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre në raste individuale. Dispozitat e këtij Kodi zbatohen edhe mbi aktet normative për aq sa një gjë e tillë është e mundur.*

*Parimet e përgjithshme të veprimtarisë administrative të sanksionuara në këtë Kod janë të detyrueshme për të gjitha aktet administrative, qofshin këto edhe të ndërmarrura në kuadrin e të drejtës private.*

*Parimet e përgjithshme të këtij Kodi, me ligj mund të bëhen të detyrueshme për zbatim edhe për veprimtarinë e subjekteve private kur këto veprimtari kanë efekte mbi interesat publike.*

*Ky Kod zbatohet për personat fizikë dhe juridikë, të cilëve u është dhënë e drejta e ushtrimit të detyrave dhe kompetencave publike me ligj, akt nënligjor dhe kontratë. Dispozitat e këtij Kodi nuk zbatohen mbi ato veprime të administratës publike, që*

si novatore, është pikërisht parashikimi i bërë në paragrafin 4 dhe 5, ku parashikohet mundësia e bërjes së detyrueshme për subjektet private të së drejtës të parimeve të së drejtës publike, nëpërmjet një akti ligjor, në ato raste kur veprimtaria e tyre ka impakt në interesa publike.

Në mënyrën se si janë formuluar këta paragrafë e bëjnë të paqartë situatën juridike dhe, natyrisht, për të arritur në një konkluzion të drejtë dhe për të parë atë që servir të re ky parashikim. Pra, realisht paragrafi 4 në këtë nen nuk ka vend pasi është përthithur tërësisht nga paragrafi 5. Në fakt, nuk do të ishte kështu nëse ky paragraf nuk do të kishte përdorur togfjalëshin “me ligj”.

Legjislacioni italian ka një parashikim të qartë lidhur me këtë situatë. Përmbajtja e nenit 1, paragrafi i parë, i ligjit nr. 241<sup>1</sup>, na paraqet një ndryshim “epokal” sipas **Corradinos**, pasi kjo dispozitë parashikon nënshttrimin e subjekteve private kundrejt parimeve të së drejtës publike. Natyrisht nuk bëhet fjalë për të gjithë subjektet e të drejtës, por vetëm për ata të cilët “*i nënshtrohen ushtrimit të një veprimtarie administrative*”, pra atyre subjekteve të cilët, edhe pse privatë, ndjekin qëllime publike. Pra rregullimi është lehtësisht i kuptueshëm dhe nuk të pështjellon. Ky kuptim shihet si një zgjerim i kuptimit të administratës publike, duke futur në të edhe subjekte të cilët nuk mund të mendoheshin asnjëherë që do të definoheshin si administratë publike, kjo duke patur parasysh vetëm faktin se duhet të zbatojnë parimet e të drejtës publike.

Një parashikim të tillë mund ta shohim në dy këndvështrime:

- i pari ka të bëjë me fushën e zbatimit të KPA,
- dhe i dyti ka të bëjë me tendencën për të zgjeruar rrethin e subjekteve që do të përfshihen në administratë publike.

Dispozita e KPA me një mungesë paqartësie, por me synimin për të zgjeruar rrethin e subjekteve që do të zbatojnë dispozitat e Kodit, kur kryejnë veprimtari administrative, me synimin e vetëm të mbrojtjes së interesit publik, sjell realisht një risi në të drejtën tonë. Kjo mund të interpretohet nga njëra anë si një tendencë për të zgjeruar nocionin e administratës publike, por nga ana tjetër mund të definohet si një arritje për ta bërë vetë kuptimin e administratës publike sa më funksional.

---

*rregullohen nga e drejta private”.*

1 - Ligji Nr. 241, datë 7.08.1990, “Nuove norme in materia di procedimento amministrativo e di diritto di accesso ai documenti amministrativi”(Gazzeta Zyrtare, 18 gusht 1990, n.192. Tekst i koordinuar dhe përditësuar me ndryshimet e bëra në Ligjin Nr.15, datë 11.02.2005, me Dekretin nr.35, datë 14.03.2005 , Ligjin Nr.40, datë 02.04.2007, Ligjin Nr.69, datë 18.06.2009.

Tendenca për ta bërë sa më funksional kuptimin e administratës publike na vjen si nga doktrina, legjislacioni komunitar dhe sigurisht jurisprudenca<sup>1</sup> e GJED<sup>2</sup>.

Në referencë të parashikimeve të bëra në aktet e Bashkimit Europian ekziston parimi i përgjithshëm që shtetet anëtare nuk duhet të favorizojnë ose të preferojnë shtetasit e tyre, por të sigurojnë një trajtim të barabartë me qytetarët e vendeve anëtare në krahasim me qytetarët e tyre. Ndërkohë që normat parashikojnë të drejtën e shtetit t'i rezervojë qytetarëve të tij punë si nëpunës i administratës publike.

GJED ka bërë një interpretim të ngushtë të termit “*administratë publike*” dhe “*funksione publike*”, duke arsyetuar:

*“...për këtë motiv, kriteri për të aplikuar neni 45, parag.4 i Traktatit duhet të jetë funksional dhe të mbajë parasysh natyrën e detyrës dhe të përgjegjësive të vendit të punës, me qëllim që të shmangë që efekti pozitiv që sjellin parashikimet e bëra në traktat lidhur me qarkullimin e lirë të punonjësve dhe të trajtimit të barabartë të qytetarëve të shteteve anëtare, të kufizohen për shkak të një interpretimi të kuptimit të Administratës Publike, e trajtuar kjo vetëm nga e drejta pozitive dhe që përjashton zbatimin e normave komunitare”<sup>3</sup>.*

Një interpretim diametralisht të kundërt<sup>4</sup> gjykata ka aplikuar në fushën e konkurrencës, me anë të të cilit ka parashtruar një kuptim të gjerë të administratës publike. Gjykata mendon se duhet t'i nënshtrohen normave komunitare edhe ata organizma që:

*“pavarësisht nga forma juridike e aktit me të cilin ato janë krijuar, me anë të një akti të autoritetit publik, me kontratë, nën kontrollin e këtij të fundit apo jo, nëse ajo kryen një shërbim me interes publik apo ka këtë qëllim dhe që i kalon kufijtë e synimit që kanë raportet midis subjekteve privatë”<sup>5</sup>.*

---

1 - Corradino M.: *Il procedimento amministrativo*, Giappichelli Editore, Torino, nëntor 2010, i bën një analizë në rrjedhë kronologjike evolimit të këtij koncepti si në aktet e komunitetit dhe në vendimmarrjen e GJED.

2 - Gjykata Europiane e Drejtësisë.

3 - Vendimi C-473/1993, datë 2 Korrik 1996 i GJED.

4 - Corradino M.: *vep. cit.*, fq. 51.

5 - Çështja Foster kundër British Gas, Vendimi C-188/1989, datë 12 Qershor 1989 i GJED.

Pra në të drejtën komunitare kuptimi i administratës publike është si një “fizarmonikë”<sup>1</sup>, në kuptimin që ngushtohet kur prezenca e administratës do të sillte ngushtim të sferës së aplikimit të normave komunitare, dhe zgjerohet kur bëhet fjalë për të garantuar një treg eficient dhe që respekton barazinë e trajtimit të të gjithë operatorëve.

Duke iu kthyer parashikimeve të KPA, a mund të themi se kemi të bëjmë me kalimin drejt një kuptimi “komunitar” të administratës publike? Sigurisht mund ta themi këtë, pasi vetë tendenca në KPA është t’i “nënshtrojë” edhe subjektet private të së drejtës, kur ato kryejnë veprimtari me impakt publik dhe ndaj parimeve aq të rëndësishme të veprimtarisë administrative.

## **Disa konstatime të rëndësishme të zhvillimit të së drejtës administrative europiane**

Duke u kthyer në kohë në aktet themeluese të BE-së, konstatojmë se Traktatet themelore të Bashkimit Europian, deri në miratimin e Traktatit të Lisbonës, kanë patur pak për të thënë lidhur me çështjet e procedurës administrative<sup>2</sup> dhe të të drejtave proceduriale.

Burimet e të drejtës proceduriale administrative të organeve të BE-së janë formatuar në një mënyrë të ngjashme me atë të shteteve anëtare. Konstatojmë se vetëm disa pjesë të drejtës administrative europiane, në kuptimin e të drejtës administrative të Bashkimit Europian, janë të parashikuara në legjislacionin e Bashkimit Europian. Edhe sot, më shumë se gjysëm shekulli pas miratimit të Traktatit të parë të Bashkimit Europian, ky i fundit ende vuan mungesën e një **seti** rregullash të kodifikuar të së drejtës administrative<sup>3</sup>.

Kështu, është konstatuar një fragmentarizëm i të drejtës, e për pasojë jurisprudenca e GJED ka luajtur një rol të rëndësishëm në fushën e të drejtës administrative europiane. Vihet re se numri më i madh i parimeve të cilat

---

1 - *Konkluzion i parashtruar nga O. Grasso, i cili ka trajtuar kapitullin I: I principi generali dell’attività amministrativa, të librit Il procedimento amministrativo, Giappichelli Editore, Torino, nëntor 2010.*

2 - *Schwarze. J: European Administrative Law, 1992, fq. 1173, 1186.*

3 - *Kjo analizë është bazuar në: J. Schwarze: European Administrative Law, London 2006, revised 1st edition; J. Schwarze, Europäisches Verwaltungsrecht, 2005, 2nd extended edition, Baden-Baden; J. Schwarze: Droit administratif européen, 2nd completed edition, Bruxelles 2009; J. Schwarze: Le funzioni amministrative, in G. Guzzetta/F. Bindi (eds.), Lo Stato Dell’Unione, Torino 2009, p. 89; J. Schwarze: L’état actuel et les perspectives du droit administratif européen”, Bruxelles 2010 (ed.).*

udhëheqin veprimtarinë e Bashkimit European e kanë origjinën e tyre nga procesi vendimmarrës kreativ i GJED.

Pra, zhvillimi i të drejtës administrative europiane për një kohë të gjatë i është besuar jurisprudencës së GJED, e cila krijoi një trupë parimesh të përgjithshme të cilat fillimet i kanë në Traktatet dhe legjislacioni dytësor, dhe në veçanti të rrënjosura thellë në legjislacionin e vendeve anëtare<sup>1</sup>.

Kështu GJED elaboroi në vijim, përveç parimit të ligjshmërisë, edhe parimet e proporcionalitetit, të sigurisë juridike, të mbrojtjes së pritshmërive të ligjshme, të mosdiskriminimit, të procesit të rregullt ligjor dhe rishikimit gjyqësor<sup>2</sup>.

Ka qenë çështja **Algera**<sup>3</sup> pikënisja e fillimit të detyrimit të GJED për të krijuar ligje në mënyrë kreative në rastet e mungesës së parashikimeve në traktate. Në këtë çështje Gjykata arsyetoi:

*“Në mënyrë që gjykata të mos mohojë dhënien e drejtësisë, është e detyruar të zgjidhë mosmarrëveshjen duke iu referuar rregullave të njohura nga legjislacionet dhe jurisprudenca e vendeve anëtare”.*

Në vijim të këtij vendimi ka ekzistuar një marrëveshje sipas të cilës këto parime duhet të zbatohen nga Institucionet e Bashkimit dhe se GJED mund të dënojë shkeljen e këtyre parimeve ashtu si në shkeljen e çdo norme të së drejtës së shkruar<sup>4</sup>.

Pra orientimi në legjislacionet e vendeve anëtare dhe të jurisprudencës së tyre kanë qenë hapat e parë të zhvillimit të së drejtës administrative europiane. Është për t'u përmendur se e drejta franceze ka luajtur një rol shumë të madh në krijimin e të drejtës europiane, por edhe legjislacionet e vendeve të tjera anëtare kanë dhënë kontributin e tyre.

E drejta angleze ka patur një efekt të veçantë në drejtim të garancive procedurale<sup>5</sup>, ndërkohë e drejta gjermane ka ndihmuar në përkufizimin e parimit të proporcionalitetit.

---

1 - M.P.Chiti: 2004, *Diritto amministrativo europeo*, Giuffrè, Milan, 2004, Botimi i dytë, fq. 416.

2 - [www.gjk.gov.al](http://www.gjk.gov.al)

3 - Çështja 7/56 dhe 3-7/57, *Dineke Algeria et al./Common Assembly*, ECR 1957, p. 83.

4 - J. Schwarze: **EU-Kommentar**, 2nd edition, Baden-Baden 2009.

5 - Çështja 17/74, *Shoqata Transoqeanike kundër Komisionit*, ECR 1974, p. 1063.

Ndërkohë një perceptim të ri mori e drejta për informim me futjen e vendeve skandinave në Bashkimin European<sup>1</sup>.

Në vijim kjo fazë u ndoq nga një rritje e parashikimit të procedurave në legjislacionin dytësor<sup>2</sup>. Ky fakt u konsiderua nga shumë autorë studiues të së drejtës administrative europiane si një kodifikim. Ndërkohë konstatohet se janë miratuar akte të cilat janë shembuj të një tendence të kodifikimit të pjesshëm të disa prej instituteve të rëndësishme të procedurës administrative<sup>3</sup> si afati, e drejta për informim, mbrojtja e të dhënave personale, apo rregulla të cilat normojnë procedurën vendimmarrëse në disa agjenci të rëndësishme në nivel europian.

Pavarësisht ekzistencës së akteve të përmendura më lart, këto përpjekje natyrisht nuk mund të barazohen me kodifikimin në termat dhe natyrën e akteve nëpërmjet të cilave vendet e komunitetit dhe vendi ynë ka rregulluar duke kodifikuar institutet e procedimit administrativ.

Pas hyrjes në fuqi të tij më datë 1 dhjetor 2009, Traktati i Lisbonës shënoi një hap të rëndësishëm të rrugës së Bashkimit European drejt konsolidimit të mëtejshëm të vlerave të përbashkëta mbi të cilat është krijuar ai. Traktati i Lisbonës e lë sistemin në tërësinë e tij të paprekur dhe të lidhur me format tradicionale. Megjithatë, konstatohet se ky akt solli një ndryshim shumë të madh në fushën e të drejtës administrative europiane, duke rikonfirmuar rëndësinë e **shtetit të së drejtës**.

Në nenin 6, paragrafi 3, të Traktatit, parashikohet se:

*“të drejtat themelore (.....) duhet të përbëjnë parimet e përgjithshme të së drejtës së Bashkimit European”.*

---

1 - Çështja 353/01 P, Olli Mattila kundër Këshillit, ECR 2004, I-1073.

2 - Rregullorja nr.1/2003 për mbrojtjen nga konkurrenca; Rregullorja për kontrollin e ndihmës shtetërore; Rregullore për strukturat dhe kohezionin e fondeve; Rregullore në tregun agrokultural; Rregulloret e disa agjensive europiane, në mënyrë të veçantë ato agjensi, të cilat kanë fuqi vendimmarrëse, si: Zyra për harmonizimin e tregut të brendshëm, Agjencia Europiane e mjekësisë, Agjencia e sigurisë së aviacionit, Agjencia Europiane e Kimisë.

3 - Rregullore lidhur me afatet; Rregulla lidhur me gjuhën e përdorur nga BE; Rregulla lidhur me garantimin e të drejtës për informim nga Institucionet e BE; Rregulla për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë proceseve nga institucionet dhe organet e BE; Rregullore për stafin e BE; Rregulla të përgjithshme lidhur me inspektimet e komunitetit; Rregullore nr.58/2003 lidhur me agjensitë ekzekutuese të BE, të cilat përbajnë rregulla procedurale të veçanta të aplikueshme për të gjitha agjensitë.

Por ajo që vlen për t'u evidentuar është fakti se Traktati i Lisbonës sanksionoi nënshtrimin e procedurave administrative ndaj shtetit ligjor, duke i dhënë Kartës së të Drejtave Themelore të njëjtën vlerë si dhe Traktateve. Në këtë kontekst merr një vlerë të veçantë neni 41 i Kartës, ku parashikohet e drejta e miradministrimit dhe konkretisht:

*1. Çdo person ka të drejtë që çështjet e tij ose të saj të trajtohen në mënyrë të paanshme, të drejtë dhe brenda afateve kohore të arsyeshme nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit.*

*2. Kjo e drejtë përfshin:*

*(a) të drejtën e çdo personi që të dëgjohet përpara se kundër tij të merren masa që do ta cënonin atë;*

*(b) të drejtën e çdo personi për të parë dosjen e vet, duke respektuar interesat legjitime të ruajtjes së fshehtësisë së informacionit si edhe të sekretit profesional dhe tregtar;*

*(c) detyrimin e administratës që të argumentojë vendimet e marra.*

*3. Çdo person ka të drejtën që t'i kërkojë Bashkimit zhdëmtim për dëmet që mund të jenë shkaktuar prej institucioneve apo prej nëpunësve të tij gjatë ushtrimit të detyrave, në përputhje me parimet e përgjithshme që janë të përbashkëta për legjislacionet e Shteteve Anëtare.*

*4. Çdo person mund t'u drejtohet me shkrim institucioneve të Bashkimit në një prej gjuhëve të Traktateve dhe është e detyrueshme që të marrë përgjigje në po atë gjuhë.*

## **Disa zhvillime jurisprudenciale të GJED dhe Gjykatës Kushtetuese lidhur me të drejtën e dëgjimit gjatë procedurave administrative**

E drejta e dëgjimit të palëve të interesuara është një nga të drejtat procedurale me një rëndësi të veçantë në një procedim administrativ. Kjo është dhe arsyeja që kjo e drejtë do të trajtohet në këndvështrim të GJED dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese.

Neni 96 i KPA, parashikon modalitetet e të drejtës së dëgjimit gjatë procedimit administrativ. Duke vlerësuar në parantezë garancitë që kjo dispozitë ka në raport me të drejtën për t'u dëgjuar, parashtrimi i qëndrimeve jurisprudenciale, të GJED dhe Gjykatës Kushtetuese, do të bëjnë që kjo dispozitë dhe mundësitë për ta përmirësuar atë të jetë në fokus të diskutimeve të mëvonshme.

GJED e ka lidhur në mënyrë organike të drejtën e palës për t'u informuar në mënyrë të plotë me dokumentacionin që lidhet në të me garantimin e të drejtës së mbrojtjes. Pra, nëse subjekti argumenton se ai nuk ka marrë dijeni lidhur me një dokument dhe kjo sjell një impakt të drejtpërdrejtë në cilësinë e mbrojtjes, atëherë kjo nuk mund të **riparohet** nga gjykata pasi është një çështje administrative.

Në gamën e vendimeve të cilat kanë trajtuar parimin e të drejtës së dëgjimit po analizojmë çështjen nr.110/10, **Solvay v Komisionit**, ku është vendosur anulimi i Vendimit të Komisionit European të datës 13 dhjetor 2000, 2003/5/EC, lidhur me procedimin bazuar në nenin 81 të Traktatit.

Kjo gjykatë arsyeton:

*“...E drejta e mbrojtjes është një e drejtë themelore, e cila formon një pjesë integrale të parimeve të përgjithshme që Gjykata garanton. ...Respektimi i të drejtës së mbrojtjes gjatë një procedimi para Komisionit, në lidhje me vendosjen e një gjobe kundrejt një kompanie për shkelje të ligjit të konkurrencës, kërkon që vendimmarrja në fjalë të jetë e bazuar në fakte të bëra të njohura dhe në dokumentacionin ku Komisioni është bazuar dhe ku ka mbështetur pretendimet e tij se kemi shkelje të Traktatit...*

*E drejta e aksesit në dokumentacion do të thotë që Komisioni t'i japë subjektit në fjalë mundësinë të shqyrtojë të gjitha dokumentet në dosjen hetimore që mund të jenë relevante për mbrojtjen e tij. Këto dokumente përfshijnë ato dokumente që lidhen apo nuk lidhen me të, pa cënuar sekretet tregtare të subjekteve të tjera, dokumente të brendshme të Komisionit dhe çdo informacion tjetër i konsideruar...*

*Shkelja e të drejtës së aksesit në dokumentacion gjatë procedurës para se vendimi të miratohet, mund të çojë, në parim, në anulimin e këtij vendimi, nëse subjekteve u është cënuar e drejta e dëgjimit... Në këtë rast, shkelja e ndodhur nuk mund të rregullohet duke lejuar akses gjatë procedurës gjyqësore. ...Në të vërtetë, shqyrtimi gjyqësor i kufizuar në objektin e kërkesës së depozituar, nuk ka për objekt dhe as efekt të zëvendësojë hetimin e plotësuar gjatë praktikës së një procedimi administrativ. ...Njohja me vonesë e disa dokumenteve të lidhura me aktin nuk ka të bëjë me faktin se në cilën situatë do të gjendej subjekti dhe organi, por ka lidhje vetëm me faktet që duhet t'i parashtroheshin institucionit... Nëqoftëse jemi para situatës kur subjekti është njohur me dokumentacionin gjatë procesit gjyqësor, nuk është e detyrueshme për atë të provojë që mosnjohja me dokumentacionin do të sillte një vendim tjetër, por të argumentojë se ato dokumente do të ishin të dobishme për mbrojtjen e tij...”*



Gjykata Kushtetuese ka patur disa vendime, në të cilat ajo ka arsyetuar lidhur me impaktin që ka në një vendimmarrje të caktuar mosrespektimi i parimit të dëgjimit, duke e parë çështjen edhe në kontekstin e të drejtës së mbrojtjes.

Gjykata Kushtetuese në vendimin Nr.17 /2004<sup>1</sup> ka arsyetuar se:

*“...në referencë të rregullave procedurale që parashikohen për zhvillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarit, si dhe të konceptit kushtetues të individit për të gëzuar një proces të rregullt ligjor, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka shkelur të drejtën e kerkueses për t’u dëgjuar dhe mbrojtur në kuptim të nenit 42 të Kushtetutes dhe të nenit 6 të KEDNJ. Në rastin konkret, nuk kanë ekzistuar rastet e parashikuara në nenin 96 të KPA. Në të njëjtën kohë, në këtë çështje Gjykata Kushtetuese është nisur nga kuptimi kushtetues që i është dhënë të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Jurisprudenca e GJEDNJ dhe në veçanti ajo shqiptare, kanë pranuar se elementët thelbësorë të kësaj të drejte zbatohen si për procedurat gjyqësore, ashtu edhe për procedurat parlamentare dhe ato administrative. E drejta për një proces të rregullt ligjor paraqitet si një garanci për shtetasin kundër veprimeve të padrejta të organeve të pushtetit, si dhe përbën njëkohësisht një detyrim për këto që të mos çenojnë të drejtat dhe liritë e shtetasve pa u siguruar respektimi i procedurave të rregullta ligjore”.*

Ndërsa në vendimin interpretues nr. 75/2002, Gjykata Kushtetuese shprehet se:

*“...njohja paraprake e personit, ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit, me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i të drejtës për t’u dëgjuar dhe mbrojtur, si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake ashtu dhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementët bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt, si një e drejtë themelore, cënimin e së cilës jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese e ka identifikuar në çdo rast si shkelje të Kushtetutës”.*

Në vijim të paraqitjes së jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, në vendimin Nr. 76/2002 ajo shprehet se:

*“...Kuvendi, gjatë procedurës së ndjekur për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm nuk i është përmbajtur pikërisht respektimit të këtyre standarteve. Kështu Kuvendi i ka konsideruar të mirëqena të gjitha akuzat e drejtuara ndaj kerkuesit, duke u mbështetur vetëm në diskutimet e deputetëve, pa argumentuar shkeljet konkrete, pa njoftuar rregullisht kerkuesin*

---

<sup>1</sup> - Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.17, datë 12.11.2004, botuar në **Fletoren Zyrtare** Nr.89, faqe 6374.

*për përmbajtjen e materialit në ngarkim të tij, pa i dhënë kohën e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe pa e dëgjuar atë për të parashtruar prapësimet rreth këtyre akuzave”.*

## **Përfundime**

Është mëse e qartë për të gjithë tashmë që KPA paraqitet një ligj shumë i rëndësishëm për procedurat administrative në përgjithësi dhe të drejtat proceduriale në veçanti.

Ky konkluzion e ka fillësën në fushën e zbatimit të këtij akti dhe sidomos në zgjerimin e rrethit të subjekteve, duke përfshirë dhe subjektet privatë, të cilët kryejnë një veprimtari me interes publik, të zbatojnë parimet e përgjithshme të sanksionuara në këtë akt.

Megjithë konstatimin se në dispozitat e KPA paraqitet me një mungesë paqartësie, konstatojmë se synimi për të zgjeruar rrethin e subjekteve që do të zbatojnë dispozitat e Kodit, kur kryejnë veprimtari administrative, me qëllimin e vetëm të mbrojtjes së interesit publik, sjell realisht një risi pozitive në të drejtën tonë.

Kjo mund të interpretohet nga njëra anë si një tendencë për të zgjeruar nocionin e administratës publike, por nga ana tjetër mund të definohet si një arritje për ta bërë vetë kuptimin e administratës publike sa më funksional. Është për t'u vlerësuar gjithashtu se tendenca për të bërë sa më funksional kuptimin e administratës publike, na vjen si nga doktrina dhe legjislacioni komunitar dhe sigurisht jurisprudenca e GJED.

## **Bibliografia**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 8417, datë 21.10.1998, Fletore Zyrtare Nr. 28, datë 7.12.1998
- Ligji nr. 8485 datë 12.05.1999: Kodi i Procedurave Administrative, Fletore Zyrtare Nr.19 datë 20.07.1999
- Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese (1992-2008)
- Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të Drejtësisë
- Schwarze. J: European Administrative Law 1992
- Craig. Paul, De Butca Grainne: EC Law Text, Cases, &Materials. Clarendon Press Oxford
- Wolfgang Rusch: Montenegro Budva, 26-27 mars 2009, Administrative

procedure in EU member states”, Paper në Conference on public administration reform and european integration

- J. Schwarze: European Administrative Law, London 2006, revised 1st edition

- J. Schwarze: Europäisches Verwaltungsrecht, 2nd extended edition, Baden-Baden 2005

- J. Schwarze: Droit administratif européen, 2nd completed edition, Bruxelles 2009

- J. Schwarze: Le funzioni amministrative, in G. Guzzetta/F. Bindi (eds.), Lo Stato Dell’Unione, Torino 2009

- J. Schwarze: L’état actuel et les perspectives du droit administratif européen, Bruxelles 2010 (ed.)

## *Criminal offenses of the environment*

---

■ PhD. *Elvana ÇIÇOLLI*

---

**Abstract.** *Awareness of natural resource limits has highlighted the need for greater protection for the environment. Due to the environmental initiatives the interest for the “environmental issue” has received a greater impulse. As a consequence of this is created a civil movement which requires immediate and efficient response to these problems, not only nationally, but above all at an international level.*

*Of course, first of all we should verify the legislator term of “environment” which is a concept with a general sense, or occasionally used to identify different realities which have in common only the involvement in an abstract concept.*

### **Mjedisi**

**K**oncepti i “mjedisit”, të cilit i referohet doktrina dhe jurisprudenca, konsiderohet si një koncept gjithpërfshirës. Në fakt përkufizimi i konceptit “mjedis”, eskluzivisht nën këndvështrimin e evoluimit ekologjik, do të ishte mjaft kufizues dhe i pamjaftueshëm. Për të arritur në

një përkufizim të arsyeshëm dhe sa më të plotë, është e nevojshme përqasja mes teorive vlerësuese etiko-filozofike, konsideratave ekonomike dhe përkufizimeve shkencore.<sup>1</sup>

Termi “mjedis” është në vetvete një koncept i shumëfishtë. Në gjuhën e përditshme kuptimi për mjedisin mund të ndryshojë nga një kontekst në një tjetër. Mjedisi mund të nënkuptojë “hapësirën që rrethon një kafshë ose një person, në të cilën ajo lëviz ose jeton”, ashtu si mund të përbëjë një “kompleks të vlerave shoqërore, kulturore dhe morale, në të cilën një person gjen dhe e zhvillon personalitetin e vet”. Në të njëjtën kohë kur flasim për mjedisin mund të kuptojmë dhe “një grup i kushteve fiziko-kimike (të tilla si temperatura, ndriçimi, prania e kripërave në ujë dhe në tokë, çdo lëvizje të mjetit) dhe biologjik (prania e organizmave të tjera), që lejon dhe inkurajon jetën e qenieve të gjalla”.

Nga pikëpamja ligjore, një shumëllojshmëri e kuptimeve të këtij koncepti, është shkaku që shumica e interpretuesve të së drejtës kanë hasur vështirësi për të gjetur një përkufizim të qartë të vetë konceptit.

Ashtu sikurse imponon dhe neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, juristët i referohen së pari aktit themelor kur bëhet fjalë për mbrojtje të vlerave dhe interesit publik. Në nenin 59 të Kushtetutës listohen objektivat sociale sipas të cilave:

*“Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:*

.....

d) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;

dh) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm;

.....

g) mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe...”.

Kushtetuta, ashtu sikurse edhe në lidhje me koncepte të tjerë, nuk jep përkufizime por, si akti themelor me fuqi ligjore, garanton vetëm përgjegjësinë e shtetit për realizimin e një mjedisi të shëndetshëm. Detajimi i mënyrës së mbrojtjes së mjedisit vijon me ligjet specifike në fushën e mjedisit si dhe në legjislacionin penal.

Legjislacioni shqiptar për mjedisin është një tërësi ligjesh specifike të cilat marrin në mbrojtje elementë të caktuar të tij. Legjislacioni penal në fushën e mjedisit është një prej ligjeve më të rëndësishëm në këtë fushë për shkak të

---

<sup>1</sup> - Woltering Scaramella: Conferenza SRMC-UNICRI, Consiglio dell'Ordine degli Avvocati di Napoli, Castelcapuano, 1995.

specifikës së tij si garantues i këtij objekti që na përket të gjithëve.

Ligji shqiptar i mbrojtjes së mjedisit i vitit 1993 e përkufizon mjedisin si:

*“...tërësia e elementëve dhe faktorëve natyrorë e njerëzorë me veprimet dhe bashkëveprimet e tyre. Elementët, fenomenet dhe produktet përfaqësohen nga uji, ajri, toka dhe nëntoka, rrezatimi diellor, organizmat bimore e shtazore si dhe të gjitha proceset dhe fenomenet natyrore që rrjedhin nga bashkëveprimi i tyre e që kushtëzojnë jetën. Faktorët njerëzorë përfaqësohen nga qënia e shoqërisë dhe veprimtaria e saj ekonomike e sociale”.<sup>1</sup>*

Ky ligj u shfuqizua me ligjin nr. 8934, datë 05.09.2002, i cili ripërkufizoi termin duke e konsideruar mjedisin si:

*“...bashkësia e ndërveprimeve të përbërësve biotikë dhe jobiotikë që nxisin dhe ushqejnë jetën e gjallë në tokë, duke përfshirë mjedisin biofizik natyror të ajrit, të tokës, të ujërave, larminë e ekosistemeve biologjike, shëndetin e njeriut, vlerat dhe trashëgimitë kulturore, shkencore, fetare e shoqërore...”.*

Me ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011: **Për mbrojtjen e mjedisit**, termi mjedis konsiderohet si:

*“përbërësit natyrorë: ajri, toka, ujërat, klima, flora dhe fauna në tërësinë e ndërveprimeve me njëra-tjetrën, si dhe trashëgimia kulturore, si pjesë e mjedisit të krijuar nga njeriu”.<sup>2</sup>*

Ky ligj është hartuar në përputhje me të drejtën europiane, me qëllim përafrimin paraprak të legjislacionit në këtë fushë.

Ligjet specifike në fushën e mjedisit shërbejnë për të përkufizuar në mënyrë të qartë mënyrën se si garantohet një mjedis i shëndetshëm, por edhe për të përcaktuar se cilat veprime do të përbëjnë dëmtime, cënime apo ndotje të mjedisit.

Këto ligje specifike shërbejnë si bazë e legjislacionit penal, i cili ndëshkon ndotjen e mjedisit. Kodi penal, në nenin 1/b të tij, e radhit në një nga vlerat kryesore që ka për detyrë të mbrojtë dhe sigurojë legjislacioni penal:

*“Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojtë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, **mjedisin**, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare, si dhe bashkëjetesën fetare nga veprat penale, si dhe parandalimin e tyre”.*

Veprat penale që kanë për qëllim mbrojtjen e mjedisit, kanë në themel shkeljet e parashikuara në ligjet specifike të cilat e kalojnë rrezikshmërinë e kundravajtjeve administrative.

---

1 - Ligji 7664, datë 21.01.1993.

2 - Ky ligj është përafruar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 21 Prill 2004: “Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin” e ndryshuar. Numri CELEX: 32004L0035, **Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian**, Seria L, nr. 143, datë 30.4.2004, faqe 56-75.

## Veprat penale në fushën e mjedisit

Para së gjithash, duhet sqaruar se termi “e drejta penale e mjedisit” përdoret si pasojë e konvencionalizmit dhe përparësisë që ka marrë tashmë kjo problematikë në nivel ndërkombëtar. Ky koncept rrjedh nga parimet e përgjithshme të së drejtës penale, të cilat e individualizojnë këtë degë jo në bazë të problematikës së saj, por në bazë të pasojave të parashikuara në rastin e cënimit të dispozitave që kanë si objekt këto marrëdhënie.

Pra, në të drejtën penale të mjedisit hyjnë të gjitha ato rregulla me karakter penal që, duke ndjekur qëllimin e mbrojtjes së mjedisit, parashikojnë sanksione penale si pasojë e mosrespektimit të tyre.

Kompleksiteti i këtyre dispozitave, i cili është pasojë jo vetëm e mungesës së organizimit, por edhe për shkak të elementëve teknikë të interpretimit të tyre, ka kushtëzuar nevojën e vlerësimit të tyre në një këndvështrim të veçantë, duke individualizuar një dimension të pavarur nga koncepti i të drejtës së përgjithshme të mjedisit.<sup>1</sup>

Këto veçanti nuk mund të jenë shkak për t’u njohur automatikisht si e drejtë penale e mjedisit, ose të paktën jo si një pjesë e veçantë e të drejtës penale.

Kjo terminologji, ashtu si u përmend më lart, është pasojë e konvencionalizmit të studiuesve të kësaj tematike. Përsa i përket dispozitave penale në fushën e mjedisit, e veçanta qëndron në faktin se ato lidhen me ligje specifike të cilat rregullojnë fushat përkatëse ku është evidentuar cënimi i mjedisit.

Veprat penale në fushën e mjedisit sipas kodit penal shqiptar, janë ato të parashikuara prej neneve 201-207 të Kodit Penal:

Ndotja e ajrit

Transportimi i mbeturinave toksike

Mbrojtja e ujrave

Peshkimi i ndaluar

Prerja e paligjshme e pyjeve

Prerja e drurëve dekorativë dhe

Shkelja e karantinës.

Secila nga këto vepra penale merr në mbrojtje një prej elementëve të veçantë të mjedisit.

---

1 - L. Ramacci: **Manuale di diritto penale dell’medise**, Padova, 2012, fq 16.

Specifikë e këtyre veprave është fakti se për të përcaktuar përgjegjësinë penale sipas tyre, duhet t'i referohemi ligjeve specifike sipas së drejtës së përgjithshme të mjedisit. Autori i veprimeve që çënojnë apo dëmtojnë ambientin, mund të penalizohet sipas të drejtës penale vetëm nëse veprimi nuk dënohet në rrugë administrative.

Parashikimi i krimeve ekologjike, pavarësisht nëse janë të parashikuar në kodin penal apo në ligje të tjera të veçanta, është e vetmja mënyrë për të mbrojtur vlerat ambientale, të cilat janë me karakter të përbashkët, të përgjithshëm dhe të pazëvendësueshme.<sup>1</sup>

Krimi i drejtuar ndaj mjedisit konsiderohet dyfish i rrezikshëm pasi:

- në mënyrë të drejtëpërdrejtë evidentohet në dëmtimin ose vënien në rrezik të vetë të mirës natyrore;

- në radhë të dytë, por jo më pak të rëndësishme, çënon interesat e përgjithshme të komunitetit për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm.

Të gjithë ndihemi të cënuar, të fyer, të dëmtuar nga një veprim i drejtuar ndaj një të mire natyrore, ndaj një pjese të mjedisit që na rrethon, në të cilin jetojmë dhe zhvillojmë ekzistencën tonë. Arsyeja kryesore e të përjetuarit në këtë mënyrë të këtyre veprime të kundraligjshme gjendet në ndjenjën e përfshirjes në një sistem ku baza janë marrëdhëniet biologjike, të cilat bashkohen me qeniet e tjera të gjalla. Të gjithë jemi pjesë e një skenari natyror për ta mbrojtur dhe ruajtur për brezat që do të vijnë. Ky pohim manifestohet në qëndrimin e gjithsecilit prej nesh në momentin e vënies dijeni për një krim që lidhet me ndotjen e mjedisit. Është kjo ndjenjë e përgjithshme që tregon nevojën e domosdoshme për një ndërhyrje të menjëhershme të aftë për të ndaluar ose të paktën të parandalojë mundësinë e një çënimi të mëtejshëm. Çfarëdolloj dëmi që i shkaktohet një elementi të kësaj hallke, herët a vonë do të prodhojë pasoja për të gjithë sistemin, duke sjellë dëme të rënda dhe të pashmangshme.

Për këto arsye nuk mund të pranohet ideja sipas të cilës e drejta penale duhet të ketë si objekt të saj in vetëm mbrojtjen e marrëdhënieve të tjera juridike dhe jo ato që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, si një fushë me rëndësi më të vogël.<sup>2</sup>

Nuk është ligji ai që krijon situatat dhe veprimet penalisht të dënueshme, nuk është ligji që parashikon paraprakisht krimet. Është vetë realiteti dhe situatat e kundraligjshme që paraqesin nevojën e mbrojtjes penale dhe parashikimit

---

1 - F. Bricola: *Politica criminale e politica penale dell'ordine pubblico*, in **II questione criminale**, 1975, fq. 221.

2 - Fiandaca-Musco: **Diritto penale**. Parte generale, Bologna ed III 34.



të mbrojtjes ligjore. Edhe pse në pamje të parë duket se parashikimet ligjore penale parashikojnë thjesht një sistem mbështetës sanksionues për normat e degëve të tjera të së drejtës. Në të vërtetë të gjitha këto norma ruajnë një vlerë autonome dhe një individualitet specifik juridik. Në momentin kur nga shoqëria civile vjen një kërkesë konkrete për mbrojtjen ndaj mjedisit, duke paraqitur në mënyrë specifike se kjo mbrojtje është e mangët nga pikëpamja administrative, ligjvënësi duhet të marrë përsipër detyrën për të “fotografuar” realitetin dhe për ta fiksuar në norma të veçanta dhe të specifikuara sjelljen që duhet ndëshkuar.

## **Mbrojtja penale e mjedisit nëpërmjet së drejtës komunitare**

Për të siguruar një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje të mjedisit, ashtu siç është parashikuar në nenin 174 paragrafi 2 i Traktatit të KE, është i nevojshëm përballimi i problemeve që lidhen me kriminalitetin në fushën e mjedisit.

Bashkimi European dhe shtetet anëtare kanë adoptuar një sërë aktesh legjislative me anë të të cilave kanë ofruar garanci dhe mbrojtje për mjedisin dhe elementët që e përbëjnë atë. Megjithatë, sipas studimeve<sup>1</sup>, sanksionet e parashikuara prej legjislacioneve penale të shteteve anëtare kanë rezultuar të pamjaftueshëm për të garantuar standartet e parashikuara prej të drejtës komunitare në mbrojtje të mjedisit. Jo të gjitha shtetet anëtare kanë parashikuar sanksione të një shkalle të tillë represive të përshtatshme për krimet e rënda ndaj mjedisit, edhe pse tashmë dihet se vetëm nëpërmjet sanksioneve penale mund të garantohet një mbrojtje efektive. Arsyet për këtë janë të ndryshme:

- Në radhë të parë, parashikimi i sanksioneve penale është tregues i përgjegjësisë sociale me natyrë cilësisht të ndryshme nga sanksionet administrative apo mekanizmat zhdëmtues e civilë.

- Në radhë të dytë, masat me karakter administrativ apo gjordat rrezikojnë të mos japin efektin e kërkuar në rastin e personave insolvabël, ose në rast të kundërt kur fuqia financiare e tyre është shumë e madhe dhe gjorda e caktuar është një masë e pallogaritshme.

- Së treti, sanksionet dhe mekanizmat që i shërbejnë të drejtës penale janë shumë më të mprehtë se ato të përdorur prej të drejtës civile apo administrative dhe mund të japin efektin e tyre më të plotë për mbrojtjen e mjedisit.

---

1 - <http://ec.europa.eu/environment/crime/index.htm#studies>.

- Së fundi, fakti që në këtë hetim ndërhyjnë organizma të ndryshëm, të cilët mund të kenë të bëjnë me dhënien e lejeve apo të liçensave për ndotjet, e bën këtë hetim më të paanshëm. Përveç natyrës së ndryshme të sanksioneve të përdorur prej legjislacioneve penale të shteteve të ndryshme, hasen probleme dhe të shkallës së ndryshme të penalizimit penal për të njëjtën shkelje.

Duke qenë se shpesh krimet ndaj mjedisit kanë karakter transnacional, autorët e këtyre veprave mund të përfitojnë avantazhe për shkak të asimetrisë në sanksionimin e këtyre krimeve.

Për arsyet e lartpërmendura, Bashkimi Europian, me qëllim unifikimin e mbrojtjes dhe të penalizimit të krimeve ndaj mjedisit, zgjodhi të adoptojë direktivën 2007/0022: **Për mbrojtjen penale të mjedisit.**

Përfundimisht u gjet një rrugë e mesme duke adoptuar një direktivë e cila është një akt me fuqi juridike, i cili për shtetin që e nënshkruan ka fuqi detyruese përsa i përket qëllimit, por jo mjetit me të cilin arrihet ky qëllim.

Pra, shtetet që nënshkruajnë këtë direktivë janë të detyruar të arrijnë standartet e parashikuara në të duke përdorur politika individuale.

Direktiva parashikon disa krime kundër mjedisit, të cilët duhet të parashikohen si fakte penale serioze nga të gjitha legjislacionet penale të shteteve anëtare. Kjo pavarësisht faktit nëse janë kryer me dashje apo nga pakujdesia. Edhe pjesëmarrja apo nxitja për kryerjen e këtyre veprave penale duhet dënuar pa patur asnjë lloj dyshimi. Përgjegjësia penale e personave juridikë në lidhje me këto vepra është e parashikuar në mënyrë të detajuar.

Këto krime duhen ndëshkuar nëpërmjet dënimeve të përshtatshme, proporcionale dhe frenuese kur janë kryer nga persona fizikë, dhe nga sanksione penale ose jo për personat juridikë.

Përsa i përket krimeve ndaj mjedisit të cilat janë kryer në rrethana të cilësuar, p.sh. kur kanë shkaktuar pasoja të rënda, duhet parashikuar një nivel minimal i ngjashëm, si kur ato janë kryer nga persona fizikë, ashtu edhe kur kanë qenë pasojë e veprimtarisë së personave juridikë.

## **Konkluzione**

Aktualisht mjedisi konsiderohet dhe studiohet në globalizimin e tij si habitat i njeriut dhe si një kusht i domosdoshëm për jetën njerëzore, i cili shërben si bazë juridike për afirmimin e ekzistencës së një të drejte thelbësore

e cila i përket komunitetit.<sup>1</sup>

Disa autorë përdorin një përkufizim shumë më të gjerë, të çliruar nga teoritë antropologjike, duke i dhënë përparësi teorive ekologjike. Sipas tyre, me mjedis kuptohet: “*ekuilibri ekologjik i biosferës ose i ekosistemeve referues*”.<sup>2</sup>

Një përkufizim i përshtatshëm për konceptin “mjedis” është dhënë nga Komisioni i Bashkimit Europian:

*“Bashkësia e elementëve që në kompleksitetin e tyre krijojnë hapësirat, ambientet dhe kushtet e jetesës të njeriut dhe të shoqërisë në formën në të cilën manifestohen”*.<sup>3</sup>

Interesi i mbrojtjes së mjedisit nuk i përket një subjekti individual, por iu përket të gjithëve! Ajo ka si objekt mbrojtjen e një të mire me karakter të pazëvendësueshëm dhe të përgjithshëm. Mbrojtja e kësaj të mire duhet të ketë karakter të gjithanshëm dhe mbrojtja juridike penale merr një rëndësi të veçantë pikërisht për shkak të objektit të një rëndësie të posaçme me interes komunitar.<sup>4</sup>

## Bibliografia

### *Legjislacioni*

Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011: “Për mbrojtjen e mjedisit”

Ligji Nr. 10 440, datë 7.7.2011: “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”

Ligji Nr. 10 463, datë 22.9.2011: “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

### *Literatura*

BAJNO R.: La tutela dell’ambiente nel diritto penale, in Riv. Trim. dir. pen. econ., 1990

---

1 - Postiglione: *Mjedise: suo significato giuridico unitario*, in Riv. Trim. Dir. Publ. 1983.

2 - Caravita: **Il Diritto pubblico dell’mjedise**, Ed. Mulino, 1990.

3 - Consiglio dei Ministri per la Protezione dell’Mjedise, in G.U.C.E. n. C52 del 26 maggio 1972.

4 - Protospisani: *Aspetti preliminari per uno studio giurisdizionale degli interessi collettivi*, in **Diritto e Giurisprudenza** 1974, fq. 801.

BENOZZO, M.: La direttiva sulla tutela penale dell'ambiente, tra intenzionalità, grave negligenza e responsabilità delle persone giuridiche, in *Diritto e giurisprudenza agraria, alimentare e dell'ambiente*, 5/2009

BERNASCONI C.: Il difficile equilibrio tra legalità ed offensività nella tutela penale dell'ambiente, Padova, 2003

CALAMANTI A.: Tecnica sanzionatoria e funzione della pena nei reati ecologici, Protezione dell'ambiente e diritto penale, Bari 1993

CARAVITA B.: *Diritto pubblico dell'ambiente*, Bologna 1990

CATENACCI M.: *La tutela penale dell'ambiente*, Padova 1996

FIANDACA G.: Note sui reati di pericolo, Tommaso Natale, Palermo, 1997

IORE C. - IORE S.: *Diritto penale, parte generale, I*, Torino 2003

IORELLA A.: Reato in generale in *Enciclopedia del diritto*, Vol. XXXVIII, Milano 1987

GALLO M.: I reati di pericolo, in *Il foro penale*, Napoli, 1969

GARGANI A.: *Reati contro l'incolumità pubblica*, Tomo I, Milano 2008

GIANNINI S.: Ambiente: saggio sui diversi aspetti giuridici, in *Rivista trimestrale*

LO MONTE E.: Uno sguardo sulla legge delega per la riforma dei reati in materia di ambiente: nuovi "orchestrali" per vecchi spartiti, Milano 2002

## *Drejtësia shqiptare dhe procesi i integritit evropian*

---

■ Dokt. Jeta GOXHA

---

**Abstract.** *The aspiration to join Europe's got to be since the early 90s, shortly after the collapse of the communist regime. It is quite significant that the Albanians, the idea of change by number of union with the great European family. The only way to separate the tragic isolation and severe economic backwardness By number of European integration, through the construction of democracy and market economy*

*Due to the type of agreement signed in 1992 with the EU and the lack of progress in the relationship with the Union, the time-gap between the first steps of EU integration and one of the most essential elements of this process – approximation of legislation – in the Albanian case was quite long.*

*Scientific contributions on the issue under consideration are mainly projects and EU legislation and also legislation, national reports and strategies developed by the Albanian government, in order to harmonize its legislation with international standards. Study method is theoretical.*

*In the context of EU integration, the terms “approximation” or “harmonization” refer to the process of adapting the legal systems of associated*

*countries to the *acquis communautaire* and, as previously mentioned, it involves not only the adaptation of laws but also their actual implementation. On the Albanian side, the Strategy for European and Euro-Atlantic Integration approved by the Council of Ministers in 1998 was the first step towards a structured approach regarding the challenges of approximation of legislation with the EU *acquis*. It is the first document that makes a clear and direct reference to the process and measures that would facilitate the start of approximation.*

*Problems within the article are: the importance of adapting the Albanian legislation with EU standards, legislative changes to strengthen not only the Albanian justice but also its progress towards European civilization and values.*

**P**as rënies së diktaturës në Shqipëri në fillim të viteve '90, integrimi i Shqipërisë në BE është bazuar tek një shpresë e madhe se procesi i integritimit ishte rruga e rimëkëmbjes dhe e kthimit të Shqipërisë në identitetin e saj evropian. Shpresa tek integrimi evropian, si zgjidhja përfundimtare e problemit shqiptar, ishte mjaft e madhe dhe koha e anëtarësimit nuk dukej shumë larg. Anëtarësimi në BE shikohej si proces konkret nëpërmjet të cilit ëndrra evropiane do të bëhej realitet.

Premisa bazë ishte se anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian do të shënonte fundin e tranzicionit, transformimin e Shqipërisë në një vend të zhvilluar dhe demokratik. Të gjitha sondazhet e zhvilluara në periudha të ndryshme kohore, kanë treguar mbështetje popullore mbi 90% për anëtarësimin në Bashkimin Evropian<sup>1</sup>. Marrëdhëniet e para diplomatike të Shqipërisë me Bashkimin Evropian u vendosën në vitin 1991, por ngjarja me rëndësi në këto vite u shënuar në 11 maj 1992, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit, e cila hyri në fuqi në 1 dhjetor 1992.<sup>2</sup>

---

1 - Albanian Institute for International Studies, *Rethinking EU Integration. Perceptions and realities*, Tirana 2007.

2 - *Kjo marrëveshje i krijoi mundësinë Shqipërisë që të përfitojë nga fondet e programit PHARE. Në kuadrin e këtij programi, në periudhën e viteve 1991-1996 ndihma e përgjithshme e BE për vendin tonë llogaritet në rreth 511 milionë euro, një pjesë e së cilës përfshinte asistencë teknike, si konsulentë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë e administratës, trajnime e studime; ndërsa pjesa tjetër është akorduar për investime në infrastrukturë, në sektorin e prodhimit, në atë shoqëror, në administratën publike dhe në zhvillimin rajonal.*

## Përpjekjet për t'iu afruar Europës

Në nëntor të vitit 2000, në samitin e Zagrebit, një grup ekspertësh vlerësuan progreset e përmbushura nga Shqipëria në lidhje me reformat e nevojshme, për të arritur më pas me nënshkrimin e marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Në qershor të vitit 2001, grupi i punës paraqiti relacionin final, mbi bazën e të cilit Komisioni Europian mendoi se ishte më në fund e mundur të niste negociatat për nënshkrimin e marrëveshjes (MSA).

Procesi i integritimit euro-atlantik të Shqipërisë ka gjetur pasqyrim edhe në tekstin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila ka afirmuar klauzola të rëndësishme që vendosin parimet bazë për përgatitjen dhe legjitimitimin e integritimit të Shqipërisë në aleancat ndërkombëtare. Kushtetuta e vitit 1998 në Shqipëri, ishte ndër kushtetutat e para në Europë që sanksionoi dispozita të vlefshme për procesin e integritimit<sup>1</sup>.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit me Shqipërinë shfaqet jo vetëm një akt mbiligjor, por edhe një akt mbikushtetutor. Pavarësisht nga fakti nëse do ta quajmë MSA një marrëveshje ndërkombëtare si ato klasike, apo nëse do ta konsiderojmë atë pjesë të së drejtës komunitare, detyrimet e Shqipërisë në kuadrin e procesit të integritimit europian nuk do të kishin dallime.<sup>2</sup>

Qëllimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ishte vendosja e stabilitetit ekonomik dhe politik. Për t'u bërë palë e marrëveshjes, Shqipëria duhet të plotësonte kriteret politike dhe ekonomike të vendosura nga Këshilli Europian në qershor të vitit 1993<sup>3</sup>.

---

1 - Vetëm Kushtetuta e Polonisë kishte parashikuar dispozita që vendosnin klauzolat e integritimit dhe të delegimit të pushteteve. Në vendet e tjera të Europës Qendrore e Lindore që kishin nënshkruar marrëveshjet europiane për asociim, amendimet e Kushtetutës u kryen më vonë, kryesisht në vitet 2000.

2 - Xhezair, Z., Aurela, A and Eranda Cani: *Rule of law in the Constitution of the Republic of Albania*, Publishing house Adelprint, Tiranë 2011, p. 59-66.

3 - Në vitin 1993, në pajtim me kërkesat e ish-vendeve komuniste për anëtarësim drejt Unionit, Këshilli i Europës i hartoi tre kriteret që vendet-kandidate duhet t'i plotësojnë para se të bëhen anëtare. Para anëtarësimit, anëtarët e reja duhet të kenë:  
- Institucione të konsoliduara që garantojnë demokraci, ushtrimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektimin e mbrojtjen e pakicave. - Ekonomi funksionale të tregut dhe mundësi për t'u ballafaquar me presionin e konkurrencës dhe forcat e tregut përbrenda Unionit. - Aftësi për t'i pranuar obligimet e anëtarësisë në BE, përfshirë edhe mbështetje qëllimeve të Unionit. Ato duhet të kenë administratë të aftë publike që

Më 31 janar 2003 u hapën zyrtarisht bisedimet për nënshkrimin e marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit nëpërmjet Komunitetit European dhe vendeve anëtare nga njëra anë dhe Shqipërisë nga ana tjetër.<sup>1</sup> Kjo marrëveshje hyri në fuqi më 1 prill të vitit 2009, pasi ishte ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë në korrik të vitit 2006, nga Parlamenti European, si dhe nga parlamentet e 25 vendeve që në momentin e nënshkrimit të MSA, ishin anëtare të BE. Kjo Marrëveshje e detyron Shqipërinë që të bëjë të gjitha përpjekjet për të përqsur legjislacionin e vendit me atë Komunitar.

## Shteti i të drejtës dhe implementimi i tij në Shqipëri

Shteti i të drejtës nënkupton një sistem ligjor që funksionon mirë, i cili siguron drejtim mbi rregullat bazë që përcaktojnë funksionimin e organizimit shoqëror dhe që ndihmon në vënien e tyre në praktikë<sup>2</sup>.

Ekzistojnë disa standarde të pranura gjerësisht, të cilat, duke përbërë një emërues të përbashkët të shteteve anëtare të BE, ndikojnë në procesin e reformës gjyqësore në shtetet që aspirojnë anëtarësimin në BE, gjithsesi duke i lënë këtyre të fundit një hapësirë veprimi dhe zgjedhjeje. Komisioni i ka përdorur këto standarde për të monitoruar reformat në gjyqësor. Këto standarde mund të përmblihen në detyrimin e çdo shteti për të siguruar një gjyqësor të pavarur dhe të aftë.

Në Shqipëri, gjatë njëzet viteve të tranzicionit demokratik, çështjet e pavarësisë së gjyqësorit dhe raportet e tij me pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv, kanë qenë problemet më të debatueshme. Ky debat ka nxjerrë në dukje shumë probleme, të cilat konsiderohen mjaft të rëndësishme për të siguruar një gjyqësor të pavarur. Në mjaft raste, këto çështje janë bërë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese e RSH, madje edhe nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut. Duke interpretuar Kushtetutën, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë e ka kuptuar sanksionimin e shkallëve të gjyqësorit dhe mbrojtjen e garancive e statusit të gjyqtarit nga Kushtetuta, si një nga aspektet më të rëndësishme të pavarësisë së pushtetit gjyqësor.

---

*t'i zbatojë dhe administrojë në praktikë ligjet e BE.*

1 - Kastriot Dervishi: *Historia e Shtetit shqiptar 1912-2005, Organizimi shtetëror, jeta politike, ngjarjet kryesore, të gjithë ligjvënësit, ministrat dhe kryetarët e shtetit shqiptar në historinë 93 vjeçare të tij. Toena, Tiranë 2005.*

2 - *Analizë e sistemit ligjor në Shqipëri, OSCE, Prezenca në Shqipëri, Tiranë 2004, fq. 3.*



Lufta ndaj fenomeneve të korrupsionit ka qenë dhe vazhdon të mbetet një ndër prioritetet kryesore për Shqipërinë, në funksion të zhvillimit ekonomik dhe institucional të vendit, si dhe për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritimit europian. Kaq i rëndësishëm është ky proces, sa që ai tashmë përcakton edhe vetë sistemin tonë demokratik. Demokratizimi nënkupton një proces ndërmjet të cilit demokracia përmirësohet, konsolidohet dhe funksionon më mirë. Ky koncept mbart në vetvete edhe paradigmen e konsolidimit të demokracisë dhe institucioneve, të cilat, sipas kësaj qasjeje, janë të brishta dhe duhet të forcohen.

Demokracia, si një produkt i shtetit të së drejtës, nuk mund të realizohet pa institucionet që realizojnë drejtësinë. Demokratizimi si proces është njëshuar me integrimin në Bashkimin Europian, sikurse dhe modernizimi apo progresi i shoqërisë shqiptare në përgjithësi.

Kështu, në programin e qeverisë shqiptare 2005-2009 theksohej qartë se “Zhvillimi dhe integrimi janë dy anë të së njëjtës medalje, dy drejtime plotësisht të lidhura e kushtëzues të njëri-tjetrit. Zhvillimi kalon nëpërmjet integritimit dhe integrimi nëpërmjet zhvillimit të vendit”. Në mënyrë identike perceptohet edhe marrëdhënia midis integritimit europian dhe demokratizimit<sup>1</sup>.

Harmonizimi i legjislacionit me **Acquis Communautaire** paraqet një nga sfidat kryesore për shtetet kandidatë për anëtarësim në BE, duke përfshirë ato që aspirojnë t’i bashkohen BE në vitet që vijojnë, apo të ashtuquajturat vendet e Ballkanit perëndimor.

## Përqasja e legjislacionit me atë europian

Harmonizimi i legjislacionit me Acquis communautaire<sup>2</sup>, në mes të tjerash, nënkupton miratimin e normave juridike të Acquis communautaire në legjislacionin e vendit. Miratimi nuk nënkupton procesin mekanik, me fjalë të tjera nuk është një përafrim tekstual i tekstit ligjor, por një përafrim standardesh.

Procesi legjislativ shqiptar gjithnjë e më tepër orientohet drejt BE dhe gjithnjë e më pak drejt realitetit lokal. Në këtë mënyrë miratohen një pafundësi ligjesh që janë të palidhur dhe të pazbatueshëm me realitetin politik, social dhe administrativ shqiptar.

---

1 Blendi Kajsiu: *Integrimi si pengesë për demokracinë*, [www.revistapolis.com](http://www.revistapolis.com)

2 - Ky term në mënyrë më të qartë është përdorur në nenin 2 të Traktatit të Bashkimit Europian, të njohur gjithashtu si Traktati i Mاستrihtit. Thënë më thjesht, Acquis communautaire do të thotë rregullat që e formojnë kornizën ligjore funksionale të Komunitetit Europian.

Mjafton të përmendim ligjin e duhanit për ta kuptuar këtë dinamikë<sup>1</sup>. Në këtë mënyrë prodhohet një inflacion legjislativ që ul zbatueshmërinë e ligjit.

Në aspektin normativ, rruga drejt integritit europian kërkonte aderimin nga ana e Shqipërisë në traktatet ndërkombëtare në të cilat kishin aderuar më parë shtetet anëtare, si dhe përshtatja e legjislacionit kombëtar me direktivat e Komunitetit. Ky u bë objektivi i shtetit shqiptar në fillimin e procesit të **acquis communautaire**, i pasuar me atë të nënshkrimit të marrëveshjes së Asociim Stabilizimit.

Problemi nuk qëndron vetëm tek inefikasiteti që prodhon përafrimi aktual i legjislacionit me BE. Problemi nuk qëndron as vetëm tek mospërputhja e legjislacionit me realitetin shqiptar. Problemi qëndron tek një proces legjislativ jo-demokratik që, më shumë se tek shqetësimet e shoqërisë shqiptare, orientohet drejt direktivave europiane<sup>2</sup>.

Në një shoqëri si kjo e jona, lufta ndaj korrupsionit kërkon një përmirësim dhe zbatim efektiv të kuadrit ligjor, në mënyrë që të jetë e vërtetë, efektive, në përputhje me parimet kushtetuese dhe në funksion të zhvillimit e modernizimit të vendit. Kjo arrihet nëpërmjet reformave politike, ligjore, ekonomike dhe sociale, sikundër nëpërmjet ndërtimit të një sistemi drejtësie mbi baza thellësisht ligjore e profesionale.<sup>3</sup>

Nëse i referohemi KEDNJ, për shkak të natyrës së brishtë që kishte për shoqërinë shqiptare heqja e dënimit me vdekje, ligjvënësi, dhe në veçanti politika, prej disa vitesh nuk arrinin të nënshkruanin dhe të ratifikonin protokollin nr. 6 të Konventës Europiane të të drejtave të njeriut. Kjo sfidë u arrit të kapërcehej nëpërmjet vendimmarrjes së gjykatës kushtetuese, e cila pas shpalljes si antikushtetues të dënimit me vdekje, shmangu pengesën për integrimin europian të Republikës së Shqipërisë.<sup>4</sup>

---

1 - Ligji anti-duhan ka hyrë në fuqi prej më shumë se 5 vjetësh dhe që në fillim zbatimi i tij ka dështuar. Janë ndërmarrë një sërë aksionesh, por pa rezultat. Duket se urdhëri, i cili ka hyrë në fuqi në 1 shtator të këtij viti (2012), po jep rezultat në terren.

2 - Paradigma dëshpëruese e integritit në Bashkimin Europian. [www.euro-paesse.wordpress.com](http://www.euro-paesse.wordpress.com)

3 - Drejt integritit europian në një Shqipëri me ngërç, Agenda Institute, Tiranë.

4 - Sokol Sadushi: Drejtësia kushtetuese në zhvillim. Trajtime teorike dhe të praktikës së gjyqimit kushtetues, Botimet Toena, Tiranë.

## Ndikimet e integrimit europian ne drejtësinë shqiptare

Shqipëria është një vend me një sistem ligjor pak a shumë të ri, sepse, para viteve 1990 nuk ekzistonte një sistem gjyqësor i konsoliduar, çka do të thotë se e gjithë puna fillon pas vitit 1990, për te arritur në situatën e sotme. Shqipëria është në një fazë që nuk ka as më shumë dhe as më pak probleme se vendet e tjera.

Gjatë viteve të fundit janë ndërmarrë reforma në fushën e drejtësisë, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës së drejtësisë, hartimin e legjislacionit në përputhje me standardet europiane dhe monitorimin e zbatimit të suksesshëm të tij.

Është miratuar Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë dhe plani i saj i veprimit<sup>1</sup>, e cila është në fazën e zbatimit të saj. Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë përcakton këtë vizion për sistemin e drejtësisë: “Shqipëria do të gëzojë statusin e një vendi të integruar në strukturat europiane dhe euroatlantike, si një shtet i të drejtës, demokratik dhe garant i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, duke e shndërruar sistemin e drejtësisë që të jetë i hapur për këdo, të frymëzojë besim te kushdo dhe të sigurojë drejtësi për këdo”<sup>2</sup>. Strategjia Ndërsektoriale e sistemit të drejtësisë synon përsosjen më tej të sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë, rritjen e aksesit në drejtësi, rritjen e besimit të publikut në drejtësinë shqiptare, si dhe nxitjen e përshtetimit të integrimit europian<sup>3</sup>.

Realizimi i vizionit strategjik pritet të arrihet nëpërmjet zbatimit të objektivave konkretë, të tillë si:

- zhvillimi dhe konsolidimi i shtetit demokratik bazuar në liritë dhe të drejtat themelore të të gjithë individëve;

- luftë ndaj korrupsionit dhe fenomeneve të tjera negative që pengojnë zhvillimin e integrimin e vendit dhe garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës;

- pavarësi, transparencë, përgjegjshmëri dhe efikasitet në funksionimin e sistemit të drejtësisë.

---

1 - Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 20.7.2011.

2 - Vendim nr. 406, datë 27.6.2012: “Për miratimin e rekomandimeve për luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2012”.

3 - Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Botim i qendrës së publikimeve zyrtare, n. 116, Gusht 2011.

Në procesin e realizimit për forcimin e shtetit të së drejtës, fokusi kryesor, midis të tjerave, do të jetë: forcimi i pavarësisë së prokurorëve në procesin e hetimit, si dhe përmirësimi i transparencës dhe i efikasitetit të organeve të drejtësisë.

Objektivi kryesor është lufta kundër korrupsionit. Kjo duhet mbajtur parasysh nga të gjithë: Ministria e Drejtësisë, Prokuroria, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, gjyqtarët, etj. Edhe pse janë bërë shumë përpjekje, kjo është si një histori që nuk mbaron dhe që duhet mbajtur gjithnjë parasysh.

Në 12 rekomandimet e BE drejtuar Shqipërisë, bënte pjesë edhe miratimi i ligjit për krijimin e Gjykatës administrative. Kjo çështje kaloi me debate të fuqishme në parlamentin shqiptar, por më në fund ky ligj u miratua. Kjo përveçse plotësoi një nga kushtet për t'u antarësuar në BE, do të sjellë edhe lehtësimin e procesit në gjykata, gjithashtu do të kemi gjyqtarë të mirë specializuar në fushën administrative. Sistemi i gjykatave administrative do të jetë një mekanizëm i efektshëm për të mbrojtur interesat dhe të drejtat ligjore të të gjithë qytetarëve, lidhur me çështjet administrative<sup>1</sup>.

Përparimi ka qenë i kufizuar në plotësimin e kuadrit ligjor për reformën në gjyqësor. Nuk ka pasur përparim të mëtejshëm në lidhje me pavarësinë e gjyqësorit. Ka pasur shqetësime për ndërhyrje të papërshtatshme apo pengim të hetimeve të pavarura dhe ndjekjes penale të veprave të mundshme penale.

Procesi i emërimit të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese mbetet çështje shqetësuese për shkak të zgjatjes së procesit dhe, mbi të gjitha, për shkak të rrezikut të politizimit. Paanshmëria dhe pavarësia e këtyre institucioneve nuk është ende e garantuar plotësisht. Nuk është bërë përparim në luftën kundër korrupsionit brenda sistemit gjyqësor.

Imuniteti i plotë që gëzojnë gjyqtarët është një nga faktorët kryesorë që pengon hetimet për rastet e mundshme të korrupsionit brenda sistemit gjyqësor. Imuniteti i gjyqtarëve duhet të kufizohet apo të hiqet, gjë që kërkon ndryshime kushtetuese.

---

<sup>1</sup> - Procesi i gjykimit do të jetë i shpejtë, si rregull jo më shumë se 30 ditë. Përmes një procedure me hapa të sakta, të qarta, të thjeshta e me afate fikse që nga dorëzimi i ankimit e deri te marrja e vendimit. Procedura e shpejtë ndihmohet edhe nga qartësimi i termave, zhvillimi i seancave edhe pa praninë e palëve e bazuar në dokumente, qartësimet mbi masat për sigurimin e padisë, rolin e ekspertëve, rregullime të tjera specifike e deri tek përdorimi i teknologjisë së informacionit e komunikimit.

## Konkluzione

Shqipëria ka për të arritur ende një shkallë të nevojshme të pajtueshmërisë me kriteret e anëtarësimit dhe në veçanti për të përmbushur 12 prioritetet kyçe.

Lidhur me pavarësinë e gjyqësorit, nuk është bërë progres. Pavarësia e Gjykatës së Lartë duhet të garantohet, duke përfshirë një rishikim të sistemit aktual të emërimeve në mënyrë që të shmangen politizimet. Në lidhje me përgjegjshmërinë në gjykim, imuniteti i plotë që gëzojnë gjyqtarët mbetet një nga faktorë kryesorë që pengojnë hetimet në rastet e mundshme të korrupsionit në gjyqësor.

Imuniteti i gjyqtarëve duhet të kufizohet ose të hiqet, gjë e cila kërkon ndryshime kushtetuese.

Korrupsioni i përhapur është faktor kyç, i cili ka penguar përgjegjshmërinë e gjyqësorit. Një ligj i ri dhe aktet nënligjore përkatëse mbi “Ndërmjetësimin në zgjidhjen e konflikteve” u miratuan në shkurt 2011, në përputhje me standardet e BE.

Njëfarë progresi është bërë në lidhje me politikat e qeverisë për të luftuar korrupsionin. Në qershor 2011 u miratua një plan veprimi i ri anti-korrupsion për periudhën 2011-2013, i cili përfshin planet e përmirësuar individuale për ministritë dhe agjencitë qeveritare.

Gjithashtu janë vënë në zbatim disa projekte po aq të rëndësishme, të cilat synojnë të përmirësojnë cilësinë e veprimtarisë së gjykatave nëpërmjet aplikimit të sistemeve dixhitale dhe standartizimit të disa prej procedurave ligjore, mungesa e të cilave rrit si pakënaqësitë ashtu edhe mosbesimin e qytetarëve.

## Referenca

Erjona Canaj, Sokol Bana: E drejta e Bashkimit Europian, e azhurnuar me Traktatin e Lisbonës, Sh.B. “Arbëria 07”, Tirane 2010

Iva Zajmi: E drejta europiane, cikël leksionesh, Tiranë 2008

Kastriot Dervishi: Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005, Organizimi shtetëror, jeta politike, ngjarjet kryesore, të gjithë ligjvënësit, ministrat dhe kryetarët e shtetit shqiptar në historinë 93-vjeçare të tij, Toena, Tiranë 2006

Luan Omari: Parime dhe institucione të së drejtës publike, Botimet Elena Gjika, Tiranë 2007

Sokol Sadushi: Drejtësia kushtetuese në zhvillim. Trajtime teorike dhe të praktikës së gjyqimit kushtetues, Toena, Tiranë 2012

Xhezair Zaganjori, Aurela Anastasi, Eralda Cani: Shteti i së drejtës në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Adelprint, Tiranë 2011

Gjykata administrative alternative apo domosdoshmëri?, botim i institutit kërkimor shkencor Marin Barleti, Tiranë 2011

Analizë e sistemit ligjor në Shqipëri, OSCE, Prezenca në Shqipëri, Tiranë 2004

Manuali i procesit të Integritimit Europian. Roli dhe rëndësia e institucioneve, European Movement in Albania, Tiranë, shkurt 2009

Drejt integritimit europian në një Shqipëri me ngërç, Agenda Institute, Tiranë 2006 ([www.agendainstitute.org](http://www.agendainstitute.org))

Paskal Fonten: Europa në 12 leksione, Luksemburg: Zyra për botime zyrtare të Bashkësive europiane, 2006

Blendi Kajsiu: Integrimi si pengesë për demokracinë, Revista Polis ([www.revistapolis.com](http://www.revistapolis.com))

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë

Policy Paper: Një udhëtim në Progres Raportet e Komisionit Europian për Shqipërinë

Impakti mbi aplikimin e Shqipërisë për anëtarësimin në BE, European Movement in Albania, dhjetor 2009

Paradigma dëshpëruese e integritimit në Bashkimin Europian ([www.wordpress.com](http://www.wordpress.com))

Press review - Visit of a CEPEJ delegation in the framework of the CEPEJ Court Coaching Programme on the SATURN tools with the Tirana District Court 17-20 January 2012. Presentation of the CEPEJ work in Albania by Stéphane Leyenberger, Secretary of the CEPEJ and Jacques Bühler, President of the Pilot Group of the SATURN Centre for judicial time management

Dokument pune i stafit të Komisionit; Progres-Raporti për Shqipërinë që shoqëron komunikatën e Komisionit për Parlamentin Europian dhe Këshillin, Strategjia e zhvillimit dhe sfidat kryesore 2011-2012, Brukselles 2011

Republika e Shqipërisë, Këshilli i Ministrave: Strategjia për zhvillim dhe integrim 2007-2013, mars 2008

## *Raporti midis hapësirës urbane dhe lirive politike*

---

■ *MnD. Lindita LIÇAJ*

---

■ *MA. Eriola ÇAKRANI (HOXHA)*

---

**Abstrakt.** *Hapësira urbane është vendi ku qytetarët mund të ushtrojnë liritë dhe të drejtat e tyre politike të sanksionuara në Kushtetutë. E drejta e votës, si një e drejtë politike, në hapësirën urbane mund të shihet si e drejtë për t'u zgjedhur dhe e drejtë për të zgjedhur. Të drejtën për të votuar në një zonë urbane të caktuar e gezojnë të gjithë personat të cilët kanë mbushur moshën për të votuar dhe që banojnë në atë zonë urbane, përveç rastit kur personi është deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si i paaftë mendërisht. Këta zgjedhës kanë të drejtë të votojnë për subjektet zgjedhore. Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i njuh subjekteve zgjedhore të drejtën që ata brenda zonës ku kandidojnë të paraqesin programet e tyre në çdo formë dhe mënyrë të ligjshme.*

*Një tjetër liri politike është liria e tubimit paqësor, e cila realizohet në hapësirën urbane apo edhe në periferi të saj. Për ushtrimin e kësaj lirie, ligji për tubimet paqësore përcakton disa kushte të cilat duhet të plotësohen në mënyrë të tillë që tubimi të quhet i ligjshëm dhe të mos paraqesë rrezik real për sigurinë kombëtare, sigurinë publike, parandalimin e krimit, mbrojtjen e shëndetit ose të moralit ose mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të tjerëve.*

## E drejta e zgjedhjes

**K**ushtetuta e Republikës së Shqipërisë në pjesën e saj të dytë ka përcaktuar normat kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Këto liri dhe të drejta të njeriut ndahen: në liri dhe të drejta vetjake, liri dhe të drejta politike, si dhe liritë dhe të drejtat ekonomike sociale dhe kulturore. Pas lirive dhe të drejtave vetjake, në rend të dytë janë sanksionuar liritë dhe të drejtat politike, të cilat kanë një rëndësi të madhe në territorin e Republikës së Shqipërisë. Garantimi dhe respektimi i të drejtave politike realizohet sipas standardeve europiane.

Në Raportin e vitit 2011 drejtuar Keshillit të Bashkimit Europian, Shqipëria ka bërë progres të dukshëm të respektimit dhe garantimit të të drejtave politike, afirmimin e të drejtës për të zgjedhur, afirmimin e të drejtës për t'u organizuar në organizata apo shoqata, si dhe liria e tubimeve paqësore. Në tërësi, me gjithë disa aspekte, si konkurrueshmëria e procesit, përgatitjet teknike transparente, votimi relativisht i qetë në ditën e zgjedhjeve, procesi pozitiv i numërimit, mbulimi mediatik pluralist dhe i shumëllojshëm, zhvillimi i zgjedhjeve që është prioritet kyç i Opinionit, përmbushi vetëm pjesërisht standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

Megjithëse Kodi Zgjedhor mbetet një bazë e mirë ligjore dhe teknike për procesin zgjedhor, reforma zgjedhore është e nevojshme për përparim të mëtejshëm. Në këtë kontekst, roli i partive politike është i rëndësishëm, jo vetëm si aktorët kryesorë në procesin e reformës, por edhe për të siguruar që klima politike të mos ndikojë negativisht në proces dhe në shprehjen e vullnetit të votuesve.<sup>1</sup>

Në Nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohet e drejta për të votuar. Hapësira urbane është vendi ku qytetarët mund të ushtrojnë liritë dhe të drejtat e tyre politike të sanksionuara në Kushtetutë.

Kjo e drejtë harmonizohet me disa dispozita të tjera kushtetuese, të cilat sigurojnë ushtrimin e të drejtës për të votuar si një e drejtë konkrete<sup>2</sup>. Në doktrinën juridike e drejta për të votuar ka ndryshuar dhe ka evoluar. Kjo e drejtë është zbatuar në kohë të ndryshme dhe në hapësira gjeografike të ndryshme, duke zbatuar parime themelore të cilat kanë ndryshuar dhe janë zgjeruar duke pasur si qëllim kryesor lirinë e votës, barazinë, fshehtësinë e votës si dhe qenien vetjake të votës.

---

1 - Progres raporti për Shqipërinë 2011 për Parlamentin Europian dhe Këshillin e Bashkimit Europian, fq. 7.

2 - Luan Omari, Aurela Anastasi: E drejta kushtetuese, abc, Tiranë 2008, fq. 160.



Sot zbatohet e drejta e zgjedhjes e përgjithshme, e cila nënkupton të drejtën e zgjedhjes së të gjithë shtetasve që kanë mbushur moshën 18 vjeç qoftë edhe ditën e zgjedhjeve. Ky votim ndryshe quhet votim universal, i cili ndryshon nga votimi mashkullor, i cili është zbatuar në gjithë rajonin dhe në Shqipëri para luftës së dytë botërore në masë të madhe, ku të drejtën për të votuar e gëzonin vetëm meshkujt. Të drejtat dhe liritë politike zgjerohen varësisht nga karakteri i shoqërisë si dhe nga niveli i demokracisë, funksionit të shtetit si dhe të shtetit të së drejtës<sup>1</sup>. Pas luftës së dytë shohim një rritje të të drejtave të njeriut dhe përkatësisht të drejtave të grave, të cilat mbroheshin dhe garantoheshin nga shtetet. Një e drejtë e rëndësishme ishte edhe e drejta për të votuar.

E drejta e zgjedhjes, si një e drejtë politike në hapësirën urbane, mund të shihet si e drejtë për t'u zgjedhur dhe e drejtë për të zgjedhur, e cilësuar ndryshe, e drejtë aktive dhe e drejtë pasive. E drejta aktive e zgjedhjes është e drejta e zgjedhësve për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre në organet përfaqësuese. E drejta pasive e zgjedhjes është e drejta e shtetasve që të kandidojnë dhe të kenë mundësinë për t'u zgjedhur si përfaqësues në organet përfaqësuese. Kushtetuta jonë përcakton se shtetasit që mund të ushtrojnë të drejtën aktive të zgjedhjes në një zonë urbane të caktuar e gëzojnë të gjithë personat të cilët kanë mbushur moshën për të votuar dhe që banojnë në atë zonë urbane, përveç rastit kur personi është deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si i paaftë mendërisht. Ndërsa në lidhje me të drejtën pasive të zgjedhjes, përcaktohet se shtetasit të cilët vuajnë një dënim me heqje lirie gëzojnë vetëm të drejtën aktive dhe jo të drejtën pasive.

Personat që ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes aktive janë cilësuar në kodin zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si zgjedhës. Zgjedhësit ndahen në zgjedhës të zonës urbane dhe zgjedhës të zonës rurale, për shkak të ushtrimit të të drejtës së zgjedhjes në zona të ndryshme. Kodi zgjedhor rregullon çështje që kanë të bëjnë me listat e zgjedhësve, përcakton norma me karakter material që përcaktojnë kuptimin dhe përmbajtjen e tyre, norma me karakter organik që përcaktojnë organet kompetente për përgatitjen e tyre, si dhe norma me karakter procedural, të cilat përcaktojnë procedurat që ndiqen për përgatitjen dhe shpalljen përfundimtare të tyre. Kodi parashikon detyrimin e zgjedhësve për t'u regjistruar në zyrat e gjendjes civile dhe të vërtetojë vendqëndrimin në zonën përkatëse të qendrës së votimit. Zgjedhësit të cilët banojnë në zonën urbane e ushtrojnë të drejtën e votës brenda zonës së tyre urbane, sipas ndarjes në zonën elektorale që ka përcaktuar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Zgjedhësit kanë të drejtë të ndryshojnë zonën e votimit nëse ata jetojnë në një vendbanim të ndryshëm nga vendqëndrimi i mëparshëm.

---

1 - Kurtesh Saliu: *E drejta kushtetuese, Timegate, 2004, fq. 222.*

Organet kompetente bëjnë të mundur regjistrimin e zgjedhësve në listën e zgjedhësve dhe ndryshimet kur zgjedhësit ndryshojnë vendbanimin.

Në Shqipëri, si dhe në çdo shtet tjetër, përqindja e zgjedhësve që ushtrojnë të drejtën e votës është gjithmone më e ulët se përqindja e pjesëmarrjes absolute të zgjedhësve. Pjesëmarrja e zgjedhësve është e ndryshme në varësi të zonave ku zgjedhësit ushtrojnë të drejtën aktive. Në zonat urbane votojnë në përqindje më të ulët lidhur me numrin e zgjedhësve që banojnë në ato zona, duke e krahasuar me përqindjen e zgjedhësve në zonat rurale, ku përqindja është më e lartë duke e krahasuar me zgjedhësit e listave të zgjedhjes. Procesi zgjedhor pas rënies së komunizmit ndryshoi rrënjësisht duke pasur si qëllim të tij garantimin dhe respektimin e të drejtave politike të shtetasve shqiptarë.

Hapësira gjeografike e zonës urbane ka ndryshuar me kalimin e viteve, e cila është zgjeruar më tepër. Si pasojë, personat të cilët ushtrojnë të drejtën e zgjedhjes brenda kësaj zone janë rritur si rrjedhojë e vendqëndrimit të një numri më të madh të shtetasve në këto zona.

Këta zgjedhës kanë të drejtë të votojnë për subjektet zgjedhore. Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i njeh subjekteve zgjedhore të drejtën që ata, brenda zonës ku kandidojnë, të paraqesin programet e tyre në çdo formë dhe mënyrë të ligjshme. Demokracia është një kompleks i tërë marrëdhëniesh, që përfshijnë jo vetëm aspektin legjislativ normativ, por edhe aspektin praktik, pra vënien në jetë të akteve juridike duke iu shmangur faktorëve të ndryshëm objektivë dhe subjektivë. Sipas Xhovani Sartorit, demokracitë moderne mbështeten në:

1. qeverisjen e kufizuar të shumicës,
2. procedurat zgjedhore,
3. transmetimin e pushtetit me anë të përfaqësimit.<sup>1</sup>

Neni 45/3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton se vullneti i çdo zgjedhësi realizohet nëpërmjet shprehjes së votës; vota duhet të jetë vetjake, e lirë, e barabartë dhe e fshehtë. E drejta e zgjedhjes së votuesit quhet se është ushtuar kur vota gëzon elementët thelbësorë të saj. Tipari i qenies vetjake të votës shfaq më tepër moszbatime në zonat rurale, ku zgjedhësit edhe në ditën e votimit votojnë në grup ose në familje. Votimi i gjithë familjes sëbashku sjell imponimin e votës pjesëtarëve të familjes sipas vullnetit të kryetarit të familjes në familjet patriarkale. Ky fenomen ndodh më pak në zonat urbane, duke qenë se numri i familjeve patriarkale është më i vogël se në zonat rurale. Votimi në grup apo familje çënon dhe votimin e lirë sepse familjari ndihet i detyruar për të votuar kandidatin apo partinë politike duke pasur pranë urdhëruesin, dhe në atë rast ai ndodhet përpara votimit të vesuar dhe nuk voton i lirë.

---

1 - Luan Omari: *Sistemi parlamentar*, Elena Gjika, Tiranë. fq. 232.

## E drejta për t'u organizuar lirisht në hapësirën urbane

Në nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është sanksionuar e drejta e organizimit kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm. Pluralizmi politik dhe ideologjik është një nga parimet themelore kushtetuese në shtetin shqiptar. Çdo person mund të organizohet lirisht dhe të bashkohet në organizatë, të cilat mund të kenë qëllime të ndryshme, por me kushtin që këto qëllime të mos shkelin parimet kushtetuese dhe të mos jenë të kundraligjshme.

Në Kushtetutë dhe në ligjin për partitë politike ndalohet krijimi i partive politike dhe organizatave të tjera, në të cilat programet dhe veprimtaritë e tyre mbështeten në metoda totalitariste, që nxisin dhe përkrahin urrejtjen racore, fetare, krahinore ose etnike, që përdorin dhunën për marrjen e pushtetit, ose për të ndikuar në politikën shtetërore. Ndalohen gjithashtu partitë dhe organizatat më natyrë të fshehtë, të cilat nuk tregojnë qëllimin e krijimit të vetë partisë apo organizatës. Në këtë mënyrë programet që paraqesin partitë politike si dhe organizimi i tyre i brendshëm, bazohen në parime demokratike. Kjo sjell detyrimin e shtetit për të ushtruar kontrollin mbi partitë politike, në mënyrë që të respektojnë dhe garantojnë të drejtat e anëtarëve të partisë, qytetarëve nga vetë organizata ku ata aderojnë. Përveç kontrollit, shteti i garanton këtyre organizatave edhe lehtësira për të vepruar brenda programit të tyre. Dispozitat e ligjit "Për partitë politike" nuk trajtojnë asnjë lloj kufizimi për qytetarët që hyjnë në partitë politike dhe as e motivojnë futjen në parti në bazë të bindjeve politike<sup>1</sup>.

Partitë politike kanë detyrimin ligjor për t'u regjistruar në gjykatën e rrethit ku ato kanë selinë qendrore. Partitë politike e ushtrojnë veprimtarinë e tyre edhe në zonat e tjera urbane dhe rurale, ku ato mund të kenë filiale apo grumbullime të anëtarëve të asaj partie. Në procesin zgjedhor marrin pjesë të gjitha partitë politike. Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë përcakton mënyrën e organizimit dhe funksionimit të zgjedhjeve, ku parashikohet gjithashtu detyrimi i partive politike për të dorëzuar para Komisionit Qendror të Zgjedhjeve listën e kandidatëve për t'u zgjedhur nga ajo parti, kandidatë të cilët do të garojnë në zgjedhjet qendrore. Zgjedhësit kanë të drejtë të votojnë për subjektet zgjedhore. Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i njeh subjekteve zgjedhore të drejtën që ata, brenda zonës ku kandidojnë, të paraqesin programet e tyre në çdo formë dhe mënyrë të ligjshme.

---

<sup>1</sup> - Luan Omari, Aurela Anastasi: *E drejta kushtetuese, abc, Tiranë 2008 fq. 175.*

Brenda hapësirës urbane për të cilën ata janë regjistruar si kandidatë, apo zonës rurale, ligji i njeh të drejtën e fushatës zgjedhore, e cila realizohet duke paraqitur programin në atë zonë urbane që ai kandidat kandidon. Nga kjo e drejtë e subjektit zgjedhor kuptohet dhe ndalimi i fushatës jashtë zonës së hapësirës urbane apo rurale për të cilën ai është përcaktuar si kandidat.

## **Liria e tubimeve paqësore në zonat urbane**

Një tjetër liri politike është liria e tubimit paqësor, e cila realizohet në hapësirën urbane apo edhe në periferi të saj. Për ushtrimin e kësaj lirie, ligji për tubimet paqësore përcakton disa kushte të cilat duhet të plotësohen në mënyrë të tillë që tubimi të quhet i ligjshëm dhe të mos paraqesë rrezik real për sigurinë kombëtare, sigurinë publike, parandalimin e krimit, mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, ose mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të tjerëve,

Kushtetuta përcakton në nenin 47, se kushdo është i lirë për të organizuar tubime paqësore dhe pa armë. Shteti ka detyrimin e garantimit të pjesëmarrjes në tubimet paqësore dhe nëpërmjet policisë së shtetit, e cila ka për detyrë të garantojë dhe të mbrojë të drejtën e çdo personi për të organizuar dhe marrë pjesë në tubime paqësore dhe pa armë. Ndalimi ose shpërndarja e një tubimi lejohet vetëm në rastet kur: mënyra e zhvillimit të tubimit është e tillë që mund të dëmtojë në mënyrë konkrete rendin publik dhe sigurinë e personave; gjatë zhvillimit të tij kryhen krime; ekziston një situatë emergjente që lidhet me sigurinë publike, kur vendi i zënë nga tubimi kërkohet nga shërbimet e emergjencës. Oficeri i policisë, përgjegjës për të ndihmuar dhe vëzhguar zhvillimin e tubimit, mund të urdhërojë largimin e një grupi personash nga tubimi, në rast se mendon se rreziku shmanget me largimin e këtij grupi personash që pengojnë zhvillimin normal të tubimit. Në rast të kundërt, oficeri i policisë, përgjegjës për të ndihmuar dhe vëzhguar tubimin, urdhëron organizatorët, drejtuesit dhe pjesëmarrësit të ndërpresin tubimin dhe të largohen nga vendi. Në çdo rast, zbatimi i masave për ndalimin dhe shpërndarjen e një tubimi paqësor e pa armë bëhet në mënyrë të shkallëzuar.

Ligji për tubimet përcakton se tubimet mund të kryen në sheshe dhe vendkalime publike. Vendet publike si dhe sheshet mund të gjenden si në zonat urbane ashtu dhe zonat rurale. Të gjithë shtetasit pavarësisht vendbanimit apo vendqëndrimit në këto zona rurale dhe urbane, janë të lirë për t'u organizuar në tubime. Organizimi i tubimeve realizohet me pjesëmarrjen e organizatorit të tubimit si dhe me personat ndihmës të tij për zhvillimin e tubimit paqësor dhe pa armë. Tubimet në hapësirën e vendeve publike mund të organizohen në formën e grumbullimeve, manifestimeve, mbledhjeve dhe parakalimeve me karakter paqësor dhe pa armë, gjatë të cilave grupi i personave shpreh kërkesat

dhe pikëpamjet e tyre për probleme për të cilat janë të interesuar, si dhe mund të organizohen edhe në tubime urgjente.

Nëqoftëse grupet e njerëzve do të grumbullohen në mënyrë spontane dhe të menjëhershme dhe nuk çenojnë rendin publik, veprimtaria e tyre nuk përfshihet në përkufizimin e tubimit, kjo sepse ligji parashikon detyrimin e organizatorit të tubimit për njoftim me shkrim shefin e komisiariatit të policisë në hapësirën urbane të vendit publik jo më vonë se tre ditë përpara datës së zhvillimit të tubimit. Njoftimi duhet të përmbajë identitetin dhe adresën e drejtuesit dhe të organizatorit të tubimit, qëllimin e tubimit, datën, vendin, orën e fillimit dhe të përfundimit të tubimit dhe itinerarin e tij, numrin e përafërt të pjesëmarrësve dhe numrin e personave ndihmës në mbarëvajtjen e tubimit, si dhe personat që do të flasin në tubim.

Tubimet mund të zhvillohen edhe në zonat private, brenda zonave urbane, ku në një pronë private lejohet të hyjnë vetëm personat të cilët janë të autorizuar dhe në këtë rast policia nuk lejohet të hyjë pa marrë lejen e drejtuesit të tubimit që organizohet apo pronarit të pronës, vetëm nëqoftëse ndodhet përpara një rasti flagrant për të ndaluar një rrezik të çastit për jetën dhe shëndetin që mund t'u kanoset pjesëmarrësve të tubimit.

Në Shqipëri, pjesën më të madhe të tubimeve të ndodhura pas rënies së komunizmit, e zënë tubimet paqësore lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut apo tubimet me karakter politik.

Liritë dhe të drejtat politike të njeriut zbatohen më tepër në zonat urbane krahasuar me zonat rurale. Zbatimi në zonat urbane ka më tepër hapësira si rezultat i hapësirës më të favorshme, i arsimimit në numër më të lartë të popullsisë urbane, ekzistenca e lehtësirave në teknologjitë e informacionit, mundësia më e madhe e trajnimeve, grupimeve dhe mbledhjeve të qytetarëve në ambiente të përshtatshme me hapësira të mëdha.

## ***Bibliografia***

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë  
Ligji Nr. 8773, datë 23.4.2001: “Për tubimet”  
Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë  
Luan Omari, Aurela Anastasi: E drejta kushtetuese, abc, Tiranë 2008  
Kurtesh Saliu: E drejta kushtetuese, Timegate, 2004  
Ligji “Për partitë politike”  
Luan Omari: Sistemi parlamentar, Elena Gjika, Tiranë.  
Progres raporti për Shqipërinë 2011 për Parlamentin Europian dhe  
Këshillin e Bashkimit Europian

## *Ligji, politika dhe zgjedhjet e sistemit zgjedhor në Shqipëri.*

---

■ *Dokt. Urjana ÇURI*

---

**Abstract.** *This paper aims to highlight the observance of the law of political parties and elections electoral system as one of the most important institutional decisions for any democracy.*

*History tells us that electoral systems generally can not be solved in a conscious and free way. Often they are determined by a combination of unusual circumstances or historical changes. While as in case of new democracies, electoral systems are selected with a view, in the center of which stands parliamentary election. Albanian history after 90 years, is a party-multiplication history, which will quench the thirst of the democratic wind with the creation of a large number of political parties. This tendency had its historical explanation, because it was like a 50-year-old one-party system antipodal and got infinite scale examined as abusive. This addition to the vacuum party in Albanian life, consequently brought the definition of a majoritarian electoral system to proportional mix with it.*

*During the practical application of the elections are held two different systems of majoritarian and proportional system. Whereas, in practice, in most cases find out mixed*

*forms (...). Political structure of a country and the process formation of political will may be affected in a crucial way mill of the electoral system, because as intra order, the relationship between the parties and the relations between the government and the parliament depends on the electoral system.*

*23 June is coming. Along with high temperatures, this half-year expects to "taste", in addition to the opening of the election campaign and sweat of each competitor candidate for deputy(MP) in the assembly place, but while as candidates sweating is an issue that mostly should be managed in a organized way by the party structure aimed at the eve of the campaign gaining majority or safe places for potential alliances are Albanian citizens in their individual brand this time should respect the vote and its value.*

## Hyrje

**P**ërzgjedhja e sistemit të zgjedhjeve është një nga vendimet institucionale më të rëndësishme për çdo demokraci. Megjithatë, rrallë bëhet përzgjedhja e një sistemi të zgjedhjeve me vetëdije dhe me qëllim. Shpesh përzgjedhja është e rastit, rezultat i kombinimit jo të zakonshëm të rrethanave, të një trendi kalimtar, ose të historisë së huaj.

Ndikimi i kolonializmit dhe efektet e fqinjve me ndikim janë shpesh të bidshëm për të bërë përzgjedhjen e sistemeve të zgjedhjeve. Megjithatë, thuaja në të gjitha rastet përzgjedhja së një sistemi të veçantë të zgjedhjeve ka ndikim themelor në jetën e ardhshme politike të vendit në fjalë. Në shumicën e rasteve, kur të përzgjidhen njëherë sistemet elektorale, mbeten bukur të qëndrueshme meqë shtohen interesat politike dhe u përgjigjet stimulimeve që ato paraqesin.

Historiku i përzgjedhjes së sistemit elektorale pra mund të jetë aq i rëndësishëm sa edhe vetë përzgjedhja. Njeriu nuk duhet të ketë iluzion se vendimet e tilla bëhen në vakuum politik. Në të vërtetë, trajtimi i përparësisë politike është thuaja gjithmonë një faktor në përzgjedhjen e sistemeve elektorale – nganjëherë kjo është e vetmja konsideratë. Njëherit, përzgjedhjet e sistemeve elektorale në dispozicion janë shpesh, në të vërtetë, relativisht të reja. Megjithatë, ngjan po ashtu që llogaritjet e interesave politike afatshkurtëra mund shpesh të mjeçullojnë sukseset e një sistemi të veçantë zgjedhor dhe interesat më të gjera të sistemit politik. Si pasojë e kësaj, gjersa pranohen detyrimet praktike, nepërpqemi t'i qasemi çështjes së përzgjedhjes së sistemit elektorale në mënyrë sa më të gjerë dhe gjithpërfshirëse.

Gjatë zbatimit praktik të zgjedhjeve janë zhvilluar dy sisteme të ndryshme, sistemi mazhoritar dhe ai proporcional. Ndërsa në praktikë, në shumicën e rasteve gjejmë forma të përziera (...).

Struktura politike e një vendi dhe procesi i formimit të vullnetit politik mund të ndikohen në mënyrë vendimtare nëpërmjet përpunimit të sistemit zgjedhor, sepse sikurse rendi brendapartiak, edhe raporti mes partive dhe marrëdhëniet ndërmjet qeverisë dhe parlamentit varen nga sistemi zgjedhor. Nga ana tjetër, traditat e caktuara politike, gjendjet historike dhe kushtet shoqërore lejojnë vetëm sisteme të caktuara zgjedhore. Aplikimi universal i çdo sistemi zgjedhor nuk është i mundshëm. Manipulimi i sistemit zgjedhor pa marrë parasysh strukturat konkrete të dhëna politike dhe sociale rrezikon humbjen e funksionit të vërtetë të zgjedhjeve; nëse sistemi zgjedhor nuk pranohet dhe nuk njihet nga e gjithë popullsia, atëherë edhe pushteti i të zgjedhurve nga shumica nuk pranohet si i ligjshëm nga pakica.

## **Roli i sistemeve zgjedhore në konsolidimin e demokracisë përfaqësuese**

Njëra prej çështjeve më fundamentale që parashtrohet në teorinë e psefologjisë dhe të shkencave politike, është sqarimi i rolit të sistemeve kryesore zgjedhore për konsolidimin e demokracisë përfaqësuese.

Bota bashkëkohore dominohet nga tri tipe kryesore të sistemeve zgjedhore, nga të cilat derivojnë edhe një numër i madh i nënsistemeve dhe formave të tjera të modifikuara.

Për shkak të larmisë së sistemeve zgjedhore, përgjithësimi mbi rolet apo funksionet e zgjedhjeve është gjithmonë i vështirë. Domethënia e sistemeve të tilla, gjithsesi është më e vështirë të përcaktohet. Sistemi zgjedhor është në thelbin e kredibilitetit dhe legjitimitetit të demokracive moderne dhe me këtë rast në këto shoqëri është më rendësi të arrihet sa më tepër të jetë e mundur pajtueshmëri më e madhe përbrenda shoqërisë lidhur me sistemin zgjedhor i cili aplikohet. Situatat në të cilat ndryshim të madh të pushtetit sjell edhe ndryshimi konsekuent i sistemit zgjedhor,<sup>1</sup> janë fakte që janë vërtetuar shumë herë në praktikë. Studiuesi i mirënjohur i lëmisë së psefologjisë Duverger parashtroi një argument që më vonë u pagëzua si ligji i Duvergerit: sipas të cilit, sistemi i thjeshtë i shumicës së votimit e favorizon sistemin dypartiak.

---

<sup>1</sup> Latifi, Veton; *Politikologjia, Instituti për Demokraci dhe zhvillim; Shkup 2008, faqe 226*



Ai gjithashtu, argumentoi se përfaqësimi proporcional tenton të shoqërohet me sistemin shumëpartiak.<sup>1</sup>

Ky përkufizim për sistemet elektorale është mjaft argumentues për të treguar se cili prej sistemeve elektorale ndihmon më shumë dhe cili më pak në konsolidimin e demokracisë përfaqësuese, por nuk mund të vlejë gjithherë dhe në të gjitha vendet ku aplikohen këto sisteme zgjedhore. Zakonisht sistemi elektoral mazhoritar krijon bazament mjaftë stabil për qeveri dhe qeverisje demokratike të tipit të sistemit dypartiak; ndërsa sistemi proporcional hap mundësinë që një numër më i madh i partive politike të marrin mandate deputetësh në legjislaturë, mbi bazën e së cilës ndërtohet një qeveri shumëpartiake e qeverisur nga dy apo më shumë parti politike.

Sipas disa autorëve ky këndvështrim nuk përshtatet mirë në terren: shumica e vendeve evropiane prej vitit 1945 e këtej e kanë përdorur një formë të përfaqësimit proporcional me qeveri koalicioni dhe shumica prej tyre kanë pasur regjime stabile. Megjithatë, e metë kryesore e këtij sistemi është se, si rregull ai bënë të mundur copëtimin e shumtë të elektoratit dhe për rrjedhojë, përfaqësimin e shumë partive politike në parlament dhe acarimin e klimës politike në tërësi. Për këtë arsye, në vendet që aplikojnë një sistem të tillë të zgjedhjeve, paraqiten shpesh vështirësi dhe probleme për krijimin dhe ruajtjen e koalicioneve duke dëmtuar mjaftë stabilitetin e qeverisjes dhe duke vështirësuar marrjen e vendimeve politike në parlament dhe në qeveri.<sup>2</sup>

Varësisht nga tipi i sistemit zgjedhor dhe i traditës së ndërtimit të pluralizmit politik në një vend ngec apo konsolidohet demokracia përfaqësuese. Sistemi mazhoritar aplikohet një kohë të gjatë në shtetet me traditë të ndërtimit të pluralizmit politik dhe sistemit shumëpartiak. Madje, deri në fund të shek. XIX në shumicën e vendeve të Evropës Perëndimore zbatohet vetëm sistemi mazhoritar: pra, në çdo zonë zgjidhet kandidati që kishte fituar shumicën absolute të votave (50 % plus 1) ose shumicën relative ( më shumë vota se kandidatët e tjerë).<sup>3</sup>

Aplikimi i tij në vazhdimësi jo vetëm që ka stabilizuar raportet politike të partive politike, por edhe luftën e ashpër të partive politike dhe grupeve të tjera të interesit i ka shndërruar në garë politike, për ruajtjen, marrjen apo participimin në pushtetin shtetëror.

Edhe pse sistemi mazhoritar nuk mund t'i prodhojë sistemet dypartiake, ai i ruan dhe i siguron ato. Në kushte të tilla, votuesi në zgjedhje vendos mes dy programeve dhe grupeve të ndryshme qeveritare.

---

1 *Po aty.*

2 *Zaganjori, Xhezair; Demokracia dhe shteti i së drejtës; Luarasi Tiranë 2002, faqe 30*

3 *Filo, Llambro; Sistemet politike bashkëkohore, Tiranë 2008 faqe 131*

Grupi fitues qeveritar mund të shpresoj në këtë mënyrë në një shumicë të qëndrueshme parlamentare të partisë së tij. Nga ana tjetër, një gjë e tillë e ndihmon votuesin që në zgjedhjet e ardhshme të kërkojë përgjegjësinë e qeveris, sepse në këto rrethana suksesi apo mossuksesi politik mund të identifikohet qartë. Ndikimi i votuesve në formimin e qeveris përbëjnë përparësin e sistemit dypartiak të stabilizuar nga sistemi mazhoritar i zgjedhjeve.

Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA-të janë model se si organizohen zgjedhjet demokratike dhe si konsolidohet demokracia përfaqësuese. Në këto vende që nga organizimi i zgjedhjeve të para pluraliste, ato janë organizuar sipas sistemit mazhoritar. Si rezultat i aplikimit të këtyre sistemeve zgjedhore skena politike është e dominuar kryesisht nga dy parti politike.

Sistemi tradicional britanik i zgjedhjeve është sistemi i shumicës relative me zona elektorale me një kandidat, i quajtur: I pari listës merr postin. Postin e deputetit e fiton kandidati i zonës elektorale, i cili fiton numrin më të madh të votave në krahasim me konkurruesit e tjerë. Votat e ndara për kandidatët e tjerë nuk merren parasysh gjatë ndarjes së vendeve në parlament.<sup>1</sup>

Sistemi i zgjedhjeve paraqet një lidhje të ngushtë mes zonës elektorale dhe deputetëve. Pasi që ministrat domosdoshmërisht duhet t'i takojnë njërës nga dhomat e parlamentit, me humbjen në zonën e tyre elektorale ata i humbin të gjitha gjasat për postin qeveritar. Deputeti i zgjedhur për të gjithë qytetarët e zonës së tij elektorale është "ambasador" i tyre në parlamentin londinez. Ai zakonisht është i njohur në zonën e tij elektorale, edhe pse nuk duhet të jetë autokton për të pasur gjasa në zgjedhje.<sup>2</sup>

Parimet kryesore të sistemit partiak amerikan dallohen dukshëm nga parimet e organizimit të sistemit partiak në shtetet e Evropës. Partitë nuk kanë organizim hierarkik, instanca autonome partiake dhe nuk kanë mundësi disiplinimi nga kreu partiak. Programet partiako-politike formulohen vetëm para zgjedhjeve presidenciale. Nuk ekzistojnë parti të qarta programore. Parazgjedhjet zëvendësojnë gjithnjë e më tepër funksionin e nominimit të partive.

Lidhja e kandidatëve dhe e delegatëve me zonën elektorale është më e fortë se ajo me partinë. Sistemi elektoral mazhoritar ka qitur në qendrën e vëmendjes jo partinë politike por individin gjegjësisht kandidatin konkret.

---

1 <http://www.dadalos>, Roland Sturm: *Regierung und Veräaltung: Informationen zur Politischen Bildung 262, "Großbritannien"*, Bonn BpB 1999

2 *Po aty*

Kjo vjen në shprehje sidomos në zgjedhjet presidenciale ku presidenti përfaqëson më shumë orientimet e tij politike dhe programore e më pak programin e partisë politike prej nga është nominuar. Madje organizimi i zgjedhjeve për në Dhomën Përfaqësuese çdo dy vjet është më shumë rivlerësim i elektoratit ndaj kongresmenëve të zgjedhur e më pak vlerësim i partisë politike prej nga është i nominuar.

Kjo formë e kontrollit të deputetëve nga ana e elektoratit pas çdo dy viteve është si rezultat i aplikimit të Sistemit mazhoritar, ku elektorati ka mundësi të bëjë zgjedhjen e figurave autoritative në organet përfaqësuese.<sup>1</sup> Ky sistem përfaqëson një lidhje të veçantë në mes përfaqësuesve dhe zgjedhësve, duke i ofruar elektoratit një zgjedhje të qartë partish potenciale qeverisëse dhe duke ndihmuar që të formohen qeveri që kanë mandat të qartë nga elektorati, në bazë të mbështetjes së shumicës së tij. Në përgjithësi, sistemi mazhoritar i aplikuar në këto vende për një kohë të gjatë ka ndihmuar në konsolidimin e demokracisë përfaqësuese sepse në qendër të vëmendjes politike është individi, sikurse përbrenda strukturave nëpër parti politike po ashtu edhe para elektoratit nga i cili e marrin mandatin për në legjislaturë.

Parlamenti formohet kryesisht nga dy tri parti politike, ndërsa qeveria kryesisht përbëhet nga një parti politike pa pasur nevojë për krijimin e koalicioneve paszgjedhore, të cilat koalicione në shumicën e herëve janë gjenerator të krizave parlamentare dhe qeveritare.

Sistemi proporcional ndihmon në konsolidimin e demokracisë përfaqësuese në vendet me diversitete etnike. Madje, në këto vende aplikimi i sistemeve mazhoritare shpeshherë shmang mundësinë ose pengon minoritetet të marrin mandate deputetësh në organet përfaqësuese. Sri Lanka ka trashëguar modelin e sistemit zgjedhor të Britanisë, koloni e së cilës ishte deri në shpalljen e pavarësisë.

Zgjedhjet e vitit 1947 në Sri Lanka u mbajtën sipas sistemit mazhoritar I pari listës merr postin, por me kohë u zbulua se zgjedhjet sipas sistemit I pari listës merr postin nuk përfaqësonin interesat e minoriteteve, sepse Sri Lanka është shtet me histori të gjatë konfliktesh të hidhura në mes të mazhorancës Sinhaleze dhe minoritetit të Tamilëve.

---

<sup>1</sup> Nga: Gerhard Greiner / Hans woldt: *Das politische der USA / në Politik und Unterricht 13, 2/1987*

<sup>1</sup>Më vonë ajo miratoi një tip të sistemit proporcional të zgjedhjeve përmes të cilit është pretenduar të zbuten raportet në mes të shumicës Sinhaleze dhe pakicës Tamile për zgjedhjen e organeve përfaqësuese, ku komunitetit tamil i është mundësuar zgjedhja e një numri të caktuar përfaqësuesish në parlamentin 225 deputetësh.<sup>2</sup> Pas rënies së komunizmit në shtetet e Evropës Lindore është aplikuar kryesisht sistemi proporcional i cili ka mundësuar një numri të madh të partive politike me diversitete të mëdha politike, fetare, etnike etj., të marrin mandate deputetësh në legjislaturë. Përmes këtij sistemi është bërë e mundur që në parlament të marrin mandate deputetësh: partitë politike anti komuniste, partitë e komuniteteve të vogla etnike, madje edhe strukturat e ish partive komuniste tani të konvertuara në parti socialiste apo socialdemokrate. Përmes këtij sistemi zgjedhor lufta që ka mund të hapej lehtë në terrene tjera, veçanërisht në mes ish strukturave komuniste dhe anti komuniste është bartur në parlament përmes debateve të ashpra politike.

Kosova është shteti në të cilin sistemi proporcional i zgjedhjeve ka luajtur një rol vendimtar për konsolidimin e demokracisë përfaqësuese nga viti 2001 e tutje. Aplikimi i tij ka mundësuar që një numër i madh i partive politike dhe përfaqësuesve të grupeve të vogla etnike të marrin mandate deputetësh në legjislaturë.

Ndryshe nga sistemi mazhoritar dhe proporcional, sistemi gjysmë proporcional aplikohet në njërin anë për mbajtjen e lidhjeve deputet njësi elektorale dhe në anën tjetër për mbrojtjen e votës së qytetarit, që në përfundim të zgjedhjeve sa më pak të ketë vota të dështuara. Ky sistem zgjedhor ka luajtur një rol shumë pozitiv në shtetet me përbërje heterogjene të popullsisë, sidomos në ato vende ku ndasitë etnike kanë qenë shumë të shprehura. Meqenëse këtu votohet sipas dy fletëvotimeve, grupet e vogla etnike nëse nuk mund të marrin mandate deputetësh nga lista partiake në tërë territorin e shtetit, e kanë rastin të marrin mandate sipas listës së dytë e cila mund të jetë listë që përfaqëson: njësi federale, kantone, lande, njësi regjionale etj,

Këtë më së miri mund ta ilustrojmë me sistemin elektoral në Shqipëri para zgjedhjeve parlamentare të vitit 2009, ku partitë politike garuan edhe në njësitë elektorale një kandidatëshe edhe sipas listës partiake në tërë territorin e Shqipërisë.

---

1 *Manual i International, IDEA për hartimin e sistemeve elektorale, Intrenational IDEA, Information Division, Stromsberg, 5 – 103, 34, Stockholm, Sweden 1997, faqe 107*

2 *Shih: Electoral systems of the world; faqe 1-9*

Ky sistem zgjedhor ka ndihmuar Shqipërinë në konsolidimin e demokracisë përfaqësuese në një rën anë duke krijuar blloqe politike me parti lidere dhe në anën tjetër duke u përfaqësuar Shqipëria në organin më të lartë përfaqësues nga të gjitha regjionet e saj.<sup>1</sup>

Në përgjithësi, sistemet elektorale luajnë rol shumë të rëndësishëm për konsolidimin e demokracisë përfaqësuese, mirëpo secili prej tyre ka rol pozitiv nëse hartohet dhe aplikohet mbi bazën e specifikave të natyrës politike, ekonomike, gjeografike, të ndasive etnike dhe veçanërisht në bazë të traditës dhe kulturës për ndërtimin e shtetit të së drejtës.

## **Sistemet zgjedhore dhe kushtetutat**

Shumë nga krijimi kushtetues është paraqitur në kohë relativisht të vonshme: lëvizja gjithëbotërore drejt qeverisjes demokratike në vitet e 80-a dhe të 90-a të shekullit të kaluar kanë stimuluar një urgjencë të re duke hulumtuar modele të qëndrueshme të qeverisë së përfaqësimit përkatës, krahas me vlerësimin e freskët të sistemeve elektorale.

Ky proces është inkurajuar me realizimin e përhapur gjerësisht se zgjedhja e institucioneve mund të ketë ndikim të dukshëm mbi sistemin e gjerë politik – për shembull, gjithnjë e më shumë pranohet se një sistem elektorale mund të ndihmojë për të “inxhinieruar” bashkëpunimin dhe vendosjen në shoqëri të ndarë. Krijimi i sistemit elektorale tani i pranuar si me rëndësi të rëndësishme për çështje të mëdha të qeverisjes, dhe me gjasë si njëri me ndikimin më të madh, nga të gjitha institucionet politike.

Duke siguruar këtë analizë të hollësishme të përzgjedhjeve dhe të pasojave, dhe duke treguar si kanë punuar sistemet zgjedhore në botën demokratike, shpresojmë të arrijmë dy gjëra:

- të zgjerojmë njohuritë dhe të ndriçojmë diskutimet politike dhe publike;
- si dhe t’u japim mjetet përpiluesve të kushtetutës për të bërë një përzgjedhje me informacion, dhe
- në këtë mënyrë të shmangim disa nga efektet e mosfunksionimit dhe të destabilizimit të përzgjedhjeve të sistemeve të posaçme elektorale.

---

<sup>1</sup> *Shih: Kushtetuta e Shqipërisë, Pjesa e tretë, kreu I, neni 64, paragrafi 1,2,3,*

Në nivelin më themelor, sistemet elektorale tregojnë se në zgjedhjet e përgjithshme votat hidhen në vende që i fitojnë partitë dhe kandidatët. Variabilet kryesore janë:

1. formula elektorale e përdorur (d.m.th. qoftë të jetë sistem me mazhorancë ose proporcional, dhe çfarë formule matematike përdoret për të llogaritur caktimin e vendeve) dhe

2. përmasa e rajonit, jo sa votues jetojnë në një rajon, por më tepër sa anëtarë të parlamentit zgjidhen në atë rajon.

Struktura e sistemit elektorale lidhet ngushtë me më shumë aspekte të tjera administrative të zgjedhjeve me të cilat kanë të bëjnë në këtë faqe të internetit, siç janë shpërndarja e vendeve të votimit, caktimi i kandidatëve, regjistrimi i votuesve, kush i drejton zgjedhjet dhe kështu me radhë. Këto çështje janë me rëndësi të madhe, kurse avantazhi i mundshëm i çdo përzgjedhjeje të sistemit të zgjedhjeve do të pengohet përveç nëse u kushtohet vëmendje e nevojshme. Forma e sistemit elektorale po ashtu ndikon në fushat e tjera të ligjeve elektorale: përzgjedhja e sistemit elektorale ka ndikim në mënyrën me të cilën caktohen kufijtë rajonal, izajni i fletëvotimit, si numërohen votat, krahas aspekteve të tjera të shumta të procesit elektorale.

Sistemi zgjedhor në Shqipëri, ka si veçori të parë dhe kryesore të tij faktin se gjendet i sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Shqipëria përfaqëson (dhe përfaqëson akoma sot) një demokraci shumëpartiake të re, të pakonsoliduar. Për rrjedhojë, konkurrimi politik dhe ai i alternativave qeverisëse shpesh herë nuk është zhvilluar me rregulla dhe procedura të favorshme, ose jo, për të gjitha alternativat politike garuese në një proces zgjedhor.

Ajo forcë/alternativë politike e cila ka pasur pushtetin politik/legjislativ në prag të konkurrimit elektorale të radhës ka synuar gjithmonë aplikimin e rregullave elektorale për ta ndihmuar atë në mënyrë jo të drejtë apo të ndershme, për të marrë një rezultat elektorale më të mirë në përfundim të garës zgjedhore.

Dhe jo vetëm në Shqipëri, por gati në të gjitha vendet me demokraci të re, është konstatuar se përgjithësisht zgjedhja e sistemit zgjedhor është parë më tepër si një “mjet axhustimi” politik.

Duket se heqja e sa më shumë rasteve për ta përdorur ndryshimin apo sanksionimin e rregullave elektorale sipas interesave politike të momentit, në favor të njërës palë dhe kundër palës tjetër, ka kushtëzuar sanksionimin e sistemit zgjedhor në Kushtetutë.

Është e qartë se ndryshimi i sistemit zgjedhor, kur ai është pjesë e Kushtetutës, paraqet një vështirësi më të madhe se sa në rastin kur ai (sistemi zgjedhor) është pjesë e një ligji jo kushtetues.

Kushtetuta përcakton se:

- a- Kuvendi përbëhet nga 140 deputetë;
- b- 100 prej tyre zgjidhen direkt në zona zgjedhore me numër të përafërt zgjedhësish;
- c- 40 deputetë zgjidhen nga listat shumë-emërore të partive politike apo koalicioneve, të cilat marrin më shumë se 2,5% të votave të vlefshme (për partitë) dhe 4% të votave po të vlefshme (për koalicionet);
- d- Numri i përgjithshëm i deputetëve të çdo partie/koalicioni përcaktohet në raport sa më të afërt me votat e vlefshme të marra prej tyre në të gjithë vendin. Shiko nenin 64 të Kushtetutës , “Sistemi Zgjedhore”

Pra, sipas këtij përcaktimi vendet që merr një parti/koalicion në Kuvend janë në proporcion të drejtë me numrin e votave të vlefshme që kjo parti merr zgjedhje. Nëse një parti e caktuar e merr këtë numër vendesh në zgjedhjet që zhvillohen për 100 kandidatë në 100 zonat zgjedhore, ajo nuk përfiton mandate(vende) të tjera nga 40 mandatet deputetët e të cilëve zgjidhen nga listat shumë emërore të partive/koalicioneve.

Partia/koalicioni i cili ka kaluar respektivisht pragun e 2,5% dhe 4% të votave të vlefshme, por nuk ka marrë asnjë deputet në zonat një-emërore, ka të drejtë (dhe sistemi përgjithësisht e mundëson) që të përfitojë nga 40 vendet (mandatet), të cilat caktohen nga listat shumë-emërore të partive/koalicioneve

Kodi Zgjedhor përcakton edhe formulën e përlllogaritjes së mandateve që përfiton një parti politike/koalicion.<sup>1</sup>

Ky sistem zgjedhor duket se jep mundësi për një përfaqësim të gjerë të spektrit politik në Shqipëri, duke mos konsideruar në këtë rast se sa përfaqësues është ky spektër ndaj elektoratit. Dyzet (40) mandate plotësuese i japin mundësi partive të vogla që të jenë prezentë në Kuvend.

Kjo pasi të ashtuquajturat parti të mëdha, duke qenë se kanë mundësi të marrin më shumë kandidatë në zonat një-emërore për shkak të formulës/sistemit, nuk mund përfitojnë mandate shtesë. Në këtë mënyrë, këto mandate janë gati një “grant” për të ashtuquajtura parti të vogla.

---

1 Shiko nenin 67 dhe 68 të Kodit Zgjedhor – të ndryshuar

Parti të ndryshme politike e kanë vënë në një provë ekstreme këtë sistem zgjedhor, duke u përpjekur që të përfitojnë sa më shumë që të jetë e mundur nga hapësira që ky sistem ofron.

Dhe ashtu sikurse çdo sistem tjetër zgjedhor edhe ky mundet të deformohet në rast se mungon vullneti për ta aplikuar në mënyrë “të ndershme”. Këtë konkluzion e kanë evidentuar edhe vëzhguesit ndërkombëtar.<sup>1</sup>

Sipas gjetjeve të tyre duket se nuk ka një kritikë të drejtpërdrejtë për vetë sistemin zgjedhor që aplikohet, por kritikohet mungesa e vullnetit të partive politike për ta interpretuar nenin 64 të Kushtetutës në mënyrë të drejtë dhe të ndershme.

Kjo gjë duket më së shumti në faktin se jo pak dispozita të Kodit Zgjedhor kanë mangësi serioze në raport me standardet ndërkombëtare. Si të tilla mundet të përmendim ato dispozita të cilat lejojnë partitë të depozitojnë në KQZ marrëveshjet e tyre të brendshme për radhitjen e kandidatëve të tyre fitues nga lista shumë-emërore.

Sot në Kuvendin e Shqipërisë ka parti që kanë numër vendesh në disproporcion me përqindjen e tyre elektorale.

Është e kuptueshme që asnjë sistem zgjedhor nuk qëllon gjithmonë që të përputhë numrin e votave të fituara nga një parti politike, proporcionalisht me numrin e vendeve që kjo parti fiton në organin përfaqësues.

Gjithashtu, nga ana tjetër duket se ky sistem siguron një qeveri të qëndrueshme, e nevojshme kjo për vendet si Shqipëria me demokraci pluraliste të re, ku nevoja për reforma kërkon “moskokëçarje” politike dhe një qeverisje “të qetë”, pa probleme me “aleatët” politikë.

## **Sistemi proporcional: përparësitë dhe të metat<sup>2</sup>**

Se sa i ndikueshëm është stili politik dhe struktura politike e një shoqërie nga përpunimi i sistemit zgjedhor, këtë e tregon përmbledhja e dallimeve

---

1 *Shiko Raportet e OSBE/ODIHR*

2 *L.Omari “Sistemi Parlamentar” Tiranë 2000*



kryesore. Sistemi proporcional bazohet në parimin, sipas të cilit vendet në parlament ndahen saktësisht në proporcion të drejtë me votat që iu janë dhënë partive në të gjitha qendrat zgjedhore.

Nëse një parti përkatëse fiton 10 % të votave, asaj i jepen 10 % të mandateve. Në këtë mënyrë, parlamenti shndërrohet në një lloj pasqyre politike të rrymave të ndryshme të zgjedhësve. Çdo pakicë dhe çdo drejtim politikopragsmatik është i përfaqësuar dhe mund të paraqesë në parlament pikëpamjet e veta.

Sistemi proporcional i zgjedhjeve bën të mundur edhe themelimin e lehtë dhe me sukses të partive të reja, sepse për përfaqësimin e tyre në parlament mjafton të fitojnë vetëm nga një vote në çdo zonë elektorale, sepse ato mbliidhen në fund së bashku, kështu që fitimi p.sh. i një përqind të votave nga një parti e re, i jep asaj mundësinë të fitojë disa vende në parlament.

Joshja për themelimin e partive të reja padyshim që sjell me vete elemente të reja, nxit degëzimin e partive dhe grupeve të interesave të kufizuara.

Për këtë arsye, sistemit proporcional të zgjedhjeve i përgjigjet shpesh parlamenti i ndarë në shumë grupe parlamentare, nga të cilat dalin qeveri të paqëndrueshme koalicioni me dobësi të njohura të udhëheqjes dhe me kriza.

Votuesi, me votën e tij mund të ndikojë në formimin e qeverisë, sepse partitë në raste të zakonshme nuk përcaktohen në fushatat elektorale për koalicione të caktuara. Meqë sukseset e qeverisë çdo anëtar i koalicionit i konsideron të vetat, ndërsa mossukseset ua dedikon partnerëve, votuesi e ka edhe më të vështirë të njohë kompetentët, si në aspektin pozitiv, ashtu edhe në atë negativ.

Kandidatët për deputet, në sistemin proporcional përcaktohen në kongreset vendore apo të qarqeve, e jo nga komisionet partiake lokale, gjë që iu jep mundësi më të madhe ndikimi kryesive të partive. Votuesi nuk zgjedh kandidatin përkatës, por duhet t'ia japë votën listës së partive përkatëse, në të cilën kandidatët janë të renditur sipas një radhe të caktuar.

Edhe pse votuesi nuk ka një përfaqësues të një zone të caktuar elektorale, ai u jep mundësinë partive që gjatë përpilimit të listave të kenë në konsideratë të gjitha grupet relevante të partisë dhe shtresat e synuara të votuesve.

Nga ana tjetër, kjo u jep mundësi shoqatave të interesave të premtojnë përkrahje ndaj partisë, nëse ato sjellin anëtarët e këyre të fundit në listën e kandidatëve.

## Sistemi mazhoritar: përparësitë dhe të metat<sup>1</sup>

Në dallim nga sistemi proporcional, në sistemin mazhoritar, zona elektorale ndahet në po aq qendra zgjedhore, sa është edhe numri i ofruar i vendeve në parlament. I zgjedhur konsiderohet ai që në zonat elektorale ka fituar ose shumicën absolute ose shumicën relative të votave. Këtë, në kushte normale, e arrijnë vetëm kandidatët që mbështeten nga partitë e mëdha apo partitë e bashkuara rajonale. Nga ana tjetër, ato duhet të heqin dorë nga përfaqësimi vetëm i interesave të veçanta dhe duhet të bëhen atraktive për shumë grupe të mëdha të popullsisë, me qëllim që të arrijnë shumicën e votave. Sistemi mazhoritar i zgjedhjeve i detyron në këtë mënyrë partitë të modernizohen dhe të heqin dorë në programet dhe veprimet e tyre nga përfaqësimi i grupeve ekstreme.

Në perspektivën historike, zgjedhja e mazhorancës dhe sistemet dypartiake janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Edhe pse sistemi mazhoritar nuk mund t'i prodhojë sistemet dypartiake, ai i ruan dhe i siguron ato. Në kushte të tilla, votuesi në zgjedhje vendos mes dy programeve dhe grupeve të ndryshme qeveritare. Zgjedhja e parlamentit fiton tendencën e shndërrimit në zgjedhje të qeverisë. Grupi fitues qeveritar mund të shpresojë në këtë mënyrë në një shumicë të qëndrueshme parlamentare të partisë së tij. Nga ana tjetër, një gjë e tillë e ndimhon votuesin që në zgjedhjet e ardhshme të kërkojë përgjegjësisë e qeverisë, sepse në rrethana të qarta mazhoritare suksesi apo mospuksesi politik mund të identifikohet qartë. Për mospukseset eventuale nuk mund të fajësohen partnerët e koalicionit. Ndikimi i votuesve në formimin e qeverisë dhe mbi efektin e qeverisë së mbështetur te shumica përbëjnë përparësinë e sistemit dypartiak të stabilizuar nga sistemi mazhoritar i zgjedhjeve. Përveç kësaj, sistemi mazhoritar krijon ingranim relativisht të ngushtë mes parlamentit dhe zonës elektorale, përcakton deri në një farë mase deputetët në zona të caktuara dhe pengon në këtë mënyrë krijimin e distancave të mëdha mes elektoratit dhe të zgjedhurve. Njëkohësisht, organizimi i ulët lokal, gjatë përcaktimit të kandidatëve fiton rëndësi të madhe, gjë që është e dëshirueshme në procesin e demokratizimit të brendshëm të partive.

Megjithatë nuk duhen anashkaluar të metat e sistemit mazhoritar. Përcaktimi i kandidatëve vetëm nga këndvështrimi i interesave lokale bën shpesh që pakicat përkatëse apo grupet e ndryshme të popullsisë të mos

---

1 L.Omari "Sistemi Parlamentar" Tiranë 2000

përfaqësohen. Shembull në këtë aspekt janë ndër të tjera femrat, të cilat, duke pasur parasysh rrethanat ekzistuese, sot e kanë më lehtë të arrijnë në parlament se sa të fitojnë votat e një zone përkatës elektorale.

Përveç kësaj, ngaqë në zonat elektorale merren në konsideratë vetëm votat që i janë dhënë kandidatit të suksesshëm, grupet e tjera të zgjedhësve mbeten të papërfaqësuara në parlament. Sistemi mazhoritar i zgjedhjeve i jep shpesh mundësinë një shumice përkatëse të ngushtë të ketë një përfaqësim tepër të lartë në parlament. Në Angli ka ndodhur që Partia Konservatore të fitojë me 38,2 % të votave mbi 56 % të vendeve në parlament.

Shkaku për këtë qëndron pjesërisht në ndarjen e zonave elektorale, të cilat është e pamundur të mbahen njëlloj të mëdha dhe të strukturohen në atë mënyrë që të mos dëmtohet apo përfitojë asnjë parti. Një „gjeometri“ e tillë e zoanve elektorale zgjedhore hap një mundësi tjetër të manipulimeve. Përveç kësaj, ky sistem zgjedhor pengon realizimin e përfaqësimit parlamentar të pakicave, në rast se ato nuk janë në shumicë të paktën në disa zona elektorale. Lindja e partive të reja është praktikisht e pamundur. Përveç kësaj, edhe stabiliteti i qeverisë me shumicë absolute vihet në pikëpyetje, në rast se beteja e partive përfundon me fitore të ngushtë.

Për këtë arsye, sukcesi i sistemit mazhoritar të zgjedhjeve parashikon që të dy partitë të jenë të hapura nga të gjitha anët dhe të mos qëndrojnë në opozitë parimore ndaj njëra-tjetrës. Në të kundërt, ndryshimet mes partive do të nënkuptonin përmbysjen totale të bashkësisë. Përveç kësaj, sistemi dypartiak i stabilizuar përmes sistemit mazhoritar të zgjedhjeve kërkon një konsensus të fortë në popullsi. Duhet të ekzistojë ndjenja e të qenit në të njëjtën anë, toleranca dhe gatishmëria për të mos e konsideruar përfaqësuesin e palës së kundërt si armik. Në një popull të përçarë në aspektin social dhe në çështjet kryesore të bashkëjetesës politike, sistemi mazhoritar do të kishte jo rrallë efekte negative, sepse ndërrimi i pushtetit nuk do të ishte i mundur për shkak të ngurtësisë së fronteve dhe pakicat e mëdha nuk do të përfaqësoheshin në parlament. Jo matura por radikalizimi dhe polarizimi do të ishte rezultati i kësaj. Në disa raste të tilla do të paraqitet nevoja e modifikimit të sistemit proporcional të zgjedhjeve (...).

Është vështirë të thuhet parimisht se cili sistem zgjedhor është më demokratik. Në varësi të traditës historike, sistemit ekzistues partiak dhe rrethanave sociale në një shoqëri duhet zgjedhur një sistem apo një tjetër. As për këtë element konstruktiv të demokracisë nuk ekziston një recetë e përgjithshme, por forma të ndryshme, në të cilat mund të realizohet demokracia.

Përshtatshmëria varet nga shkalla e realizimit të pjesëmarrjes politike të qytetarëve dhe aftësia e qeverisjes së personave të zgjedhur.

## Demokracia si pushtet i popullit? Doktrina e sovranitetit të popullit

Nëse shtrohet pyetja rreth elementeve të veçanta, nga të cilat përbëhet një bashkësi shoqërore demokratike, arrihet domosdoshmërisht te thënia, sipas së cilësdemokracia është sundim i popullit. Të njëjtën gjë nënkupton edhe përkthimi nga greqishtja i fjalës „demokraci“.

Në çdo kushtetutë demokratike, në këtë apo në një formë tjetër gjendet thënia, sipas së cilës populli është bartësi i fundit i gjithë sovranitetit. Sipas saj, pushteti është i legjitimuar në mënyrë demokratike vetëm në rast se ai ka dalë nga vullneti i lirë dhe me miratimin e popullit. Doktrina e sovranitetit të popullit hodhi poshtë pikëpamjen tradicionale, sipas së cilës, mbretit apo princit i takonte pushteti për shkak të prejardhjes nga dinastia e tij e dhuruar nga Zoti.

Autoriteti shtetëror, në dinastitë e „dhuruara nga Zoti“ nuk vinte pra nga shoqëria, por nga kristalizimi, trashëgimia dhe pikëpamja fetare, të dala nga fuqitë mistike dhe të themeluara sipas parimeve, të cilat përjashtonin ndërhyrjen e qytetarit.

Në këtë ndarje themelore të sunduesve dhe të të sunduarve qëndron thelbi i antagonizmit mes demokracisë dhe monarkisë. Demokracia nuk i njeh shtetit pushtetin e lartë të ndarë nga fuqitë mbinatyrore, por e njeh atë si rezultat të vullnetit të të gjithë individëve pjesëmarrës në angazhimin e tyre për zgjidhjen e detyrave të përbashkëta. Në këtë kontekst, forma dhe përmbajtja e shtetit nuk i janë paracaktuar popullit si të tilla, por ato rrjedhin nga vetë ai. E tërë kompetenca e tyre mbi këto detyra, nga zgjidhja e të cilave janë të prekur të gjithë, quhet me fjalë të tjera sovranitet i popullit.

(...) Thënia se i gjithë pushteti del nga populli nuk nënkupton edhe qeverisjen dhe ushtrimin e ndikimit të tij në të gjitha veçantitë e vendimeve politike, edhe pse kjo do t'i përshtatej konsekuencës formale të mendimit politik. Vetëm në këtë mënyrë do të realizohej ideja, sipas së cilës vetë qytetari duhet t'i respektonte ligjet dheurdhërat e veta, duke qenë në këtë mënyrë vërtetë i lirë. Por ky identitet i qeverisësve dhe i të qeverisurve nuk ka ekzistuar asnjëherë në kuptimin e plotë të fjalës, edhe pse format fillestare të historisë së demokracisë në Greqinë antike bazoheshin në parimet e „demokracisë së drejtpërdrejtë“. Rusoi konsideronte demokraci vetëm këtë formë të ushtrimit të pushtetit.

## **Sovraniteti i popullit përmes zgjedhjeve**

(...) Nëse qeverisja e popullit përmes popullit, në kohën tonë është e pamundur për shkak të arsyeve të brendshme dhe të jashtme, atëherë mbetet si konkretizim i sovranitetit të popullit para së gjithash zgjedhja e përfaqësuesve apo reprezentantëve, të cilët më pas e udhëheqin me përgjegjësi qeverinë sipas vullnetit të popullit dhe me miratimin e tij. Vendimi mbi çështjet detale i lihet përfaqësuesve të zgjedhur; zgjedhësi vetëm duhet të vendosë në mes kandidatëve të prezentuar nga partitë dhe t'i zgjedhë ata, për të cilët në kushte të rëndomta, për shkak të përkatësisë së tyre partiake mendon se do të bëjnë politikë në kuptimin e bindjeve dhe interesave të tij.

## **Kushtet për zgjedhjet demokratike**

Ai që do t'i japë kuptim vullnetit të popullit duke marrë në konsideratë aktin e daljes në zgjedhje duke i bërë ato në këtë mënyrë instrument vendimtar të konkretizimit të sovranitetit të popullit, duhet të parashtrojë fillimisht disa kërkesa. Të zgjedhurit mund të lidhen me vullnetin e zgjedhësve vetëm nëse ata detyrohen të zgjidhen rregullisht në intervale periodike kohore, për të marrë pëlqimin e zgjedhësve për punën e tyre të deritanishme dhe për vazhdimin e saj në të ardhmen. Vetëm në këtë mënyrë, të zgjedhurit detyrohen të respektojnë bindjet dhe interesat e zgjedhësve të tyre. Përveç kësaj, populli zgjedhës duhet të ketë mundësinë e vërtetë të zgjedhjes. Zgjedhjet duhet t'i ofrojnë atij alternativa të ndryshme të pavarura dhe personale. Listat me kufij të përcaktuar janë simptoma të diktaturës.

(...) Një sistem qeveritar, i cili synon t'u japë të gjithë qytetarëve mundësi të barabartë për bashkëvendosje me përgjegjësi gjatë zgjedhjes së detyrave publike, përveç periodicitetit dhe mundësisë së vërtetë për zgjedhje, duhet të sigurojë edhe përgjithësinë e zgjedhjeve. Nga ligji i barazisë, del domosdoshmërisht edhe ligji i ndarjes së të drejtës së votës për të gjithë qytetarët. Askush nuk duhet p.sh. të përjashtohet nga e drejta e votës për shkak të racës, fesë, nivelit të tij arsimor apo pronës dhe rrethanave të tij ekonomike. Të pranueshme janë ndërkaq vetëm disa kushte formale, si p.sh. arritja e moshës së caktuar për të gjithë dhe pa diskriminime individëve apo grupeve të caktuara, kusht ky i cili mund të arrihet dhe të pranohet pa i shkelur parimet demokratike.

I lidhur ngushtë me parimin e përgjithësisë është parimi i barazisë së zgjedhjeve.

(...) Në një shoqëri të hapur dhe pluraliste, përveç parimit të ekzistencës së grupeve në parim të barabarta, ndarja e të drejtës së barabartë është procedura e vetme e mundshme për ngarkimin e përfaqësuesve dhe për plotësimin e pozitive të larta shtetërore në një mënyrë të tillë të pranueshme nga të gjitha grupet. E drejta e përgjithshme dhe e barabartë e votës është realizuar jo ngaqë me ndihmën e saj mundësohet zgjedhja e qeverisë „më të mirë“, por sepse ajo është provuar si metoda më e mirë dhe praktike për sigurimin e paqes sociale. Ajo i jep mundësinë çdo çdonjërit të marrë pjesë në themelimin e qeverisë dhe, në parim, u jep pakicave të mundura mundësinë e shndërrimit të mëvonshëm në shumicë qeveritare. Në një shoqëri të ndarë në grupe të shumëfishta interesash dhe botëkuptimesh, kjo mënyrë zgjedhjeje arriti të bëjë të mundur zgjidhjen e konflikteve në rrugë paqësore dhe të mundësojë, me gjithë presionet e brendshme, formimin e qeverisë së aftë për marrjen e vendimeve, kryesia e së cilës mund të pranohet nga të gjithë. E drejta e përgjithshme dhe e barabartë e votës është një ndër procedurat më të suksesshme për bashkimin e brendshëm të një bashkësie politike dhe për aftësimin e saj për veprim.

Me qëllim përmbushjen e kërkesave demokratike, kjo e drejtë e përgjithshme dhe e barabartë e votës kërkon edhe garanci plotësuese. Duhet të bëhet i pamundur çdo presion mbi votuesin, i cili ka për qëllim ndikimin e votës së tij në një drejtim të caktuar. Kjo nuk nënkupton ndalimin e propagandës dhe të ndikimit politik. Në këtë mënyrë synohet vetëm siguri i vërtetë i lirisë së vendosjes së votuesit. Ky është njëherazi edhe qëllimi i votimit të fshehtë. Derisa kjo të jetë garantuar, derisa të mbetet e panjohur vota e individit, deri atëherë është e mundur edhe shmangia e pasojave negative për shkak të mënyrës së tij të zgjedhjes.

Vetëm pas plotësimit të të gjitha këtyre kushteve, të cilat vlejné edhe për të drejtën për t'u zgjedhur - edhe e drejta dhe mundësia e marrjes së detyrave politike duhet të jetë e hapur për këdo - mund të flitet për zgjedhje demokratike. Vetëm ajo mund ta bëjë të aftë parlamentin për të vepruar në emër të popullit. Vetëm njëqeveri e tillë, e cila mund të ndërrohet përmes zgjedhjeve të lira të këtij lloji ushtron pushtet të legjitimuar në mënyrë demokratike.

(...) Në politikën moderne flitet shpesh për vullnetin e popullit, pa qenë e qartë se ç' nënkuptohet saktësisht me këtë nocion. Rusoi besonte se kishte arritur të ndërtonte vullnetin e përbashkët të popullit; sipas tij, ai duhet të jetë identik me të mirën e përgjithshme. Megjithatë, edhe ai ishte i detyruar ta paraqiste në teorinë politike vullnetin e shumicës si të barabartë me vullnetin e përbashkët dhe të shtypte pakicën devijuese, sepse, sipas tij, ajo ka vullnet të gabuar.

Pas rrahjes së mendimit tonë të peshuar mbi karakterin e shoqërisë pluraliste bëhet e qartë se një vullnet i përbashkët është po aq joekzistues në realitet sa edhe njëpikëpamje e përbashkët botërore. Ajo që kuptohet si vullnet i popullit, tështë gjithnjë vullneti i forcave më të fuqishme brenda tij. Ne nuk jemi më aq optimistë si Rusoi kur bëhet fjalë për identifikimin e vullnetit të shumicës me të mirën e përbashkët. Përvoja ka treguar se edhe shumicat gabojnë. Për këtë arsye është i nevojshëm një sistem i tillë qeveritar, i cili nuk i shtyp, por i respekton pakicat dhe përfill njëkohësisht vullnetin e shumicës, sepse ai i afrohet më tepër idesë të së drejtës për vetëvendosje, duke respektuar domosdoshmërinë e bashkëjetesës.

Meqë veprimi politik ndodh gjithnjë duke planifikuar një të ardhme të hapur, ai mbetet gjithnjë i ngarkuar me pasiguri, një ndërmarrje, e cila asnjëherë nuk mund të parashikohet në mënyrë ekzakte në të gjitha konsekuencat. Kush mund të thotë me siguri absolute se ky apo ai veprim i sjell më shumë dobi të mirës së përgjithshme se sa një veprim tjetër? Kush mund ta përkufizojë përfundimisht të mirën e përgjithshme, nëse nuk dihet si do të rrjedhë historia? Në çështjet themelore politike duhen pyetur të gjithë, pasi ne nuk e njohim të ardhmen. Për këtë arsye, në një shoqëri demokratike mbetet vetëm orientim në shumicën, duke respektuar pakicën e mundur, mundësia për t'u bërë shumicë që duhet të mbetet e e hapur.

## **Parimi i shumicës**

Ashtu si kërkesa për të drejtën e përgjithshme të votës, edhe parimi i shumicës është rrjedhoja e vetme e mundshme nga pikëpamja demokratike mbi njeriun, e cila nisët nga njeriu i pjekur në një botë të lirë dhe merr parasysh konfliktet e mendimeve dhe të interesave në mes njerëzve. Pranimi i parimit të shumicës nuk do të thotë që politikani përgjegjës duhet të bazohet vetëm në mendimin e masës. Megjithatë, parimisht parimi i sovranitetit të popullit mund të konkretizohet vetëm nëpërmjet parimit të shumicës, si bazë e veprimit politik.

Për këtë arsye, demokracia moderne nuk është vetëqeverisje e popullit. Ajo sot mund të realizohet si qeveri e përfaqësuesve të popullit, të dalë nga zgjedhjet e përgjithshme, të lira, të barabarta dhe të fshehta, të cilët mund të detyrohen prej tij, të marrin detyrat qeveritare dhe ta udhëheqin vendin sipas vullnetit të shumicës përkatëse të forcave politiko-shoqërore të një kombi.

# Ndarja e pushtetit: Ruajtja e lirisë dhe kontrolli I pushtetit

## *Kufizimet e pushtetit*

Të gjitha demokracitë kushtetuese kanë një cilësi të përbashkët e të rëndësishme: kompetencat e qeveritarëve janë të kufizuara, ndërsa njerëzit kanë të drejta, të cilat janë të numëruara në Kushtetutë, sikundër ato të drejta, të cilat qeveria nuk mund të ua marr. Per shembull, në Shtetet e Bashkuara, Kushtetuta numëron të drejtat, të cilat qeveria nuk mund te ua privojë qytetarëve, sikundër janë: liria fetare, liria e mbledhjeve dhe e ligjit deri te liria e gjyqit të ndershëm Kushtetuta ndalon, që organi me i lartë legjislativ - Kongresi i Shteteve të Bashkuara - të vendos çfarëdo ligji, i cili merr apo shkel liritë themelore të qytetarëve.

Këto të drejta themelore, njerëzit nuk i kanë marr përmes pushtetit; këto të drejta u përkasin njerëzve dhe, janë të garantuara përmes Kushtetutës. Në demokracite kushtetuese sistemet qeveritare jane ashtu te ndertuara, qe asnje individ apo institucion te mos fitojnë pushtetin jashtë mase.

Për shembull është me shumë rëndësi, që të ekzistojnë gjykatat e pavarura, kështu që gjyqtarët të jenë kompetent, të ua bëjnë të pamundur pushtetit ekzekutiv apo legjislativ shkeljen e të drejtave të qytetarëve. Një prej parimeve themelore të sistemit demokratik amerikan është dyshimi i thellë ndaj koncentrimit jashtë mase të pushtetit politik; krijuesit e këtij sistemi politik ishin të bindur se, secili kush ka dhe merr më shumë pushtet, bëhet tiran. Krijuan qeverinë, e cila ka mjaft pushtet, që të qeveris , por jo aq , që të ia uzurpojë te drejtat qytetarëve. Themeluesit dëshiruan, që organet e veçanta të pushtetit, në mënyrë reciproke “të kontrollohën dhe të barazohen”, kështu që asnjëri të mos mund të grumbullojë pushtet tepër të madh. Demokracitë mund të pësojnë humbje, në qoftë se qeveria ka tepër pushtet; mirëpo demokracitë po ashtu mund të pësojnë humbje, në qoftë se qeveria nuk ka mjaft pushtet, qe të qeveris. Sistemi demokratik përbën formulën e pushtetit të mirë e të shëndoshë , e jo të anarkisë apo të plogështisë. Si zotërimi i udhëheqësve ashtu edhe marrja e vendimeve që janë të domosdoshme, që qeveritë demokratike të korrin sukses.

Të gjitha parlamentet demokratike respektojnë rregullat themelore, në mënyrë që të mundësojnë një diskutim solid të çështjeve, mbylljen e debatëve dhe, më në fund - votimi.



## *Ndarja e pushtetit në shtetin demokratik*

Liria e themelimit të partive, e parasëgjithash veprimi i lirë i opozitës dhe mendimi i lirë publik i dalur nga burimet e ndryshme informative kanë për detyrë kontrollimin e pushtetit dhe mundësimin e pjesëmarrjes në jetën shoqërore. Kontrolli dhe impulset shoqërore nuk do të ishin të mundura në rast se pushteti do të ishte ikoncentruar në një me ndihmën e shtetit.

Për këtë arsye, bashkësitë e lira shoqërore kërkojnë ndarjen e pushtetit në organe të ndryshme të pavarura, me qëllim që ato ta kontrollojnë njëri-tjetrin në mënyrë të ndërsjellë dhe të pengojnë koncentrimin e pushtetit dhe monopolizimit e tij. Në shtetin e lirë demokratik, pluralizmit në fushën e partive politike dhe mendimit të lirë publik i bashkohet një numër i madh i organeve shtetërore. Mirëpo, derisa tek partitë dhe mendimi publik, procesi i pluralizimit i lihet lojës së lirë të forcave shoqërore, ndarja e pushtetit në instanca të ndryshme, të pavarura njëra prej tjetrës, është e përcaktuar në kushtetutën e shkruar. Në të janë të fiksuara kompetencat e organeve të shtetit veç e veç. Një ndarje e tillë kushtetuese e kompetencave të shtetit nuk synon vetëm kontrollin e ndërsjellë të organeve, por edhe qartësimin e veprimtarisë së aparatit shtetëror. Klasifikimi i pushtetit e mbronë qytetarin nga arbitrarizmi shtetëror dhe i lehtëson atij njëkohësisht të kuptuarit e procesit të qeverisë.

Fakti se shoqëria dhe liria e saj mund të sigurohet vetëm përmes ndarjes së pushtetit në organe të ndryshme të pavarura përbën thelbin e bindjes kushtetutaro-politike të kohës sonë. Në këtë ndarje qëndron edhe dallimi kryesor në mes demokracisë liridashëse dhe diktaturës. Në këtë të fundit, i gjithë pushteti i vendosjes është i koncentruar në duart e një individi apo një partie. Për këtë shkak këtu edhe nuk ka kontroll të pushtetit, gjë që i lëshon individin arbitraritetit të pushtetarit. Montesquieu, themeluesi i mësimin mbi ndarjen e pushtetit shkruan në këtë kontekst: "Çdo gjë do të ishte e humbur në rast se personi i njejtë apo bashkimi i njejtë i të mëdhenjëve, aristokratëve apo edhe i popullit do t'i ushtronte të trija këto pushtete: pushtetin e lëshimit të ligjeve, zbatimin e vendimeve publike dhe gjykimin e krimeve apo të konflikteve."

Një vlerësim i drejtë i këtij epshi për pushtet dhe i gatishmërisë së natyrës njerëzore për keqpërdorimin e tij mjafton për ta dëshmuar saktësinë e kësaj të vërtete. Domosdoshmëria e kontrollit të ndërsjellë gjatë ushtrimit të pushtetit politik në formën e ndarjes së tij në degë të ndryshme qeveritare, secila prej së cilës synon mbrojtjen e të mirës së përbashkët nga ndërhyrjet e të tjerëve, është dëshmuar nga përvoja e kohërave vjetra dhe të reja."

Kjo ndarje niset nga përvoja, sipas së cilës, secili posedues i pushtetit politik mund të joshet për keqpërdorimin e tij dhe se për këtë arsye, pushteti duhet kufizuar dhe ndarë. Ai njihet tri funksione themelore të shtetit sovran: ligjvënien, zbatimin e ligjit dhe zbatimin juridik. Këto tri funksione, sipas Monteskiës, nëse dëshirohet sigurimi i lirisë së qytetarëve, duhet ndarë në tri organe. Pasardhësit e Montesquieu-t e kanë dogmatizuar mësimin e tij duke ndarë në mënyrë strikte ekzekutiven, në të cilën fusin qeverinë dhe administratën, nga legjislativja dhe juridiksioni. Kjo ndarje mbretëron edhe sot e kësaj dite mendimin politik të demokracive perëndimore (...).

## **Ndarja e pushtetit përmes zgjedhjes**

Në konceptin e ndarjes së pushtetit bën pjesë edhe rizgjedhja periodike e bartësve të funksioneve politike. Thënë ndryshe, atje bëhet ndarja e pushtetit në mënyrë të përkohshme. Fakti që presidenti amerikan është i detyruar t'i nënshtrohet rizgjedhjes para konkurrentëve të tij dhe mund të rizgjedhet vetëm njëherë, e kufizon pushtetin e tij në një masë të dukshme. E njëja gjë vlenë edhe për periudhat zgjedhore të parlamenteve. Sa më të shkurtëra që të jenë ato, aq më i fortë është ndikimi i mendimit publik dhe e elektoratit. Edhe këta të fundit janë pjesëmarrës në sistemin e tërësishëm të ndarjes së pushtetit dhe të kontrollimit të tij. Me rëndësi vendimtare në këtë kontekst mund të jenë edhe urdhëresat mbi afatet e tjera (...). Ndikimi i një komisioni politik vendoset jo rrallë nga fakti, se sa shpesh duhet apoguxon të mbledhet ai. Një komision i cili mbledhet për çdo muaj është shumë më i fortë se sa një tjetër, i cili mbledhet vetëm një herë në vit. Në anën tjetër, pavarësia e gjyqeve psh. sigurohet së këndejmi përmes emëtimit të gjykatësve për një kohë të përjetshme.

## **Format e reja të ndarjes së pushtetit në shek. XX**

Realizimi i plotë i mendimit demokratik në shek. XX ka përfunduar dalimin rigoroz në mes pushtetit ekzekutiv dhe atij legjislativ. Sidoqoftë, kjo nuk ka ndryshuar asgjë në rëndësinë e parimit të ndarjes së pushtetit, si parim organizativ për një bashkësi paqedashëse shoqërore. Janë ndryshuar vetëm format e theksimit të ndarjes së pushtetit. Ky zhvillim është karakterizuar posaçërisht përmes zgjerimit në fushën e juridiksionit.

Në trajtën e gjyqësisë kushtetuese, ajo e kontrollon instancën ligjvënëse dhe qeverinë. Montesquieu akoma nuk e kishte paramenduar një kontroll të tillë. Si degë veçanërisht e rëndësishme është zhvilluar një gjyqësi tjetër, e cila prej dekade në dekadë fitoi rëndësi gjithnjë e më të madhe. Mbikqyrja e vënies së ligjeve, mbikqyrje kjo e cila sipas Montesquieu-t është detyre e instancës legjislativë, sot zbatohet nga ana e gjyqeve. Për shkak të gërshetimit të tij politik me qeverinë, kontrollin mbi instancën ekzekutive, veçanërisht në çështjet administrative, parlamenti e zbaton vetëm në një masë tejet të vogël.

Format e tjera të ndarjes së pushtetit janë zhvilluar edhe në fusha të tjera. Shumë shoqëri demokratike të kohës së sotme janë organizuar në mënyrë federale. Pavarësia relative e disa shteteve të themeluara në mënyrë artificiale, përlligjen e tyre të mbrenshme në pikëpamjen e ndarjes së pushtetit e fitojnë parasëgjithash vetëm atëherë kur mungon argumentimi i shtetëformimit përmes traditës historike. Edhe zgjerimi i të drejtës për vetëqeverisje i komunave dhe i korporatave territoriale shërben për shpërndarjen e ndikimit të ngjeshur të ekzekutives moderne shtetërore dhe për pjesëmarrjen e qytetarëve në disa nivele të angazhimit shtetëror.

Kjo në anën tjetër paraqet një element të kontrollit dhe të mbikqyrjes së ndërsjellë të byrokracisë shtetërore në federatë, në rrethe dhe në komuna. Përveç kësaj, ajo bën të qartë se si i shërbejnë demokratizimit aspektet e caktuara të ndarjes së pushtetit dhe si janë të motivuara nga ai. Përmes ndarjeve të tilla të pushtetit krijohen mundësitë e bashkëvendimit dhe participimit të qytetarëve (...).

## **Checks and Balances**

Nëse parlamenti dhe qeveria janë të angazhuara në të njëjtin funksion, atëherë ata edhe kontrollohen nga njëri-tjetri. Ndarje e përgjegjësisë do të thotë ndarje e pushtetit. Aktorët, përmes sistemit të „checks and balances“, paraqesin një sistem të kundërpeshave dhe të balancës, të lidhura njëra-me tjetrën. Qeveria dhe parlamenti janë të varur nga njëri-tjetri dhe u duhet një konsensus për formulimin e vendimeve bazë politike.

Një procedurë e tillë qëndron në konsekuencën e mendimit të Montesquieu-t, i cili në kategoritë e kohës së tij, ligjvënien, në mënyrë primare e radhit në fushën e vendimeve bazë politike dhe e konsideron pjesëmarrëse në të dy

dhoma - në dhomën e aristokratëve dhe në atë të qytetarëve -, duke bërë edhe këtu ndarjen e pushtetit. Në këtë mënyrë, dy organet shtetërore dhe grupet shoqërore që qëndrojnë prapa tyre janë të detyruara të ndikojnë bashkarisht gjatë akteve të caktuara të shtetit. Detyrimi për bashkëpunim mbanë në vete elementin e kontrollit.<sup>1</sup>

Në anën tjetër, në parlament ekziston në formë të partisë opozitare edhe një element tjetër i kontrollit autonom të pushtetit, kontroll ky i cili ushtrohet në mënyrë të pavarur. Në gjendjen e pavarur dhe në lirinë e të vepruarit të opozitës akoma gjenden elementet e raportit të parlamentit dhe qeverisë të kohës së monarkisëkonstitucionale. Edhe shema klasike e ndarjes së pushtetit paraqet vetëm fiksimin e një situatë të caktuar historike, në të cilën, mbreti përbënte ekzekutiven, e cila si forcë politike me të drejta dhe legjitimitet të veçantë qëndronte përballë parlamentit.

Me qëllim të kufizimit të pretendimit të mëparshëm absolut të pushtetit të mbretit, Montesquieu e morri në mësimin e tij mbi ndarjen e pushtetit ligjvënien dhe ia ndau parlamentit të zgjedhur, në të cilin ishte e përfaqësuar borgjezia. Mbreti dhe parlamenti, së bashku reprezentonin shtetin; Dallueshmëria e legjitimeve të tyre mundësonte një ndarje më të qartë të këtyre dy pushteteve.

Ideja e sovranitetit të popullit u realizua në një masë të madhe, ndërsa pushtetit ekzekutiv mbretëror iu dha legjitimiteti. Mbreti gjithnjë e më tepër humbi rëndësinë në të mirë të parlamentit. Në këtë mënyrë, dallimi në mes pushtetit ekzekutiv dhe atij legjislativ u bë gjithnjë e më i vështirë, dhe atë deri në atë masë, sa që parlamenti pushtoi pushtetin ekzekutiv, duke e bërë atë të varur nga ai. Në këtë mënyrë, praktikisht u bë ndarja e vjetër. Ajo ia arriti të ruhet vetëm në shtetet me sisteme kushtetuese presidenciale si SHBA-të.

Në vend të monarkut, atje u paraqit presidenti, gjithashtu i zgjedhur nga populli dhe i pavarur nga kongresi. Ai fiton përmes zgjedhjeve të njejtën bazë legjitimuese sikurse edhe parlamenti. Në këtë mënyrë bëhet e mundur së paku njëndarje personale. Pjesëtarët e qeverisë amerikane nuk janë delegatë të kongresit, por persona të zgjedhur në pozitë të tyre nga votbesimi i presidentit. Sidoqoftë, në qështjet e rëndësishme, presidenti mbetet i varur nga bashkëpunimi dhe pajtimi me kongresin, kështu që as SHBA-të nuk paraqesin përjashtim gjatë angazhimit me vendime bazë politike.

---

1 *Fletore e Akademisë për Udhëheqës dhe Reformë Politike*

## Votimi elektronik, kaq larg dhe njëkohësisht kaq afër?

Zakonisht kur flitet për votimin elektronik, tendenca apo reagimi i parë janë: një buzëqeshje mirëdashëse ose një ngritje supesh dhe menjëherë të thuhet po, është një gjë e mirë, por akoma shumë moderne për kushtet tona.<sup>1</sup>

Në të vërtetë termi modern në këtë rast mbulon një sere argumentesh, që në fakt po të shihej më në thellësi, do të shfaqeshin me tërë thjeshtësinë e tyre. Për ta kuptuar më mirë konceptin le të bëjmë një hyrje të vogël. Kohët e fundit me shumë ngulm po flitet dhe madje ka filluar edhe të praktikohet parimi “Një Anëtar Një Votë”.

Nga të gjitha anët ky parim po shihet si një ide novatore që shërben për të modernizuar jetën politike, apo më saktë vendimmarrjen brenda partisë apo forcës politike.

Por në fakt ky sistem në vetvete nuk është as i ri dhe aq më pak modern (në kuptimin jo e modës, por si një zbulim i kohëve moderne). Ideja “Një Anëtar Një Votë”, në fakt është ideja më

vjetër për sa i përket formës së votimit, e cila që në antikitetin e hershëm përbënte një nga bazat e demokracisë; por me kalimin e kohës, ndërlikimin e konceptit politik, rritjen e popullsisë (dhe si

rrjedhje edhe të votuesve), u zëvendësua me forma ose në disa raste sisteme të mirëfillta votimi shumë më të reja nga ana ideore dhe ana grafike, por jo detyrimisht më të mira.

Rikthimi në *modë* i këtij modeli kohët e fundit më të drejtë i është bashkangjitur votimit brenda përbrenda forcës politike, duke e afruar kështu me idenë origjinale të antikitetit ku votohej brenda *polisit* për njerëz të cilët të përbashkët kishin qytetarinë dhe civilizimin; kurse në ditët e sotme idealin politik dhe afinitetin e ideve.

Kështu duke pasur parasysh këto fakte mund të kuptojmë fare mirë se ideali politik i ditëve tona si dhe deklamimet mbi mbrojtjen dhe shenjtërinë e votës nuk ndryshojnë shumë nga idetë dhe problemet e antikitetit. Ashtu sikurse edhe modelet “e reja” politike ose manaxheriale me emra të kumbueshëm anglo-saksonë, p.sh. *multilevel system*, në vetvete s’janë veçse rimodelime apo përkthime të sistemeve të lashta ushtarako-civile të ROMËS antike.

---

1 Elton Beqiraj Fletore e Akademisë për Udhëheqës dhe Reformë Politike

Sigurisht të fl asësh për antikitetin në një shkrim mbi votimin elektronik mund të lerë të çuditur shumë njerez (dhe madje të duket edhe si pa lidhje), por shpresoj se me këtë hyrje kam bërë të

qartë që ndryshimi midis ideve të reja dhe atyre të vjetra qëndron sidomos në formën dhe teknikën e aplikimit, sesa tek vetë ato.

Dhe pikërisht për këtë arsye për ne të “të mbeturit kaq prapa”, votimi elektronik ndoshta nuk është edhe aq alien sa duket, por përkundrazi mund të jetë, në disa aspekte më i afërt dhe më realist, sesa imagjinohet. Për ta shqyrtuar më mirë problemin duhet të kemi parasysh pikat nga të cilat do të bazojmë këndvështrimin tonë; dhe këto janë: ana ideore, aspekti ligjor, nevojat praktike të aplikimit, si dhe kushtet teknike të çështjes (teknologjia).

## Ana ideore

Nga ana ideore apo morale deri më sot, jo vetëm në Shqipëri, por në asnjë vend tjetër të botës nuk ka pasur asnjë kundërshtim mbi vlefshmërinë e votimit elektronik. Ky fakt tregon më së miri se këtu nuk kemi të bëjmë aspak me ndonjë problem social apo që mund të shndërrohet në një të tillë. Madje edhe përsa i përket sigurisë, janë përdorur dhe vazhdojnë të përdoren sisteme votimi

që lejojnë një *hapësirë* manipulimi shumë më të madhe (zgjedhësit e dytë), apo një vonesë procedurale (votimi me postë), të cilat vazhdojnë të tolerohen për vetë specifi kat e disa vendeve.

## Dobitë praktike

Në dallim nga pika e mëparshme dobitë praktike apo më saktë detyrimet për aplikimin e këtij sistemi për ne shqiptarët janë më të prekshme. Specifi ka jonë, si një vend me një emigracion të zhvilluar dhe të vazhdueshëm është decisive për gjykimin e problemit. Kësaj i shtohet edhe fakti që tek ne nuk ekziston asnjë barrierë ligjore e modelit perëndimor, përkundrazi ata fatlumë që marrin viza mund të thonë shumë mirë se sa shkelje të *privacies* janë të detyruar të pësojnë përfshirë këtu edhe skedimin e detyrueshëm (shenjat e gishtave). Nga ana tjetër vetë shteti shqiptar kohët e fundit ka publicizuar modelin e ri të patentës e cila do të përmbajë edhe shenjat e gishtërinjve si

dhe elemente të tjerë identifi kimi. Pra si përfundim justifi kimi ligjor dhe moral përsa i përket realitetit shqiptar nuk qëndron. Por në të kundërt qëndron sa një mal detyrimi moral i këtij vendi ndaj emigrantëve dhe diasporës. Dhe pikërisht këtu votimi elektronik merr një rol shumë të rëndësishëm.

Është fakt që gjithnjë e më shumë politika apo më saktë pjesa më e ndërgjegjshme e saj, po kupton rëndësinë e elementit votues që ndodhet jashtë vendit. Rëndësi kjo që shihet qartë po të marrim parasysh se numri i votuesve që ndodhen jashtë vendit sipas të dhënave zyrtare, është më shumë se gjysma e votuesve që morën pjesë në zgjedhjet e fundit (për pushtetin lokal). Dhe këtu bëhet fjalë për pjesën më me vizion (për arsye të kuptueshme) të elektoratit, dhe njëkohësisht për pjesën më pak të manipulueshme, zgjedhjet e së cilës nuk mund të ndikohen nga interesat e momentit apo “çuditë” e fushatave elektorale shqiptare. Përsa i përket të drejtës së votës së këtyre njerëzve që me kursimet e tyre garantojnë një pjesë të mirë të të ardhurave të këtij vendi, askush nuk ka kundërshtuar të drejtën ose më saktë shenjtërinë e saj, por gjithmonë kundërshtitë janë ndeshur për të përcaktuar mënyrën sesi kjo mund të realizohet.

Dhe këtu paradokset s’kanë të sosur. Janë shpikur receta nga më të pamunduraturat: që nga transportimi i detyrueshëm prej shtetit I emigrantëve nëpër qendrat e votimit (gjë që për të qenë të qartë është qesharake edhe për sa i përket votuesve brenda vendit), gjer tek votimi me postë; kur tek ne është e pamundur të sigurosh transportin me skortë të një kutie votimi, mendo sigurinë që i duhet fl uksit prej qindra mijë letrash-vote?

Pra siç duket ajo formë votimi që dukej e largët, moderne dhe për këtë e papranueshme në fund mbetet si shpresa e fundit, për të mbrojtur një të drejtë themelore si ajo e votës.

Siç e shpjeguam më lart midis votimit elektronik dhe atij të çfarëdoshëm (si koncept) i vetmi ndryshim është termi elektronik, i cili na bën t’i imagjinojmë saktë mundësitë që ofron. Në fakt opsioni më i rëndësishëm që teknologjia ofron në këtë rast (njëkohësisht edhe ai që ne na intereson më tepër), është shpejtësia e identifi kimit dhe monitorimit të listave të zgjedhësve.

Kushdo që është përballur me rinovimin e lejeve të qëndrimit në Europë kohët e fundit mund të thotë se përveç dokumentacionit normal tashmë kërkojnë edhe shenjat e gishtërinjve, gjë që bën të mundur identifi kimin e sigurt të personave të cilët për arsyet dhe hallet e emigracionit që aq mirë i njohim ne shqiptarët, kanë qenë të detyruar edhe të ndryshojnë identitetin.

Këto elemente, identifi kimit të të cilave u shtohen edhe të dhëna të tjera të vjelura nga dokumentacioni që zakonisht kërkohet, formojnë një *bazë të dhënash*, e cila në çdo moment është në dispozicion të organeve kompetente dhe që në teori shërben për kontrollimin e krimit dhe të emigracionit ilegal në BE. Ideja është që i gjithë ky sistem I menduar për arsyet e mësipërme, të përdoret për një qëllim shumë më human dhe shumë më të nevojshëm për vendin tonë:

## **Krijimin e një liste të përpiktë votuesish në secilin nga vendet e emigrimit.**

Në këtë mënyrë në bazë të një kërkesë precize nga ana e shtetit shqiptar këto lista mund të vihen shumë lehtë në dispozicionin tonë, aq më tepër që nuk ekziston asnjë bazë ligjore që të përbënte pengesë. Problemi i vetëm në këtë pikë është përdorimi praktik i këtyre listave.

Ideja më e parë do të ishte përdorimi i kësaj vote në listen proporcionale (duke parë problemet e ndarjeve gjeografi ke të zonave zgjedhore), por me një refl ektim më të kujdesshëm mund të mendohet edhe një aplikim më i gjerë.

Prej kohësh qeveria shqiptare deklaroi se ka nëpër gjendjet civile lista të sakta të popullsisë, përfshi këtu edhe të emigruarit, të cilët në bazë të ligjit thirren rregullisht për të votuar edhe për kandidatët e listës mazhoritare. Do të mjaftonte një verifi kim i këtyre listave në bashkëpunim me organizmat europianë për t'i dhënë të drejtën e njohjes, votës së një emigranti në kolegjin elektoral përkatës. Jemi të sigurt se edhe për vetë organizmat europianë një projekt i tillë do të rezultonte më interesant sesa pjesa më e madhe e projekteve (shpesh të pakuptimta), që aktualisht zbatohen.

## **Kushtet teknike**

Pa diskutim ekziston teknologjia e nevojshme për të realizuar një projekt të tillë! Madje kostoja e kësaj teknologjie mund të rezultojë më e vogël sesa ajo trainimeve të shumta që u bëhen komisionerëve nëpër qendra votimi, dhe do të prodhonte një rezultat shumë më domethënës, përse i përket sigurisë së votes si dhe vetë rezultatit të votimit. Pika më e rëndësishme këtu mund të bëhej garantimi i qendrave të votimit në një vend të huaj, si dhe komisioni i votimit.

Në këtë rast ambasadat dhe konsullatat (atje ku ekzistojnë) e shtetit tonë do të përbënin terrenin ideal për zhvillimin e votimeve, duke u dhënë kështu



edhe atë plusin e krenarisë kombëtare aq të nevojshme në vend të huaj.

Përsa i përket komisionit të votimit ky fare mirë mund të përbëhet nga vetë ekspertët elektronikë (sigurisht të huaj), që do të monitorojnë edhe anën teknike, ashtu sikurse edhe nga ndonjë komision dy-palësh i krijuar *ad hoc*.

Por garancinë e vërtetë e përbën vetë sistemi i votimit ku votuesi do të identifi kohej automatikisht thjesht nga vendosja e gishtit mbi aparaturë (siç ndodh tashmë pothuajse në të gjitha pikat e kontrollit të aeroporteve perëndimore, për ne shqiptaret), dhe njëkohësisht duke qenë se fl eta e votimit në këtë rast, do të ishte në formën e një ikone kompjuteri edhe përpunimi i të dhënave do të bëhej në kohë reale.

Rezultati i votimit në këtë mënyrë s'do të linte vend për kontestime pasi prej kohësh jemi mësuar të mendojmë se për ne shqiptarët, të vetmit “gjykatës” në rast zgjedhjesh janë faktorët ndërkombëtarë. Ajo që mungon me të vërtetë s'është modernia, apo ultra teknologjia; përkundrazi është ajo më antikja dhe më primitivia:

## **Idetë dhe vullneti i mirë!**

### ***REKOMANDIME***

I. Sistemi zgjedhor mund të mos jetë pjesë e Kushtetutës, por Kushtetuta mund të përcaktojë rregullat mbi të cilat duhet të përzgjidhet një sistem zgjedhor. Për të garantuar që përzgjedhja e sistemit zgjedhor të mos jetë “në dorë” vetëm të një mazhorance të caktuar,

Kushtetuta mund të përcaktojë që “ligji për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë dhe organet e qeverisjes vendore të miratohet me jo më pak se 3/5 e votave të të gjithë deputetëve”.

Kjo zgjidhje do të mundësonte ndryshimin e sistemit, në se çmohet, më shpesh, pa qenë nevoja për ti hyrë procedurave “të komplikuar” të ndryshimit të Kushtetutës.

II. Kushtetuta në rastin e pikës 1 të japë përkufizimin dhe të tregojë se çfarë duhet të përmbajë ligji në fjalë, si p.sh. si dhe kur shpallet data e zgjedhjeve, kush janë organet që i administrojnë, i mbikëqyrin, kontrollojnë, shpallin rezultatin e zgjedhjeve, etj.

Në këtë mënyrë përcaktimi në Kushtetutë i asaj që çfarë duhet të përmbajë “ligji për zgjedhjet” i heq mundësinë ndonjë mazhorance të caktuar për të abuzuar me përcaktimin e numrit dhe llojit të rregullimeve që duhet të përmbajë “ligji për zgjedhjet” – (një rast abuzimi mundet të ishte: një mazhorancë në “ligjin për zgjedhjet” përcakton disa rregulla për zgjedhjet, p.sh si përgatitet lista e votuesve, si bëhen ankimet dhe apelimet, etj, por nuk përfshin rregulla mbi përbërjen e komisioneve apo ndonjë rregull tjetër. Këto rregulla të fundit ajo (mazhoranca) mundet të bëjë pjesë të një ligji tjetër, për të cilin mundet të konsiderojë se nuk është nevoja për shumicë të cilësuar);

III. Sistemi zgjedhor duhet të jetë i thjeshtëzuar dhe të garantojë një zhvillim, administrim të procesit të votimit, si dhe shpallje të rezultatit mundësisht në një ditë të vetme – në këtë kontekst votimet mundet të zhvillohen me një raund dhe formula e nxjerrjes së rezultatit përfundimtar të mos lidhet me zhvillimin e zgjedhjeve dhe/ose shpalljen e rezultatit në një njësi zgjedhore të veçantë;

IV. Në kushtet aktuale të zhvillimit ekonomik dhe politik të Shqipërisë, sistemi zgjedhor duhet të jetë i tillë që të sigurojë me një mundësi të madhe një mazhorancë qeverisëse të qëndrueshme, në gjendje që të zhvillojë reformat e momentit por njëkohësisht duhet ti japë mundësi pakicës që të ketë rrol të fort në shprehjen e pikëpamjeve dhe qëndrimeve të saj ndaj programit të qeverisë dhe ecurisë së saj – kështu, një sistem zgjedhor ku ai që merr rezultatin më të mirë në zgjedhje fiton edhe të drejtën për të qeverisur me shumicë absolute mundet të kënaqte këtë nevojë, ose ndoshta edhe një sistem i pastër mazhoritar në kushtet e një administrimi teknik të zgjedhjeve të besueshëm;

V. Megjithëse konfigurimi partiak në Shqipëri është mjaft i gjerë, është e qartë se individualitetet e spikatura elektorale dhe politike gjenden vetëm në një numër të kufizuar partish politike. Por jo pak prej partive të tjera gjenden të përfaqësuara në organin legjislativ, në Kuvend, vetëm për shkak të “sponsorizimit” politik “të aleatëve” të tjerë me peshë elektorale me të madhe.

Prandaj, panevojshmëria për të pasur një numër kaq të madh partish të përfaqësuara në Kuvend mund të justifikojë zgjedhjen e një sistemi i cili lejon përfaqësimin në Kuvend vetëm të atyre partive apo grupeve politike të cilat kanë një përqindje votash domethënëse në elektorat – kështu, rritja e pragut elektoral do të shërbente gradualisht si filtër për realizimin e këtij qëllimi, por ndërkohë do tu jepte mundësi atyre partive të cilat edhe pse “të vogla” janë afër asaj që mundet të përkufizohet si “peshë reale në elektorat”;

VI. Duket se për të pasur një stabilitet në jetën politike të vendit, si dhe

për të qenë në gjendje që për çështje të ndryshme të mundësohen marrëveshje politike të rëndësishme, kërkohet një rrol i fortë i partive politike dhe ndoshta edhe i liderëve të tyre. Por koha gjithnjë e më shumë po tregon se në zgjedhjet e tyre elektorale votuesit po orientohen më shumë nga vlerat e personit sesa nga ajo se çfarë ai përfaqëson politikisht.

Megjithatë simpatia politike vazhdon të mbetet një faktor përcaktues në përzgjedhjen elektorale të votuesit shqiptar

-për këtë arsye një sistem elektorale që i harmonizon këto interesa mundet të ishte një zgjidhje e duhur. Kështu mundet të votohet për partitë politike, por ndoshta ata kandidatë të cilët fitojnë vende për shkak të numrit të votave që ka marrë partia politike që përfaqësojnë, mundet të radhiten nga vetë zgjedhësit.

- Sistemi i tillë është ai i votimit proporcional me listë të hapur;

VII. Shqipëria është në fazën kur i kërkohet të demonstrojë përpara organizmave ndërkombëtare ku ajo aspiron të anëtarësohet, se është një shtet demokratik i cili njih dhe respekton të drejtat e minoriteteve dhe grupeve të caktuara sociale. Për këtë shkak ajo së pari, ndoshta duhet të garantojë që këto grupe, në rastin kur ato përbëjnë një numër të spikatur në raport me popullsinë në vendit, të kenë mundësi reale të kenë përfaqësuesit e tyre në Kuvend në një numër të arsyeshëm përfaqësuesish të tillë – Zgjidhje mund të ishte sistemi elektorale i cili garanton në çdo rast një numër vendesh të caktuara paraprakisht për këto grupe etnike, sociale, etj;

VIII. Me synim zhvillimin sa më të harmonizuar të të gjithë territorit të vendit, të paktën për aq sa objektivisht është kjo e nevojshme duhet që politikën qeverisëse dhe administruese të jenë të tilla që të kenë në fokusin e tyre mundësisht çdo pjesë të territorit.

Të prirur nga interesa politike të ngushta dhe elektorale, qeveritë shpesh herë i drejtojnë programet e tyre në terriore të cilat ju japin atyre një mbështetje politike me të mirë apo ku ato mund të tregojnë më mirë “kualitetin e qeverisjes”. Duke lënë në këtë mënyrë jashtë vëmendjes zona apo terriore të tjera. Por pasja e zërave përfaqësues nga këto zona/terriore “të diskriminuara” në rastin më minimal do të bënte që të sillte të paktën në vëmendje të opinionit nevojat e këtyre zonave, por në rastin më të mirë mund të ndikonte në zhvillimin e programeve të caktuara në to. Sa më sipër, do të thotë që ngelet e nevojshme që të ketë një lidhje ndërmjet territorit/komunitetit të caktuar dhe përfaqësuesit të këtij komuniteti në Kuvend.

Interesi i përfaqësuesit për të fituar në zgjedhjet e radhës do të ishte një nxitje mëse e mjaftueshme për të, që të shprehte kudo dhe në çdo rast interesat e komunitetit që përfaqëson.

- Në përmbushje të kësaj kërkese, si zgjidhje mundet të ishte një sistem zgjedhor mazhoritar i pastër, ose një sistem proporcional me listë hapur, rajonal;

## Përfundim

Nga e tërë kjo që u tha më lart del se nuk ekziston më dogma e një ndarjeje të zbatuar në mënyrë strikte e pushtetit mes ekzekutivit, legjislativit dhe judikativit. Njëkohësisht, demokracia moderne pretendon të pamundësoj monopolizim të pushtetit. Ajo organizon në pesë nivele bashkekzistencën dhe konkurrencën e forcave politike: elektorati dhe mendimi publik, shoqatat dhe partitë, parlamenti, ekzekutivi si qeveri dhe administratë dhe gjyqësori, edhe pse me ndikim të ndryshëm, marrin pjesë në formulimin e vendimeve bazë politike, zbatimin dhe kontrollimin e tyre. Por të gjithë pjesëmarrësit mbeten të lidhur me parimet themelore të kushtetutës dhe duhet t'u përmbahen rregullave që parashikon ajo. Të gjithë duhet t'i nënshtrohen edhe kontrollit të përhershëm të organeve të tjera. Në këtë mënyrë, ndikimi i shtetit, në vendet demokratike është i kufizuar nga një sistem i komplikuar i kufizimit të pushtetit përmes peshave dhe kundëpeshave. Në pikëpamjen e demokracisë moderne, mbrojtës i të gjithave është norma e shtetit juridik, e cila duhet të mbrohet në mënyrë të posaçme nga gjyqësori i pavarur (...).

Sistemet politike të quajtura demokratike, nuk janë pra demokratike me kuptimin se pushteti i takon popullit, por se janë sisteme politike të ndryshme edhe nëse kanë mes tyre pika të përbashkëta. Pra është gabim që Demokracia të përkufizohet si sistem i shteteve të bashkuara apo Mbretërisë së bashkuar, apo Francës apo ndonjë shteti tjetër perëndimor. Pasi që prej të drejtave të këtyre shteteve është zgjedhja për vete atë që e sheh të përshtatshme, prej themeleve dhe vlerave politike edhe pse e tërë ajo quhet demokratike, a nuk është e drejtë e jona që të zgjedhim parime dhe vlera politike që i shohim të përshtatshme për unin tonë, realitetin tonë, si mjet më të mirë për realizimin e qëllimeve tona, qofshin ato vlera në përputhshmëri me sistemin demokratik apo në kundërshtim me te? Si jo! Madje kjo është mënyra e natyrshme e çdo populli që gjykon me mendjen e tij, respekton vetveten e tij dhe krenohet me personalitetin dhe origjinalitetin e tij.

Që këndeje, nëse ndonjë prej shteteve tona, dëshiron që të zgjedh për veten e tij sistem që do të përfaqësoj unin e saj dhe do të jetë i përshtatshëm për kohën e saj, duhet që të filloj me konsolidimin e parimeve dhe vlerave të cilave do t'u përmbahet, pastaj të kërkoj institucione të përshtatshme për kohën dhe rrethanat e tij që do të mund t'i bartin ato vlera dhe t'i shprehin ato. Për shembull mund të thuhet: ai shtet dëshiron për veten të dallohet me veçori, prej tyre: udhëheqësinë e tyre e zgjedh populli, mbizotrimi i pushtetit kanunal, liria e të menduarit dhe e gjithë kjo të jetë brenda kornizave të besimit të tyre për mënyrën e jetës që nuk është patjetër të jetë e njëjtë si ajo e perëndimit. Nëse

ummeti musliman e bën tërë këtë brenda kornizave të Kur'anit dhe Sunnetit, dhe shton gjëra të tjera sikur urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja, mbrojtja e fesë e kështu më rradhë. Pajtimi me Demokracinë Liberale perendimore në disa hollësira nuk do të thotë që të pajtohemi në të gjitha gjërat, apo të përkrah filozofinë e saj, apo të quhet me atë emër. Disa gjëra të mira që janë në demokraci nuk janë të veçanta për të, por mund që ajo të zhveshet nga ato të mira apo të gjinden në ndonjë sistem tjetër.

## ***Bibliografia***

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i 1998  
A.Anastasi “E drejta Kushtetuese”  
L.Omari “Sistemi Parlamentar” Tiranë 2000  
Filo Llambro: Sistemet Politike bashkëkohore Tirane 2008  
Fletore e Akademisë për Udhëheqësi dhe Reformë Politike  
Latifi, Veton; Politikologjia, Instituti për Demokraci dhe zhvillim  
Zaganjori, Xhezair; Demokracia dhe shteti i së drejtës; Luarasi Tiranë  
2002  
[http://www, dadalos,](http://www.dadalos.de) Roland Sturm: Regierung und Veräaltung:  
Informationen zur Politischen Bildung 262, “Großbritannien”, Bonn BpB  
1999  
Gerhard Greiner / Hans woldt: Das politische der USA / në Politik und  
Unterricht 13, 2/1987



*Dukuri të recesionit ekonomik dhe qasjet  
efiçente në qeverisje*

---

■ *Dokt. Florian MITI*

---

**Abstract.** *Economists postulate the efficient use of resources in order to maximize the production of goods and services. Instead, the politicians seem to have many other concerns, way different from seeking the efficiency. The need of getting (re)elected, drives them to (public) choices of not optimal outcomes and sometimes even harmful to public. If the economy is in a recession phase, textbooks advice a firm action of fiscal and monetary policy of public authorities. But increasing public expenditures and reducing taxation, in combination with not accurate investments selected and implemented according to their election needs, leads to greater public deficits and higher debt burdens in the future. Most of the analysis reported in this paper is based on the contributions of J. M Buchanan to the public choice economics. As a final consideration, some main features of the Greek crisis are also taken into consideration.*

**E**fiçenca në ekonomi është një term që i referohet përdorimit të burimeve në mënyrë të atillë që të maksimizojë prodhimin e mallrave dhe të shërbimeve.<sup>1</sup> Pra, ideja që qëndron pas është se një sistem është efiçent (në kuptimin absolut) nëse nuk mund të arrihet të përftojme diçka më tepër duke pasur të pandryshueshme burimet që janë në dispozicion.

Në kuptimin administrativ, efiçenca ka të bëjë me rritjen e transparencës brenda institucioneve publike, si dhe me thjeshtëzimin e rregullave dhe të procedurave që i adresohen qytetarëve apo bizneseve.

Megjithatë, kërkimi i efiçencës nuk është i vetmi qëllim në një sistem ekonomik. Gjatë kërkimit të efiçencës, shpesh herë duhet të ballafaqohemi me objektiva të tjerë prioritarë si barazia, liria dhe drejtësia, të cilat mund të ecin në drejtim të kundërt.

Në situata krizash ekonomike të rënda, hendeku që ekziston midis recetave ekonomike të hartuara në tekstet universitare dhe realitetit ekonomik në terren mund të jetë i madh. Është e evidente tanimë se në shume raste shpenzimet e larta qeveritare, si ato në infrastrukturën rrugore, apo dhe ndërhyrjet rregullatore në sektorët më strategjikë, si energjetika, nuk kanë dhënë gjithmonë rezultate optimale. Shtojmë këtu se një masë e mirë e shpenzimeve qeveritare janë të shpërndara në programe që shpesh herë ndërthuren apo publikojnë njëri-tjetrin, dështojnë në adresimin e nevojave reale të shoqërisë dhe nuk zbatohen me efiçencë.

Për të pasur një shoqëri të shëndoshë e të suksesshme në të gjitha sferat e saj sociale dhe ekonomike, parakushti është që ajo ka nevojë të jetojë në një klimë optimale të siguruar nga një qeverisje efektive dhe e aftë për të kryer dhe përballuar me sukses funksionet e veta. Këto funksione përfshijnë edhe menaxhimin me efektivitet të shpenzimeve të përcaktuara sipas buxhetit, për të financuar implementimin e këtyre funksioneve. Por, ashtu si drejtimi i një firme prodhuese komplikohet me zmadhimin e përmasave të saj (për shkak të asimetrive informative), duke rritur kostot administrative dhe rrezikun e shpenzimeve të tepërta dhe jo efektive, edhe një qeveri e enjtur artificialisht në aparatit e saj me karakter të theksuar burokratik, me një vendimmarrje thuajse tërësisht të centralizuar, në fund të fundit dëmton ekonominë në tërësi dhe iniciativën private në veçanti. E meqë të ardhurat në buxhet sigurohen, në pjesën më të madhe, nëpërmjet sistemit të tatim-taksave dhe të marrjes borxh, nevoja për shpenzime të mëdha nga ana e qeverisë krijon tendencë të rrezikshme për të rritur barrën tatimore apo për të rritur nivelin e borxhit publik.

---

*1 - Sullivan, Arthur; Steven M. Sheffrin (2003). Economics: Principles in action. Upper Saddle River, New Jersey 07458: Pearson Prentice Hall. p. 15.*



Ekonomisti nobelist, James M. Buchanan<sup>1</sup>, një nga studiuesit më në zë të politikave publike ekonomike, ka paraqitur një sërë publikimesh në lidhje me ekonominë e zgjedhjeve publike (*publik-choice economics*) dhe është e udhës, në një situatë ekonomiko-politike si ajo që aktualisht po kalojmë, për të reflektuar mbi paralajmërimet e tij. Buchanan, në studimet e tij shumëvjeçare, la të theksuar konkluzionin se ndjekja e interesave vetjake nga ana e politikanëve çon shpesh drejt një rezultati të dëmshëm për publikun.

*“Në ballafaqimin me votuesit në periudhën e zgjedhjeve, - sjell si shembull autori, - ligjvënësi ka tendencën që të miratojë uljen e taksave dhe rritjen e shpenzimeve për projekte dhe programe asistence të pëlqyera nga elektorati. Ky kombinim mund të çojë në deficite gjithnjë e në rritje, një barrë të lartë të borxhit publik dhe qeverive gjithnjë e më të mëdha për të kryer shërbimet ndaj publikut”.*<sup>2</sup>

Ndjekja e interesave vetjake nga ana e të deleguarve, në fakt është një problem i njohur gjerësisht nga ekonomistët, sidomos në brendësinë e ekonomisë së informacionit (*Information Economy*), ku problemi i agjensisë dhe oportunitizmi post-kontraktual<sup>3</sup> i administratorëve të përzgjedhur nga aksionistët zë një vend thelbësor<sup>4</sup>.

Analiza e bërë nga Buchanan qëndron në kontrast të dukshëm, jo vetëm me thënien e Adam Smithit se ndjekja e interesit vetjak çon, nëpërmjet “një dore të padukshme”, në rezultatet e dëshiruara sociale, por është në kontrast edhe me mendimin që mbizotëron në analizën e politikave publike, e cila e konsideron qeverinë si një planifikues dashamirës, në zbatim të supozimeve të bëra nga tekstet universitare.<sup>5</sup>

Sipas kësaj pikëpamjeje, nëse tregjet nuk përvetësojnë plotësisht të gjitha kostot e veprimtarisë private (marrim për shembull ndotjen e mjedisit si pasojë e veprimtarisë prodhuese), pra kemi *eksternalitete negative* nga procesi i prodhimit, zgjidhja teorike nëpër tekste jepet nëpërmjet një taksimi optimal ose nëpërmjet subvencionit, i cili mendohet se mund të korrigjojë efektet anësore të prodhimit.

---

1 - *Iu dha Çmimi Nobel në vitin 1986 për qasjen studimore mbi qeverisjen dhe sjelljen e zyrtarëve të qeverisë me të njëjtën analizë rigorozë që ekonomistët kishin aplikuar gjatë në lidhje me vendim-marrjen në sistemin ekonomik privat.*

2 - *Për një vështrim me të thelluar: James M. Buchanan: Public Principles of Public Debt: A Defense and Restatement (Homewood, Ill.: Richard D. Irwin, 1958), volume 2.*

3 - *Njohur në terminologji si moral hazard.*

4 - *Për një thellim konsulto: Nicita A. & Scoppa V.: Economia dei Contratti, Carocci editore, Roma, Italy 2005.*

5 - *Michael Boskin për J.M. Buchanan tek “Taming the Leviathan”, Project Syndicate, 27.01.2013.*

Gjithashtu, nga leksionet e makroekonomisë moderne, në rastet kur rënia e kërkesës agregate shkakton një recesion ekonomik, rritja e shpenzimeve qeveritare ose ulja e taksave sipas një mase optimale, e përcaktuar kjo sipas doktrinës keynesiane, do të shpinte në një rimëkëmbje të ekonomisë.

Buchanan e konsideronte këtë një lloj analize romantike dhe larg realitetit<sup>1</sup>. Ai tregoi se zyrtarët publikë, si gjithë të tjerët, janë të shtyrë nga interesi vetjak dhe të drejtuar nga rregullat e përcaktuara nga mjedisi i tyre ekonomik në të cilin operojnë. Në zhvillim të kësaj logjike, konsumatorët kanë një kufizim buxhetor; firmat kanë kufizime teknologjike dhe për politikanët, mundësia për të ushtruar pushtetin - në funksion të interesave vetjake - është e kufizuar nga nevoja për t'u zgjedhur<sup>2</sup>.

Buchanan parashikoi se, duke fshehur kostot e plota, mundësia për të financuar shpenzimet publike përmes deficitit do të çojë në shpenzime më të larta dhe në taksat më të ulëta në dëm të brezave të ardhshëm, përfaqësuesit e të cilëve nuk ishin të përfaqësuar direkt në votim aktual. Ai parashikoi deficite dhe borxhe gjithnjë e më të mëdha dhe një qeveri gjithnjë e më të zmadhuar si rezultat i kësaj.<sup>3</sup>

Ky parashikim fatkeqësisht u vërtetua dhe u realizua gjatë krizës financiare dhe recesionit të thellë në shumë vende europiane, ku u shoqërua me deficite të mëdha dhe nivele të borxhit publik të papërballueshme nga qeveritë. Mjafton të përmendim masat antikrizë që qeveria greke është detyruar të ndërmarrë vitet e fundit, për kuptuar rrënimin ekonomik të krijuar nga një politikëbërje e papërgjegjshme: reduktim të vendeve të punës në sektorin publik me 150.000 nëpunës civilë më pak brenda vitit 2015; privatizime masive me një vlerë prej 50 miliard eurosh në periudhën afatmesme; shkurtime të pagës minimale dhe pensioneve me 22-25%, dhe shumë shkurtime të tjera në shpenzimet qeveritare<sup>4</sup>.

Por a janë masat shtrënguese të imponuara nga Trojka europiane, të denja për ta drejtuar ekonominë greke të lundrojë në ujëra të qeta, në përputhje me recetat ekonomike të paraqitura nga doktrinat ekonomike moderne? Këtu ekonomistët nuk janë të të njëjtit mendim. Ndoshta, edhe më e vështirë është gjetja e fajtorit të vërtetë në përmasat e kësaj krize dhe ky është një realitet më i vështirë për t'u pranuar. Një nga zërat më autoritarë të ekonomisë botërore, Paul Krugman, në një intervistë të dhënë për **New Yourk Times** shprehet:

---

1 - *Po aty.*

2 - *James M. Buchanan: The Limits of Liberty: Between Anarchy and Leviathan, Liberty Fund, Volume 7, 1975, p. 198.*

3 - *James M. Buchanan: Democracy in Deficit: The Political Legacy of Lord Keynes, Academic Press. Volume 8, 1977, p. 73.*

4 - *Factbox: Greek austerity and reform measures, Reuters, 19/02/2012.*

“Pra Greqia, edhe pse jo pa mëkate, është në telashe sidomos falë arrogancës së zyrtarëve europianë, dhe kryesisht prej atyre të vendeve më të pasura, të cilët bindën vetveten se ata mund t’ia dilnin që monedha e përbashkët të mund të funksiononte edhe pa pasur një qeveri të përbashkët. Dhe po këta zyrtarë e kanë çuar situatën edhe më keq, duke insistuar përpara fakteve, se të gjitha telashtet me monedhën e përbashkët u shkaktuan nga sjellja e papërgjegjshme e zyrtarëve të qeverive europiane të Jugut, dhe se çdo gjë do të funksionojë vetëm nëqoftëse popullsia e këtyre vendeve është e gatshme për të bërë sakrificë më të mëdha...”<sup>1</sup>

Ekonomistë si Milton Friedman, James M. Buchanan e shumë të tjerë, evidentuan se dështimet ekonomike të qeverive janë po aq të shpeshta sa dhe dështimet e tregut.

A mos vallë duhet t’i rikthehemi dhe të ç’pluhurosim doktrinat liberale mbi **Shtetin minimal**, funksionet e të cilit janë të kufizuara në garantimin e mbrojtjes kombëtare dhe të rendit publik? Diçka e tillë, edhe pse është jashtë çdo logjike zbatimi, ndoshta lë hapësirë për reflektim. Shoqëria dhe realiteti social-ekonomik i sotëm është krejt ndryshe dhe më kompleks nga rrethanat që çuan në lindjen e ideve iluministe të shekullit të tetëmbëdhjetë.

Sot teknologjia e informacionit dhe e komunikimit ka rritur ndjeshëm transparencën dhe informacioni qarkullon më shpejt. Kjo ka bërë të mundur që në njërin anë kostot të ulen ndjeshëm dhe të përmirësohen shërbimet (si p.sh rasti i shërbimeve *one-stop shop*) dhe, në anën tjetër, shpejtësia me të cilën qarkullon informacioni ka rritur transparencën dhe reagimin e shoqërisë, përfshirë këtu gjithë sistemin mediatik, duke rritur presionin për një qeverisje më efektive dhe efikase.

## ***Bibliografia***

Adam Smith: **The Wealth of Nations**, Modern Library Edition, New York 1937

Batalli M: *Megatrends in eGovernment*, European Journal epractice Volume 13, N. 12, 2011.

Factbox: *Greek austerity and reform measures*, **Reuters**, 19/02/2012

James M. Buchanan: **Public Principles of Public Debt: A Defense and Restatement** (Homewood, Ill.: Richard D. Irwin, 1958), volume 2 in the series

---

1 - Paul Krugman, në *Greece as Victim*, *The New York Times*, 17/06/2012.

James M. Buchanan: **Cost and Choice: An Inquiry in Economic Theory** (Chicago: Markham Publishing Co., 1969), volume 6 in the series

James M. Buchanan and Richard E. Wagner: **Democracy in Deficit: The Political Legacy of Lord Keynes** (New York: Academic Press, 1977), volume 8 in the series

Michael Boskin për J.M. Buchanan tek *Taming the Leviathan*, Project syndicate, 27.01.2013.

Milton Friedman: *The 'Welfare' Effects of an Income Tax and an Excise Tax*, **Journal of Political Economy**, LX (February, 1952), 25-33.

Nicita A. & Scoppa V. **Economia dei Contratti**, Carocci editore, Roma, Italy 2005

Paul Krugman: *Greece as Victim*, në **The New York Times**, 17/06/2012

Sullivan, Arthur; Steven M. Sheffrin: *Economics: Principles in action*. Upper Saddle River, New Jersey 07458: Pearson Prentice Hall, 2003

### *Bibliografi shitesë*

Francesco Forte & James M. Buchanan: *The Evaluation of Public Services*, **Journal of Political Economy**, University of Chicago Press, vol. 69, 1961

Buchanan, James M. & Goetz, Charles J.: *Efficiency limits of fiscal mobility: An assessment of the tiebout model*, **Journal of Public Economics**, Elsevier, vol. 1(1), pages 25-43, April 1972

Buchanan, James M.: *Let Us Understand Adam Smith*, **Journal of the History of Economic Thought**, Cambridge University Press, vol. 30(01), pages 21-28, March 2008

James M. Buchanan: *Individual Choice in Voting and the Market*, **Journal of Political Economy**, University of Chicago Press, vol. 62, 1954

Kaldor N.: **Further Essays on Economic Theory**, London 1978

Kornai J.: *Resource-Constrained Versus Demand-Constrained Systems*, **Econometrica**, July 1979

Salamon, L. M. & Odus V. E.: **The Tools of Government: A Guide to the New Governance**, New York: Oxford University Press, 2002

## *Përfitueshmëria dhe risku në bankat e nivelit të dytë* *RAST STUDIMI CREDINS SHA.*

---

■ Klodiana DAUTAJ, MsC

---

**Abstract.** *The recent financial crisis showed that credit risk is a very important source of risk for the financial system. Already all analysts are of the opinion that the credit risk associated with other macroeconomic factors, occupies a considerable weight on bank risk, and for this reason is considered the main risk that faces a bank.*

*According to Duffin & Singelton (2003), credit risk can be defined as the risk of default or the risk of a reduction in the market value caused by changes in the credit quality of issuers or counterparties. In general terms, this is a common thing in the world of business, which means that this risk always exists whenever expected a charge on the basis of a contractual obligation. In another way we can say that credit risk is present in lending or investment activities, and concerns the return of borrowed money or the payment for sold goods. There is no doubt that when the obligation against other party does not fully comply, loss occurs. According to Horcher (2005), if an organization has accumulated large losses as a result of financial difficulties of creditors, credit failure is more likely.*

**B**ota e sotme ka hasur një numër të konsiderueshëm krizash financiare dhe bankare përgjatë tridhjetë viteve të fundit. Caprio and Klingebiel (1997) kanë identifikuar 112 kriza sistematike bankare<sup>1</sup> në 93 vende që prej fundit të viteve 1970. Demirguc-Kunt-Detragniache (1998) kanë identifikuar 30 krizat më të mëdha bankare të ndodhura që prej fillimit të viteve '80 e deri në ditët e sotme, shumica e tyre ishin të përqendruara në vendet në zhvillim. Çuditërisht, pjesa më e madhe e këtyre krizave kishin të bënin me zgjerimin e shpejtë të kreditimit.

Kriza aktuale financiare ka shumë tipare të ngjashme me krizat e shkuara financiare dhe, sikundër edhe në këto të fundit, kjo krizë ka qenë rezultat i ndikimit të tri faktorëve kryesorë, të cilët janë:

1. keqmanaxhimi i inovacioneve financiare,
2. keqmanaxhimi i rrezikut të aktivitetit kreditues,
3. fluska e krijuar nga ndryshimi në çmimin e aseteve. (F. Mishkin, 2009)

Përdorimi i kolateralit ndihmon në zvogëlimin e problemit të asimetrisë së informacionit, pasi huamarrësi është më i limituar për t'u përfshirë në nivele të larta rreziku, si rrjedhojë e frikës për të humbur këtë kolateral. Në rast se mosshlyerja e kredisë ndodh, huadhënësi do të marrë pronësinë e kolateralit dhe për pasojë do të ketë mundësinë për të mbuluar një pjesë ose ndoshta të gjithë shumën e kredisë. Sidoqoftë, në një situatë makroekonomike të përkeqësuar, çmimet e shumë formave të kolateralit tentojnë të bien. Në një periudhë afatgjatë, rritja e vazhdueshme e çmimeve të aseteve krijoi efektin e tollumbaces<sup>2</sup>. Në një moment të caktuar tollumbacja plasi dhe tregjet e aseteve përjetuan një rënie dramatike në çmimin e këtyre të fundit, e shoqëruar me çrregullime. Së fundi, rezultati ishte një numër shumë i madh bankash të falimentuara, si pasojë e një numri shumë të madh kredish të këqija.

Si pasojë e krizës financiare në tregun amerikan gjatë periudhës 2007-2008, tregu financiar global po përjeton një situatë të turbullt. Kjo gjë ka sjellë domosdoshmërinë e një ekzaminimi më të ngushtë të shumë çështjeve të lidhura me operimin e tregjeve financiare për të gjetur shkakun kryesor të problemit. Çështje të ndryshme, si psh. niveli i mjaftueshmërisë së kapitalit në sistemin bankar, vlera e tregut të aseteve bankare, si dhe roli i agjensive financiare, janë ndër më të debatuarat.

Si për ironi, frekuenca e krizës nuk u zbut, pavarësisht parashtrimit të disa reformave të njëpasnjëshme. Natyrshëm shtrohet pyetja: Pse? Ka shumë faktorë që ndikojnë, veçanërisht kushtet ekonomike dhe politike. Pra, mund

---

1 - Risku sistematik është risku i kolapsit të një sistemi ose tregu të tërë dhe jo i një entiteti individual apo komponenti të atij sistemi.

2 - Englund P.: *The Swedish Banking crisis: Roots and Consequences*, Oxford review of Economic Policy, Vol. 15, no.3, 1999, fq. 80-97.

të jetë e dukshme që përmirësimi i menaxhimit të riskut të kredisë nuk do të thotë në të njëjtën kohë dhe përmirësim i biznesit bankar. Për më tepër, Jean-Charles Rochet (2008) pohon se faktorët kyç të një reforme kanë të bëjnë me pavarësinë dhe profesionalizmin e supervisorëve të sistemit bankar.

Për sa kohë që supervisorët e sistemit bankar përfaqësojnë interesat ekonomike dhe politike të vendeve të tyre respektive, është e pamundur të implementohen rregulla ndërkombëtare në mënyrë të suksesshme.

Sistemi financiar, përveç funksioneve të tjera, luan dhe rolin e kanalizimit të fondeve në mënyre frytdhënëse drejt individëve ose kompanive që kanë mundësi dhe dëshirë për të investuar duke mbledhur dhe përpunuar informacion nga këta të fundit. Edhe pse tregjet financiare përballen me sasi të mëdha informacioni, një pjesë e këtij informacioni ka natyrë asimetrike; që do të thotë se njëra palë në një kontratë financiare (kryesisht huadhënësi) ka më pak informacion të saktë në lidhje me shpërndarjen e të ardhurave, sesa ka pala tjetër (kryesisht huamarrësi).

Bankat kanë luajtur një rol të rëndësishëm në zvogëlimin e kësaj asimetrie, por kjo vlen kryesisht për rastin e atyre kompanive të cilat tentojnë të krijojnë një marrëdhënie afatgjatë me bankën. (F.Mishkin, 2009)

Kriza financiare globale tregon që menaxhimi i riskut në institucionet financiare nuk është i një niveli të mjaftueshëm, gjë e cila çoi në falimentimin e shumë bankave. Për më tepër, diskutimi në media rreth krizës financiare, përmend kryesisht lënien pas dore të sinjaleve për menaxhimin e riskut.

Për këtë arsye **Menaxhimi i Riskut** si disipline më vete po merret shumë në konsideratë në ditët e sotme<sup>13</sup>. Pavarësisht të tjerave, stuhia financiare na jep disa mësimet me vlerë për të përmirësuar menaxhimin e riskut në të ardhmen.

Sektori bankar është bërë gjithmonë e më kompleks gjatë viteve të fundit, si rrjedhojë e zhvillimeve në tregun financiar. Si rezultat, bankat po përfshihen gjithmonë e më tepër në më shumë transaksione, pa analizuar plotësisht nivelin e riskut. Për pasojë, ekspozimi kundrejt riskut bëhet më i madh. Kjo gjë shkakton faliment sistematik - sistemi ekonomik i vendit pëson kolaps. Qeveria ndikon në këtë situatë duke u përpjekur të stabilizojë ekonominë nëpërmjet mekanizmave rregullues.

Ekspozimi ndaj riskut - me kryesori dhe më i vështiri për t'u identifikuar - lidhet me riskun e kredidhënies. Sipas Welzel (2002), risku i kredidhënies

---

1 <sup>13</sup> Joe Nocera: *Risk management and financial crisis*, *Herald Tribune*, Janar. 04. 2009.

është ndër më të vjetrit dhe më të rëndësishmit për t'u marrë në konsideratë nga bankat si institucione financiare, pasi ky rrezik ka ndikim të drejtperdrejtë në masën e kapitalit që banka duhet të mbajë për t'u përballur me një situatë të vështirë. Qëllimi kryesor i një banke duhet të jetë pasja e një norme rreziku të tillë, e cila të mos e ekspozojë bankën më tepër nga ç'duhet. Rëndësia e këtij risku është rritur sepse lidhet me problemin e kolateralit. Si rrjedhojë, është i rëndësishëm dhe i nevojshëm studimi i tij.

Sipas Hennie (2003), pavarësisht inovacioneve në sektorin financiar, rreziku i kredisë është shkaku kryesor për falimentimin e shumë bankave.

Rregullat duhet të jenë ndërvepruese ose fleksibël për të qenë të suksesshme, për shkak të ndryshimit të shpejtë të rrethanave teknologjike, ekonomike dhe politike. Mënyrat dhe mjetet e përdorura në Basel II për të matur rrezikun e kredisë, përpiqen të jenë fleksibël. Kjo do të thotë që bankat mund të zgjedhin nga mundësitë e paraqitura, ose të përdorin mënyrat e tyre për aq kohë sa rezultatet e marra prej këtyre të fundit do të jenë të kënaqshme.

Midis të tjerave është e rëndësishme të bëj dallimin midis analizimit të një kredie dhe analizimit të riskut, dy koncepte të përdorura gjerësisht në këtë studim.

Analizimi i kredisë përfshin përcaktimin e mundësive të pagesave dhe është më e praktikuara në të dy analizat. Mundësia e pagesave përfshin mbledhjen e informacionit nga ana e bankës në lidhje me vlerësimin dhe analizimin e bilanceve të klientit, vlerësimin e kapacitetit dhe kapitalit që ai zotëron si dhe vlerësimin e karakterit të përgjithshëm të tij. Kjo analizë në përgjithësi është afatshkurtër dhe shpesh analiza e vetme që bankat bëjnë për të përcaktuar nëse duhet miratuar një kredi apo jo.

Nga ana tjetër, analizimi i riskut përfshin identifikimin e humbjes apo të fitimit potencial që rrjedh nga shitja e një kredie tek një klient për një periudhë kohe të caktuar, dhe kjo konsiderohet si një analizë e avancuar e kredisë.

Në mjedisin e sotëm analizimi i rrezikut luan një rol shumë të rëndësishëm në vendimet e një banke, si rezultat i kësaj shumë banka tregojnë mjaft kujdes në përzgjedhjen e punonjësve të departamentit të kredisë dhe riskut.

Rëndësia e menaxhimit të riskut të kredisë dhe ndikimi i tij në përfitueshmëri, ka qenë motivi kryesor i këtij studimi. Nëpërmjet kësaj teze unë përfundoj që, nëse menaxhimi i riskut të kredisë është nën kontroll, niveli i përfitueshmërisë do të jetë i kënaqshëm. Ana tjetër e medaljes, nëse menaxhimi i riskut të kredisë është jo i mirë, niveli i përfitueshmërisë do të jetë relativisht i ulët, kjo sepse sa më pak bankat humbin nga kreditë, aq më shumë



fitojnë ato. Për më tepër, përfitueshmëria është një nga treguesit e menaxhimit të riskut të kredisë. Çështja kryesore lidhet me atë se sa i rëndësishëm është ndikimi i menaxhimit të riskut të kredisë në përfitueshmërinë e bankës. Kjo tezë perpiqet të gjejë përgjigjen në lidhje me çështjen në fjalë.

Si fillim, përpiqem të përshkruaj jo vetëm ndikimin e menaxhimit të riskut të kredisë në përfitueshmërinë e bankës **Credins**, por edhe se si kjo bankë e monitoron riskun e procesit të kreditimit. Metoda e studimit është *sasiore*. Për analizimin e të dhënave të marra nga raportet vjetore të bankës së zgjedhur, është përdorur modeli i regresionit. Analiza e regresionit paraqitet nëpërmjet një modeli përshkrues, pasi rezultatet e saj nxirren nëpërmjet testimit me anë të *software*-ve specifike si SPSS. Burimi i të dhënave janë Raportet Vjetore për 10 vjet, 2003-2011. Përveç kësaj, studimi ka nevojë që të fokusohet në analizimin e riskut të kredisë dhe në shënimet financiare të bëra në raportet vjetore.

Nga studimet e mëparshme është vërtetuar se treguesi i përfitueshmërisë është ROE (Të ardhurat neto/totalin e kapitalit aksioner), ndërsa për menaxhimin e riskut të kreditimit, tregues janë KP (kredi me performance jo të mirë) dhe norma e mjaftueshmërisë së kapitalit CAR (Capital Adequacy Ratio). Modeli i regresionit të shumëfishtë në këtë rast ka dy variabla të pavarur.

Në lidhje me modelin e regresionit kam marrë në vëmendje këto aspekte:

#### *-Variabli i varur*

Në këtë model është përdorur si tregues i përfitueshmërisë ROE, pasi në krahasim me ROA (Return On Assets - kthimi mbi asetet), është përdorur gjerësisht në studimet e mëparshme. Si fillim janë marrë në vëmendje treguesit ROE dhe ROARC (Fitimi pas Taksave / Kapitalin e Rregulluar me Riskun). Treguesi ROARC është një tregues i performancës relative të bankës dhe mund të ishte përdorur në analizën e regresionit. Sidoqoftë, unë nuk kam përdorur këtë tregues sepse zakonisht ky tregues përdoret nga banka dhe llogaritja e tij kërkon informacion konfidencial të bankës, si p.sh. kapitali i rregulluar me riskun. Për këtë arsye është përdorur ROE si tregues i përfitueshmërisë.

#### *-Variablat e pavarur*

Në modelin e regresionit janë zgjedhur dy variabla të pavarur: NKP (Norma e Kredive me Probleme) dhe CAR, sepse këta janë dy tregues të menaxhimit të riskut që ndikojnë në përfitueshmërinë e bankës. Norma e Kredive me Probleme (NKP), në veçanti tregon sesi e menaxhon banka riskun e kredisë,

pasi ky tregues përcakton sa është pesha që zënë kreditë me probleme (KP) në totalin e kredive të dhëna (TK).

**NKP.** NKP llogaritet me anë të pjesimit midis KP dhe TK. Të dhënat për të kryer këtë llogaritje janë të pasqyrura në raportet vjetore të bankës. Emrat e përdorur në raportet vjetore për KP kanë qenë të ndryshme, si p.sh. kredi me probleme, kredi të dyshimta, kredi nën standard<sup>1</sup> etj. Sidoqoftë, këta emra përfshihen në termin e përdorur KP. Ky tregues gjendet në shënimet financiare të bëra në raportet vjetore në seksionin **Kreditimi**.

Sasia e TK, emëruesi i llogaritjes së raportit, është gjetur duke mbledhur dy kategori kredie: kredi për institucione dhe kredi për publikun. Nëpërmjet marrjes së totalit të kredive nga bilancet e bankës të paraqitur në raportet vjetore, llogaritja e NKP paraqitet si më poshtë:

$$NKP = (KP \text{ Total}) / (TK \text{ Total})$$

**CAR.** CAR është norma e mjaftueshmërisë së kapitalit. Vlera e CAR është marrë nga raportet vjetore të bankës dhe nuk është kryer ndonjë llogaritje për gjetjen e saj.

Modeli i regresionit të përdorur paraqitet si më poshtë:

$$Y = \alpha + \beta_1 X_1 + \beta_2 X_2 + \dots + \beta_n X_n + \varepsilon$$

Standard	Të aplikuara
Y – vlera e variablit të varur	Y: ROE- treguesi i përfitueshmërisë
$\alpha$ – konstantja	X1: NKP - treguesi i riskut të menaxhimit të kredisë
$\beta$ – koeficienti i regresionit	X2: CAR - treguesi i riskut të menaxhimit të kredisë
X – vlera e variablave të pavarur	
$\varepsilon$ – termi i gabimit	

Si rrjedhojë ekuacioni i regresionit bëhet:

$$ROE = \alpha + \beta_1 NKP + \beta_2 CAR + \varepsilon$$

Funksioni i regresionit përcakton lidhjen midis X (NKP dhe CAR) dhe Y (ROE).  $\alpha$  është konstantja dhe  $\beta$  është koeficienti i regresionit<sup>2</sup>, është vlera e ekuacionit të regresionit që parashikon variancën e shkaktuar te variabli i varur, nga variablat e pavarur. Kjo do të thotë që, nëse koeficienti  $\beta$  është negativ, variabli i pavarur ndikon negativisht te variabli i varur: rritja me një njësi në variablin e pavarur, do të çojë në uljen e variablit të varur në masën e koeficientit. Në të njëjtën mënyrë, nëse koeficienti  $\beta$  është pozitiv, variabli i

<sup>1</sup> - kreditë që kanë mungesë pagese më të madhe se 3 muaj.

<sup>2</sup> -  $\beta$  përfaqëson kontributin e pavarur të çdo variabli të pavarur për parashikimin e variablit të varur.

varur do të rritet në masën e koeficientit.  $\alpha$  është vlera e konstantes kur variablat e pavarur janë të barabartë me zero (nëse  $X_1, X_2 = 0$  atëherë  $\alpha = Y$ ). Së fundi,  $\varepsilon$  është termi i gabimit, që paraqet ndikimet e të gjithë variablave të tjerë<sup>1</sup>, me përjashtim të ndikimit të variablave të pavarur te variabli i varur që përfshihen në model.

Rezultatet e analizës së regresionit përfshijnë vlera të cilat shpjegohen si më poshtë:

$R^2$  është masa e variacës në variablin e varur, që mund të parashikohet nga variablat e pavarur. Gjithashtu kemi edhe  $R^2$  i rregulluar, i cili na jep një vlerë më të saktë, sepse shmang efektin e mbivlerësimit si pasojë e shtimit të më shumë variablave në funksion. Pra, një vlerë e lartë e  $R^2$  tregon që ndikimi i variablave të pavarur te variabli i varur është gjithashtu i lartë.  $R^2$  i rregulluar llogaritet sipas formulës:

$$1 - ((1 - R^2) * ((N - 1) / (N - k^2 - 1)))$$

Formula tregon që, nëse numri i vëzhgimeve është i vogël, diferenca midis  $R^2$  dhe  $R^2$  i rregulluar është më e madhe se 1, përderisa emëruesi është shumë më i vogël se numëruesi.  $R^2$  i rregulluar mund të marrë dhe vlera negative.

Gjithashtu, vlerat negative për  $R^2$  e rregulluar ndodhin nëse modeli përfshin kushte që nuk ndihmojnë në parashikimin e ROE, ose parashikuesit (NKP dhe CAR) janë përzgjedhur gabim për të parashikuar ROE.  $R^2$  në përgjithësi konsiderohet si një tregues i rëndësisë së dytë, në të kundërt më i rëndësishëm është përdorimi i ekuacionit të regresionit për të bërë një parashikim të saktë.  $R^2$  konsiderohet një matës i përgjithshëm i fortësisë së lidhjes dhe nuk tregon mënyrën se si ndonjëri prej variablave të pavarur lidhet me variablin e varur.

Vlera propabilitare (P) përdoret për të matur besueshmërinë e parashikimit të variablave të pavarur te variabli i varur. Kjo vlerë krahasohet me nivelin e rëndësisë që zakonisht është 0,05. N.q.s. vlera e P është më e madhe se 0,05, mund të thuhet se lidhja midis variablit të pavarur dhe atij të varur, statistikisht është e parëndësishme. Vlera F e llogaritur si  $(R^2/1)/((1-R^2/n^3-2))$  dhe vlera P përkatëse tregojnë masën e ndikimit të grupit të variablave të pavarur ndaj variablit të varur. Vlera e F të marrë nga regresioni duhet të krahasohet me vlerën kritike të F ( $F_{v_1, v_2}$ ), e cila merret nga tabela e shpërndarjes së vlerave të F. Të dy elementët  $V_1$  dhe  $V_2$  njihen me termin shkallët e lirisë.  $V_1$  është

1 - Variabla të cilët nuk përfshihen në funksion, por që mund të kenë ndikim te variabli i varur.

2 - k - numri i variablave të pavarur.

3 - numri i vrojtimeve.

numri i variablave të pavarur, ndërsa  $V_2$  është numri i vëzhgimeve minus numrin e variablave të pavarur minus 1. Në modelin e studimit konkret numri i vëzhgimeve është 8, numri i variablave të pavarur është 2, atëherë  $V_1=2$ , dhe  $V_2=n-k-1=8-2-1=5$ . Si rrjedhojë, vlera kritike e  $F(2,4)$ <sup>1</sup> mund të gjendet në tabelën e shpërndarjes përkatëse. Nëse vlera e  $F$  është më e madhe se vlera kritike, mund të thuhet që modeli i regresionit në tërësi është i rëndësishëm.

## **Treguesit e menaxhimit të rrezikut të kredisë sipas akordit të Basel II**

Si përgjigje ndaj situatës financiare që po kalon sot gjithë ekonomia botërore, mekanizmat rregullatorë janë përforcuar më shumë. Shumë banka kanë bërë investime të konsiderueshme për të përmirësuar menaxhimin e rrezikut të kredisë. Për të qenë më të qartë, bankat kanë investuar në metoda, procese, burime dhe teknologji, në mënyrë që të menaxhojnë, modelojnë dhe monitorojnë më mirë rrezikun e kredisë. (Jorg Hashagen 2008)

Në sektorin bankar, sipas akordit të Basel II, koncepte të tilla si kapaciteti mbrojtës kundrejt rrezikut, kapitali ekonomik etj., kanë qenë në qendër të vëmendjes për rregullatorët dhe menaxherët e rrezikut. Përveç të tjerave, ky akord ka vendosur një lidhje të drejtpërdrejtë midis minimumit të kapitalit rregullator që një bankë duhet të mbajë dhe ekspozimit të saj kundrejt rrezikut të kredisë, rrezikut të tregut dhe rrezikut të biznesit. Sipas Basel II, qëllimi i krijimit të një sistemi për të kufizuar rrezikun e kredisë, është të sigurojë që niveli aktual i rrezikut që mban banka është në përputhje me kapacitetin e saj mbrojtës kundrejt këtij rreziku. Sipas ekspertëve, kjo gjë do të shmangë tejkalimin e rrezikut të ndërmarrë, por nga ana tjetër masa e kufizimit të këtij të fundit duhet të rrjedhë nga strategjia që ndjek banka për nivelin e rrezikut në të cilin përfshihet, objektivat dhe kapacitetin e saj mbrojtës.

Ky proces në përgjithësi përfshin metoda cilësore, por edhe ndërthurje me metodat sasiore gjithashtu. Kjo gjë tregon që menaxhimi i kapitalit luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe zvogëlimin e rrezikut.

Një nga qëllimet kryesore të Basel II është krijimi i një standardi ndërkombëtar në lidhje me sasinë e kapitalit që duhet të mbajnë bankat për t'u mbrojtur nga rreziqet me të cilat ato përballen. Në tërësi rregullat e Basel II tregojnë se, sa më i madh të jetë ekspozimi i bankës kundrejt rrezikut, aq më e madhe është sasia e kapitalit që banka duhet të mbajë për t'u mbrojtur nga

---

<sup>1</sup> Anerson. D.R & Sweeney. D.J & Williams. T.A.: *Statistics for business and economics, 10th edition, F-distribution Table, 2008, fq. 928.*

mungesa e aftësisë paguese.

Nga studime të ndryshme akademike që janë bërë në këtë fushë, është arritur në dy përfundime të ndryshme:

1. kërkesa për mbajtjen e kapitalit kontribuon në stabilitetin e bankës dhe
2. kërkesa për mbajtjen e kapitalit i bën bankat të jenë të përfshira në aktivitete me rrezik të lartë se sa do të ishin në mungesë të këtyre kërkesave.

Sidoqoftë, vendimi për masën e kapitalit që banka duhet të mbajë, përveç atij të detyrueshëm, ka të bëjë edhe me natyrën e aksionerëve të saj.

Pra, teoritë e ndryshme paraqesin të dhëna kontradiktore në lidhje me faktin nëse kapitali i mbajtur kufizon apo rrit performancën dhe stabilitetin e bankës.

## Risku në banka

Risku lidhet me pasigurinë që mund t'i shkaktojë një banke humbje të konsiderueshme, ose në rastin më të keq ta çojë në falimentim. Risku me të cilin përballen bankat mund të klasifikohet në tre kategori: risku i kredisë, risku i tregut dhe risku operacional.

**Risku i kredisë** është risku i humbjes si pasojë e mospagesës së detyrimit e shprehur në termat e një huaje apo të një linje tjetër krediti<sup>1</sup>.

**Risku i tregut** është risku që ndodh si pasojë e ndryshimeve në kushtet e tregut.<sup>2</sup> ndërsa,

**Risku operacional** përkufizohet si risku i humbjeve në mënyrë direkte ose indirekte si pasojë e një sistemi që nuk funksionon mirë, apo nga ineficenca e punonjësve.

Për të menaxhuar në mënyrë sa më të frytshme secilin prej tyre, bankat duhet të krijojnë struktura të posaçme, të cilat duhet të merren me identifikimin, matjen, monitorimin dhe kontrollin e këtyre rreziqeve, me qëllim që ekspozimi i bankës të mos jetë më i madh se limitet e përcaktuara dhe vendimet për marrjen përsipër të një rreziku shtesë të jenë në përputhje me strategjinë dhe objektivat e bankës.

---

1 - Basel II (2006) *International Convergence of Capital Measurement and Capital Standards, A Revised Framework Comprehensive Version.*

2 - Basel II (2006) *International Convergence of Capital Measurement and Capital Standards, A Revised Framework Comprehensive Version.*

## Administrimi i rrezikut në bankën Credins

Banka **Credins** Sha. ka treguar kujdes të vazhdueshëm ndaj procesit të kreditimit, duke u bazuar në metodën e klasifikimit të brendshëm (internal rating) dhe në një monitorim të kujdesshëm, por situata financiare, duke u bazuar edhe në raportet e publikuara nga Shoqata Shqiptare e Bankave, tregon për një rritje në normën e kredive me probleme në sistemin bankar dhe fatkeqësisht kjo tregon që nuk po i kushtohet vëmendja e duhur menaxhimit të rrezikut të kredisë.

Sipas parashikimit që është bërë nga znj. Valentina Prodani për periudhën 2010-2011, norma e kredive me probleme do të pësojë sërish rritje dhe paralelisht me të edhe norma e mjaftueshmërisë së kapitalit për të mundësuar mbrojtje

ndaj rrezikut të aktivitetit kreditues.

Përgjatë gjithë kohës që prej krijimit të saj, banka është përpjekur të ketë një portofol të diversifikuar të kredisë dhe këtë fakt e dëshmojnë dhe marrëveshjet e ndryshme që ajo ka bërë. Në bazë të raportimeve të bëra nga departamenti i kredisë në vite, mund të thuhet se është bërë një punë shumë e mirë në diversifikimin e portofolit të kredisë sipas sektorëve të ekonomisë.

Është treguar shumë kujdes në shmangien e financimeve të mëtejshme në sektorët të cilët janë konsideruar me përqendrim të madh, si ndërtimi dhe tregtia deri diku. Për sektorin e ndërtimit, i cili rezultoi dhe më i godituri nga kriza, banka reduktoi deri në minimum financimet e reja për vitin 2009. Në lidhje me diversifikimin e portofolit të kredisë sipas monedhave në përgjithësi është i mirë dhe afër përcaktimeve të bëra në politikat kredituese. Pjesa më e madhe e portofolit të kredisë është e financuar në lekë dhe ka prirje në rritje, po ta krahasojmë me sistemin bankar, shpërndarja është pozitive.

Arsyeja e një politike të tillë lidhet me mbrojtjen nga rreziku i kursit të këmbimit. Përsa i takon shpërndarjes së portofolit të kredisë sipas maturitetit, vërehet një zhvendosje e portofolit të kredisë drejt maturiteteve të gjata, kjo si pasojë e rritjes së afateve të shlyerjeve të kredive për disa produkte kredie, dhe konkretisht ato të investimeve dhe hipotekore. Ndonëse shpërndarja e portofolit sipas maturiteteve është në përputhje të plotë me politikat kredituese, është për t'u pasur në konsideratë të veçantë kjo zhvendosje e përqendrimeve drejt maturiteteve afatgjatë, për shkak të risqeve të ndryshme që mbartin këto maturitete. Edhe në sistemin bankar vërehet një përqendrim i rreth 50% të portofolit të kredisë në afatet e gjata, ndërsa pjesa tjetër në maturitete afatmesme dhe afatshkurtra.

Megjithatë, përqendrimi i rreth 50% të portofolit në maturitetet afatgjata, kërkon një vlerësim më të mirë të riskut për këtë portofol, duke marrë në

konsideratë komplikacionet e ndryshme potenciale në afat të gjatë. Në lidhje me diversifikimin e portofolit të kredisë sipas grupeve të biznesit të klientëve, duhet thënë se shpërndarja e portofolit gjatë viteve kryesisht ka ndjekur prirjen e përqëndrimeve të mëdha në grupin e biznesit të madh dhe korporatave, pavarësisht se politikat e institucionit në vitet e fundit, kryesisht 2008 dhe 2009, kërkonin një zvogëlim të përqendrimit në këtë grup dhe rritje të grupeve të reja të biznesit, si SME dhe mikrokredi.


Rritja e Bankës dhe e numrit të transaksioneve të tyre, kërkojnë organizimin e strukturave në mënyrë të tillë që të rrisin frytshmërinë e operacioneve në bankë. Për rritje të frytshmërisë në menaxhimin e rasteve të kategorizuara si kredi me probleme, Menaxhmenti i bankës ka vendosur lidhjen e një kontrate shërbimi me shoqërinë ADCE Shpk, e cila do të ofrojë një shërbim më të specializuar në zgjidhjen e kredive me probleme.

Përsa i takon kredive me probleme, mund të thuhet se deget të cilat janë më problematike dhe që kanë tejkaluar mesataren e bankës për vitin 2009, janë dega e qytetit të Fierit dhe ajo e Korçës. Banka e marrë në studim ka themeluar Komitetin e Kredisë së Bankës, i cili është përgjegjës për identifikimin dhe analizimin e rrezikut të kredisë. Rreziku që rrjedh nga tregtimi i letrave me vlerë mbahet në nivele të ulëta, pasi përbëhet vetem nga letra me vlerë shtetërore, bono dhe obligacione thesari që janë konsideruar si instrumente pa rrezik. Për të gjitha ekspozimet e rrezikut më të mëdha se 10% e kapitalit rregullues, Bordi i Drejtorëve ka deleguar përgjegjësinë për administrimin e rrezikut tek Komiteti i Kreditimit (Raporti Vjetor i Aktivitetit Kreditues 2009)<sup>1</sup>.


Nëse do t'i referohemi raporteve vjetore të bankës për periudhën e marrë në studim, vihet re një rritje e të ardhurave neto nga interesat dhe po të njëjtën gjë mund të themi edhe për fitimin neto me përjashtim të vitit 2009, ku pati një rënie të këtij të fundit nga 738.933 që ishte në vitin 2008 në 524.765 në vitin 2009. Përgjatë gjithë periudhës 2004-2009, nga treguesit e paraqitur në raportet vjetore, viti 2007 dhe 2008 kane pasur ecurinë më të mirë. Grafiku më poshtë paraqet ecurinë e të ardhurave neto nga interesat dhe fitimit neto të bankës Credins sha për periudhën 2004-2009.

---

<sup>1</sup> - Raporti Vjetor i Aktivitetit Kreditues 2009, fq. 56-59.



*Figura 1 TA Neto nga int 2004-2009*



*Figura 2 Fitimi neto 2004-2009*

## Lidhja midis administrimit të rrezikut të kredisë dhe përfitueshmërisë në bankën Credins

Banka Credins e përcakton rrezikun e kredisë si rrezikun e humbjes financiare të bankës nëse klienti apo pala tjetër në një instrument financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti. Ky rrezik vjen kryesisht nga kreditë dhe paradhëniet klientëve, bankave dhe investimi në letra me vlerë.

Matja e rrezikut të kredisë bëhet në përputhje me rregullat e vendosura nga Banka e Shqipërisë për sa më sipër.






Figura 2 ROE e bankës Credins 2004-2011 në %




Figura 3 NKP e bankës Credins 2004-2011 në %

Figura 2 tregon se norma e kredive me probleme ka pësuar një rritje të vazhdueshme që prej vitit 2007, edhe pse ky tregues fillimisht në vitin 2007 ishte ndjeshëm më i ulët se në 2006 (nga 3.8 ra në 2.82). Kjo rritje e këtij treguesi mund të shpjgohet dhe me situatën e paqëndrueshme të tregut financiar si rezultat i ndikimit të krizës.

Në figurën 1 vihet re se përfitueshmëria e bankës e matur nga treguesi ROE ka pësuar një rënie të konsiderueshme që prej vitit 2008, vit i cili ka dhe vlerën më të lartë të këtij treguesi 33.1%.

Tabela 2: Tab e përmbledhjes së koef

	$\beta$ Coef	Signif. (P-value)	N
ROE			
NKP	-5,786	0,079	8
CAR	5,628	0,067	8

Tabela 3 Tab përmbledhese e modelit

$R^2$	Adj $R^2$	F	Model Signif (P-value)
0,559	0,369	3,054	0,136

Tabelat më sipër paraqesin rezultatet e ekuacionit të përfitueshmërisë, të marra nga analiza e regresionit sipas programit SPSS dhe MS Excel 2007. Për të dhënat më sipër është e nevojshme që të bëhet një interpretim në bazë të disa treguesve, të cilët janë përzgjedhur nga analiza e regresionit. Këta tregues janë: koeficienti  $\beta$  për të dy variablat e pavarur, norma e kredive me probleme (NKP) dhe norma e mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR), rëndësia e parashikimit për secilin variabel e matur nga P-value,  $R^2$ , Fisherit e matur nga F-value dhe niveli i rëndësisë së modelit, d.m.th. parashikimi i përfitueshmërisë nga të dy variablat së bashku, i matur nga P - value i modelit.

Nga paraqitja e të dhënave vihet re se koeficienti i modelit të regresionit për variablin e pavarur NKP tregon që ka një ndikim negativ tek variabli i varur ROE, që do të thotë se një njësi rritje në normën e kredive me probleme (NKP), përfitueshmëria e bankës do të ulet me 5.786 njësi kur variabli tjetër i pavarur, pra norma e mjaftueshmërisë së kapitalit (CAR) mbahet e pandryshuar.

Niveli i rëndësisë për variablin NKP i paraqitur nga P-value, sipas rezultatit është 0.078, që në krahasim me nivelin e rëndësisë së përzgjedhur 0.05 është lehtësisht më e madhe dhe do të thotë që NKP mund të parashikojë përfitueshmërinë ROE me një probabilitet 92.2 %.

Variabli tjetër i pavarur, në të kundërt, paraqet një ndikim pozitiv në përfitueshmërinë e bankës, i shprehur ky i fundit nga një koeficient  $\beta$  5.628. Kjo tregon që një rritje me një njësi në normën e mjaftueshmërisë së kapitalit do të rrisë përfitueshmërinë ROE me 5.628 njësi, kur variabli tjetër i pavarur, pra norma e kredive me probleme NKP mbahet e pandryshuar.

Rëndësia statistikore e këtij variabli, e përcaktuar nga treguesi P-value, është 0.067, përsëri lehtësisht më e madhe se niveli i përzgjedhur i sigurisë 0.05, dhe që do të thotë se variabli CAR mund të parashikojë përfitueshmërinë ROE me një probabilitet 93.3%.

Në tabelën tjetër, ku paraqiten rezultatet për regresionin në tërësi, treguesi  $R^2$  me një vlerë 0.549 tregon nivelin e parashikimit të variablave CAR dhe NKP mbi përfitueshmërinë ROE; kjo vlerë do të thotë që 55% e variablit ROE mund të parashikohet nga norma e kredive me probleme dhe norma e mjaftueshmërisë së kapitalit që mban banka. Në këto nivele të këtij treguesi mund të thuhet që ekziston një lidhje midis përfitueshmërisë dhe menaxhimit të rrezikut të kredisë për bankën e marrë në studim, Credins sha. Për më tepër, vlera e treguesit  $R^2$  i rregulluar 40%, që është një vlerë më e besueshme për analizën e modelit, përsëri tregon për një nivel parashikimi të kënaqshëm.

Sipas tabelës së shpërndarjes së Fisherit, vlera kritike për një nivel besueshmërie 5% dhe me shkallë lirie përkatësisht  $df_1 = 2$  dhe  $df_2 = 5$ , është 5.77, ndërkohë që rezultatet e analizës SPSS paraqesin një vlerë 3.05, e cila është më e vogël se vlera kritike, pra statistikisht modeli i regresionit nuk është i rëndësishëm, por nga ana tjetër treguesi P-value për modelin është 0.135, i cili tregon se të dy variablat e pavarur (CAR dhe NKP) së bashku parashikojnë përfitueshmërinë ROE me një probabilitet 86.5%, pra tregon për një lidhje të rëndësishme midis përfitueshmërisë dhe menaxhimit të rrezikut të kredisë.

Për të përmbledhur analizën, të dy variablat e pavarur NKP dhe CAR ndikojnë në përfitueshmërinë e bankës në drejtime të kundërta, pra rritja e NKP ndikon negativisht dhe rritja e CAR ndikon pozitivisht.

## **Konkluzione**

Rezultatet e marra nga testimi i modelit të regresionit treguan që ka një ndikim të normës së kredive me probleme dhe të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit në përfitueshmërinë e bankës së marrë në studim në një nivel të arsyeshëm besueshmërie.

Pra, mund të them që strategjia e menaxhimit të rrezikut të kredisë që ndjek banka, përcakton nivelin e përfitueshmërisë në një masë të konsiderueshme. Faktori ose variabli që ka më shumë peshë në këtë ndikim është norma e kredive me probleme, por dhe norma e mjaftueshmërisë së kapitalit luan një rol të rëndësishëm. Sidoqoftë, nëse i njëjti model regresioni do të testohej dhe për banka të tjera, ndoshta dhe duke bërë një ndërrurje midis grupeve në të cilat ato janë klasifikuar (G1, G2, G3), rezultatet e marra do të ishin të një spektri më të gjerë dhe mund të përfshinin rezultate të ndryshme, si p.sh. variablat e zgjedhur të mos ishin statistikisht të rëndësishme për parashikim, modeli të mos rezultonte i qëndrueshëm në rast se  $R^2$  do të dilte në vlerë negative etj.

Strukturat e bankave mund të ndikojnë në mënyrën që ato zgjedhin për të menaxhuar rrezikun e procesit kreditues dhe si rezultat norma e kredive me probleme do të përfshinte vlera të ndryshme, që nga ana tjetër do të ndikonin në rezultatet e regresionit.

## ***Referenca***

### *Libra*

Anerson. D.R & Sweeney. D.J & Williams. T.A.: Statistics for business and economics, 10th edition, Distribution Table, (2008)

Briscoe. A: The regulation of banking in Europe, (2001)

Bryman, Allan., Bell, Emma: Business Research Methods. Second Edition, Oxford University Press, (2007)

Gerhard. S.: Risk management and value creation in financial institutions, Illustrated edition, Published by John Wiley and Sons (2002)

Jean-Charles Rochet: Why Are There So Many Banking Crises? Princeton University Press (2008)

Joel Bessis: Risk Management in Banking, John Wiley&Sons (1998)

Joetta Colquitt: Credit risk management: hoë to avoid lending disasters and maximize earnings, 3rd edition (2007)

*Artikuj akademikë*

Blum, Jurg: Do capital adequacy requirements reduce risks in banking?  
Journal of Banking and Finance, Vol.23, 1999, faqe 755–771

Brewer III E., Jackson III E. W.: A note on the “risk-adjusted” price–  
concentration relationship in banking. Journal of Banking & Finance, Vol. 30,  
2006, faq 1041–1054

Demirguc, Kunt, A. & Huizinga, H.: Determinants of commercial bank  
interest margins and profitability: Some international evidence. World Bank  
Economic Review, Vol. 13, 1999, faq 379–408. *Raportë vjetore*

Raport vjetor, Banka Credins 2003-2011

Raport vjetor për aktivitetin kreditues, Banka e Shqipërisë 2004-2011

Raport Risku, Mjaftueshmëria e kapitalit dhe menaxhimi i rrezikut të  
kredisë 2006 - 2009

*Burime interneti*

*A.E. Feldman Associates, Inc., US Consulting firm report “On financial  
crisis and its effect”*

An Explanatory Note on the Basel II IRB Risk Weight Functions, [http://  
www.bis.org/bcbs/irbriskweight](http://www.bis.org/bcbs/irbriskweight), hapur me 2009-03-14

## *Roli i marketingut në mjedisin konkurrues të porteve detare*

---

■ *Dokt. Merita Murati*

---

■ *Dokt. Sonila Berdo*

---

**Abstract.** *The management of the sea ports in the economy is becoming complex and challenging due to the many changes in the macroenvironment which are creating a high competition.. Three approaches used by seaport management in attempts to overcome these challenges are examined – value adding, co-opetition and the use of technology to gain cost efficiencies. These approaches are insufficient by themselves in a high competitive environment. In particular, highlights by benefits of seaports undertaking a services based approach to marketing and of being market oriented. In addition, a number of services marketing strategies are recommended using the expanded marketing mix as a foundation. These recommendations are illustrated through their placements in the seaport industry which has essential part of its activity a wide range services.*

**P**ortet detare përballen me shumë sfida të ekonomisë, të krijuara nga reforma qeveritare dhe liberalizimi, të tjerat nga përparimet teknologjike në sektorin e transportit dhe komunikacioneve, si dhe ato që rezultojnë nga ndryshime të tilla, si globalizimi dhe barrierat më të ulëta të tregtisë.

Që portet detare të dalin nga ombrella mbrojtëse e sektorit publik si biznese të tregut, në mjedisin e trazuar dhe konkurrues tipik të ekonomisë, janë të nevojshme strategji të reja për të ruajtur dhe rritur biznesin e tyre. Edhe pse portet mund të fitojnë mjaftueshmëri operative nga zhvillime të tilla si përdorimi i teknologjisë dhe infrastrukturës së re, kapacitetet e tyre mund të mbeten të pashfrytëzuara. Sfida mbetet për të tërhequr dhe mbajtur sa më shumë ngarkesë, që është një detyrë e vështirë në një mjedis konkurrues.

Qëllimi është të shqyrtojmë mjedisin konkurrues brenda së cilës veprojnë portet detare dhe të sugjerojmë se pse marketingu mund të jetë një strategji e dobishme për rritjen e biznesit në një mjedis të tillë. Në veçanti, do të nxjerrim në pah të mirat e porteve të bazuar në shërbime të marketingut, si dhe përfitimet e të qenit të orientuar nga tregu.

## **Mjedisi konkurrues i porteve detar dhe ekonomia**

Ky seksion ekzaminon presionin e madh konkurrues me të cilin përballen portet detare dhe përpjekjet e bëra për të kapërcyer këto presione, për të mbajtur dhe/ose për të rritur ngarkesat. Diskutimi mbi ekonominë në drejtim të krijimit të një mjedisi konkurrues është duke u intensifikuar më tej nga reformat qeveritare. Kjo ka rezultuar në kalimin në korporata të porteve detare dhe në inkurajimin e investimeve të sektorit privat dhe të menaxhimit, duke rritur edhe presionet konkurruese. Ekonomia tenton të karakterizohet nga përmirësimet teknologjike në transport dhe komunikacion, liberalizimi dhe privatizimi brenda industrive, dhe përdorimi në rritje i bashkimeve dhe blerjeve, të gjitha të intensifikuara nga ndryshimet e makromjedisit në drejtime të tilla si globalizimi dhe barrierat më të ulëta të tregtisë.

Edhe pse teknologjia e informacionit dhe komunikimit janë bazë për lindjen e ekonomisë së re, shërbimi i informacionit ekonomik sugjeron se tipari më i rëndësishëm është ai i konkurrencës në rritje. Si rezultat i superkonkurrencës, në çmim dhe cilësi, luftërat e çmimeve janë të zakonshme. Kjo është nxitëse, kompanitë kërkojnë tregje të reja, si një mjet për të rritur të ardhurat, ose për të formuar aleanca strategjike me konkurrentët në përpjekjet për të konkurruar në mënyrë më frytdhënëse me kompanitë më të mëdha dhe më të fuqishme.

Është e njohur gjerësisht se portet detare në mbarë botën janë duke vepruar në një mjedis gjithnjë e më konkurrues, gjë e cila është intensifikuar

nga efektet e ekonomisë dhe një kërkesë në rritje për eksportet dhe importet në tregun ndërkombëtar. Kjo ndodh për shkak të faktorëve të tillë si globalizimi, përdorimi në rritje i marrëveshjeve të tregtisë rajonale, liberalizimi i tregtisë, dhe vendeve të botës së tretë që janë duke u hapur në tregtinë ndërkombëtare. Ashtu si po rritet në mënyrë të vazhdueshme vëllimi i tregtisë, po rritet dhe rëndësia e porteve detare në ekonominë globale, për shkak se pjesa më e madhe e importeve dhe eksporteve duhet të lëvizin nëpër to. Për këtë arsye, për manaxhimin e porteve detare është bërë e nevojshme të kuptohen ndryshimet e makromjedisit dhe të jenë në gjendje të njohin konkurrentët potencialë dhe partnerët për të siguruar një të ardhme fitimprurëse dhe të qëndrueshme.

Ndryshimet e makromjedisit për portet, përveç rritjes së tregtisë ndërkombëtare, përfshijnë çështje të tilla si industria specifike e konteinerizimit, rritje e madhësisë së anijeve, investimet e mëdha në infrastrukturë të specializuar, dhe fuqia në rritje e tregut të linjave të transportit detar. Këto çështje janë duke kontribuar në konkurrencën për mallra ndërmjet porteve detare në baza rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Përveç kësaj, konkurrenca është duke u rritur më tej nga reforma e qeverive në sektorin portual, që kërkon një qasje të komercializuar për menaxhimin e porteve detare në secilin vend. Për të mundësuar transportin në rritje të tregtisë detare rreth globit, konteinerizimi është duke u bërë më i zakonshmi. Si rezultat, industria detare po përballlet me ndryshime revolucionare. Portet detare kanë vlerësuar se, nëse ndërmerret një investim i rëndësishëm për t'u kujdesur për mallra të konteinerizuara dhe anije të mëdha, përparësitë e mëparshme konkurruese të tyre përfundojnë.

Ashtu si me shumë industri të tjera që veprojnë në një mjedis konkurrues, aleancat strategjike dhe bashkimet brenda transportit detar janë duke u bërë më të zakonshme. Kjo është veçanërisht e dukshme në numrin e aleancave mes linjave të transportit detar. Kjo është një arsye tjetër për racionalizimin e rrugëve tregtare. Për shembull, kompanitë e anijeve janë në gjendje që të bëjnë kërkesa më të mëdha për përmirësime në infrastrukturën portuale dhe objektet për të siguruar që ata të mbeten një port i kërkuar, veçanërisht nëqoftëse ky i fundit nuk është në një lokacion optimal. Pra, është e qartë se anijet e mëdha, rrugët dhe modelet tregtare të ndryshuara, si dhe kërkesat e subjekteve të specializuara për trajtimin e ngarkesave, të gjitha janë ndikuar nga administrimi dhe operacionet portuale.

Ndryshimet në pronësinë portuale dhe drejtimin e tyre për shkak të reformave së qeverive, janë gjithashtu ngjarje për konkurrencën. Qeveritë në shumë vende të tilla, si Mbretëria e Bashkuar, Kanadaja, Irlanda, Europë dhe Australi po përpiqen për të racionalizuar sektorin portual. Objektivi kryesor

i reformave ka prirje për të mundësuar porte frytdhënëse dhe konkurrese, si dhe zvogëlimin e varësisë nga shteti. Në vendin tonë, për shembull, për të kryer ndryshimet në menaxhim dhe pronësi, portet detare kanë lëvizur nëpërmjet një procesi të komercializuar. Roli publik i sektorit portual shfaqet në zhvillimin e infrastrukturës, për të kryer një rol rregullator në lidhje me sigurinë detare dhe mjedisin, lehtësimin e tregtisë dhe marketingun e portit detar.

Argumenti për lëvizjen drejt korporatave është që portet detare të bëhen më të frytshëm dhe më të aftë për të konkurruar në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Më konkretisht, përfitimet përfshijnë përshtatjen e një qasjeje komerciale për menaxhimin e porteve detare, fleksibilitet dhe frytshmëri më të madhe në portin detar dhe treg, rritjen e shërbimeve portuale në sektorin privat për të fituar përparësi në kosto, dhe të bëhen me klient-të përqendruar dhe treg -të orientuar. Këta porte detare priren të jenë përqendruar në kryerjen e shërbimeve me frytshmëri, si një mjet për të rritur në shkallën më të lartë përfitimet tregtare dhe ekonomike të komunitetit.

## **Marketingu: Një strategji për bizneset në rritje dhe presionit në rritje të konkurrencës**

Janë duke u përdorur tre qasje për të tërhequr më shumë ngarkesë, portet detare ende mund të kenë kapacitet të pashfrytëzuar. Për shembull, në sektorin shqiptar portet janë shoqëri aksionere me aksioner të vetëm shtetin, sektori është më i madh se niveli ekzistues i tregtisë. Në mënyrë të ngjashme, raportojmë kapacitete të pashfrytëzuara në терминаlet europiane, që rezultojnë në një mjedis gjithnjë e më konkurrues. Raporti i njëjtit në Kanada. Nëse portet detare bëhen më frytdhënës, por mbeten kapacitete të pashfrytëzuara, sfida mbetet për të tërhequr më shumë xhiro mallrash, që është një detyrë e vështirë në një mjedis konkurrues.

Marketingu është një mjet i frytshëm për të rritur biznesin dhe të ardhurat, duke e bërë të plotë përdorimin e kapaciteteve të pashfrytëzuara. Kur përshpejtohet konkurrenca e tregut, marketingu bëhet më i rëndësishëm. Marketingu është sugjeruar gjithashtu si një funksion i rëndësishëm i autoriteteve portuale, kur rriten lehtësimet në tregti. Në praktikë, megjithatë, kjo është e vështirë për t'u aplikuar. Për shembull, sfida nuk është vetëm për të tërhequr klientët, por edhe për të mbajtur konsumatorët ekzistues. Kjo mund të arrihet me anë të strategjive të frytshme të marketingut, të cilat mund të ndikojnë në perceptimet e përdoruesve për shërbimet portuale të ofruara. Për



të realizuar përdorimin efikas të objekteve, portet detare tani janë në gjendje të mbështeten në mbajtjen e klientëve bazuar në pozicionimin historik të tregut. Mbështetja në një pozitë monopoliste apo edhe gjeografike, gjithashtu, është duke u eliminuar si një përparësi e qëndrueshme konkurruese.

Murphy vëren se në lidhje me portet, disa monopole vazhdojnë të mbeten të pandryshueshëm me kalimin e kohës. Të konsideruar si rob të mallrave, portet detare janë të detyruar për të konkurruar.

Me transformimin e ekonomisë është shfaqur konkurrenca e cila rezulton në formimin e strukturave të marketingut brenda porteve shqiptare dhe zhvillimin e menaxhimit të tregut të orientuar. Nëse marketingu është ndërmarrë seriozisht, portet detare do të jenë në gjendje për të përballuar kërkesat shtesë të mjedisit të ri, si ata që konkurrojnë me njëri-tjetrin, si ata që konkurrojnë me portet detare në vendet fqinjë.

## **Përfitimet e marketingut**

Zbatimi i strategjive të marketingut është vlerësuar gjerësisht si një çelës për konkurrencën dhe rritjen afatgjatë. Një numër në rritje i studiuesve tani identifikojnë nevojën e marketingut si kriter për suksesin e një organizate dhe arritjen e objektivave të korporatës. Marketingu është sugjeruar, gjithashtu, si një mjet i qëndrueshëm për të fituar përparësi konkurruese (gjatë kohës së inflacionit të ulët, kostove dhe produkteve në rritje) - të gjithë këto janë faktorët që ndikojnë në aktivitetin e porteve.

Një dekadë më parë, u sugjerua që menaxhimi i porteve duhet të bëhet më i vetëdijshëm për përfitimet e ndërmarrjes së marketingut dhe të zhvillojnë strategji agresive të tregut për të kompensuar sfidat e mjedisit konkurrues. Është nevojë në rritje marketingu nga portet detare, për shkak të ndikimit të tij pozitiv në rrjedhën e parasë, përfitimet, nivelet e prodhimit, tregut dhe imazhit të përgjithshëm.

Kjo është pasqyruar në thënien se marketingu “duhet të konsiderohet po aq i rëndësishëm me funksionet e tjera të menaxhimit”. Në mënyrë të ngjashme janë shprehur se marketingu është tani një funksion thelbësor i menaxhimit portual. Marketingu është rekomanduar si thelbësor për mbijetesën e porteve detare dhe si një prej aktiviteteve më kritike të një porti.

Edhe pse disa nga pretendimet e mësipërme janë bërë deri në një dekadë më parë, duket nga literatura ekzistuese se portet detare rreth botës nuk kanë miratuar seriozisht praktikën e marketingut. Marketingu detar deri më sot ka tërhequr vëmendje minimale dhe kërkime të cekta apo empirike. Rezultati është se kontributi i rëndësishëm i marketingut për portet duket se ka ende për t'u vlerësuar plotësisht përmes testimit të vazhdueshëm.

## **Orientimi i tregut të porteve**

Kërkuesit kanë argumentuar se marketingu përfshin më shumë se ndërmarrja e një sërë aktivitetesh, dhe duhet të trajtohet nga perspektiva e të qenit një filozofi e përgjithshme e biznesit, ku orientimi nga tregu është një objektivi. Të qenit të orientuar nga tregu është themeli për ndërtimin e një përparësie të qëndrueshme konkurruese, që ka lidhje me ecurinë e biznesit, përfitimet, kënaqësinë e konsumatorit dhe mobilizimin e punonjësve. Përveç kësaj, të qenit të orientuar drejt tregut përmirëson performancën e biznesit në organizata të mëdha dhe të vogla, nëse ato prodhojnë produkte të prekshme apo shërbime.

Bizneset që janë të orientuar drejt tregut shpesh kanë karakteristika të ngjashme. Sugjerohet se në këto biznese, kërkimi i tregut është ndërmarrë si të klientët dhe konkurrentët, dhe gjetjet përfshihen brenda një sistemi informacioni të tregut; zhvillimi i produktit dhe risitë udhëhiqen nga marketingu; dhe strategjitë janë zhvilluar për menaxhimin afatgjatë të marrëdhënieve me klientët, bazuar në segmentet e tregut, targetimin dhe pozicionimin.

Edhe pse argumenton se është e dobishme që menaxheri i marketingut / specialist, t'i raportojë drejtpërdrejt zyrtarit kryesor ekzekutiv (CEO), të paturit e përkrahjes dhe përkushtimit të menaxhimit të lartë për kënaqësinë e konsumatorit dhe planin e marketingut, është gjithashtu një faktor i madh i suksesit. Një konsideratë e madhe për orientimin e tregut të biznesit është arritja e fitimit, jo vetëm rritja e shitjeve. Orientimi nga tregu është duke u bërë i njohur si i nevojshëm për një port që të jetë i suksesshëm, sepse zhvillon veprimtari tregtare me fokus në rritjen e pjesës së tregut, duke tërhequr më shumë mallra. Organi që menaxhon portin e Roterdamit, është një shembull specifik i një porti me orientim të tregut. Plani i tij i biznesit shpjegon se rritja e orientimit të tyre drejt tregut dhe pozicionimi i portit detar si një partner për komunitetin e biznesit portual, janë dy çështje të përditshme për portin detar.

## Strategjitë e shërbimeve të marketingut për portet detare

Një mjet i frytshëm për të përmbushur kërkesat e konsumatorëve dhe objektivat organizative, është zhvillimi dhe zbatimi i strategjive të marketingut. Duke qenë të orientuar nga tregu, një prej strategjive që përqëndrohet në konkurrentët dhe klientët e sotëm potencialë, është strategjia e korporatave. Strategjia e marketingut, megjithatë, ka prirje të jetë një strategji funksionale, e cila kur është e integruar me strategjitë e tjera funksionale, të tilla si menaxhimi i burimeve njerëzore dhe financa, përmbledhen nga strategjia e korporatës.

Ashtu si strategjitë funksionale implementohen në strategjinë e korporatës, shpjegohen strategjitë nënfunkionale për të zbatuar strategjitë funksionale. Në rastin e strategjisë së marketingut, si nënstrategji funksionale, i referohet variablave të marketingut miks, që për produktet fizike në përgjithësi përbëhet nga zhvillimi i produktit dhe menaxhimi, çmimi, promovimi dhe vendi (e njohur edhe si “shpërndarje”). Miksi i marketingut, ose më saktë miksi tradicional i marketingut, është i njohur zakonisht si 4P si referencë shkronjave të para të çdo elementi (produkt, çmim, promovion, vend). Strategjia e marketingut është zhvillimi dhe zbatimi i marketingut miks. Sfida strategjike qëndron në përzierjen e çdo elementi të marketingut miks, për të formuar një qëndrim koheziv.

Shumë studiues sugjerojnë miks tradicional të marketingut si një kornizë strategjike për përfaqësimin joadekuat në tërësinë e shërbimeve, sepse produktet-shërbim zotërojnë karakteristika të ndryshme (të tilla si ndryshueshmëria, paprekshmëria, pazezrvueshmëria dhe pandashmëria e prodhimit dhe konsumit) nga produktet fizike. Ky realizim ishte rezultat i debateve të shumta gjatë viteve formuese të disiplinës së shërbimeve të marketingut dhe është raportuar gjerësisht në të gjithë literaturën.

Pranimi i shërbimeve që zotërojnë karakteristika të ndryshme në krahasim me produktet fizike, ka pasur një ndikim të thellë në strategjitë e marketingut për bizneset e shërbimit. Rezultati ka qenë zgjerimi i strategjive të marketingut të produkteve fizike dhe zhvillimi i konsideratave të reja për të lejuar dallimet. Këto karakteristika, të paprekshmërisë në veçanti, formojnë barrierat e hyrjes për bizneset e shërbimit. Shembuj të tillë si identifikimi i reputacionit, marka, dhe marrëdhëniet e vendosura me klientët të zhvilluara nga reklamat dhe komunikimi gojor, shfaqen si pengesa që mund të jenë të vështira për konkurrentët, për të replikuar. Për shumë vite, miksi tradicional i marketingut ka qenë i njohur si thelbi i marketingut. Megjithatë, për shkak të zhvillimit të Amerikës së Veriut dhe theksin e tij të fortë kryesisht në drejtim

të mallrave të konsumit, ka shqetësime se miksi tradicional i marketingut nuk është lehtësisht i transferueshëm në format e tjera të marketingut, të tilla si për bizneset e shërbimit, apo mjediset e marketingut në vende të tjera. Një numër studiuesish kanë sugjeruar të shtohen elementë shtesë në miksin e marketingut, për të kapërcyer kufizimet e tij.

Shtimi i elementëve strategjikë të prekshëm, procesi dhe pjesëmarrësit në miksin tradicional të marketingut të 4P, për të formuar përzierjen e zgjeruar të marketingut ose 7P. Gjithashtu propozohen disa modifikime të 4P origjinale për të pasqyruar nevojat e ndryshme të shërbimeve. Duke bërë këto ndryshime, kërkohet të sigurohet qasje gjithëpërfshirëse në menaxhimin e biznesit të shërbimit portual. Edhe pse ka pasur thirrje për testimin empirik, përzierja e zgjeruar e marketingut është pranuar gjerësisht si një kuadër që identifikon elementët shtesë që duhet të merren parasysh për zhvillimin e strategjive të marketingut për bizneset e shërbimit. Sipas literaturës së limituar të marketingut të porteve, një numër prej tyre përpiqen të zbatojnë konceptet më të zbatueshme për marketingun e produkteve fizike, që nuk mund të jenë të përshtatshme për portet që bëjnë përpjekje për të ofruar shërbime.

## **Konkluzione dhe rekomandime**

Portet detare në ekonomi përballen me shumë sfida, disa krijuar nga qeveria, të tjerat të krijuara nga konkurrentët brenda të njëjtës industri dhe ato që rezultojnë nga makromjedisi i gjerë. Portet detare po dalin nga ombrella mbrojtëse e sektorit publik, dhe për të ruajtur dhe rritur biznesin e tyre, janë të nevojshme strategjitë e reja. Ashtu si shumë biznese të shërbimeve të tjera, aftësia për t'iu përgjigjur me shpejtësi ndryshimeve të tregut dhe prirjeve ndërkombëtare, të qenit inovativ dhe sipërmarrës, dhe të orientuar nga tregu, do të bëhen karakteristika për porte detare të suksesshme.

Marketingu është duke u bërë një aktivitet i nevojshëm menaxhimi portual, për shkak të ndryshimeve në makromjedis dhe efekteve të konkurrencës. Orientimi drejt tregut dhe agresiviteti me klientët, tërheqja dhe mbajtja e tyre, nuk mund të jetë një zgjedhje, por një domosdoshmëri për portet.

Kërkimi mbi marketingun portual, edhe pse në një fazë embrionale, është në zhvillim. Shkalla e shfaqjes, megjithatë, po ndodh me një shpejtësi më të lartë për praktikuesit në sektorin portual, se sa në qarqet akademike. Si rritja e konkurrencës dhe vlera e shtuar e vendosur për lehtësimin e tregtisë (pratikuesit dhe qeveritë do të bëhen më të interesuar në mënyrën se si portet detare mund të rrisin të ardhurat dhe xhirot e ngarkesave), barazpeshojnë çështje të komuniteteve lokale.

Nga kundërshtitë ndërmjet praktikuesve dhe studiuesve mbi atë çfarë përbën marketingu në portet detare, literatura e marketingut të porteve do të përftojë përkufizimet e koncepteve kyç të marketingut, që do të zbatohen për portet. Përpjekjet më të mëdha të përbashkëta mes praktikuesve dhe studiuesve, mund të ndihmojnë për të rritur të kuptuarit e nevojave të sektorit portual. Organizata të ndryshme mund të ndërmarrin lehtësisht zhvillimin e kërkimeve dhe shpalljes së rezultateve, duke përfshirë diskutimet nxitëse në fushën e marketingut edhe në konferenca për sektorin portual. Një qasje e tillë mund të lejojë grumbullimin e njohurive të marketingut për të zhvilluar dhe për të kapërcyer pauzën që ekziston mes praktikës dhe kërkimit.

## ***Bibliografia***

American Association of Port Authorities (2000) "Industry information", American Association of Port Authorities,

(<http://www.aapa-orts.org/industryinfo/portfact.htm>), accessed 9 May 2003

Akimova, I.: Development of market orientation and competitiveness of Ukrainian firms, *European Journal of Marketing*, 34 (9/10), 2000, fq.1128-1148

Alderton, P. M.: *Port Management and Operations*, London: LLP Reference Publishing (1999)

Atkinson, R. D. and Court, R. H.: *The New Economy Index: Understanding America's Economic Transformation*, Washington, DC: Progressive Policy Institute (1998)

Baird, A. J.: An investigation into the suitability of an enclosed seaport for cruise ships: The case of Leith, *Maritime Policy and Management*, 24 (1), 1997, 31-43

Baird, A. J. Port privatisation: Objectives, extent, process, and the UK experience, *International Journal of Maritime Economics*, 2 (3), 2000, 177-194

Booms, B. H. and Bitner, M. J.: Marketing strategies and organizational structures for service firms. In *Marketing of Services*, Eds. J. Donnelly and W. R. George, Chicago: American Marketing Association, 1981, pp. 47-51

Branch, A. E.: *Elements of Port Operation and Management*, reprint edn., London: Chapman and Hall, 1997

Branch, A. E.: *Maritime Economics: Management and Marketing*, 3<sup>rd</sup> edn., Cheltenham United Kingdom: Stanley Thornes, 1998

Brooksbank, R. W.: Successful marketing practice: A literature review and checklist for marketing practitioners, *European Journal of Marketing*, 25 (5), 1991, 20-29.

Buckley, P. J., Pass, C. L. and Prescott, K.: The internationalization of service firms: A comparison with the manufacturing sector, *Scandinavian International Business Review*, 1 (1), 1992, 39-56

Bureau of Transport and Communications Economics: Adequacy of Transport Infrastructure: Seaports, Working Paper 14.3, Canberra: Australian Government Publishing Service, 1995

Whitaker, C.: Wnsuring long-term sustainability of our ports: What should we be doing today as an investment for tomorrow?, Paper presented to Pan Pacific 2002, 14-16 October, Oakland, California, 2002, pp. 1-18

Winkelmans, W.: Strategic seaport planning: In search of core competencies and competitive advantage, *Ports and Harbors*, April, 2002, 17-21.

Wired Digital (2000) Encyclopedia of the new Economy, (<http://hotwired.lycos.com/special/ene>), accessed 3 January 2001

Wotton, J. H.: *Port planning and design*, Proceedings of the Inaugural International Conference on Port and Maritime R&D and Technology, vol. 1, 29-31 October 2001, Singapore, pp. 13-20

Bureau of Transport and Regional Economics: Australia's Seaborne Containerised Freight: Forecasts to 2010-11, Working Paper 50, 2002, Canberra: Commonwealth of Australia

Bureau of Transport Economics: Regional Impact of Ports, Report 101, 2000, Canberra: Bureau of Transport Economics

Cahoon, S. C.: Seaport Marketing: A Census of Australian Seaports, unpublished PhD thesis, 2004, Tasmania, Australia: University of Tasmania

Cañamero, C.: UNCTAD activities in the field of ports and their future, *Maritime Policy and Management*, 27 (1), 2000, 65-70

Chang, T. Z. and Chen, S. J.: Market orientation, service quality and business profitability: A conceptual model and empirical evidence, *Journal of Service Marketing*, 12 (4), 1998, 246-264

Conduit, J. and Mavondo, T.: How critical is internal customer orientation to market orientation, *Journal of Business Research*, 51 (1), 2001, 11-24

Cowell, D.: *The Marketing of Services*, reprint edn., Oxford: Butterworth-Heinemann, 1993

Everett, S.: Corporatization: A legislative framework for port inefficiencies, *Maritime Policy and Management*, 30 (3), 2003, 211-219

## *Kontributi i turizmit në zhvillimin e qëndrueshëm dhe ndikimet ekonomike, mjedisore dhe sociale të tij*

---

■ Veronika DURMISHI, PhD

---

**Abstract.** *Tourism industry is not a single activity, but a collection of very special activities and related products that include: transportation, accommodation, food, service, drinks, cultural entertainment, conventions and trade shows, sports etc... All these activities come together in the production and consumption of tourism, starting with hotel accommodation as a major tourism activity and consumption, followed by suppliers of inputs needed for immediate consumption. Tourism also establishes relationship with construction companies, manufacturers of equipment and uniforms. Tourism can be seen as an economic activity that produces a range of positive and negative impacts, but sustainable tourism seeks to achieve the best balance between economic benefits and environmental and social costs. In order to successfully plan and develop tourism, economic impacts, social and environmental aspects of tourism should be well understood. Strategy for a well-managed tourism leads to an increase in private sector investment*

*and economic growth. The more such local connections there are, the more depth can be economic growth of a country of tourism, and the less the economy will rely on imported inputs. The main purpose of this paper is to show, through statistical analysis of the questionnaires, how tourism contributes to the sustainable development of the local community by using as an example the comparison with Albania, Dubrovnik in Croatia.*

*Problems of the paper:*

- How tourism contributes to the sustainable development of local communities?*
- What are the economic, social and environmental tourism in Albania?*
- What should follow the example of Albania to have a sustainable tourism Dubrovnik it is based on cultural tourism, or it based on mass tourism?*
- What are the trends in the number of tourists in the future in Albania?*
- Is there a risk of overcrowding and pollution to these places?*

**T**urizmi është një komponent madhor në rritjen ekonomike dhe është në një masë të madhe i varur nga mjedisi. Marrëdhëniet turizëm - mjedis kanë zënë një vend të rëndësishëm në studimet mbi turizmin vitet e fundit.

**Çfarë turizmi pritet të zhvillohet në Shqipëri?** Është e vështirë të përcaktohet një linjë e qëndrueshme, pasi turizmi është një dukuri gjithmonë e re dhe e ndryshueshme, por është e sigurt që linjat e zhvillimit të ardhshëm të turizmit janë të lidhura me një kulturë të re, të thellë, të aftë për ta çuar njeriun drejt rikuperimit të rrënjëve dhe identitetit të tij dhe për t'i bërë raportet e tij me mjedisin natyror, njerëzor dhe social, sa më pak të paparashikuara, por të vetëdijshme dhe të organizuara. Një alternativë e turizmit është ekoturizmi, si modeli i një zhvillimi të qëndrueshëm të turizmit, sepse grupon tipe të ndryshme të turizmit rreth një nocioni të përgjithshëm që është mjedisi natyror.

Edhe pse ka ndikime negative ekonomike, sociale dhe mjedisore, turizmi ende ka një ndikim të rëndësishëm pozitiv në komunitet dhe kontribuon në zhvillimin e tij të qëndrueshëm.

## **Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik**

Zhvillimi i qëndrueshëm është përcaktuar në mënyra të ndryshme. Ndoshta përkufizimi më i njohur është: “*zhvillim që plotëson nevojat e së tashmes pa kompromentuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar*



nevojat e tyre“.<sup>1</sup> Ekonomia e re reflekton kërkesën në rritje në mbarë botën për mënyra të reja të jetës ekonomike, duke ruajtur Tokën dhe burimet e saj, si dhe fuqizimin e njerëzve për të plotësuar nevojat e tyre dhe nevojat e të tjerëve. Në thelb, koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm është i ndërthurur me konceptin e kapacitetit bartës. Shqetësimet e ndryshme për shoqërinë tonë të tanishme janë për shkak të veprimeve të pamatura prej qenieve njerëzore, për të ndihmuar qëndrueshmërinë.

Zhvillimi i qëndrueshëm integron tre faktorë të rëndësishëm të qëndrueshmërisë: problemet ekonomike, sociale dhe mjedisore. Këto shtylla mund të përshkruhen si tre rrahë të mbivendosur në një diagramë Venn, për të përcjellë idenë se këto aspekte të qëndrueshmërisë nuk janë reciprokisht ekskluzive, por reciprokisht të ndërvarura. Ky model tregon se shoqëritë dhe ekonomitë janë të varura nga bota natyrore.

Sipas autorit të mjedisit, Jonathon Porrit: *”Ekonomia është, në radhë të parë, një subsistem i shoqërisë njerëzore ... i cili është në vetvete, në radhë të dytë, një subsistem i tërësisë së jetës në Tokë (biosferë). Dhe nuk ka subsistem që mund të zgjerohet përtej kapacitetit të sistemit të përgjithshëm që ajo është pjesë”*,<sup>2</sup> ose ekonomisti i Bankës Botërore Amerikane Ekologjike Herman Daly, i cili pyeti: *“Çfarë është një sharrë pa një pyll?”*.

Karta e Tokës shkon përtej përcaktimit të qëndrueshmërisë, dhe kërkon të përcaktojë vlerat dhe drejtimin e nevojshëm për ta arritur atë: *“Ne duhet të bashkohemi së bashku për të lindur një shoqëri të qëndrueshme botërore bazuar në respektin për natyrën, të drejtat universale të njeriut, drejtësinë ekonomike, kulturën dhe paqen. Drejt këtij qëllimi, është e domosdoshme që ne, popujt e Tokës, të deklarojmë përgjegjësinë tonë për njëri-tjetrin, për komunitetin më të madh të jetës, dhe për brezat e ardhshëm”*.<sup>3</sup>

## **Ekonomia globale dhe zhvillimi i qëndrueshëm**

Popujt dhe qeveritë e Europës kanë një rol të madh në evolucionin e mëtejshëm të qeverisjes së ekonomisë globale gjatë viteve të ardhshme. *“Ne si brez mund të ndihmojmë në formimin e politikave ekonomike globale dhe institucioneve, në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm. Ne mund të tregojmë se jemi të angazhuar për të riorientuar mënyrën tonë të jetës drejt zhvillimit të qëndrueshëm, të sigurojmë që aktivitetet tona kombëtare dhe europiane në*

---

1 - *The New Economics of Sustainable Development* by James Robertson.

2 - Jonathon Porri.

3 - *The New Economics of Sustainable Development* by James Robertson.

*sferat e investimeve dhe tregtisë ndërkombëtare të kontribuojnë në ndihmë të zhvillimit të qëndrueshëm*”.<sup>1</sup>

Ja disa sfida që duhet të kalojë shoqëria njerëzore globale:

**a.** Shoqëria moderne është duke kaluar nëpër një transformimi rrënjësor, pasqyruar në shumë probleme institucionale e kulturore dhe në inovacione konstruktive sociale dhe eksperimentale.

**b.** Përkeqësimi i krizës kombëtare dhe globale, problemet mjedisore, sociale dhe dështimet institucionale ndoshta janë parë më së miri jo si “probleme” të veçanta që do të trajtohen me “zgjidhje” specifike teknologjike, menaxheriale, apo legjislativë, por si simptomat e një çrregullimi bazë.

**c.** Ndryshimet thelbësore që duhet të bëhen në mënyrë të pashmangshme, do të çojnë në përqëndrime të mëdha të pushtetit në shoqërinë moderne, veçanërisht institucionet financiare, të biznesit dhe të qeverisë.

## **Turizmi si pjesë e zhvillimit të qëndrueshëm**

Turizmi është një proces në vazhdim dhe një nga sektorët me rritje më të shpejtë ekonomike në botë, i cili është zgjeruar në mënyrë dramatike gjatë 50 viteve të fundit dhe është bërë një industri globale. “Edhe pse ka qenë i nënvlerësuar mjaft kohët e fundit, turizmi ka qenë prej kohësh një komponent qendror i zhvendosjes ekonomike, sociale dhe kulturore, që ka lënë gjurmët e tij në sistemin botëror të qyteteve në dy dekadat e fundit” (Dumont 2005). Sipas statistikave të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), ka pasur një total prej 693.000.000 ardhjesh turistike në të gjithë globin. Për më tepër, OBT parashikon se deri në vitin 2025 do të ketë mbi një miliard ardhje. Në nivel evropian, turizmi është një nga sektorët më të mëdhenj ekonomikë dhe i takon industrisë më të mëdhe të rëndësishme të shekullit të 21. Mesdheu është numri një në botë për sa i përket destinacionit turistik, dhe rajoni më i madh i turizmit në botë, i cili do të vizitohet nga 655.000.000 deri në vitin 2025 (235-355.000.000 në rajonin bregdetar). Kroacia dhe Turqia janë dy vende europiane dhe mesdhetare, ku turizmi konsiderohet shpesh si e ardhmja e tyre ekonomike, pasi ai kontribuon dukshëm në PPB dhe normat e punësimit. Përveç kësaj, Kroacia dhe Turqia janë renditur ndër qytetet europiane dhe rajonet urbane që janë të nxitur për zhvillimin e turizmit. Po ashtu edhe Shqipëria në këto 20 vitet e demokracisë ka rritur përpjekjet e saj për të nxitur një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në përgjithësi dhe turistik në veçanti.

---

1 - *The New Economics of Sustainable Development by James Robertson.*

Turizmi nuk është një aktivitet i vetëm, por është një grumbullim i shumë aktiviteteve të veçanta dhe të ngjashme, që përfshijnë: transportin, strehimin, ushqimin, shërbimet, pijet, argëtimin kulturor, konventat dhe panairët tregtare, sportin dhe rekreacionin. Përveç kësaj, aktivitetet që janë kritike për suksesin e turizmit përfshijnë shërbimet financiare, telekomunikacionin, shërbimet shëndetësore dhe të tjera, të tilla si: energjinë, ujin, sigurinë, rendin dhe ligjin. Të gjitha këto aktivitete të gjera vijnë së bashku në prodhimin dhe konsumin e turizmit, duke filluar me akomodimin në hotel, si një veprimtari kryesore e turizmit dhe e konsumit, e duke vazhduar më tej me furnizuesit e inputeve që janë të nevojshëm për konsum të menjëhershëm, të tilla si mish dhe peshk, prodhimet e qumështit, të perimeve dhe të pijeve. Gjithashtu turizmi vendos marrëdhënie me kompanitë e ndërtimit, me prodhuesit e pajisjeve dhe të uniformave.

Sa më shumë lidhje të tilla lokale të ekzistojnë, aq më e thellë mund të jetë rritja ekonomike e një vendi prej turizmit, dhe aq më pak ekonomia do të mbështetet në inputet e importuara.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme për zhvillimin e vendeve që kanë përjetuar rritje të papunësisë në vite. Industritë nxjerrëse dhe prodhuese, për shembull, krijojnë vende pune më pak krahasuar me turizmin, i cili mbështet aktivitete që përfshijnë një numër relativisht të lartë dhe gjysëm të kualifikuar, sidomos punëtorët femra. Gjithashtu, turizmi përfshin një gamë të madhe të ndërmarrjeve, nga ato mikro deri tek ato transnacionale, sepse turizmi është një sektor me efekte të gjera ndërsektoriale. Pikëpamja se turizmi mund të përbëjë një kontribut thelbësor në zhvillimin ekonomik dhe social të vendeve në zhvillim, po fiton vrull për shkak të asaj që është përshkruar si një “linjë e qetë, por e rëndësishme”, për shkak të potencialit që mund të ketë në rritjen ekonomike dhe uljen e varfërisë (ODI, 2006). Për shembull, në një leter të kohëve të fundit nga Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Afrikën (UNECA) është deklaruar: “Si një industri, [turizmi] është labourintensive; është më pak e rrezikuar se sektorët tradicionalë, por është jo ciklik, ka një efekt katalitik në pjesën tjetër të ekonomisë, por ka pengesa të ulëta të hyrjes dhe krijon më shumë punë gjinore në fjalë se sa në sektorët e tjerë. Më e rëndësishme është se, duke u ndërtuar mbi pasuritë natyrore dhe kulturore, ajo mund të arrijë të ulë varfërinë në zonat rurale ku varfëria është e ashpër”.<sup>1</sup>

Konsumatorët e turizmit udhëtojnë në vendet ku shërbimet e turizmit janë të gatshme, e kjo e rrit mundësinë për lidhje të vlefshme në vendin pritës,

---

<sup>1</sup> - *Some aspects of financial crisis influence on tourism industry in west Balkan countries, Igor Mladenović, Aleksandar Zlatković.*

krahasuar me konventa të tregtisë ndërkufitare të mallrave. Kjo për shkak se turisti është i pranishëm fizikisht dhe për këtë arsye është në gjendje të konsumojë mallra dhe shërbime, të cilat janë ekuivalente me eksportet. Gjithashtu, turizmi është një industri ku, pasi biznesi ka filluar, të ardhurat mund të rrjedhin relativisht shpejt dhe në aktivitetet e tjera ekonomike.

Nga ana tjetër, turizmi është një sektor jashtëzakonisht i ndjeshëm ndaj goditjeve të jashtme, qoftë ekonomike, mjedisore apo politike. Por turizmi ka dhe efekte negative. Efektet negative të turizmit në komunitet mund të jenë drastike. Vendet në zhvillim duhet të nxjerrin një mësim se turizmi duhet të menaxhohet me kujdes, nëse ai duhet që të kontribuojë në krijimin e vendeve të reja të punës dhe të të ardhurave, dhe të luajë një rol në eliminimin e varfërisë, pa çënuar ekonominë lokale, mjedisin, traditat dhe burimet kulturore.

## **Ndikimet e turizmit**

Ndikimet më të rëndësishme janë kontributi i madh i turizmit në GDP dhe shkallën e punësimit. Turizmi mund të shihet si një aktivitet ekonomik që prodhon një gamë të ndikimeve pozitive dhe negative, por turizmi i qëndrueshëm kërkon të arrijë balancën më të mirë midis përfitimeve ekonomike dhe kostove sociale e mjedisore. Në mënyrë që të planifikojmë dhe të zhvillojmë me sukses turizmin, ndikimet ekonomike, aspektet mjedisore dhe sociale të turizmit duhet të kuptohen mirë. OBT, Këshilli i Turizmit dhe Këshilli i Tokës përcaktojnë turizmin e qëndrueshëm si: *“Zhvillim që plotëson nevojat e turistëve të pranishëm në rajonet pritëse, duke mbrojtur dhe rritur mundësinë për të ardhmen. Kjo është parashikuar si orientim për menaxhimin e të gjitha burimeve në mënyrë të tillë që nevojat ekonomike, sociale dhe estetike mund të përmbushen duke ruajtur integritetin kulturor, proceset thelbësore ekologjike, diversitetin biologjik dhe sistemet e mbështetjes së jetës. Produktet e turizmit të qëndrueshëm janë produkte të cilat janë operuar në harmoni me komunitetin, mjedisin lokal dhe kulturat, në mënyrë që këto të bëhen përfitues dhe jo viktimat e zhvillimit të turizmit”*.

Sipas këtij përkufizimi, turizmi i qëndrueshëm ka tri aspekte të ndërlidhura: mjedisore, socio-kulturore, dhe ekonomike. Turizmi i qëndrueshëm duhet të përfshijë përdorimin optimal të burimeve, minimizimin e ndikimeve ekologjike, kulturore dhe sociale, si dhe maksimizimin e përfitimeve për ruajtjen e komuniteteve.

Për më tepër, ata janë duke e parë turizmin si një konsumator të mjediseve natyrore, ndërtesave historike, hapësirave urbane dhe të kulturës lokale, të cilat janë duke u përballur me rrezikun për ta braktisur neqoftëse destinacionet turistike bëhen të mbipopulluara. Ndikimet e të gjitha llojeve të turizmit kryesisht varen nga kapaciteti fizik dhe kulturor i një vendi për të thithur turistët, por pa u bërë një pengesë në jetën e përditshme. Prandaj, kryeqytetet e mëdha mund të thuhet se i absorbojnë ndikimet e turizmit më lehtë se sa qytetet dhe komunitetet e vogla. Llojet e ndikimeve në turizëm janë:

#### a. Ndikimet ekonomike

Turizmi ka një shumëllojshmëri të ndikimeve ekonomike, të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Turistët kontribuojnë për shitjet, fitimet, punësimin, të ardhurat nga taksat dhe të ardhurat e një zone. Efektet e drejtpërdrejta ndodhin brenda ndërmarrjeve kryesore, hotele, restorante, transport, zbavitëse dhe të tregtisë me pakicë. Efektet indirekte përfshijnë furnizimin e bizneseve me të gjitha mallrat dhe shërbimet e nevojshme lidhur me turizmin. Kjo do të thotë se, nëpërmjet efekteve indirekte, turizmi ndikon tek sektorët e tjerë të ekonomisë.

Turizmi luan një rol të rëndësishëm në shumë ekonomi dhe kontribuon në masë të madhe në PBB. Megjithatë, është e vështirë për të përcaktuar masat lidhur me turizmin dhe të ardhurat e tij totale. Si rezultat, industria vuan nga një problem kredibiliteti. Kontributi i industrive konvencionale, të tilla si bujqësia apo prodhimi, tek PPB matet me anë të ofertës.

#### b. Ndikimet sociale

Ndikimet sociale dhe kulturore të turizmit kanë nevojë për një shqyrtim të kujdesshëm, pasi mund të ndikojnë pozitivisht ose negativisht mbi komunitetin. Fluksi i turistëve sjell vlera të ndryshme për komunitetin dhe një ndikim të jetës familjare. Për më tepër, individët dhe komuniteti mund të përpiqen që të kënaqin turistët apo edhe të imitojnë sjelljet turistike. Ndërveprimi midis banorëve dhe turistëve mund të rezultojë në krijimin e mundësive të reja, ose të kufizimeve të individualitetit. Megjithatë, shumica e ndikimeve sociale të turizmit në Shqipëri janë të lidhura ngushtë me ndikimet ekonomike dhe kjo mund të shihet si pozitive. Interesi vizitor dhe kënaqësia për komunitetin shpesh i bën banorët më mirënjohës të burimeve lokale.

Aktivitetet turistike kanë tendencën t'i bëjnë turistët të jetojnë në një vend më interesant dhe më emocionues.

## **Përfitimet e këmbimit kulturor**

Shpesh turizmi është përcaktuar si një takim mes kulturave të ndryshme. Turistët vijnë me zakonet e tyre dhe tregojnë për banorët lokalë se ndryshimi ekziston. Sipas UNESCO, "larmia kulturore zgjeron gamën e opsioneve të hapura për të gjithë, por është një nga rrënjët e zhvillimit, kuptohet jo thjesht në aspektin e rritjes ekonomike, por edhe si një mjet për të arritur një kënaqësi intelektuale, emocionale, ekzistence morale dhe shpirtërore".

## **Infrastruktura**

Zhvillimi i turizmit shpesh çon në ndërtimin e infrastrukturave të reja. Në shumicën e rasteve, është i lidhur me transportin, ndërtimin e autostradave, të cilat e bëjnë udhëtimin më të shpejtë dhe më të rehatshëm, por dhe mundëson lidhje midis qytetit me pjesën tjetër të vendit.

Turizmi ka ndikuar edhe në frekuencën e linjave të autobusëve, linjat detare dhe ajrore. Edhe pse në terma ekonomikë është e dëshirueshme që të ketë sa më shumë turistë të jetë e mundur, qytetet nuk janë gjithmonë të gatshëm për të akomoduar dhjetë herë më shumë vizitorë në ditë si banorë lokalë gjatë stinës së verës.

## **Rritja e çmimeve**

Flukset e mëdha turistike dhe përfitimi i madh i qyteteve turistike shpesh të çojnë në një rritje të çmimeve të pasurive të patundshme, dhe ndoshta krijimin nga ana e popullsisive të varfra të ndjenjave të zemërimit ndaj turistëve.

Në rajonin e Vlorës çmimet e apartamenteve të ndërtimit të destinuara për turizëm, variojnë nga 800 euro për metër katror në 1600 euro për metër katror, duke filluar nga zona e Ujit të Ftohtë dhe duke përfunduar në Radhimë. Ndërsa në zonën e Orikumit këto çmime variojnë nga 450 euro për metër katror në 600 euro për metër katror. Ndërsa çmimet e dhomave të hoteleve variojnë nga 50 euro/nata, në 70 dhe 80 euro/nata në zonat bregdetare.

Kjo rritje e shpejtë e çmimeve të pasurive të patundshme, sidomos në zonën bregdetare të rajonit të Vlorës, do të kontribuojë negativisht në problemin e turizmit.

## **Ndikimet mjedisore**

Zhvillimi i turizmit shkakton ndikime pozitive dhe negative të mjedisit, ndërsa me kalimin e kohës, rritja e numrit të turistëve rrit presionet mbi mjedisin dhe mund të çojë në ndikime të ndryshme negative. Nëqoftëse praktika turistike bëhet më e përhapur, veçanërisht në zonat e turizmit masiv, kapaciteti për të absorbuar një numër të madh të njerëzve është sfiduar nga problemet e mjedisit që kanë tendencë në rritje.

Ndërtime të paplanifikuara dhe të pakontrolluara, urbanizimi i shtrëmbëruar dëmton infrastrukturën joadekuate, mjedisin natyror dhe kafshët e egra, dhe shkaktojnë ndotjen e ajrit dhe të ujit. Përdorimi i tepruar ose keqpërdorimi i vendeve mjedisore arkeologjike dhe historike të brishta, mund të çojë në dëmtimin e mjedisit natyror. Megjithatë, turizmi mund të ketë ndikime pozitive mjedisore, të tilla si rritja e ndërgjegjësimit të njerëzve për mjedisin dhe për të ndihmuar në mbrojtjen e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe historike, ngritjen e vetëdijes vendore lidhur me vlerën financiare të objekteve kulturore dhe me mundësinë e mirëmbajtjes së tyre.

Shpesh turizmi ndihmon për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve lidhur me vlerën financiare të vendeve natyrore dhe kulturore. Ajo mund të stimulojë një ndjenjë të krenarisë në trashëgiminë vendore dhe kombëtare dhe interes në ruajtjen e saj:

## **Përdorimi më i qëndrueshëm i plazheve dhe pyjeve rreth tyre**

Shoqëria duhet të bëjë përpjekje të veçanta për të mirëmbajtur plazhet dhe për të menaxhuar më së miri mjedisin lokal.

Parqet dhe pyjet janë të kërcënuara nga një rrezik i lartë i zjarrit në muajt e verës, si dhe nga shansi për të humbur një pjesë të zonës, pasi shtëpitë janë duke u ndërtuar në mënyrë progresive dhe pa kriter.

Pyjet rreth plazheve sa po vijnë e po zhduken.

## **Konsumi i madh i energjisë dhe ujit**

Sipas Agjensisë Europiane të Mjedisit, hotelet janë forma më e pranueshme ekologjikisht e akomodimit.

Në Dubrovnik shumica e turistëve janë të vendosur në hotele (rreth 80% janë turistë të vendosur në hotele), ndërsa në Shqipëri shumica e turistëve akomodohet në ambiente familjare të marra me qera. Megjithatë, edhe pse hotelet janë forma më e pranueshme ekologjikisht e akomodimit, ata janë ende konsumatorët më të mëdhenj të energjisë elektrike. Sipas ZEE, konsumi i energjisë në vit/m<sup>2</sup> për në një hotel me një yll është 157 kwh, në hotele me dy yje është 230 kwh, dhe në një hotel me katër yje është 380 kwh.

Kjo do të thotë se konsumi mesatar i energjisë në hotele me pesë yje ndoshta është afër 500 kwh. Pra, ne mund të shohim se ky problem nuk duhet të nënvlerësohet. Sipas një studimi të bërë, çdo turist mesatarisht konsumon rreth 300 litra ujë dhe prodhon 180 litra ujëra të zeza në ditë. Në turizmin luksoz, shifrat rriten në konsumin e 880 litrave në ditë.

Përveç konsumit të madh të energjisë dhe ujit, turizmi është gjithashtu konsumator shumë i madh i tokës për ndërtimin e objekteve të akomodimit. Shumë qytetarë lokalë shpesh e shohin turizmin si një burim i mirë të ardhurash.

## **Ndotja e ajrit**

Turizmi është përgjegjës për shkak të një trafiku të dendur ajror, i cili kontribuon ndjeshëm në ndotjen e ajrit. Mesatarisht të gjithë llojet e aeroplanëve të moshave të ndryshme, lëshojnë £ 0,566 të dioksidit të karbonit (RMI 2006).

## **Ujërat e zeza**

Ndërtimet e bëra në zonën bregdetare i derdhin ujërat e zeza në det të papërpunuara. Projekti për ngritjen e një impjanti të përpunimit të këtyre ujërave para se ato të derdhen në det, është lënë i papërfunduar. Sipas një studimi të bërë, zona e plazhit nga Skela deri tek Kalaja është e ndotur, mbi normat e lejuara.




## Tendencat e numrit të turistëve në të ardhmen

Për të analizuar tendencën e prurjeve turistike për të ardhmen, bëjmë një analizë elementare të serive historike në lidhje me prezencat dhe prurjet turistike mujore në Shqipëri për periudhën 2007-2011, mbështetur në një model multiplikativ.

Nr.	PERIUDHA	VIZITORË TË HYRË				
		2007	2008	2009	2010	2011
1	Janar	49437	55635	58640	68997	90712
2	Shkurt	41173	52284	52787	55181	79189
3	Mars	53532	68942	62933	72864	106649
4	Prill	70040	76867	98735	90139	145171
5	Maj	77577	97995	113362	117261	146114
6	Qershor	93533	123249	135740	144663	196704
7	Korrik	201428	251926	469109	565262	670713
8	Gusht	215120	257185	411252	711546	684886
9	Shtator	95148	101461	119358	158545	200486
10	Tetor	75109	91319	100783	128452	149917
11	Nentor	54994	65691	73165	95288	122986
12	Dhjetor	71674	87584	90181	94701	140123
GJITHSEJ		1098765	1330138	1786045	2302899	2733650


Ekuacioni i përdorur në Modelin Multiplikativ është:  $Y_t = 49047 + 2370 * t$



Në terma absolutë, nga të dhënat numerike del qartë se sezonaliteti i turizmit shqiptar me rënie prezencash dhe natyrisht prurjesh, shtrihet kryesisht në periudhën tetor-mars, fakt që tregon nevojën e një politike për desezonalizimin e kërkesës, pra për shpërndarjen e saj në mënyrë më uniforme gjatë gjithë vitit, me metoda administrimi më efikase.

Grafikët e Modelit Multiplikativ tregojnë sezonalitetin e fortë të ardhjeve turistike në muajt e verës, e në veçanti në tremujorin e tretë, dhe gjithashtu tregojnë tendencën në rritje të prurjeve për periudhat e ardhshme.

Ky fakt duhet të nxisë programimin e këtij sektori drejt një oferte më konkurruese dhe të diferencuar, e cila të qëndrojë e tillë gjatë gjithë vitit.



## KONKLUZIONE

Turizmi nuk është një aktivitet i vetëm, por është një grumbullim i shumë aktiviteteve të veçanta dhe të ngjashme që përfshijnë: transportin, strehimin, ushqimin, shërbimet, pijet, argëtimin kulturor, konventat dhe panaiet tregtare, sportin dhe rekreacionin.

Vendet në zhvillim duhet të nxjerrin një mësim se turizmi duhet të menaxhohet me kujdes, nëse ai duhet që të kontribuojë në krijimin e vendeve të reja të punës dhe të të ardhurave, e të luajë një rol në eliminimin e varfërisë, pa çënuar ekonominë lokale, mjedisin, traditat dhe burimet kulturore.

Edhe pse turizmi në shumë vende është industria më e madhe, turizmi është më pak i globalizuar.

Turizmi rezulton me një shumëllojshmëri ndikimesh ekonomike, të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Turistët kontribuojnë për shitjet, fitimet, punësimin, të ardhurat nga taksat, dhe të ardhurat e një zone.

Ndërtimet e paplanifikuara dhe të pakontrolluara, urbanizimi i shtrëm-bëruar dëmton infrastrukturën joadekuate, mjedisin natyror dhe kafshët e egra, dhe shkakton ndotjen e ajrit dhe të ujit.

Përdorimi i tepruar ose keqpërdorimi i vendeve mjedisore arkeologjike dhe historike të brishta, sjell dëmtimin e mjedisit natyror.

Turizmi është një industri e paqëndrueshme dhe tepër sezonale. Punësimi turistik shpesh karakterizohet si një profesion i ulët, i paguar pak, dhe i mungon një qëndrueshmëri afatgjatë.

## ***Bibliografia***

\  
Ana Beban, Huseyin Ok: Contribution of Tourism to the Sustainable Development of the Local Community, 2006

Andrew Seidl: Albania's International Tourists: Final report of an airport survey, 2008

Cali, M., I. Massa, dhe Willem te Velde, D.: Kriza financiare globale: flukset financiare të vendeve në zhvillim, 2008

Igor Mladenović, Aleksandar Zlatković: Some aspects of financial crisis influence on tourism industry in west balkan countries, 2008

James Robertson: A Report for the European Commission "The new economics of sustainable"

Mihali c, T., and T. Dmitrovic: The competitiveness of the Slovenian hotel and travel industry before and after eu entry. In Tour is m and transition, 2000, 259–286.

Ranieri, M.: Foreign Direct Investment in the Western Balkans, Working Paper, Summer School, Cervia, Italy 2007

UNDP 2008: "Report on Seasonal Visitor Surveys Administered at Cultural and Natural Tourism Sites in Albania, Summer 2007"

<http://www.instat.gov.al>

<http://www.wikipedia.org>

<http://www.mtkrs.gov.al>

## ✦ SHOQERORE

### *Rikonceptimi i metodës së mësimdhënies në gjuhën shqipe nga forma globale në atë fonologjike apo rrokjezim*

---

■ *Dokt. Darina MINGA*

---

*Abstract Nowadays, in the age of globalization, integration, intertwine and space restrictions, processes that, according to McLuhan, have transformed the world into a “global village”, nothing, even more communication and the education are like before. Every phenomena, process and system takes a new position by building new socialization concepts and practices. The today society is so dense, that in some aspects can be named global mega society, by transforming the communication process in an overall and catalyzing meta process.*

*In the age of globalization native language takes extraordinary values by being the only characteristics that distinguishes us from the others or as Leopardi states: “Language, the people and the nation that speak this language are the same thing”.*

*Language is the oldest and noblest heritage of a nation. It is the oldest because people that speak it has formed and cultivate the language since entering their own civilization, and it is the noblest because is the first sign of nationality that connects us with our past generations and brings us together with the people of our country even when distant.*

*But what is the importance of respecting the language standards in education when the Albanian Language is facing “DEFICIENCY”?*

*How can we judge present elementary and high school educational system, when knowledge on Albanian Language and Literature have been structured under the same subject.*

*In my opinion it is important to review the curricula because the existing structure under the same subject (Language-Literature) has brought many problems and deficiencies in the standard language education and today it persists as one of the problems that expect solution for a clearer and correct conceptualization.*

*High school and university students as all Albanian society nowadays faces “the dissolution pressure” of the standard language and under continues pressure of: audio-visual and written media (non-standard), dialects, imported words, incorrect structures of syntax etc.*

*With preoccupation we notice that: Present norms of grammar are facing the strong pressure of foreign languages...that is why the main duty is re-establishment of strong requirements on orthography and respecting the standards by showing more attention to EDUCATION.*

*The problem is that education should start from the early stages and demonstrate reliability. I have previously tackled the course of education through the chain: spelling- orthography – critical thinking that responds different phases of education from preschool until university education. This should also be reflected in the new curricula where Albanian language should be divided from Literature. We stand in front of established challenges from the education system to create individuals of a new generation where the foundation stone is the respecting of language standards that passes through the chain spelling- orthography - critical thinking.*

*Children grow up soon and it is the individual of tomorrow’s society that is why we should not forget in any moment that the future society will reflect the present education.*

**S**ot, në epokën e globalizimit, integritit, ndërthurjes dhe ngushtimit të hapësirave, procese të cilat e kanë kthyer botën në një “fshat global” sipas Mc Luhan, asgjë, e aq më pak komunikimi dhe edukimi, nuk është më si më parë; çdo fenomen, proces dhe sistem ripozicionohet duke ndërtuar rishtazi koncepte dhe praktika të reja shoqërizimi. Shoqëria e sotme është aq e ngjeshur, sa në disa aspekte ajo mund të quhet megashoqëri globale, duke e kthyer procesin e komunikimit në një megaproces të gjithëmbarshëm dhe katalizues.

Dhe në këtë epokë globalizmi gjuha amtare merr vlera të jashtëzakonshme, pasi është e vetmja që na dallon, ose siç ka theksuar Leopardi: “*Gjuha, njeriu e kombi që e flet janë pothuajse një gjë*”.

*“Gjuha është mëndesha jonë mendore, është marrja frymë e mendjes dhe e shpirtit tonë si popull, kumbimi i kohës, jo vetëm fjala, por edhe qenësia e shpirtit të atdheut” - thotë De Amicis.*

Gjuha është trashëgimi më i vjetër dhe më fisnik i një populli, është më i vjetri sepse populli që e flet e ka formuar dhe përsosur që kur ka hyrë në rrugën e tij të qytetërimit, është më fisniku sepse është shenja më e parë e kombësisë që na mban lidhur me stërgjyshërit tanë e që na bashkon gjithnjë me njerëzit e me vendin tonë, edhe kur ndodhemi larg.

Po që kur ka filluar puna për standardizimin e gjuhës?

Çdo epokë historike ka fytyrën e vet, ajo ka edhe fytyrën gjuhësore karakteristike për të.

Epoka në të cilën jeton populli shqiptar, është epoka e gjuhës letrare shqipe të njësuar e të përbashkët për të gjithë pjesëtarët e kombit.

Me këtë njësim mori fund përdorimi i shqipes letrare në dy variante dialektore dhe filloi epoka e një gjuhe të vetme letrare me një bazë të gjerë, që është shprehja më e lartë e njësisë njëformëshe të gjuhës së kombit. Kjo gjuhë letrare ka fituar tashmë të gjitha tiparet e gjuhës letrare bashkëkohore të përparuar, në të mund të shprehen vlerat e shumëanëshme të kulturës së sotme kombëtare dhe botërore.

Te gjuha letrare kombëtare dallohen shtatë atribute kryesore, që ndërthuren në një tërësi të pandarë.

**a. Njësimi e normëzimi** (standardizim) në një shkallë e shtrirje të tillë, që e bën shqipen një nga gjuhët letrare më të njësuar të Europës.

**b. Karakteri i vërtetë kombëtar e popullor.** Gjuha letrare kombëtare e sotme i shërben gjithë kombit dhe zotërohet në mënyrë aktive nga shumica e popullsisë, sidomos në trajtën e shkruar. Kjo gjuhë quhet gjuhë popullore. Ky është një tipar i ri që ka fituar gjuha letrare shqipe në epokën tonë.

**c. Karakteri i mëvetësishëm e origjinal.** Ky atribut vihet re që në përmendoret e para të shkrimeve shqipe, të cilat përshkohen nga shqetësimi për fatet e gjuhës amtare; ai u përforcua shumë gjatë Rilindjes dhe ka arritur shkallën më të lartë në ditët tona.

**d. Historizimi par-excellence,** sepse bartësit e saj, si bashkësi etnike e caktuar, e kanë përdorur atë e zhvilluar pa ndërprerë ndër shekuj dhe e ripërtërijnë edhe në epokën tonë, pa e shkëputur nga tradita e trashëguar brez pas brezi. Ky është një historizim i mirëfilltë i së kaluarës, së sotmes dhe së ardhmes.

**e. Homogjenësia.** Tiparet themelore të strukturës fonetike, gramatikore,

leksikore e fjalëformuese dhe strukturës dialektore të shqipes së sotme, mbi të cilat ngrihet gjuha letrare, burojnë nga standardet e mëparshme të zhvillimit të saj dhe nuk janë rrjedhim i ndonjë përzjerjeje sistemesh dhe strukturash heterogjene. Sistemi i shqipes ka trashëguar një aftësi të madhe përvetësuese ndaj elementeve të huazuara, i ka ndryshuar thellë ato dhe u ka dhënë tiparet e veta fonetiko-gramatikore, fytyrën shqipe. Kjo ka të bëjë jo vetëm me huazimet e vjetra, por edhe me të reja. Në këtë proces luajnë rol të rëndësishëm si veçoritë e sistemit fonetik e fonologjik të shqipes, ashtu edhe tipi i saj si gjuhë sintetiko-analitike.

**f. Gjithanshmëria simetrike e funksioneve** (e ashtuquajtura polivalente). Edhe ish variantet letrare kishin deri diku karakter polivalent (por kjo polivalencë nuk ishte simetrike). Gjuha letrare e sotme e ka kapërcyer në vija themelore këtë mungesë simetrie dhe i ka të gjitha mundësitë dhe mjetet për t'i përballuar pak a shumë në të njëjtin rrafsh cilësor kërkesat e të gjitha fushave të veprimtarisë shoqërore.

**g. Jetësia.** Është e pandërprerë dhe gjithnjë në rritje. Gjuha letrare shqipe është krijuar e përdorur gjatë shekujve nga një popull që e ka shqipen gjuhë amtare. Këtë jetësi ajo e ka ruajtur edhe në kohët më të rënda të pushtimeve të huaja dhe e shfaqti në mënyrë të dukshme qysh në epokën e Rilindjes Kombëtare. Rritja e vrullshme e gjallërisë së popullit shqiptar pas çlirimit është pasqyruar edhe në jetësinë e gjuhës. Në këtë gjallëri të popullit e të gjuhës e kanë burimin dhe mundësitë e pashtershme të zhvillimit të ardhshëm të saj.

Këto attribute kanë vlerë cilësore dhe dëshmojnë se shqipja letrare është ngritur në një shkallë të re historike në krahasim me periudhat e mëparshme. Një gur shënues i veçantë në këtë rrugë ishte Kongresi i Drejtshkimit Tiranë 1972. Në Kongres u përvijuan shkencërisht disa prirje të zhvillimit të ardhshëm të gjuhës letrare dhe detyrat që i dalin shoqërisë sonë në lidhje me to. Në vitet pas Kongresit norma gjuhësore është kristalizuar, ngulitur e përhapur më shumë në të gjitha trojet ku jetojnë shqiptarët. Ajo është kodifikuar në një varg veprash themelore, të cilat bashkojnë thellimin e njohurive shkencore për shqipen me qëllimet normative. Këto vepra janë: **Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Fonetika e gramatika e gjuhës letrare shqipe**, të cilat janë bërë sot udhërrëfyese normative dhe mjete të rëndësishme për ngritjen e kulturës gjuhësore të popullit tonë.

Po çfarë rëndësie ka respektimi i standardit të gjuhës në edukim, kur gjuha shqipe po përballet me VARFËRINË?

Vlera e gjuhës standarde në edukim është shumë e rëndësishme. Të gjithë



e dimë se ka norma të sjelljes së njerëzve brenda një bashkësie të dhënë, të cilat quhen rregulla të mirësjelljes. Brenda këtij kuadri “të sjelljes”, të shfaqjes së caktuar, ka edhe norma gjuhësore të cilat duhet të zbatohen nga të gjithë anëtarët e një bashkësie gjuhësore. Ideja e normës dhe e thyerjes së saj (të ndërgjegjshme apo të pandërgjegjshme) është me shumë rëndësi në jetën shoqërore e kulturore të një populli.

Kultura e gjuhës është një pjesë përbërëse e shprehëse e kulturës kombëtare të përbashkët të një populli, prandaj edhe normat gjuhësore i shërbejnë përmirësimit dhe rritjes së peshës ndikuese të kulturës së gjuhës në kuadrin e përgjithshëm të kulturës kombëtare.

Që në momentin kur një bashkësi shoqërore kombëtare zhvillohet e përparon në fusha të ndryshme, në ekonomi, në shkencë, në art, në kulturë etj., natyrisht edhe në politikë, ajo vjen e kompleksizohet dhe, pikërisht për hir të këtij kompleksizimi, ajo ka nevojë për norma të të gjitha llojeve: norma të sjelljes shoqërore, norma të organizimit të punës e të prodhimit, norma të lëvizjes etj., dhe, në këtë kuadër, ka nevojë edhe për norma gjuhësore apo për një mënyrë sjelljeje gjuhësore. Gjuhët standarde apo varietetet normative lindin, kështu, në situata të një shoqërie që ndjen domosdoshmërinë e një komunikimi shumë të gjerë, pa pengesa krahinore, të njëjta e të përbashkëta tejmbanë hapësirës ku ajo gjallon.

Shkrimi i gjuhës dhe të mësuarit e saj në shkollat e një vendi (masivisht dhe si lënda më themelore) është një nga faktorët më të fuqishëm të standardizimit dhe institucionalizimit të saj. Gjuha e shkruar ruan, në të gjitha rastet, një autonomi relative në krahasim me gjuhën e folur. Gjuha në përgjithësi (dhe gjuha standarde në veçanti) nuk është një mjet i komunikimit, por është edhe një institucion me peshë në jetën e shoqërisë.

Atëhere, si duhet të tregojmë kujdes për respektimin e standardit të gjuhës në edukim?

Problemi është se ky edukim duhet të fillojë qysh në fazën e hershme dhe duhet të jetë shumë serioz. Sepse, siç ka theksuar prof.dr. Gjovalin Shkurtaç: *“Gjithçka po privatizohet... Vetëm një gjë ka qenë, është dhe do të jetë kurdoherë e paprivatizuar, e përbashkët dhe objekt bashkarie: gjuha shqipe, gjuha jonë e lashtë, tipari themelor i etnisë dhe i kombit, ajo që na ka dalluar e na paraqet kurdoherë para botës si shqiptarë”*. (Gj, Shkurtaç: **Etnografi e të folurit të shqipes**, fq. 187)

Lidhur me këtë, interesi për të folurit që të rriturit përdorin me fëmijët e vegjël nuk është i ri, ai ka një traditë mjaft të gjerë që fillon qysh në vitet ‘60.

Mënyra e të folurit me fëmijët është quajtur **baby-talk** (Ferguson, 1964) ose edhe **motherese** (Neoport, 1976), përderisa realizohej kryesisht nga nënat, është një dukuri universale, e pranishme në gjuhë të ndryshme dhe që dallohet qartë nga të folurit normal, nga ai i folur që të rriturit përdorin me të rriturit e tjerë e dhe me fëmijët më të rritur në moshë. Kështu fëmija përvetëson gjuhën nëpërmjet imitimit të të folurit që e dëgjon në mikromjedisin e tij të përditshëm (mjedisi familjar dhe kopshti, edukimi parashkollor), shprehja gjuhësore është rezultat i këtij mikromjedisi, i shfaqur në një akt identiteti.

Kur mikromjedisi gjuhësor e ushqen fëmijën me një të folur të qartë e të kujdesshëm, fëmija i kapërcen më shpejt vështirësitë në të folur. Kjo është përvoja që ne kalojmë të gjithë me formimin gjuhësor të fëmijëve tanë nga faza e hershme në fazën e rritur, e sa më të formuar gjuhësisht të jenë fëmijët në këtë kalim drejtshqiptim-standard, aq më të sigurtë do të ecin në rrugën e formimit si individë të suksesshëm të një shoqërie që kërkon dhe shpreson integrimin.

Por ky edukim parashkollor paraqet mjaft probleme dhe, kur fëmija edukohet me një drejtshqiptim të qartë dhe të saktë në mjedisin familjar, ndodh që kur shkon në mjedisin e kopshtit e folura e fëmijës deformohet si rezultat parasëgjithash i moskujdesit të edukatoreve, e ata të ndodhur nën presionin e të folurës së fëmijëve të tjerë të pakultivuar dhe me ndikim të dukshëm të dialektit, nuk i kushtojnë rëndësinë e duhur fazës së drejtshqiptimit të saktë tashmë të kthyer në detyrë. Ky problem sjell dëme në formimin gjuhësor të mëtejshëm, kur fëmija kalon në edukimin 9-vjeçar dhe në stadin e drejtshkrimit, duke kujtuar këtu se një drejtshqiptim i pasaktë sjell dhe një drejtshkrim të tillë.

Një problem tjetër për sistemin arsimor 9-vjeçar dhe parauniversitar, është se në këto vite është përpjekur të strukturojë në një lëndë të vetme njohuri të gjuhës shqipe dhe të letërsisë (sigurisht standardin), por kjo ka hapur probleme dhe mangësi në formimin gjuhësor standard. Ky strukturim në integrim të gjuhës dhe letërsisë ka lënë shumë për të dëshiruar dhe sot paraqitet si një nga problemet kryesore që pret zgjidhje për një konceptim sa më të saktë e më të qartë. Në këto vite është vënë re se nxënësit nuk po mësojnë mirëfilli as letërsi e as gjuhë shqipe. Struktura e tekstit është ndërtuar mbi bazën e llojeve të teksteve dhe përqindjeve përkatëse, si p.sh. në lëndën gjuhë shqipe dhe letërsi klasa 12: teksti informues - shpjegues 15%, teksti përshkrues 10%, teksti argumentues 10%, eseja 10%, teksti kulturologjik 10%, teksti tregimtar 15%, teksti poetik 15%, teksti dramatik 15%... dhe brenda këtyre njohurive përfshihen ushtrime, punë me projekt, testime...

Është një ngarkesë që nuk justifikohet dhe praktikisht nuk sjell dobi kur nxënësi përafërsisht studion tekstin joletrar për 17 javë mësimore dhe më pas testohet për kryesisht formim letrar në një provim shtetëror, kur dy lëndët duhet të ishin të ndara dhe duheshin konceptuar më thjesht dhe më saktë, me qëllim që edhe formimi gjuhësor dhe ai letrar i nxënësve në sistemin parauniversitar të rezultonte më i suksesshëm.

Individi i sistemit parauniversitar, ashtu si gjithë shoqëria shqiptare, sot gjendet përballë “trysnisë së prishjes” së gjuhës e standardit që gjendet nën presionin e vazhdueshëm të:

- medias vizive e të shkruar
- depërtimit të fjalëve të huaja
- dialektit
- strukturave jo të sakta sintaksore
- gjuhës së facebook-ut

Kjo e fundit karakterizohet për shkurti, shpejtësi, ligjërim të fshehur dhe është përhapur shumë te brezi i ri, duke sjellë dëm në formimin gjuhësor si psh.

- Flm - faleminderit
- Klm - kalofsh mirë
- Tdsh - të dua shumë
- Mrz - mërzit
- Tkxh - të kam xhan
- X - për
- Tjt - tjetri
- Skgj - s'ka gjë
- Det - detyrat
- Msg - mesazh
- Sh - shumë
- Shmr - shumë mirë
- Shkr - shkruaj
- Tlt - të lutem
- Cpb - çfarë po bën
- Vër8 - vërtet
- Nlhr - ndonjëherë
- Srz - seriozisht
- Pz - për Zotin
- Vtm - vetëm
- Kr - kur
- Fr - fare
- Qt ms prs - Që të mos pres

Nsr - nesër

Xca - për çfarë

Jdmsj - jo se do të mësoj

Nshp tr dtn - në shtëpi gjithë ditën

Wtf - çfarë po ndodh....etj.

Zakonisht gjuha e facebooku-t shmang përdorimin e zanoreve.

Norma e sotme po ndeshet me trysinë e fortë gërryese të gjuhëve të huaja, sidomos të gjuhëve që dallohen shumë nga natyra e shqipes, si anglishtja, gjuhë kryesisht idiomatike, që nuk ka as lakim emrash, as zgjedhim foljesh dhe në përdorim dëmton stukturën e fjalisë shqip. (Tipi i thënieve: takimi me Clinton, fjalimi i Bler, në vend të takimi i Klintonit, fjalimi i Blerit etj).

Një tjetër problem është vërshimi i fjalëve të huaja në gjuhën shqipe dhe në jetën e përditshme, si pasqyrim i asaj çfarë lexojmë dhe çfarë dëgjojmë në median e shkruar e vizive. Shpesh dëgjojmë fjalë të tilla si: multilaterale e bilaterale, në vend të shumëpalëshe, dypalëshe; rurale, në vend të fshatare, e fshatit; bipartizan, në vend të dypalësh ose i dy partive etj. Këtu është vendi të përmendim një vlerësim të lartë që Ernest Koliqi bën për gjuhën: *n'egërsi, tash të buta deri n'amëlsi, të majtuuna e të turrëshme, qi shpirti i Shqiptarëve burra ushqen herë pas here. Gjuha shqipe asht e bukur pse asht burrnore e prandaj fisnike, zemërake.*

Ndaj detyrë urgjente është vendosja e kërkesave të rrepta për drejtshkrimin dhe kjo pikësëpari duhet të nisë me **edukimin**, duke u shoqëruar me disiplinën e shtetit dhe institucioneve shtetërore e shoqërore për zbatimin e drejtshkrimit të njësuar të shqipes.

Ndërkohë që koha sjell sfida ndaj individit në nivel parauniversitar e universitar, për të kaluar nga respektimi konkret i standardit drejtshqiptim – drejtshkrim - mendim kritik (argumentimin e problemeve të ndryshme me qëllim bindjen), ku individi mendon në mënyrë kritike mbi njohuritë që merr e deri te shkrimi i esesë, ndërkohë që sistemi i përgatitjes, i trainimit e kualifikimit të mësuesve e pedagogëve, këtë kategori tekstore të rëndësishme, e ka anashkaluar.

Shkrimi i esesë si kategori tekstore nuk është i thjeshtë, veçanërisht kur mendon të shkruash ese në nivel të kënaqshëm, me paragrafë funksionale të qartë, të përshtatshëm e domethënës për natyrën, llojin dhe synimin e esesë. Shkrimi i esesë krijon mundësinë e shfaqjes së kompetencës dhe shprehive të të menduarit kritik dhe krijues.

Të menduarit kritik është një aftësi që arsimit i lartë synon të zhvillojë sot. Dhe nuk ka të bëjë “me atë që mendojmë”, por me mënyrën se si mendojmë.

Mendimi kritik mbart vlerësim dhe formulim sepse përdoret për të vlerësuar mendimet që kemi (ne apo dikush tjetër), ashtu dhe për të formuluar të reja, duke përfshirë logjikën; kështu, të menduarit kritik çon në përfitim të dijeve dhe aftësimin vetjak, për të nxënë aktiv dhe përmirësimin e vetvetes. Detyrë parësore del kujdesi për edukimin, që çon në formim gjuhësor të saktë dhe respektim të standardit.

Gjendemi para sfidave që na vendos edukimi sot për të formuar individin e një kohe të re, ku gur themeli është standardi i gjuhës që kalon nëpër zinxhirin drejtshqiptim – drejtshkrim - mendim kritik.

Nuk duhet të harrojmë se një fëmijë rritet shumë shpejt dhe është individ i shoqërisë së nesërme, ashtu si nuk duhet të harrojmë për asnjë çast se shoqëria nesër do të jetë ashtu si është edukimi sot.

## ***Bibliografia***

Gjinari, J.: Probleme të mësimin të gjuhës letrare shqipe në shkollën tonë, Norma letrare, Tiranë 1973 f. 231

Konomi, V.: Për një fjalor më të kulturuar në skenat e teatrove, Norma letrare, Tiranë 1973, f. 355

Kostallari, A.: Gjuha letrare shqipe dhe drejtshkrimi i saj, Tiranë 1973

Lafe, E.: Probleme dhe detyra në fushën e kulturës së gjuhës, Norma letrare kombëtare dhe kutura e gjuhës, Tiranë 1973, f. 7

Lloshi, Xh.: Dialekti përballë gjuhës letrare, Norma letrare, Tiranë 1973

Shkurtaj, Gj.: Gjuha e veprave dramatike pas drejtshkrimit të njësuar, Norma letrare, Tiranë 1973, f. 349

Domi, M.: Probleme të sotme të gjuhës letrare dhe detyra të kulturës së gjuhës, Gjuha jonë, 1, 1981, fq. 48-55

Lafe, E.: Gjuhësia shqiptare për kulturën e gjuhës, Gjuha jonë, 2, 1981

Dodi, A.: Fonetika dhe dramatika e gjuhës së sotme shqipe, 1, Tiranë 1984

Lafe, E.: Lufta për pastërtinë e gjuhës në kohën tonë, St. Fil., 4, 1984

Dodi, A.: Gjuha e folur letrare dhe norma e saj fonetike në etapën e sotme, Gjuha jonë, 1, Tiranë 1985, f. 71-78

Shkurtaj, Gj.: Modele të pasurisë gjuhësore, Skena dhe ekrani, 2, 1985

Shkurtaj, Gj.: Më pak dialektalizma në skenë dhe në ekran, Skena dhe ekrani, 1, Tiranë 1985

Shkurtaj, Gj.: Modele të pasurisë gjuhësore, Skena dhe ekrani, 2, 1985

Kostallari, A.: Gjuha letrare shqipe dhe epoka jonë, Gjuha jonë, 1, 1986

Kastrati, J.: Konvergenca gjuhësore nga Komisia Letrare te Kongresi i

- Drejtshkrimit, Gjuha jonë, 1-4, 1988, f. 30-40
- Shkurtaç, Gj.: Kultura e gjuhës në skenë dhe ekran, Tiranë 1988
- Lloshi, Xh.: Mbështetje për gjuhën letrare, Tiranë 1997
- Lafe, E.: Gjuha e mediave sot - Probleme dhe detyra, Gjuha jonë, 1-2, 2000, f. 9-21
- Çeliku, M.: Çështje të shqipes standard, SHBLU, Tiranë 2001
- Islamaj, Sh.: Kultura e gjuhës dhe përdorimi estetik i saj, Toena, Tiranë 2002
- Shkurtaç, Gj.: Kultura e gjuhës, SHBLU, Tiranë 2006

## *Dimensioni european i mësimdhënies së historisë në shkollë nga riprodhimi në interpretim të fakteve dhe ngjarjeve historike*

---

■ *Dokt. Desara KARAJ*

---

**Abstract.** *Albanian education in its reform process has as a priority approximation to that of the most developed countries, giving school a European dimension, where long-term skills education remains one of the fundamental goals of achieving the objectives of integration into the society of knowledge.*

*In this context, finding the forms, techniques and practices applicable in the Albanian educational environment has attracted the attention and commitment of researchers in the field of education. In this context, this research takes the size of a study in accordance with today requirements: the integration process, the transformation of education from the transmission of knowledge into the creation and knowledge building and redesigning the history from that of wars and conflicts in the history of civilization and peaceful coexistence.*

*In our educational curricula, on textbooks and teacher ongoing training and qualification has been paid great attention to reproductive teaching and assessment of student achievement, but less work is done with the process and mechanism of children's learning and even less work is done with the education of students' skills on how to work with the text and any other written material for school purpose or not, with educational tasks in general and full and free expression of opinion and interpretation of historical facts.*

*How can the European dimension be achieved in high schools history curricula?*

*Is it a necessity of the formation of citizens in a democratic society?*

*In the current situation, the student faces difficulties and obstacles which was covered by members of the group or has been passive in the process. His involvement at home is forced, oriented to the role of others and are likely not to perform his tasks successfully. So we have a setback or locking in the process of learning, uncertainty, lack of motivation, which leads to lack of ambition on learning and more lack of school attendance.*

*Nowadays goal of education is to educate long-term learning skills, the aim of which is in itself a chance of lifetime learning beyond the school years, becoming so a member of a democratic society in the postmodern period, the society of knowledge.*

***"The main purpose of education is to create men who are capable of doing new things, not simply repeating what other generations have done - men who are creative, inventive and discoverers. Second purpose of education is to form mind that can be critical, can verify, not to accept whatever is given".***

*This statement of Piaget is the primary task of school today. Development of critical thinking among students of all levels should constitute the backbone of the whole system: plans, programs, textbooks, methodology summed up in one word in the concept curriculum.*

*This objective requirement stems from the current trend of development, from the strategic orientation that we Albanians have already defined: Integration into the family of developed nations.*

**A**rsimi shqiptar në procesin e reformimit të tij ka si përparësi përafrimin me atë të vendeve më të përparuara, duke i dhënë shkollës dimensionin european, ku edukimi i shprehive afatgjata mbetet një nga synimet themelore të realizimit të objektivave të integritimit në shoqërinë e dijes. Në këtë kuadër, gjetja e formave, teknikave dhe praktikave aplikative në mjedisin arsimor shqiptar, ka tërhequr vëmendjen dhe angazhimin e hulumtuesve të fushës së edukimit. Në këtë kuadër, ky hulumtim merr përmasat e një studimi në përputhje me kërkesat e kohës: proceset integruese, transformimin e arsimit nga transmetimi i njohurive në ndërtimin dhe krijimin e dijeve dhe rikonceptimin e historisë, nga ajo e luftërave dhe konflikteve në histori të civilizimeve dhe të bashkëjetesës paqësore.



Në praktikat tona të kurrikulave, teksteve dhe trajnimit e të kualifikimit të mësuesve, i është kushtuar shumë vëmendje mësimdhënies riprodhuese dhe vlerësimit të arritjeve të nxënësve, por pak jemi marrë me procesin dhe mekanizmin e të nxënësve të fëmijëve, e edhe më pak me edukimin e shprehive të nxënësve si të punojnë me tekstin dhe me çdo material tjetër të shkruar mësimor ose jo, me detyrat mësimore në tërësi dhe shprehjen e lirë të pikëpamjeve dhe interpretimit e dukurive e ngjarjeve historike.

Ky studim me karakter kërkimor synon të kontribuojë në këtë aspekt të edukimit të shprehive afatgjata përmes përdorimit të metodave ndërvepruese, që kanë në themel hulumtimin, të menduarit kritik dhe krijues, që i nxisin nxënësve dhe i motivojnë për arritje më të larta të karakterit formues, duke formuluar rekomandime me karakter praktik dhe zbatues për arsimin bazë.

Nëpërmjet këtij studimi të bazuar në kërkim, synojmë të ndikojmë në krijimin e kushteve dhe klimës së përshtatshme për edukimin e shprehive afatgjata të nxënësve, nëpërmjet transformimit të teknikës së dhënies nga riprodhim në analizë dhe interpretim të fakteve, të detyrave nga ato me karakter riprodhues dhe faktik, që pothuaj mbizotërojnë në praktikën aktuale.

Në përfundim të studimit do të arrijmë të evidentojmë përmes analizave sasiore dhe cilësore, efektet e praktikave konkrete në përcaktimin e metodave të vlefshme në mësimdhënien e historisë. Mbi bazën e rezultateve të arritura do të formulojmë udhëzime dhe rekomandime për hartuesit e kurrikulave, autorët e teksteve dhe mësuesit, që të mbështeten në një platformë praktike për lëndë e klasa të ndryshme.

Hipoteza: Si mund të arrihet dimensionin europian në kurrikulat e historisë të shkollës së mesme?

A është kjo një domosdoshmëri e formimit të qytetarëve në shoqërinë demokratike?

## **Background'i teorik dhe konteksti i problemit**

Në aspektin teorik, kjo qasje e re e mësimdhënies së historisë bazohet në modelet konstruktiviste dhe social-kognitiviste të të nxënësve, sipas të cilëve dy janë parimet bazë:

a. Të nxënësve është më i qëndrueshëm kur nxënësve përfshihen aktivisht në proces;

b. Nxënësve ndërtojnë dijen duke përpunuar informacionin dhe duke i modeluar sipas përvojave vetjake.

Gjithashtu shtrohen për diskutim disa nga pyetjet më të rëndësishme në kontekst të rishikimit të kurrikulës së lëndës së historisë, që janë:

a. Cilat janë /duhet me qenë qëllimet e mësimimit të historisë?

b. A do të përqendrohemi në shprehi të të menduarit, apo vetëm në përmbajtje: ku qëndron barazpesha?

c. Si mund të shfrytëzohet dhe të përdoret këndvështrimi shumëpërmasor i ngjarjeve, dukurive dhe fakteve historike?

d. Si të nxitet dhe të kultivohen shprehitë e të menduarit kritik?

e. Si të vepohet me çështjet e ndjeshme dhe kontradiktore?

Në një këndvështrim më të gjerë, përmes një kurrikule të konceptuar mbi bazën e pikëpamjeve konstruktiviste dhe të përdorimit në klasë të metodave të të menduarit kritik, atëherë këta faktorë, krahas edhe të tjerëve, do të mundësojnë përgatitjen e nxënësve për shoqërinë e dijes.

Demonstrimi i dijeve të ndërtuara, të krijuara, dhe i shprehive të përvetësuara do të bëjnë të mundur që nxënësit të jenë në gjendje t'i zbatojnë ato në praktikë, duke përdorur materiale burimore të qëmtuara e të skeduar në mënyrë sistematike, bazuar në përvojat, interesat, nevojat dhe këndvështrimin personal. Mësimdhënia bashkëkohore ndihmon në mënyrën sistemore të dijeve dhe të një praktike të suksesshme, të zbatuara në cikle të ndryshme shkollimi. Në vendet e zhvilluara perendimore mësimdhënia e historisë shoqërohet me një material teorik bazë me karakter psikologjik, që bashkëshoqërohet nga materiale teorike më të përgjithshme metodologjike, duke shërbyer edhe si udhëzues që mundësojnë zbatimin e suksesshëm të këtyre metodologjive të reja në kushtet konkrete të klasës.

Në situatën aktuale nxënësi përballet me vështirësi të pakapërcyeshme dhe është mbuluar nga anëtarët e grupit apo ka qenë pasiv në proces, angazhimi i tij në shtëpi është i sforcuar, i orientuar te roli i të tjerëve dhe ka gjasa që të mos i kryejë me sukses detyrat. Pra, kemi një frenim apo ngecje të procesit të të nxënës, pasiguri, mungesë motivimi, e cila çon deri në zvjerdhjen e dëshirës për të nxënë, duke i hequr dëshirën për shkollën.

Qëllimi i sotëm i edukimit është të edukojë shprehi të të nxënës afatgjatë, synim i cili në vetvete përmban shansin e të nxënës gjatë gjithë jetës, përtej viteve të shkollimit, anëtar i shoqërisë demokratike në periudhën post moderne, atë të shoqërisë së dijes.

## **Përkufizimi specifik i problemit**

*“Qëllimi kryesor i arsimimit është të krijojë njerëz që janë të aftë të bëjnë gjëra të reja, jo thjesht të përsëritin ato që kanë bërë brezat e tjerë - njerëz që janë krijues, shpikës dhe zbulues. Qëllimi i dytë i arsimimit është të formojë mendje që mund të jenë kritike, që të mund të verifikojnë dhe jo të pranojnë*

*çdo gjë që u jepet*".<sup>1</sup>

Kjo thënie e Piazhës përbën detyrën parësore për shkollën sot. Zhvillimi i të menduarit kritik të nxënësit dhe studentët, në të gjitha nivelet, duhet të përbëjë shtyllën kurrizore të tërë sistemit: planet, programet, tekstet, metodologjinë, që me një fjalë përmbliken në konceptin kurrikul.

Kjo kërkesë objektive buron nga prirja e sotme e zhvillimit, nga orientimi strategjik që kemi përcaktuar tashmë në shqiptarët: Integrimi në familjen e kombeve të përparuara.

## **Pse unë mendoj kështu?**

Unë kam një përvojë në mësimdhënie në të gjitha nivelet e arsimit dhe problemi i trajtimit të temave në lëndën e historisë ka qenë objekt diskutimi dhe debati midis mësuesve, nxënësve dhe prindërve. Metodologjia bashkëkohore zakonisht zbatohet nga mësues novatorë e bashkëpunues dhe unë besoj jam një prej tyre. Përvoja me organizimin e krijimtarisë së nxënësve, dhe sidomos si trajnere, më kanë dhënë mundësinë ta njoh në thellësi këtë fushë. Për dymbëdhjetë vjet jap mësim në nivelin arsimor parauniversitar, si mësuese e lëndës së historisë, dhe kam mundësinë për ta provuar hipotezën, për të eksperimentuar dhe testuar dhe idetë. Një shtysë tjetër është dhe fakti se unë jap mësim në fakultet, lëndën "Metodologji e mësimdhënies", gjë e cila më mundëson këndvështrime teorike më të plota dhe trajtesa të specializuara të problemit.

Nisur nga ky qëllim, unë e shoh veten time të përfshirë në këtë studim, duke menduar t'i shërbej kërkesës objektive që kemi përcaktuar për zhvillimin e arsimit shqiptar: integrim në familjen e kombeve të përparura.

## **Pse është i rëndësishëm mendimi kritik?**

- Mendimi udhëheq veprimet tona, për rrjedhojë ai duhet të ketë cilësi të lartë.

- Nëse nuk i kemi analizuar asnjëherë në mënyrë kritike bindjet tona, ato realisht nuk janë tonat.

- Të analizosh bindjet, do të thotë të analizosh jetën tënde. Sokrati ka thënë: "Pa u thelluar, jeta nuk ia vlen të jetohet".

---

1 - Fisher 1995, faqe 29.

- Të menduarit kritik konsiston në përcaktimin e bindjeve, të cilat kemi justifikuar për t'i mbajtur, pranimin e këndvështrimeve të reja dhe vlerësimin me drejtësi të mendimeve të tjerëve, si dhe të mendimeve tona.

- Të menduarit kritik plotëson si emocionet, ashtu edhe krijimtarinë tonë.

- Të menduarit kritik është i njëjtë me të menduarit jashtë skemave dhe kuadrateve.

Kështu, metodat për të arritur një shpjegim më të mirë duhet të jenë kërkesë e brendshme e çdo mësuesi.

Mësuesi duhet të jetë në gjendje:

- Të përcaktojë metodën për të arritur në shpjegimin më të mirë dhe të kuptojë ku dallon ajo nga llojet e tjera.

- Të qartësojë çfarë është shpjegimi dhe ku ndryshon nga argumenti.

- Të vlerësojë sesi përdoret metoda e arritjes në shpjegimin më të mirë në disiplinat shkencore dhe në jetën e përditshme.

- Të demonstrojë sesi përdoret metoda e arritjes në shpjegimin më të mirë në situata të ndryshme.

## ***Bibliografia***

Kincheloe, Joe L.: **Knowledge and Critical pedagogy**, Springer, 2008

McKimm, Judy: **Curriculum Design and Development**, 2003

Musai, Bardhyl: **Psikologji Edukimi, zhvillimi, të nxënët, mësimdhënia**, Tiranë, 1999

Mathews, Bob & Ross, Liz: **Research Methods - a practical guide for the social sciences**, Pearson 2010, London

**Strategjia kombëtare e arsimit parauniversitar 2007-2013**

## *Përdorimi i produkteve me qasje të lirë në bibliotekat universitare*

---

■ Erena HASKA , M<sup>n</sup>D

---

**Abstract.** *This article will examine the use of products Open Source (OS) in university libraries in Public Higher Education not only as a positive trend, but as a necessity, in order to realize library processes at a low cost and providing quality and effective services to the academic community.*

**Methodology.** *The methodology used in this paper consists of a combination of primary and secondary sources. Primary sources such as official data on this issue and the opinions of library managers applying open source products are brought in this paper through questionnaires. Also secondary sources are consulted such as domestic and foreign literature in this field, which establishes the basis of the theoretical approach of the paper.*

**Results.** *The results shows that: 1. the use of OS products in university libraries at Public Higher Education is growing; 2. Implementation of integrated library systems OS (ILSOS) and systems for digital libraries OS (SDLOS) has provided access to library institutions regarding finding effective and cost affordable solution to serve the academic*

community; 3. there is no doubt that the application of ILSOS and SDLOS have enriched library activity and significantly improved distance communication with the academic community.

**Conclusions.** *This article brings conclusions that contribute to: a) promote the use of OS products in university libraries, in order to automate their management and increase distance services to the academic community, and b) the application of criteria for evaluation of the ILSOS systems and SDLOS.*

Bibliotekat universitare, si pjesë e rëndësishme e Arsimit të Lartë, duhet të ofrojnë njohuri, krijimtari dhe risi. Parë në këtë këndvështrim, ato i shërbejnë shoqërisë për të krijuar individë që do të kontribuojnë më pas në të gjithë sektorët e tij. Për të përmbushur këtë mision, infrastruktura e shërbimeve në bibliotekat universitare duhet të jetë shumë afër pritshmërive të komunitetit akademik, të cilit biblioteka i shërben, me kushtet dhe teknologjinë e nevojshme që siguron një mjedis për nxënie individuale dhe zhvillim të kapaciteteve shkencore. Në këtë kontekst, bibliotekat universitare përballen me nevojën në rritje për përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), për burime elektronike, për koleksione të dixhitalizuara, për qasje të lirë tek informacioni shkencor, por në të njëjtën kohë edhe të reduktimit të burimeve financiare.

Bibliotekat në përgjithësi shqetësohen rreth kostove me të cilat duhet të plotësojnë kërkesat në rritje të përdoruesve të tyre.

Mes detyrimit të kryerjes së misionit të tyre dhe të drejtës për të funksionuar si qendra të rëndësishme ku njohuria merret, zhvillohet dhe transmetohet, bibliotekat janë gjithmonë në kërkim të metodave, mekanizmave dhe teknologjisë që do të mundësonte menaxhimin koherent të koleksionit të tyre, por edhe me një kosto të ulët.

Në të tilla kushte, produktet me qasje të lirë, ose Open Source (OS), u ofrojnë bibliotekave universitare një zgjidhje shumë tërheqëse në kushtet e një krize ekonomike globale<sup>1</sup>.

Pjesë e këtyre produkteve janë Sistemet e Integruara për Bibliotekat OS (SIBOS) dhe Sistemet për Bibliotekat Dixhitale OS (SBDOS), që janë pjesë e Sistemeve me qasje të lirë (OSS), që ndihmojnë në grumbullimin, ruajtjen, përpunimin dhe aksesimin e materialeve, duke plotësuar në këtë mënyrë një nga objektivat kryesore të institucioneve bibliotekare<sup>2</sup>.

---

1 - A. Payne dhe V. Singh: *Open Source Softwares use in libraries*, 2010, f. 708, në *Library Review*.

2 - *American Association Library, Constitution & Bylaws*, 2006.

SIBOS dhe SBDOS po fitojnë rëndësi në mbarë tregun botëror të programeve kompjuterike në vitet e fundit<sup>1</sup>. OSS është një sistem kompjuterik, ku kodi burimor i tij dhe të drejtat e autorit jepen nëpërmjet një licëse që e përcakton këtë sistem si pjesë të *domain-it* publik<sup>2</sup>.

Ky përcaktim lejon përdoruesin për të përdorur, ndryshuar dhe përmirësuar OSS<sup>3</sup>. OSS zhvillohet nga një publik i specializuar i fushës në mënyrë bashkëpunuese. Termi OSS lindi si pjesë e një fushate marketingu për programet me qasje të lirë<sup>4</sup>.

Në treg ekzistojnë lloje të ndryshme produktesh të njohura si OS. Midis tyre ekzistojnë disa produkte me interes të veçantë për bibliotekat dhe profesionistët e informacionit. Këto produkte kategorizohen sipas qëllimit të funksionit të tyre: **a.** në sisteme të integruara për bibliotekat (SIB), **b.** në mjete për komunikim, **c.** në ndërfaqet për përdoruesit, dhe **d.** në OSS të përcaktuara si sisteme mbështetëse<sup>5</sup>. Këto janë fushat kryesore në të cilat bibliotekat kanë përshtatur teknologjinë dhe zgjidhjet OS.

SIBOS janë sisteme që mundësojnë automatizimin e proceseve të punës në bibliotekë, si katalogimin, hyrjet e reja, blerjet, qarkullimin e koleksionit, kontrollin e serialeve, katalogun e kërkimit për përdoruesit (OPAC). Ndërsa SBDOS janë sisteme që mundësojnë menaxhimin, mbrojtjen dhe kërkimin e koleksioneve të dixhitalizuara në rrjet. Në treg ekzistojnë shumë SIBOS dhe SBDOS, të cilët janë të krahasueshëm me çdo SIB dhe Bibliotekë dixhitale (BD) komerciale<sup>6</sup>.

---

1 - M. Singh dhe G. Sanaman: *Open Source integrated library management systems: comparative analysis of Koha and NewGenLib*, 2012, f. 808, në *The Electronic Library*.

2 - S.P. Muir: *An introduction to the open source software issues*, 2005, f. 465, në *Library Hi Tech*.

3 - M. Krishnamurthy: *Open access, open source and digital libraries: A current trend in university libraries around the world*, 2008, f. 49, në *Program: electronic library and information systems*.

4 - S.P. Muir: *An introduction to the open source software issues*, 2005, f. 465, në *Library Hi Tech*.

5 G. Bissels: *Implementation of an open source library management system-- experiences with Koha 3.0 at the Royal London Homoeopathic Hospital*, 2008, f. 310, në *Program electronic library and information systems*.

6 - K.T. Anuradha, R. Sivakaminathan e P.A. Kumar: *Open - Source tools for enhancing full text searching of OPACs*, 2010, f. 232, në *Program electronic library and information systems*.

Ky artikull ka si synim të vërë në dukje dhe të diskutojë praninë e produkteve OS, që aktualisht implementohen në bibliotekat universitare në Arsimin Publik, me qëllim që të sigurohet një kontekst i përgjithshëm mbi funksionimin e tyre dhe nevojën për studime të mëtejshme mbi produktet OS në fushën e Bibliotekomisë, të hulumtojë arsyet se përse bibliotekat universitare po aplikojnë SIBOS dhe SBDOS. Gjithashtu qëllim i studimit është të informojë bibliotekarët mbi kriteret që duhet të njohin gjatë procesit të përzgjedhjes së një SIBOS dhe SBDOS dhe përfitimet që kanë nga përdorimi i tyre. Në vëmendje të publikut do të sillen SIBOS dhe SBDOS të vlerësuara dhe të çertifikuara në fushën e Bibliotekomisë.

## Metodologjia

Ky artikull është bazuar në pyetësorët të realizuar në 14 bibliotekat universitare në Arsimin Publik. Opinione të bibliotekarëve në lidhje me aplikimin e produkteve OS në bibliotekat universitare janë nxjerrë nëpërmjet pyetësorëve të strukturuar, bazuar në një studim të plotë, dhe shqyrtimit të literaturës të fushës, të mekanizmave referencialë dhe të dhënave të publikuara.

Komunitetet e anketuar janë 14 biblioteka që janë pjesë e universiteteve publike, si: Universitetit i Tiranës: Fakulteti Histori Filologjisë, Fakulteti Juridik, Fakulteti i Shkencave Politike dhe Sociale, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Universiteti i Arteve, Universitetit i Sporteve, Universiteti i Korçës “Fan S. Noli”, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Universiteti i Gjirokastrës “Eqerem Çabej”, Universiteti Bujqësor, Universiteti Politeknik, Universiteti i Durrësit “Aleksandër Moisiu”, Universiteti i Vlorës “Ismail Qemali”. Në rastin kur bibliotekat nuk janë përgjigjur (Biblioteka e Universitetit Politeknik), është konsultuar me faqen e tyre zyrtare në Internet, me qëllimin që të ofrohet një informacion i plotë mbi çështjet e lartpërmendura.

Pyetësori u dërgua në 17 drejtorët ose drejtuesit të bibliotekave universitare, nga të cilët 13 u përgjigjën (76.4%). Shtrirja e studimit është e kufizuar vetëm në bibliotekat universitare të Arsimit Publik. Të dhënat e mbledhura janë paraqitura në tabela.

Gjithashtu literatura koherente e fushës është konsultuar dhe përbën kuadrin teorik të këtij studimi për analizimin e të dhënave empirike të tij.



## Rezultatet

Të dhënat e mbledhura mbi pyetjen se cilët janë SIBOS që përdoren nga bibliotekat universitare, janë treguar në Tabelën 1. Përgjigjet tregojnë që SIBOS që përdoren janë të ndryshme.

Bibliotekat universitare kanë filluar projektet e dixhitalizimit të koleksioneve të caktuara që janë pjesë e trashëgimisë kulturore. Tabela 2 tregon që Biblioteka e Universitetit të Arteve dhe Biblioteka e Universitetit “Luigj Gurakuqi” kanë filluar projektet e dixhitalizimit duke përdorur SBDOS. Biblioteka e Universitetit të Arteve përdor sistemin DSpace për të menaxhuar asetet dixhitale, dhe formatet që përdorin janë: Pdf për filet tekste, MP3 për filet audio dhe MPEG-4 për filet video. Biblioteka e Universitetit “Luigj Gurakuqi” ka filluar dixhitalizimin e një koleksioni që përmban 100 libra, që janë pjesë e një fondi të rrallë me karakter albanologjik, dhe ka ndërtuar një bibliotekë dixhitale nëpërmjet sistemit OMEKA. Skanimi i librave është bërë në formatin DjVu.

Tabela 3 tregon se cilët janë shfletuesit e internetit OS dhe sistemet operative OS që përdoren nga bibliotekat universitare. Rezultatet tregojnë se sistemi operativ që përdoret është Linux dhe shfletuesi është Mozilla FireFox. Shumë njerëz mendojnë se Mozilla është një shfletues më i mirë se Internet Explorer, është më i shpejtë, më shumë në përputhje me standardet dhe me një gamë më të gjerë opsionesh<sup>1</sup>.

Mjetet e komunikimi OS në bibliotekat universitare përdoren gjerësisht. Ky lloj komunikimi ndihmon bibliotekat jo vetëm për të qenë më afër komunitetit akademik edhe në distancë, por edhe për të shkëmbyer informacione, probleme, eksperiencë me kolegët që përballen çdo ditë me të njëjtat shqetësime. Pikërisht llojet e këtyre produkteve OS që përdoren, tregohen në Tabelën 4.

*Tabela 1: Lista e bibliotekave që përdorin SIBOS*

Bibliotekat	SIBOS/Viti i aplikimit
Fakulteti i Histori Filologjik	Jo
Fakulteti Juridik	WinIsis/1999 <sup>1</sup>

*1 - N. Diamant: Breaking the barriers: the role of support companies in making open source a reality, 2010, f. 663, në Library Review.*

Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Politike	Jo
Universiteti i Arteve	Koha/2011
Universiteti Politeknik	Jo
Universiteti i Sporteve	Jo
Universiteti i Korçës	Digilib/2010
Universiteti i Gjirokastrës	JSUS/2005
Universiteti i Elbasanit	Jo
Universiteti i Shkodrës	PMB/2010
Universiteti Bujqësor	Jo
Universiteti i Vlorës	No
Universitetit i Durrësit	Jo
Fakulteti i Shkencave të Natyrës	Jo

*Tabela 2: Lista e SBDOS që aplikohen*

SBDOS	URL	Biblioteka
GreenStone	www.greenstone.org	0
Dspace	www.dspace.org	Universiteti i Arteve
Jompla	www.jompla.org	0
Fedodra	www.fedora.org	0
E-Prints	www.eprints.org	0
DigiLib		Universiteti i Korçës
Omeka	www.omeka.org	Universiteti i Shkodrës

*Tabela 3: Lista e mjeteve të komunikimit OS*

Emri	URL	Përshkrimi	Biblioteka
Blogger	www.blogger.com	Faqe diskutimi informal online	
Facebook	www.facebook.com	Rrjet social online	Universiteti i Arteve
Skype	www.skype.com	Komunikim vizual nëpërmjet PC	Universiteti i Arteve
Chat	www.chat.org	Komunikim online	Universiteti i Arteve
Listserves		Komunikim nëpërmjet email-it me profesionistë të fushës	Universiteti i Durrësit Universiteti i Gjirokastrës

## Analiza dhe Diskutimi

Bibliotekat universitare në Arsimin Publik po tregojnë një prirje në rritje të përdorimit të produkteve OS. Sipas R. Giri<sup>1</sup>, shumë avokatë të përdorimit të kësaj teknologjie në biblioteka, gjejnë ngjashmëri midis parimeve filozofike të shkencës së bibliotekonomisë dhe filozofisë së përdorimit të teknologjisë OS. Gjithmonë sipas R. Giri, ngjashmëria filozofike ka të bëjë me parimin e nxënies, e cila nxitet edhe nëpërmjet shpërndarjes së informacionit. Mbështetësit e përdorimit të produkteve OS në bibliotekat universitare, përveç ngjashmërive filozofike, mendojnë se ekzistojnë edhe arsytet buxhetore, pasi fondet e bibliotekave universitare sa vijnë dhe tkurren, kostot e burimeve rriten, ashtu si edhe rriten kërkesat e komunitetit akademik ndaj shërbimeve që bibliotekat universitare duhet të ofrojnë kundrejt tyre<sup>2</sup>. Në këto kushte, bibliotekat universitare zbatojnë produkte OS, që ofrojnë një mundësi për automatizimin e procesve të punës dhe ndihmojnë bibliotekat për të mbajtur në kontroll kërkesat e përdoruesve ndaj tyre<sup>3</sup>.

Të dhënat e këtij studimi tregojnë se janë 3 biblioteka universitare që përdorin të tilla sisteme. Bibliotekarët pohojnë që kjo tendencë në rritje vjen si pasojë e kostove të ulëta me të cilat këto sisteme mund të integrohen dhe zbatohen. Bazuar në N. Diamant<sup>4</sup>, kjo prirje në rritje vjen si rrjedhojë e disa përfitimeve konkrete, si: **a.** këto sisteme tentojnë të jenë teknologjitë e brezit të ardhshëm, duke i krahasur me sistemet e tjera të ngjashme komerciale; **b.** këto sisteme janë ndërtuar me bazë standardet e hapura dhe të pranuar, duke mundësuar integrimin dhe ndërveprimin e tyre me sistemet e tjera; **c.** përdoruesit e tyre kanë qasje tek kodet burimore të OSS, si rrjedhojë ata mund të zhvillojnë programin sipas nevojave të tyre, ose programues të tjerë mund ta realizojnë këtë për ta; **d.** përdoruesit mund të marrin mbështetjen e një komuniteti përdoruesish në mbarë botën dhe të përfitojnë nga eksperiencat dhe kontributet e tyre gjatë aplikimit të programit; **e.** shmanget varësia nga një provider i vetëm, dhe **f.** kostoja pothuajse zero e këtyre programeve.

---

1 - R. Giri: *NewGenLib 3: An Integrated Open Source Library Management System that Makes your Library Visible in Web*, 2012, f. 3, në *Library Hi Tech News*.

2 - R. Giri: *NewGenLib 3: An Integrated Open Source Library Management System that Makes your Library Visible in Web*, 2012, f. 3, në *Library Hi Tech News*.

3 - N. Dimant: *Breaking the barriers: the role of support companies in making open source a reality*, 2010, f. 663.

4 - N. Diamant: *Breaking the barriers: the role of support companies in making open source a reality*, 2010, f. 663, në *Library Review*.

D.H. Lian Goh dhe të tjerë<sup>1</sup> mendojnë se disponueshmëria e kodit burimor të një OSS lejojnë përdoruesit për ta ndryshuar dhe përmirësuar atë, dhe ndoshta këto kontribute mund të vijnë nga programues të talentuar. Në këto kushte, OSS tentojnë të kenë më shumë funksione në krahasim me programet komerciale, sepse ato zhvillohen nga vetë përdoruesit e OSS, ndërkohë që një kompani komerciale ka si përparësi fitimin, i cili nuk është në të njëjtën linjë me kërkesat e përdoruesve<sup>2</sup>.

Në thellim të këtij këndvështrimi, E.L. Morgan<sup>3</sup> mendon se, për shkak të kodit burimor të hapur, kontributet mund të çojnë në përmirësimin e funksionimit të programit dhe në vazhdim, përditësimet mund të sigurohen me kosto të ulët ose pa kosto. E.L. Morgan<sup>4</sup> mendon se një arsye tjetër e prekshme është edhe kostoja gjithmonë në rritje e SIB komerciale dhe mirëmbajtja e tyre.

Një tjetër gjetje interesante e këtij studimi është që WinIsis e deklaruar në Tabelën 1, ky studim nuk e klasifikon si SIBOS. WinIsis nuk bën pjesë as në SIB, sepse ky sistem nuk përmban modulet si qarkullimin, menaxhimin e serialeve, kontrollin e blerjeve etj. Por gjithashtu nuk bën pjesë as edhe në produktet OS. Kjo pasi kodi burimor i tij nuk është i hapur<sup>5</sup>. Programi CDS ISIS për sistemet operative DOS dhe Windows, është i mundësuar pa pagesë nga UNESCO, por kodi burimor nuk është i ofrueshëm për modifikim<sup>6</sup>. Pavarësisht faktit që ky program mundësohet pa pagesë, që në momentin që kodi burimor i tij nuk është i qasshëm, ky program nuk mund të quhet OSS<sup>7</sup>.

Dallimi i kriterëve të përzgjedhjes së SIBOS dhe SBDOS nga bibliotekat universitare ka qenë një tjetër gjetje e rëndësishme e këtij studimi. Opinione të marra nga bibliotekat universitare të përfshira në pyetësorët, rezultuan që bibliotekat kanë aplikuar të njëjtat kritere për përzgjedhjen e SIBOS, por dhe të SBDOS, dhe konkretisht janë aplikuar kriteret: **a.** programi të jetë i shkarkueshëm dhe i mundshëm për t'u instaluar pa pagesë, **b.** programi duhet të jetë i ndërtuar me bazë standardet të pranuar dhe të njohura në bazë të

---

1 - D.H. Lian Goh dhe të tjerë: *A checklist for evaluating open source digital library softwares*, 2006, f. 362, në *Online Information Review*.

2- M. Breeding, M.: *Open source integrated library systems*, 2008, f. 6, në *Library Technology Report*.

3- E.L. Morgan: *Possibilities for open source softwares in libraries*, 2002, f. 13, në *Information Technology and Libraries*".

4 - E.L. Morgan: *Possibilities for open source softwares in libraries*, 2002, f. 13, në *Information Technology and Libraries*.

5 - A. Birchall dhe A. Hopkinson: *Open Source Software in Higher Education*, 2009, f. 2.

6 - *idem*.

7 - *idem*.

funksionit që programi kryen, **c.** programi duhet të jetë i përputhshëm me platformat e njohura si Linux, Windows etj., dhe **d.** aplikimi i programit nga institucionet e tjera bibliotekare.

M. Singh dhe G. Sanaman (2012) sugjerojnë që kriteret që rekomandohen për përzgjedhjen e SIBOS dhe SBDOS janë të ndryshme për bibliotekat. Përzgjedhja e një SIBOS dhe SBDOS eficient, duhet të bëhet nëpërmjet një kuadri teorik të strukturuar, në mënyrë që bibliotekat të mund të vlerësojnë në tërësi sistemin<sup>1</sup>. Nga studimi u konstatua që bibliotekat universitare nuk janë mbështetur në një vlerësim të planifikuar ose të strukturuar për të vlerësuar sistemet plotësisht. Në disa prej bibliotekave, përzgjedhja midis SIBOS dhe SBDOS u është lënë në dorë informaticienëve.

M. Singh dhe G. Sanaman<sup>2</sup> sugjerojnë që përzgjedhja e SIBOS duhet të bëhet me bazë të 10 kriterëve që për nga rëndësia nuk janë të barabartë, të cilët janë: 1. veçoritë e SIBOS, 2. karakteristikat e përgjithshme të SIBOS, 3. teknologjia e dizenjimit të tij dhe arkitektura, 4. karakteristikat e bazës së të dhënave, 5. modulet kryesore të funksionimit, 6. formatet dhe standardet e implementuara, 7. përmbajtja dixhitale dhe programuese, 8. lehtësia në përdorim dhe në përditësimin e tij, 9. shkarkimet dhe dokumentimi, dhe 10. karakteristikat e tjera që përbëjnë veçantinë e programit.

D.H. Lian Goh dhe të tjerë<sup>3</sup>, sugjerojnë kriteret mbi të cilat bibliotekat duhet të mbështeten për të përzgjedhur një SBDOS: 1. **menaxhimi i përmbajtjes**. Ky kriter lidhet me mënyrën e krijimit, paraqitjes dhe organizimit të përmbajtjes brenda një SBDOS, 2. **ndërfaqja e përdoruesit**. Ky kriter lidhet me fleksibilitetin e ndërfaqes për t'iu përshtatur nevojave të funksioneve të ndryshme të një biblioteke dixhitale dhe në të njëjtën kohë të mbështesë edhe qasje shumëgjuhëshe, 3. **administrimi i përdoruesve**. Ky kriter ka të bëjë me gamën e funksioneve të ndryshme për të menaxhuar nivelet e përdorimit të sistemit nga përdoruesit, 4. **administrimi i sistemit**. Ky kriter lidhet me mënyrën e administrimit të plotë të tij. Funksione si hyrja automatike e materialeve në sistem, gjenerimi automatik i metatave, indeksimi lëndor automatik, standardet e rezervimit dhe identifikimi i dokumentit, transferimi i materialeve dixhitale nga një kompjuter në një tjetër me konfigurim jo të njëjtë etj., dhe 5. **kërkesat e tjera**. Ky kriter lidhet me nevojën që një bibliotekë

---

1 - M. Singh dhe G. Sanaman: *Open source integrated library management systems: comparative analysis of Koha and NewGenLib*, 2012, f. 804, në *The Electronic Library*.

2 - M. Singh dhe G. Sanaman: *Open source integrated library management systems: comparative analysis of Koha and NewGenLib*, 2012, f. 804, në *The Electronic Library*.

3 - D.H.Lian Goh dhe të tjerë: *A checklist for evaluating open source digital library softwares*, 2006, f. 364, në *Online Information Review*.

dixhitale ka për të qenë në ndërveprim me sisteme të tjera me të cilat është e lidhur. Kjo e lejon secilin sistem të përfshihet në mënyrë të pavarur pa sakrifikuar aftësitë e komunikimit midis tyre.

Në fund, dy protokolle bazë të ndërveprimit duhet të mbështeten nga sistemi, si Z39.50 dhe OAI-PMH. Përveç kësaj, një bibliotekë dixhitale duhet të jetë në përputhje me standardet dhe shërbimet dixhitale, si p.sh. standardin XML për riprezantimin e informacionit; XHTML për faqet në web; GIF, TIFF dhe JPG për riprezantimin e imazheve; UNICODE për mbështetje shumëgjuhëshe dhe shkëmbim të informacionit, DUBLIN CORE dhe MARC21 për metadatat dhe të mbështesë kërkimin me tekste të plota. E rëndësishme është që Biblioteka Dixhitale duhet të ofrojë mekanizma nëpërmjet të cilëve, administratorët të mund të marrin ndihmën dhe mbështetjen e nevojshme mbi sistemin. Këta mekanizma përfshijnë dokumentimin, manualët, forumet e diskutimit etj.

Një tjetër gjetje interesante e këtij studimi janë llojet e SIBOS dhe SBDOS që përdoren në bibliotekat universitare. Bazuar në rezultatet cilësore dhe sasiore, marrë nga litetaratura bashkëkohore, Koha në kategorinë SIBOS dhe DSpace në kategorinë SBDOS vlerësohen si dy nga paketat me përdorim më të gjerë në bibliotekat dhe rekomandohen nga studiuesit e fushës<sup>1</sup>. Në kuadër të këtij diskutimi për përdorimin e paketave të integruara për menaxhimin e bibliotekave dhe të bibliotekave dixhitale, le të ndalojmë në disa mendime të studiuesve për këto dy programe. Sipas J. Helling<sup>2</sup> dhe M. Singh<sup>3</sup>, Koha është krijuar në Zelandën e Re nga Katipo Communications Ltd për Horowhenua Library Trust, dhe u instalua atje në vitin 2000. Që nga kjo periudhë, ky sistem i integruar për bibliotekat është implementuar në të gjithë botën. Kompania LibLime është kompania që ka të drejtën e implementimit dhe ofrimit të asistencës teknike të KOHA në bibliotekat. Ekzistojnë versione të ndryshme të KOHA sipas llojit të bibliotekës akademike, bibliotekës publike dhe për bibliotekat speciale me koleksione të madhësive të ndryshme. Përveç faktit që KOHA është një sistem menaxherial i integruar për bibliotekat, që i përmbush të gjitha kriteret më sipër, ka midis të tjerave dhe karakteristikat plotësuese<sup>4</sup>: a. katalogun për përdoruesit me qasje në distancë (OPAC), që

---

1 - K.T. Anuradha, R. Sivakaminathan e P.A. Kumar: *Open –Source tools for enhancing full text searching of OPACs*, 2010, f. 233, në *Program electronic library and information systems*.

2 - J. Helling: *Cutting the proprietar cord: a case studz of one library's decision migrate to an open source ILS*, 2010, f. 702-703, në *Library Review*

3 - M. Singh dhe G. Sanaman: *Open source integrated library management systems: comparative analysis of Koha and NewGenLib*, 2012, f. 814-817, në *The Electronic Library*.

4 - R.A. Egunjobi dhe R. A. Awoyemi: *Library automation with Koha*, 2012, f. 13, në

është i bazuar në teknologjitë web, **b.** ndërfaqe online bazuar në teknologjinë web për qarkullimin e koleksionit, **c.** menaxhimin e të dhënave për përdoruesit e bibliotekës, **d.** rezervim dhe rinovim në distancë të afateve të dorëzimit të librave nga përdoruesit, **e.** komunikim me degët e bibliotekës. Nëse përdoruesi e ka huazuar një libër në njërën nga degët e bibliotekës, procedurat për kthimin e librit në bibliotekë, përdoruesi mund t'i kryejë në çdo degë të saj, **f.** historinë e qarkullimit të materialeve bibliotekare, **g.** mbështetje shumëgjuhëshe gjatë procesit të kërkimit, **gj.** informim të përdoruesve dhe vendosje të gjobave në rastet të shkeljeve të afateve për kthimin e materialeve bibliotekare apo dëmtimin e tyre, **i.** mbrojtje të sistemit nga përdorimet e paautorizuara, dhe **k.** gjenerimi i raporteve dhe statistikave etj.

Bibliotekat dixhitale, ashtu si u theksua edhe më sipër, janë të fokusuara në krijimin e organizimit dhe menaxhimit të koleksioneve multimediale dixhitale, duke ofruar mundësinë e kërkimit, gjetjes dhe shërbimeve të tjera me bazë të një rrjeti kompjuterik<sup>1</sup>. Aktualisht ekzistojnë disa paketa OS për krijimin e bibliotekave dixhitale<sup>2</sup>, si Eprints, Fedora, GreenStone, OMEKA, Dspace, GERN CDSware etj.

Versioni i parë i DSpace është publikuar në muajin nëntor të vitit 2002 dhe, në sajë të zhvillimeve të mëtejshme nga Instituti Teknologjik i Massachusetts dhe Hewlett Packard, kjo paketë përmban funksione të fuqishme për arkivim, kërkim, menaxhim të asetëve dixhitale, skema të metadatave, që e klasifikon atë ndër paketat SBDOS më të mira sot në treg.

Gjetje e rëndësishme e këtij studimi është përdorimi i produkteve OS për komunikim nga bibliotekat universitare, si Facebook, Skype, Chat, Listserves. Sipas A. Payne dhe V. Singh<sup>3</sup>, këto janë mjete komunikimi të përhapura që kërkojnë një instalim të vetëm. Me fjalë të tjera, këto burime nuk kërkojnë qasje në baza të dhënash apo hapësira të veçanta në serverin e bibliotekës. Këto instalime kërkojnë vetëm një motor kërkimi dhe qasje në Internet për të funksionuar. Konstatimi i përdorimit të këtyre produkteve nuk është thjesht një trend komercial apo koherent, por një mundësi për bibliotekat për t'i shërbyer në distancë komunitetit akademik.

---

*Library Hi Tech News.*

1 - Ming-Chen, Ch. dhe të tjerë: *Developing a Taiwan library history digitla library with reader knowledge archiving and sharing mechanisms based on the DSpace*, 2012, f. 427, në *The Electronic Library*.

2 - L.D, Jody: *Choosing software for a digital library*, 2006, f. 19, në *Library Hi Tech News*.

3 - A. Payne dhe V. Singh: *Open Source Softwares use in libraries*, 2010, f. 708, në **Library Review**.

Ky punim gjeti që aplikacionet OS në bibliotekat ndryshojnë si në funksionalitetin e tyre, por edhe në formë dhe përmbajtje, ato variojnë nga aplikacionet SIBOS (KOHA, JSUS, PMB), aplikacionet SBDOS (DIGILIB, Dspace, OMEKA), shfletuesit e Internetit (Mozilla etj.), sistemet operative (Linux etj.), e deri në guidat ndihmëse për përdoruesit që funksionojnë si asistencë teknike për përdorimin e një aplikacioni të caktuar (Koha Support etj.) Kjo shumëllojshmëri i ka dhënë mundësinë bibliotekave universitare të mund të zgjedhin aplikacione pa patur nevojën e një fondi me kosto të lartë.

SIBOS dhe SBDOS konstatuam që u ofrojnë bibliotekave universitare një mundësi menaxhimi të tyre si në nivel të sofistikuar, por dhe në të gjitha madhësitë dhe specifikimet e koleksioneve të tyre. SIBOS mbështesin funksione të bibliotekës, si ato rutinore dhe statistikore, por edhe ato profesionale. Ndërkohë që, sipas M. Breeding<sup>1</sup>, aplikacionet SBDOS i lejojnë bibliotekat universitare për të organizuar dhe menaxhuar koleksione me volum të madh, konkretisht të koleksioneve dixhitale audiovizuale etj. Pikërisht këto aplikacione përmbushin shumë prej aktiviteteve që realizohen nga bibliotekat universitare, që nga menaxhimi i koleksionit dhe deri në komunikimin virtual të bibliotekës me përdoruesit e tyre, aplikacione bazë për funksionimin normal të një biblioteke universitare dhe me kosto shumë të ulët.

## Përfundimet

Qëllimi i këtij artikulli nuk ishte të krahasonte teknologjitë OS që zbatohen në bibliotekat universitare, por synimi ishte të paraqiste një kontekst të përgjithshëm të implementimit të OS në bibliotekat universitare dhe të diskutohej funksionimi i këtyre produkteve OS. Krahasimet e këtyre teknologjive, çështjet që lidhen me sigurinë, me përshtatjen, me performancën e produkteve OS, kërkojnë studime të mëtejshme, pasi adoptimi i këtyre produkteve sot nuk është thjesht dhe vetëm një prirje e kohës, por këto studime normalisht i duhen kësaj fushe.

Ky studim arriti të gjente që:

1. përdorimi i produkteve OS në bibliotekat universitare të Arsimit Publik është në rritje;

2. produktet OS dhe implementimi i tyre u kanë dhënë institucioneve bibliotekare qasje në zgjidhje të frytshme dhe me kosto të përballueshme për t'i shërbyer komunitetit akademik;

---

*1 - M. Breeding: Open source integrated library systems, 2008, f. 6, në Library Technology Report.*



3. konstatohet se nuk ka asnjë dyshim që aplikimi i paketave të integruara për menaxhimin e bibliotekave dhe bibliotekave dixhitale kanë pasuruar aktivitetin e tyre dhe kanë përmirësuar dukshëm shërbimet në distancë që bibliotekat universitare ofrojnë për komunitetin e tyre akademik. Prandaj ky studim mbështet dhe rekomandon aplikimin e produkteve OS;

4. përzgjedhja e produkteve OSS në disa prej bibliotekave nuk është shoqëruar me një vlerësim paraprak të produkteve OS. Për këtë qëllim, ky studim ofron një strukturë për vlerësimin e SIBOS dhe SBDOS, duke parashtruar karakteristikat që duhet të përmbajë një sistem, për t'u përzgjedhur si sistem i integruar për menaxhimin e bibliotekave, por edhe bibliotekave dixhitale.

## ***Bibliografia***

Anuradha, K.T.; Sivakaminathan, R. e Arun Kumar, P.: Open-source tools for enhancing full-text searching of OPACs: Use of Koha, Greenstone and Fedora. Program: electronic library and information systems, 45, 2011, 231-239

Breeding, M.: Open source integrated library systems. Library Technology Report, 8, 6, 2008

Birchall, A. dhe Hopkinson, A.: (2011). Open Source Software in Higher Education. [http://eprints.mdx.ac.uk/6305/1/birchall\\_hopkinson\\_OSS.pdf](http://eprints.mdx.ac.uk/6305/1/birchall_hopkinson_OSS.pdf) (i aksesuar më 10 nëntor 2012)

Chen, H dhe të tjerë: Expanding the concept of requirements traceability: The role of electronic records management in gathering evidence of crucial communications and negotiations. Aslib Proceedings, 63, 2011, 168-187

Dimant, N.: Breaking the barriers: the role of support companies in making open source a Reality. Library Review, 59, 2010, 662-666

Egunjobi, R.A. dhe Awoyemi, R.A.: Library automation with Koha. Library Hi Tech News, 29, 2012, 12-15

Fox, R.: The digital library in the bazaar. OCLC Systems & Services, 22, 2006, 100-106

Helling, J.: Cutting the proprietary cord: A case study of one library's decision to migrate to an open source ILS. Library Review, 59, 2010, 702-707

Keast, D.: A survey of Koha in Australian special libraries: Open source brings new opportunities to the outback. OCLC Systems & Services, 27, 2011, 23-39

Krishnamurthy, M.: Open access, open source and digital libraries: A current trend in university libraries around the world. Program: electronic library and information systems, 42, 2008, 48-55

Lian Goh, D. H dhe të tjerë. (2006). A checklist for evaluating open source

digital library software. *Online Information Review*, 30, 2006, 360-379

McGinnis, W dhe Ransom, J.: Kete and Koha: integration built on open standards. *OCLC Systems & Services*, 26, 2010, 114-122

Ming Chen, Ch. dhe të tjerë.: Developing a Taiwan library history digital library with reader knowledge archiving and sharing mechanisms based on the DSpace platform. *The Electronic Library*, 30, 2012, 426-442

Payne, A. dhe Singh, V.: (2010). Open source software use in libraries. *Library Review*, 59, 2010, 708-717

Poulter, A.: Open source in libraries: an introduction and overview. *Library Review*, 59, 2010, 655-661

Rabishankar Giri, R.: NewGenLib 3: An Integrated Open Source Library Management System that Makes your Library Visible in Web. *Library Hi Tech News*, 29, 2012, 1-12

Singh, M. dhe Sanaman, A.: Open source integrated library management systems: Comparative analysis of Koha and NewGenLib. *The Electronic Library*, 30, 2012, 809-832

Tajoli, Z. dhe të tjerë.: OSS diffusion in Italian libraries: The case of Koha by the Consorzio Interuniversitario Lombardo per l'Elaborazione Automatica (CILEA). *OCLC Systems & Services*, 27, 2011, 45-50

Wiley, D.: Open Source, Openness, and Higher Education, 2010. [http://www.innovateonline.info/pdf/vol3\\_issue1/Open\\_Source,\\_Openness,\\_and\\_Higher\\_Education.pdf](http://www.innovateonline.info/pdf/vol3_issue1/Open_Source,_Openness,_and_Higher_Education.pdf) (i aksesuar më 10 nëntor 2012)

Winter, M. dhe Bowen-Chang, P.: Dealing with DSpace: the experience at the University of the West Indies, St Augustine. *New Library World*, 111, 2010, 320-332.

## *Organizimi dhe menaxhimi i auditorit universitar* \_\_\_\_\_

---

■ *Dokt. Esmeralda BIRÇAJ*

---

■ *Dokt. Julejda GËRXHI*

---

**Abstract.** *Menaxhimi i auditorit universitar do të thotë më shumë se evitimi i kaosit. Ai nënkupton realizimin e një rutine që lejon aktivitetet e të nxënit. Menaxhimi është edhe përdorim i rregullave dhe procedurave për të siguruar rregull, i cili siguron të nxënit. Nëse do të bënim një përmbledhje të menaxhimit të auditorit universitar, do të thoshim se është:*

**A. Organizim + B. Kontroll.**

*Qëllimi i këtij studimi është të kuptuarit se çdo të thotë një program i mirë i menaxhimit të auditorit universitar. Objektivat e këtij studimi janë:*

*1. Cila është marrëdhënia mes aftësive menaxhuese të pedagogut, akademizmit të tij dhe auditorit universitar?*

*2. Cila është marrëdhënia mes punës kryesore të pedagogut dhe zhvillimit e përshtatjes së njohurive lidhur me atë se përse studentët janë të suksesshëm ose dështojnë në procesin e të nxënit në universitet?*

3. Cila është marrëdhënia mes zhvillimit të njohurive të studentëve dhe problemeve që lidhen me të?

*Studimi është i bazuar në sistemin e “anketimit”, përmes pyetësorëve të formatuar në përputhje me qëllimet dhe objektivat e studimit. Informacioni i grumbulluar nga përpunimi i të dhënave, nga rezultatet e përgjigjeve të të anketuarve (nga pikëpamja mo-shore, gjinore, zonale, arsimore, raportit të pedagogut me “botën e punës” etj.), mundëson bërjen e një analize lineare të problemit të menaxhimit të auditorit në dy universitetet në Vlorë, por edhe nxjerrjen e disa përfundimeve të rëndësishme orientuese për punën në të ardhmen për të gjithë faktorët dhe aktorët që kanë rol dhe përgjegjësi në këtë proces të vështirë.*

## **Kampioni dhe mbledhja e të dhënave**

Popullata e këtij studimi janë pedagogët në dy universitetet e Vlorës. Nga kjo popullatë u zgjodh në mënyrë rastësore një kampion prej 200 pedagogësh. Mbledhja e të dhënave u bë me anë të një pyetësi, i cili iu shpërnda pedagogëve, të cilët e plotësuan atë në mënyrë të pavarur. Pyetësi u administrua në periudhën mars-maj 2012.

## **Instrumenti i studimit**

Instrumenti i studimit ishte një pyetësor i strukturuar, i përbërë nga dy pjesë. Në pjesën e parë u përfshinë karakteristika akademike dhe demografike të pedagogëve si dhe disa karakteristika të auditoreve universitare. Në pjesën e dytë u përfshinë pyetje për matjen e nivelit të aftësive menaxhuese të pedagogëve, si dhe pyetje që kanë të bëjnë me faktorët që lidhen me punën e pedagogut, si dhe një sërë faktorësh të cilët duken se janë specifike për mësimdhënien në Shqipëri. “Menaxhimi i mësimi ka të bëjë me drejtimin dhe organizimin e veprimtarive të tilla të të nxënës, duke synuar që të maksimalizohet përfshirja e frytshme e nxënësit në mësim.” (Musai, 2003, f. 201).

## Pyetjet mbi të cilat u realizua studimi (pjesa e parë)

Disa karakteristika të auditoreve universitare dhe disa karakteristika akademike dhe demografike të pedagogëve.

### a. Mjedisi i universitetit:

- Si janë organizuar dhe mirëmbajtur territoret e universiteteve?
- Sa është universiteti një mjedis i pastër dhe funksional?
- Sa u krijon studentëve hapësirë për mësim, argëtim e pushim?
- Sa e nxit mjedisi shkollor atmosferën intelektuale?
- A ekzistojnë bibliotekat? Sa funksionale janë ato?
- Për çfarë diskutojnë pedagogët në dhomat e tyre: për veten, për studentët, për botimet, për problemet social-ekonomike, për problemet e arsimit, etj.?

### b. Mjedisi i auditorit:

- A e shohin të gjithë studentët dërrasën e zezë, a dallohet shkrimi në të?
- A ka dritë të mjaftueshme, temperaturë të përshtatshme?
- Si janë vendosur orënditë, si i plotësojnë ato nevojat kolektive dhe personale?
- Çfarë është ekspozuar në mure dhe ç'ndikim kanë tek studentët?
- Mjedisi fizik të fton për punë, të kënaq apo të shqetëson?

### c. Pedagogu:

- Sa përgatitje ka bërë, si e ka strukturuar orën e mësimit?
- A e ka parashikuar realizimin e strukturës në më shumë se një variant?
- Sa i motivuar duket për orën e mësimit?
- Shfaq në auditor ëmbëlsi, butësi, ashpërsi, nervozitet?
- Është fleksibël në situata të paparashikuara?
- Si i manipulon të qeshurat, lëvizjet, zhurmën, kundërshtimet?
- Situata është nën kontroll apo jashtë tij?
- Si është paraqitja e tij e jashtme, në ç'drejtim e tërheq vëmendjen e studentëve apo nuk provokon qëndrime?
- Qëndron në këmbë, ulur, në lëvizje, ç'gjeste përdor?
- A i shikon studentët në sy kur flet, ç'mjete të komunikimit të heshtur përdor?
- A është të folurit e tij letrar, a është zëri i tij i qartë?
- A është shkrimi i tij i lexueshëm dhe standard?
- A e përdor dërrasën e zezë dhe si e përdor?
- Si shfrytëzohet lënda e mësuar më parë për të motivuar studentët në

informacionin e ri?

- Sa flet pedagogu e sa flasin studentët?
- A formulohen konkluzione të përbashkëta për procesin?
- Si korrigjon, plotëson, stimulon, vlerëson e motivon?
- A nervozohet pedagogu nga gabimet e bëra?
- A u jep shans studentëve të korrigjojnë gabimet e veta, të njëri-tjetrit ose të pedagogut?

- Tema e informacionit të ri a është e qartë, a zbërthehet në objektiva?  
- A përdoren nivelet: njohja, të kuptuarit, të zbatuarit, analiza, sinteza, vlerësimi?

- Në ç'mënyrë konkretizohen konceptet e reja?
- A kontrollohet të kuptuarit, a përforcohet?
- A përdoret në mënyrë të frytshme koha në dispozicion?
- Ç'qëndrim mban pedagogu ndaj studentëve që nuk e kuptojnë shpjegimin?
- A janë të qarta pyetjet dhe detyrat e kërkuara?
- A bëjnë vërejtje studentët për çfarë nuk u pëlqen?
- A bëjnë pyetje studentët për çfarë u intereson?

## **PYETJET MBI TË CILAT U REALIZUA STUDIMI (pjesa e dytë)**

Cilësia e procesit të mësimdhënies dhe e të nxënit përcaktohet nga:

1. Kurrikula mësimore
2. Koha mësimore
3. Puna në auditore
4. Strategjitë mësimdhënëse, dhe
5. Veprimtaritë mësimore të studentëve

## **Kurrikula mësimore:**

Cilat janë garancitë që ofrojnë universitetet për realizimin e programit të lëndëve mësimore?

- Cilat janë masat që janë marrë për realizimin e lëndëve mësimore?
- Cilat janë mosrealizimet e orëve mësimore të planifikuara për secilën lëndë mësimore dhe shkaqet e tyre?

- Cilat janë lëndët me zgjedhje ose kurset që organizohen në universitete?

Cilat janë shprehitë e përgjithshme që fitojnë studentët tanë gjatë procesit të realizimit të programit të të gjitha lëndëve mësimore?

- Cilat janë veprimtaritë ndërlëndore që kanë organizuar universitetet?
- Si punohet për të zhvilluar tek studentët shprehitë për të komunikuar dhe për të marrë informacion?

Si është kalueshmëria e studentëve tanë nga një cikël në tjetrin për secilën lëndë mësimore?

- Cilat janë problemet që kanë shoqëruar kalimin e studentëve nga një cikël në tjetrin, analizat që janë kryer dhe rezultatet që janë arritur?

- Cilat janë materialet që dëshmojnë se pedagogët e njërit cikël janë të familjarizuar me lëndët mësimore të cikleve para dhe pasardhëse?

- Cilat janë rezultatet e studentëve në ciklet më të larta?

- Cili është numri i studentëve përsëritës në vitin e parë të secilit cikël?

Si përdoren bibliotekat dhe sallat e kompjuterave sipas lëndëve mësimore dhe fakulteteve? Cili është plani i punës për përdorimin e teknologjisë në universitete?

- Si përdoret teknologjia në përputhje me karakteristikat e studentëve?

- Cilat janë faktet që kemi dhe që tregojnë se teknologjia përdoret si mjet për ndryshimin e strategjive të mësimdhënies?

- Cili është grafiku i përdorimit të teknologjisë nga studentët e viteve të ndryshme?

## **Sigurimi i kohës mësimore:**

Si është planifikuar realizimi i programit mësimor në përputhje me kërkesat e udhëzimeve shtetërore?

- Cili është numri i orëve mësimore të realizuara në secilën lëndë në raport me numrin e planifikuar në program?

- Cili është numri i mungesave të studentëve në lëndë të veçanta dhe në të gjitha lëndët në raport me kërkesat e Dispozitave Normative për kufirin e pranueshëm të kalimit të vitit?

Si punojnë universitetet për zvogëlimin e humbjes së orëve mësimore?

- Cilat janë orët mësimore të humbura në fillim të vitit shkollor?

- Cilat janë orët mësimore të humbura në fund të vitit shkollor?

- Cilat janë orët mësimore të humbura për shkaqe të ndryshme?

- Cilat janë masat që janë marrë për parandalimin e humbjes së orëve mësimore?

Si i parandalojnë universitetet humbjet e orëve mësimore për shkak të sëmundjeve, pushimeve, pjesëmarrjes së pedagogëve në kualifikime apo konferenca etj?

- Si është punuar për parandalimin e humbjeve të këtij lloji?

- Cila është shkalla e zbatimit të programit të dy universiteteve për zëvendësimin e orëve të humbura?

- Si janë mobilizuar studentët në punë të pavarura për plotësimin e boshllëqeve për shkak të orëve të humbura?

Si përdoren orët e mësimi nga pedagogët?

- Baza materiale përgatitet gjatë orës së mësimi dhe studentët presin pedagogun.

- Pedagogu hyn vonë dhe del shpejt nga auditori.

- Ka humbje kohe për shkak të lëvizjes së studentëve nga një sallë në sallën tjetër.

Cilat janë masat që janë marrë për të baraspeshuar ngarkesën mësimore të studentëve në shtëpi, me kohën që ata kanë për t'u përgatitur?

- Si është shpërndarë ngarkesa mësimore sipas lëndëve në orarin e mësimi?

- Cila është sasia e detyrave që jepet nga pedagogët në lëndë të ndryshme mësimore?

- Si janë organizuar testet me shkrim nga lëndët e ndryshme mësimore?

- Cilat janë konsultat që janë organizuar për zvogëlimin e ngarkesës në shtëpi?

Cila janë masat që janë marrë për zvogëlimin e mungesave të studentëve?

- Si dhe sa shpesh vërtetohet prania e studentëve në universitete?

- Cilat janë masat që janë marrë për parandalimin e mungesave dhe masat që kemi marrë pas një mungese ose pas mungesave të përsëritura?

- Si komunikojnë universitetet me prindërit për mungesat?

## **Puna në auditore:**

Karakteristikat e fushës së mësimdhënies / të nxënit:

Sa të vëmendshëm janë pedagogët ndaj studentëve?

- A i thërrasin studentët me emër?

- A krijojnë kushte që studentët të dëgjohen gjatë mësimi?

- A e dëgjojnë atë që thonë studentët?

- A e respektojnë ndihmesën e studentëve?

- A bëjnë komente për pamjen apo karakterin e studentit?

- A sillen në mënyrë cinike dhe tallëse me studentët ?

Si nxiten studentët nga pedagogët për të respektuar njëri-tjetrin?

- Cila është shkalla e respektit reciprok të studentëve, pavarësisht nga kushtet sociale apo pikëpamjet e tyre për jetën?

- Si i mësojnë studentët të kontrollojnë sjelljen e tyre dhe të punojnë me njëri-tjetrin, sipas potencialit dhe mundësive që kanë?

- Si dhe sa pedagogët nxisin shpirtin e garës tek studentët?



- A tregojnë pedagogët kujdes të menjëhershëm për mungesat e studentëve të tyre?

A trajtohen studentët në mënyrë të barabartë nga pedagogët?

- A ka dallime të panevojshme midis studentëve nga ana e pedagogëve?

- A ka shfaqje të shenjave të antipatisë ndaj disa studentëve nga ana e pedagogëve?

- A ka shfaqje të trajtimit të diferencuar të disa studentëve në mënyrë që studentët e tjerë të ndjehen të trajtuar negativisht?

- A përdorin pedagogët kritere të njëjta për vlerësimin e nxënësve?

Cila është klima e punës që krijojnë pedagogët në auditore?

- Cilat janë rregullat e sjelljes së pedagogëve për mbajtjen e rregullit dhe për krijimin e një atmosfere pune në sallë?

Si e tregojnë pedagogët se presin rezultate të mira nga studentët e tyre? Cilat janë vëzhgimet për të provuar se pedagogët:

- Mbajnë qëndrim pozitiv ndaj pyetjeve, komenteve dhe përgjigjeve të studentëve?

- Nuk bëjnë komente që shkurajojnë studentët?

- Mbajnë qëndrim pozitiv ndaj punëve që kryejnë studentët?

- Vlerësojnë përpjekjet dhe kontributet e studentëve?

Cilat janë vëzhgimet tona që tregojnë së pedagogët kanë kërkesa reale ndaj rezultateve të studentëve për:

- T'i nxitur studentët të japin përgjigje të qarta dhe të plota?

- Për të dhënë detyra me kërkesa reale (që studentët t'i kryejnë me dëshirë ose të mos bëjnë shumë pyetje)?

- Për t'u krijuar mundësi të reja studentëve për t'u përgjigjur dhe për t'i lejuar të korigjojnë gabimet që bëjnë?

- Për të dhënë detyra në përputhje me nivelin e studentëve?

## **Strategjitë mësimdhënëse të pedagogëve:**

Kanë ndërtuar mësimet me strukturë të qartë?

- Cilat janë faktet që tregojnë se pedagogët janë të qartë në atë që shpjegojnë, sidomos në fillim dhe në fund të mësimit, për të siguruar lidhje me njohuritë e mëparshme dhe qëndrueshmërinë e tyre?

Janë të qartë në shpjegimin dhe/ose dhënien e detyrave në çështje të tilla, si:

- Shpjegimi gradual i mësimit?

- Përdorimi i pyetjeve dhe udhëzimeve të qarta për studentët?

- Shembuj të qartë dhe përdorimi i materialeve konkretizuese?

Kontrollojnë rregullisht dhe nëse studentët e kanë kuptuar mësimin dhe detyrat që u jepen?

- Si janë pyetjet që bëjnë pedagogët për të parë nëse është kuptuar mësimi?
- Ç'kushte krijojnë pedagogët që studentët të shprehin ose shfajësojnë veprimet e tyre?

- Ç' mbështetje aktive ofrojnë pedagogët në këtë proces?

Si e përshtatin pedagogët metodën e tyre në përputhje me mjedisin social në të cilin jetojnë studentët?

- Veprojnë sipas moshës, mjedisit, kulturës së studentëve?
- Si i përdorin shembujt që burojnë nga mjedisi social i studentëve?
- Si e bëjnë lidhjen e njohurive dhe shprehive që marrin studentët jashtë shkollës me mësimin?

Gjatë mësimdhënies, pedagogët i kanë parasysh nivelet e ndryshme të studentëve?

Konkretisht:

- Si e organizojnë kontrollin e studentëve të dobët për të parë nëse e kanë kuptuar mësimin?

- Si dhe sa përqëndrohen te studentët e dobët dhe studentët e mirë (jo vetëm te studentët mesatarë), me anë të detyrave apo materialeve plotësuese?

- Çfarë konsultimesh janë organizuar me studentët që nuk kanë kuptuar mësimin?

Cilat janë llojet e ndryshme të metodave të mësimdhënies që përdorin pedagogët?

## **Veprimtaritë mësimore të studentëve:**

Pedagogët i nxitin studentët të marrin pjesë aktive në procesin e të nxënit.

Kujdesi i pedagogëve për një pjesëmarrje aktive të studentëve në mësim?

Konkretisht:

- Sa dhe si mësuesit u bëjnë pyetje studentëve?
- Cila është shkalla e vëmendjes me të cilën studentët dëgjojnë pedagogun?
- Si realizohet bashkëveprimi pedagog-student dhe student-student për kryerjen e detyrave?

- Krijojnë mundësi që të përgjigjen studentë të ndryshëm?

- Formulojnë pyetje që nxisin të menduarit dhe pjesëmarrjen aktive të tyre në mësim?

- Kërkojnë ide dhe sugjerime nga grupe studentësh?

- U kërkojnë studentëve t'u përgjigjen pyetjeve të shokëve të tyre?

Si nxiten studentët nga pedagogët për të punuar në grup dhe për të mbështetur njëri-tjetrin gjatë mësimin?

Si është rregullsia e procesit me anë të të cilit pedagogët informojnë studentët për progresin e tyre në mësim?

-Cila është rregullsia e informimit të studentëve nëpërmjet njohjes me rezultatet ?

## **Rezultatet**

### **1. Parandalimi i problemeve të auditorit**

Menaxhimi në klasë lidhet me motivimin, disiplinën dhe respektin.

Një program i mirë i menaxhimit të auditorit përfshin të dy anët, si reagimin veprues ndaj problemeve dhe planifikimin paraveprues për të përfutur sjellje produktive. Kjo njihet me emrin: "Menaxhimi paraveprues i auditorit", i cili bazohet në tri elementë:

1. Është më shumë parandalues se veprues.
2. Ndërthur metoda të cilat mbështesin sjelljet e përshtatshme të studentëve.
3. Nenvizon dimensionet e grupit në menaxhimin e auditorit.

### **2. Koha dhe pedagogu**

Dy kategoritë për të analizuar kohën:

1. Përcaktuesit e kohës së nevojshme për të nxënin. Kjo kategori ka tri aspekte:

- Aftësi për të kuptuar informacionin... që lidhet me inteligjencën e studentëve. Shpresa për sukses ka të bëjë me atë se çdo detyrë që i ngarkohet nxënësit duhet të jetë në përputhje me shkathtësitë psiko-fizike të tij, dhe ngarkesa në rangun e mbimesatares së mundësive të nxënësit është e lehtë dhe e mundshme për të.

- Aftësitë realizuese ... I referohet kohës që i nevojitet studentit për realizimin e detyrës në përputhje me vështirësinë e lëndës.

- Cilësia e informacionit ... Që lidhet me aftësitë e pedagogut për të paraqitur materialin sa më të përshtatshëm. "Arsimtari ose mësimdhënësi, po ashtu është faktor subjektiv me rëndësi në punën mësimore, i cili me aftësinë e tij profesionale dhe përgatitjen didaktiko-metodike planifikon, organizon dhe realizon tërë punën me nxënësit, si dhe mundëson krijimin e kushteve elementare për kryerjen e suksesshme të punës mësimore." (Zylfiu, 1985, f.

75).

Arsimtari duhet të japë sinjale pozitive tek nxënësit, duke shfaqur dinamikë, sinqeritet, gëzim dhe vullnet gjatë orës mësimore, sepse, nëse ai është i vobektë nga këto cilësi, atëherë nuk mund të themi se çdo gjë zhvillohet normal dhe sipas planit. Ai është faktori thelbësor në krijimin e klimës pozitive, sepse, siç thotë Haim Ginott: “Kam nxjerrë një konstatim të tmerrshëm, se unë jam elementi vendimtar në klasë. Qëndrimi im krijon klimën. Disponimi im i përditshëm krijon kohën. Si mësues, unë kam fuqi të madhe që ta bëj jetën e fëmijëve të mjerë ose të lumtur. Mund të jem vegël për torturë ose instrument inspirues. Mund t’i poshtëroj ose t’i disponoj, t’i lëndoq ose t’i shëroj. Në të gjitha situatat përgjigja ime vendos se a do të eskalojë apo jo kriza, ose a do të humanizohet apo jo fëmija.” (Revista **Ardhmëria**). Pra, duhet të krijohet një atmosferë e dashur në klasë, mësimi të jetë një proces i hareshëm, duke ndërtuar vetëbesimin tek nxënësit, duke bërë që ata të jenë eksplorues (zbulues, kërkues).

2. Koha e shpenzuar në të nxënin që ka dy aspekte :

a. Koha e lejuar për të nxënit.

b. Dëshira e studentëve për të nxënë.

Dy aspekte më të rëndësishme që kanë të bëjnë me fillimin e mësimit janë përpikmëria dhe rregullimi mendor (Musai, 2003, f. 206). Është shumë e rëndësishme dhe mjaft e frytshme për nxënësit, nëse arsimtari arrin me kohë ta fillojë procesin mësimor, madje përpikmëria në këtë drejtim, do t’u dërgonte mesazhe nxënësve se sa është i nevojshëm, i drejtë dhe racional, respektimi i kohës dhe orarit të mësimit.

Aleksandër Xhuvani thotë: “Lenia mundin e të kërkuarit dhe gëzimin e të gjeturit, nxënësit a studentit“.

### 3. Jeta brenda auditorit

Kompetenca kyçe për menaxhim të suksesshëm është mësimi, dizajnimi dhe aplikimi i procedurave.

”Mjedisi i klasës, i krijuar nga mësuesi, mund të ketë një ndikim në motivimin e nxënësve, që reflektohet në qëndrimin e tyre aktiv ndaj të nxënit. Pikërisht një mjedisi i tillë përbën atë që quhet “klima e klasës.“ (Musai, f. 210).

Menaxhimi i auditorit, i cili është shumë i rëndësishëm për arritjen e qëllimeve, përfshin tre funksione bazë:

1. Planifikimi... që nënkupton përcaktimin e objektivave dhe procedurave.

2. Komunikimi... që nënkupton transferimin e informacionit, për t’i treguar studentëve se çfarë prisni prej tyre.

3. Kontrolli... që nënkupton mbajtjen e një atmosfere të përshtatshme për të nxënit.

Që nga fillimi i çdo viti shkollor, mësimitdhënësi paraqet planin dhe programin mësimor dhe kriteret apo kërkesat, të cilat u drejtohen nxënësve, dhe ato duhet t'i thotë me bindshmëri, ndikim dhe qëndrueshmëri tek nxënësit, që më pas ato të gjejnë aplikimin e tyre në praktikë. Natyrisht që kjo rregullativë e mësimitdhënësit bëhet për qëllime pozitive dhe, në këtë kontekst, ai krijon një lloj marrëveshje me nxënësit, ku këta të fundit mund të japin propozimet e tyre, por pa dalë jashtë normave me të cilat drejtohet klasa dhe mësimi si tërësi. Nëse këto parashtrime që bëhen nga ana e mësimitdhënësit, me kalimin e kohës pësojnë lëkundje, atëherë kjo reflektohet negativisht nga ana e nxënësve, të cilët mund ta keqpërdorin dhe ta etiketojnë mësimitdhënësin, çka ndikon negativisht tek ai, i cili tashmë ka humbur besimin e nxënësve, duke u futur në një valle pa e ditur ritmin e lojës së saj. Në këtë aspekt, nga mosserioziteti, parimësia, konsistenca dhe racionalizmi, nxënësit jo vetëm që do ta urrejnë mësimitdhënësin, por edhe lëndën mësimore të cilën ai ligjëron. (Haliti, 2007, f. 73).

#### 4. Vendosja e rregullave dhe procedurave

“Shkolla pa edukatë, si mulliri pa ujë.” - Jan Amos Komenski

“Disiplina ka të bëjë me rregullin, i cili është i nevojshëm në klasë për të siguruar një nxënie të efektshme”. (Musai, f. 222).

Në fushën e menaxhimit punohet mbi një parim tepër domethënës: **“Nxënësit që ndjehen mirë, me siguri arrijnë suksesin!!!”**.

Mbajtja e disiplinës në klasë varet nga mënyra se si e planifikon mësimitdhënësi orën mësimore, sa i kushton rëndësi integritit të nxënësve në mësim dhe sa mundohet t'u shmangët manipulimeve nga nxënësit. Kriteret metodologjike të menaxhimit të klasës nuk i preferojnë reagimet agresive dhe qëndrimet autoritare të mësimitdhënësit, kur ai dëshiron që përmes kësaj praktike të vërë disiplinën në klasë.

Një pedagog është menaxher i mirë:

- Nëse bën të qartë para studentëve që në ditën e parë të shkollës rregullat, dhe në mënyrë të natyrshme i integrojnë ata në këtë sistem. (Rregullat janë konkrete, funksionale, dhe pedagogu jep sinjale që ato duhen zbatuar në çdo aktivitet).

- Nëse nuk i mbingarkon studentët me rregulla, por fillon me ato që janë më të domosdoshme, dhe pastaj gradualisht të tjerat që nevojiten.

- Nëse vendos standarte për sjelljet dhe parandalon sjelljet e papërshtatshme dhe penguese për mësimin.

## Konkluzione

Mësimdhënia nuk ndodh rastësisht, por është rezultat i një programimi dhe studimi të kujdesshëm. Si e tillë ajo ka këta elementë:

Planifikimi që ka të bëjë me përcaktimin e objektivave dhe të përmbajtjes apo të materialit mësimor që do t'u serviret nxënësve. Lidhet me:

- Studimin e procesit mësimor. Mësimi proces që kërkon ndryshimin e sjelljes së nxënësve.

- Studimin e realitetit jashtëshkollor. Kompleksiteti i jetës dhe përgatitja e nxënësve për jetën.

- Mbështetja në psikologjinë e të nxënit në përcaktimin e objektivave.

Mësimdhënia është drejtimi nga mësuesi i situatës mësimore dhe të të nxënit, që përfshin:

a. procesin paraveprues të marrjes së vendimeve për planifikimin, skicimin dhe përgatitjen e materialeve për të mësuarit dhe të nxënit, për diagnostikimin e nevojave të nxënësve, për krijimin e mjedisit mësimor, për shfrytëzimin e kohës mësimore;

b. procesin bashkëveprues, bashkëpunimin e drejtpërdrejtë mësues-nxënës, përdorimin e formave, metodave dhe mjeteve të mësimdhënies;

c. fazën pasvepruese, që përmbledh: vlerësimin, vetëvlerësimin, caktimin e procedurave për të vlerësuar të nxënit, për të vënë nota, për të vlerësuar programin mësimor, për të vlerësuar materialet mësimore.

Menaxhimi i auditorit i referohet proceseve të organizimit dhe realizimit të orës së mësimi, me qëllim që të nxënit të kryhet me efikasitet dhe rrjedhshmëri. Përsa i përket organizimit dhe menaxhimit, theksojmë se puna kryesore e pedagogëve duhet të jetë zhvillimi dhe përshtatja e njohurive lidhur me atë se përse studentët janë të suksesshëm ose dështojnë në procesin e të nxënit.

Disa nga tiparet që lidhen me dy kategoritë për të analizuar kohën janë:

1. Aftësia për të kuptuar informacionin që jepet.
2. Aftësia për ta realizuar atë. (për dy të parat pedagogu ka pak kontroll)
3. Koha e lejuar për të nxënin.
4. Cilësia e informacionit. (këto të dyja përcaktohen nga pedagogu)
5. Dëshira dhe motivimi. (varet nga karakteristikat e studentit dhe situatës së auditorit)

Auditorët janë vende ku kërkohen aftësi, ku bëhen teste, ku ndodhin gjëra të çuditshme dhe të papritura; vendi ku studentët rrinë bashkë, zënë miq, nxënë, dhe përfshihen në aktivitete të ndryshme rutinë. Nga ana tjetër, auditori është një vend ku koha mund të matet me rezultatet e arritura, dhe

kjo nënkupton një ambient stabil mësimi dhe aktiviteteve, vendosja e një sërë procedurash, përcaktimi i vendit të punës, përfshin diskutime në grup, bisedë pyetje-përgjigje etj.

Ka një lidhje të pashkëputshme mes të nxënësit dhe rregullit. Pse? (Të nxënësit rrallë vjen nga kaosi në auditorë).

Një auditor tepër i paorganizuar zvogëlon kohën e të nxënësit. Pse? (Sepse pjesa më e madhe e kohës shpenzohet duke vendosur rregullin)

Cilësia e informacionit që jepet është e lidhur ngushtë me efektivitetin e menaxhimit të auditorit. Pse? (Jo vetëm përqëndrim, por edhe të paturit nën kontroll të studentëve)

## ***Bibliografia***

- Administrimi dhe Menaxhimi i arsimit. ISP, Nr. 5, 2003
- Clawson. G.S.J. Haskins.E.M.: Teaching management, 2007
- Locke, E.A.: The natyre and causes of job satisfaction, 1976. Në botimin e M.D. Dunnet: Handbook of industrial and organizational psychology, Chicago, Rand McNally
- Kim, L. ,& Loadman, W.: Predicting teacher job satisfaction. Columbus: Ohio State University, 1994
- Etika profesionale e mësuesit. AEDP, Tiranë 1998
- Anderson, LW and Krathwohl, DR.: A Taxonomy for Learning, Teaching and Assessing, Longman, New York, 2001
- Ausbel, DP., Novak, JS., and Hanesian, H.: Educational Psychology: a Cognitive View, Holt, Rinehart and Winston, New York, 1978
- Baumslag, B.: Fundamentals of Teaching Mathematics at University Level, Imperial College Press, London 2000
- Boyer, CB.: A History of Mathematics, John Wiley and Sons, Inc, New York 1991
- Instituti i Studimeve Pedagogjike: Strategjitë e të Mësuarit, Eureka, Tiranë 1994
- Instituti i Studimeve Pedagogjike: Metoda të Mësimdhënies, 1999
- Musai, Bardhyl: Metodologji e Mësimdhënies. Pegi, Tiranë 2003
- Burime të tjera dhe nga Interneti

*Shpellat e velçës, si një vendbanim i hershëm,  
përkasin kulturës së neolitit të vonë*

---

■ Gëzim LLOJDIA

---

*Abstrakt. The ancient caves and their existence as early settlements instead has a limited number of historical data. A special settlement with a cave complex that I do not believe is located around us from earliest times humanity, but also preserved to the present time proving that their infallibility are Velça caves. The caves are located in the village of Velça, Vlora district which has jurisdiction as Brataj municipality. Late Neolithic culture of Velça, belongs III millennium BC, says, M.Korkuti. In Albania, the earliest settlements were established in the cave before ..... as in Welch, Vlora or randomly in other districts of the country, ... said in the first volume of the History of Albania. Cardini traveled extensively throughout southwestern Albania, has recorded over 60 natural cave stone shelters while in 1936, he has researched Velçën and conducted a preliminary study of ten caves there, says K.Francisë.Vendndodhja e shpellave në fshatin Velçë*



**K**oordinatat gjeografike në sekonda, gradë, minuta janë: 40 19' 12'' dhe 19 40' 56''. Nën këto koordinata gjendet ky territor i këtij katundi. Velça, juridikisht gjendet në komunën Brataj, qendra e kësaj të fundit shtrihet përtej lumit në një shesh guri. Nga toponimi: "Varri i Tavës", udha lë rrjedhën e ujërave të Shushicës. Ngjitja fillon me lartësi dhe me kthesa. Çdo km lartësia rritet. Një përrua me ujëra të kthjelltë zbret nga Beuni, që sikurse edhe vendi, quhen Trubull. Fshati Velçë, i sotëm, me rrënjët e lashtësisë për të udhëtuar në kohë të hershme. Pra, në zanafillë duhet të kuptojmë se ata strehoheshin, bënë jetë në një vendbanim të veçantë në mijëvjeçarin III para Krishtit, ai vendbanim ishte kompleksi i shpellave. Kompleksi i shpellave është nga atraksionet kulturore më të veçanta që gjenden në vendin tonë. Është shenjë e ekzistencës së jetës në kohët e hershme dhe është dëshmi që ruhet e trashëgohet si pjesë e trashëgimisë kulturore të vendit tonë. Nëse s'do të kishin ekzistuar këto banesa të gdhendura në brendi të shkëmbit, atëherë dëshmitë e së kaluarës do të ishin të mangëta. Mirëpo ato i ruajti koha nga erozionet e furishme, por edhe nga dora shkatërrimtare e njeriut, që vazhdon t'i cingërisë pa shkak, pa e ditur se dëmtimi i tyre rrezikon seriozisht humbjen e një kulture të lashtë të njerëzimit.

Banesat e këtij katundi, gjatë udhës në ngjitje të lartësisë, i ke para syve. Kjo *vijë demarkacioni* nuk përbën kufirin e fshatit të vjetër. Fshatrat e shullërit aty kanë rrugë-nisjen për të dalë më pas në zonën e Smokthinës. Ngjitimi majtas, nëpër kthesa... Udhë të ngjit tek shpellat...

Velça është fshati që ka në territorin e saj shpellat misterioze, të cilat dëshmojnë vendbanime të hershme autoktone. Sot, sipas shumë autorëve historianë apo arkeologë, ata, pra velçiotët, kanë përdorur ekzistencën e këtyre ngujimeve në shkëmb, pra të shpellave, që t'i tregojnë si fakte e dëshmi, se sa të hershëm janë banorët e këtyre territoreve dhe sa të lashtë janë vetë këto troje. Njoftimet e para t'i japin banorët, por ata nuk kanë më tepër të dhëna për të treguar se çfarë është gjetur në këto shpella, si ka rezistuar jeta në këto banesa dhe sa ka zgjatur ajo? Një grup studiuesish, por më tepër arkeologë, në studimet e tyre shkencore të misionit italian të vitit 1936, ndërmorrën edhe hulumtime pas shpalljes së tyre monument kulture. Nga ky mision u bë i njohur fakti i lashtësisë së shpellave, të cituara prej arkeologëve shqiptarë.

Banorët të tregojnë vendndodhjen e tyre, duke u kujtuar për takimin e përvitshëm në festën e fshatit Velçë, që mbahet çdo vit në Presaran. Shpellat e Velçës janë të njohura dhe të listuara ndër monumentet e kulturës që ka rrethi i Vlorës. Zgjedhja e shpellës së Presaranit, për të treguar historinë e fshatit të tyre, si shpella më komplekse dhe e punuar nga dora e njeriut, përbën, pikësëpari, një tregues domethënës.

## **Shpellat e fshatit Velçë - monument kulture, viti 1948**

Shpellat e fshatit Velçë janë shpallur monument kulture me këtë emërtim: Shpella e Velçës në fshatin Velçë. Viti 1948. Koordinatat gjeografike të ekzistencës së tyre janë: gjerësi 40 19' 12'' dhe gjatësi 19 40' 56''. Një shtysë e vogël kjo, që të shpie tek zbulesa: se faktikisht nuk është një shpellë, por një kompleks shpellash, të cilat gjenden në një varg shkëmbor dhe që njihen me emërtimet: Kalaja, Skota, Shpella me Qiell, Presarani, Shpella e Bushit, Shpella e Maçit, Kushtëgjini, Mëngjilli, Rasali etj. Prehistoriani italian Kardini, në vitet '30 i ka emërtuar me numra. Katundi Velçë ka pasur një emërtim tjetër, që lidhet më shpellat. Po aty nga vitet '30, ky fshat emërtohet Nr. 21 Velçë-Shpella, emërtim ky që do do t'i shkonte më tepër këtij fshati në ditët tona, se sa një emërtim sllav. Për ekzistencën e shpellave në vitet '30 ka pasur një interesim nga arkeologë italianë të misionit në Shqipërinë jugperëndimore gjatë viteve '20-40.

## **Kardini ka regjistruar mbi 60 shpella natyrore në vitin 1936 kur ka hulumtuar Velçën**

Karen Francis (Institute of World Archaeology, University of East Anglia Norwich,) shkruan: "Në vitin 1930, drejtori i Misionit Arkeologjik Italian në Shqipëri, Luigi Maria Ugolini, rekrutoi Kardinin si prehistorian të misionit. Ndërmjet viteve 1930 dhe 1939, Kardini udhëtoi gjerësisht në të gjithë Shqipërinë jugperëndimore me ndihmën e një grupi tepër të përkushtuar shqiptarësh; ka regjistruar mbi 60 shpella natyrore, strehime guri, ndërkohë që në vitin 1936 ai ka hulumtuar Velçën dhe ka kryer një studim paraprak të dhjetë shpellave atje. Në vitin 1937 Kardini është kthyer në Velçë, ku ai kishte kryer gërmimet sistematike në kuadër të "shpellës pjellore" (shpella 2)". Raporti që bën Mustili në vitin '41, thotë se në gërmimet e tij zbuluan akse guri, vegla stralli dhe një lloj, më parë të panjohur, të qeramikës së pikturuar eneolitike. Domenico Mustili shkruan: - Si provë e shkëmbimeve, janë fragmente të qeramikës neolitike të ngjyrosura, të gjetura në Velçë, jo shumë larg Vlorës...

Kush ishte hulumtuesi i shpellave të Velçës? Skeda e ndërtuar nga K. Francis, vërteton se ishte pikërisht ai, Luigi Kardini. Pas një karriere fillestare si mësues, Kardini ndjek kurse të specializimit në Universitetin e Firences (anatomji kurrizore dhe osteologji). Nga viti 1923, trajnuar si studiues në Institutin e Etnologjisë Antropologjike në Universitetin e Firences. Pesë vjet më vonë, në moshën 30 vjeçare, u promovua nga Kardini, në pozitën

e Comando të sapoformuar, Instituti Italian i Paleontologjisë Humane). Në nëntor 1966, stuhitë shkatërruese goditën Firencen, sende të çmuara dhe libra të Kardinit, humbën. Duke u bazuar te K. Francis në vitin 1999, një koleksion i vogël i Kardinit me fletoret për hulumtimet në terrenin shqiptar nga 1930, si dhe fotografi të vlefshme e harta, janë gjetur brenda në arkivat e Institutit Italian të Paleontologjisë Humane në Romë. Një pjesë e madhe e mbledhjes arkivore lidhet me shpellat e Velçës, të cilat Kardini i ka shqyrtuar në vitin 1936 dhe 1937. Velça përmban skica të kujdesshme të fakteve nga gjurmimet e tij në shpellën 2, si dhe përshkrime të qarta, si stratigrafia e depozitave etj. Materiale të tjera në lidhje me gjurmimet në shpellën 2, përfshijnë fotografi, vizatime teknike dhe një raport mbi eshtrat e dhëmbët e njeriut, si dhe skica e një raporti të detajuar nga gjeologu Alberto Pelloux, për të shtatë akset prej guri.

Gjatë vitit 2001, një numër i fotografive të shpellave të paidentifikuara nga arkivi, “u njohën si imazhet e shpellave të Velçës”, thotë K. Francis. Shpella të vogla dhe të mëdha janë të dukshme kudo në këtë fushë - shkruan K. Francis - kur në qershor të vitit 2000 një ekip arkeologësh nga Instituti i Arkeologjisë Botërore, Britania e Madhe dhe Instituti Shqiptar i Arkeologjisë filluan një studim në terren, me qëllim gjetjen e një numri shpeshash prehistorike, që janë hulumtuar për herë të parë në vitin 1930 nga një arkeolog italian, Luigi Kardini. Mbi rrugën, në të majtë, ishte mbresëlënëse fytyra e shkëmbit me vertikale të ndryshme në lartësi, me shpella të shumta të mëdha të dukshme brenda saj. Në ngjitje, duke vazhduar përgjatë rrugës edhe për disa kilometra, duke kaluar nëpër një fshat të vogël, një kthesë në të majtë. Nga atje, plani i parë i Kardinit, i grykës Velçës, erdhi në jetë.

Blloqe të mëdha guri gëlqeror ishin shpërndarë në frontin e shpellave, brenda një faqeje të pjerrët të thepisur, të mbuluara me bar dhe bimësi shkurre. Menjëherë kemi filluar një ekzaminim sistematik të shkëmbit dhe shpellave të saj, duke përdorur shënime të hollësishme të Kardinit si referencë. Shpellat, një linjë nga veri-perëndimi në jug-lindje (nga e majta në të djathtë) së bashku, u regjistruan 1-10 të tilla vetëm në atë drejtim. Në 1936, pas vëzhgimeve në pjesën e mbetur të grykës, Kardini është kthyer në shpellën 2, ku ai kryen gjurmime të detajuara brenda në dhomën e parë dhe të dytë: E tërë shpella, por sidomos dhoma e dytë është e ftohtë dhe e lagësht. Në zonën e treguar (+) nuk është ende aktiv dhe nga reshjet toka poshtë është çimentuar rëndë. Depozita e formuar e dheut dhe guri i grimcuar nga erozioni i mureve, përfshin fragmente qeramike dhe eshtra. Kjo shtresë e rëndë e tokës është shumë e hollë. Themeli është vetëm nën tokë në llogore [IPU: Kardini, fletore, 3 korrik 1936]. Kardini i është referuar shpellës 2 si: ”shpellë pjellore”, sepse është dëshmuar të jetë jashtëzakonisht e pasur në aspektin e depozitave arkeologjike dhe me objekte.

Gjatë vizitës sonë, ne kemi mësuar se shpella është e njohur lokalisht si

Shpella Maçi. Ekzaminimi ynë i kësaj shpelle ishte kombinuar me shpalljen e emocioneve se ajo ishte një nga shpellat e mëdha fotografuar nga Kardini në vitin 1937 - një shpellë parë e paidentifikuar për ne mendohet të jetë ajo e Dragotit pranë Tepelenës. Tipari më i njohur i shpellës Maçi, ishte shkëmbi në formë zemre, që pjesërisht ka penguar hyrjen. Ajo është ashtu siç duket sot, edhe pse faqja e pjerrët e dukshme në të djathtë të fotografisë Kardini, tani nuk është më, ndoshta është përdorur për të riparuar rrugën ngjitur. Hyrja në shpellën 2, e cila ishte në jug-lindje, ishte rreth 6.5 m e gjerë, 8 m e lartë dhe 6-7 m mbi nivelin e rrugës. Brenda shpellës, dhoma e parë ishte e gjerë 6 m dhe 8 m e thellë, dhe mjaft mirë e ndriçuar. Duke përdorur planin e Kardinit, ishte e lehtë për të identifikuar pozicionet e dy llogoreve të saj, një prapa shkëmbit në formë zemre dhe një tjetër në afërsi të murit të djathtë të dhomës së parë. Zona e reshjeve që gjendet prapa kanalit të dytë, është ende e dukshme, aktive. Brendësia e dhomës së parë përmban një numër gurësh të mëdhenj, të cilët formonin një zonë të ngritur në pjesën e prapme të dhomës në anën e majtë. Kati i cili përmbante ende depozita të dukshme, i vendosur pothuajse horizontalisht në hyrje të dhomës së dytë, e cila ishte vendosur rrumbullakët në të djathtë. Dyshemeja e dhomës së dytë, “Korridori i errët” i Kardinit, ishte e mbuluar me depozita të konsiderueshme të tokës së kuqe, shpërndarë me gurë. Pesëmbëdhjetë fragmente nga epoka e bronzit dhe hekurit (qeramikë) u gjetën këtu. Dhoma, rreth 7 m e gjatë, ishte jashtëzakonisht e errët dhe atmosfera ishte mjaft e thatë. Kati, i pjerrët në drejtimin e pasmë të dhomës, ka patur një të çarë shumë të vogël dhe tunele kryesore zbresin në nivelin e tokës. Në pjesën e prapme të dhomës së dytë ishte një platformë e ulët, ku shpella e ngushtuar dhe hyrja e tunelit edhe më e ngushtë e ilustruar nga Kardini, ishte e dukshme, duke na nxjerrë jashtë në mal, drejt veri-lindjes. Pjesa e parë e këtij tuneli u ekzaminua derisa ajo merrte një kthesë, drejt një qosheje rreth një depozite ku spikat një stalagtit, e më tej ai bëhet një kalim edhe më i ngushtë, i ndarë në dy pjesë nga një kolonë stalagmit. Ky korridor, që u raportua nga Kardini, të çon direkt në shpellën 4, e vendosur më tej në faqen e shkëmbit, një fakt që u konfirmua për ne edhe nga njerëzit e zonës. Shpella 4 është e njohur nga fshatarët e Velçës si Shpella Kala. Vizualisht, ajo është më mbreslënëse nga të gjitha shpellat e Velçës, e përbërë nga një hapësirë e madhe, me dy kate, me zgavër në jug-lindje, vlerësohet si 18-20 m e lartë dhe rreth 6-8 m gjerësi në pikën e saj më të gjerë.

Ajo është e vendosur njëqind ritme nga kjo. Në frontin, është ndërtuar një mur, i cili e ka transformuar dhomën e ulët në një plevicë. Muri fundor i ulët dhe një zgavër, kthesa dhomë në një pikë të caktuar, duke formuar shkop shpellë dhe një zgavër tjetër, e cila është pothuajse e paarritshme nga ajo më poshtë. Kjo zgavër e sipërme lidhet me shpellën pjellore [Nr. 2] nga një korridor i brendshëm në të njëjtin nivel. Për faqen e pjerrët të jashtme në

frontin e shpellës një hendek i matur 1.50 nga 1.20 metra është kryer. Në një thellësi prej 60 cm, një gur i sheshtë i matur 80 x 50 cm u gjet direkt në themele. Punëtorët thonë se kjo është një “tryezë shqiptare”, një gur i sheshtë mbi të cilin ruan ushqime. Nga llogorja ne gjetëm një kockë dele, pak qymyr, rrallë brenda baltë e kuqe, një fragment hekuri dhe një copë qeramike. Hyrja në shpellën 4 është vulosur nga muri me fije të ndërtuar me gur gëlqeror që përshkruan Kardini, rreth 8 m i lartë dhe përmban një derë dhe një dritare. Mbi mur ishte një zbrazëti 2 m e lartë, atëherë 4 metër i thellë-kati, guri me një zgavër tepër e madhe. Zgavra e sipërme është vlerësuar të jetë 7 ose 8 m e lartë, 6 m e gjerë dhe duket të jetë brenda e bollshme. Sipas fshatarëve, tuneli kryesor nga shpella 2 hyn në shpellën 4 në këtë nivel më të lartë. Gërmimet e Kardinit në Velçë rikthehen të pasura dhe të larmishme me burime eneolitike, si vegla stralli, objekte eshtrash dhe qeramikë e gdhendur dhe e pikturuar.

Në analizën e tij të Velçës, bazuar në punën e Kardinit, Mustilli (1941: 682), njoftoi se nuk ishte e mundur që të caktohej ndonjë ndarje kronologjike të materialit. Megjithatë, në dritën e zbulimeve të mëvonshme të periudhës së njëjtë (Prendi, 1982: 198), tani mund të jetë e mundur për t’u riinterpretuar materiali i Velçë duke përdorur fletoret e Kardinit për e Velçën dhe fotografitë e sendeve. Studimi gjeti se shpellat e Velçës kanë mbetur praktikisht të pandryshuara që prej gërmimeve të Kardinit atje. Megjithëse depozitat e faqeve të pjerrta ishin larguar nga e pjesa e jashtme e shpellës Maçi, nuk pamë asnjë provë për ndryshimin ose dëmtimin e depozitave të pasura arkeologjike brenda.

## **Në Shqipëri banimet më të hershme janë vërtetuar në shpellën e Velçës në Vlorë**

Përse e bëjmë të ditur argumentimin shkencor të kryer nga arkeologët? Krahas legjendave që qarkullojnë për jetën dhe mitet e ndërtuara nga ta në kohëra të ndryshme, mendimi shkencor është më i kualifikuari për të sjellë argumente rreth jetës së banorëve në ndërtesat e shkëmbit. Ndërtesat në shkëmb i gjejnë edhe në dy qytete antike, siç janë Amantia dhe Oriku. Në Shqipëri, banimet më të hershme janë vërtetuar në *shpellën e ...* më parë si në *Velçë të Vlorës*, ose rastësisht në rrethet e tjera të vendit, ...thuhet në vëllimin e parë të Historisë së Shqipërisë. Ky nuk është njoftimi i parë historik.

Në vitin 1959 u botua në Tiranë vëllimi i parë i Historisë së Shqipërisë, vëllimi i dytë doli më 1965, përbën e u botua si maket në vitin 1973. U përgatit nga prof. Selim Islami (redaktor përgjegjës), prof.dr. Muzafer Korkuti, prof. Frano Prendi dhe prof.dr. Skënder Anamali. Në vitin 1977, ky botim për shpellat dhe jetesën në këto vendbanime të lashta thotë: - Jeta në vendin tonë

gjatë neolitit u zhvillua në kushte shumë të përshtatshme natyrore. Klima e ftohtë dhe e lagësht e paleolitit, e cila kishte filluar që në mezolit t'i lëshonte vendin një klime më të butë, tani merr pak a shumë karakterin e klimës së sotme. Si rrjedhim, edhe flora e fauna thuajse nuk ndryshojnë prej asaj të ditëve tona. Këto rrethana të favorshme natyrore ndihmuan që vendi ynë gjatë neolitit të arrijë në një nivel të lartë zhvillimi ekonomik dhe kulturor për atë kohë. Njeriu nga skllav i natyrës, siç ishte në paleolit, shndërrohet tani, pak e nga pak, në zotërues i saj. Në këtë kohë lindin e zhvillohen forma të ndryshme të veprimtarisë prodhuese të njeriut, të cilat me plot të drejtë mund të merren si zanafilla e degëve të veçanta të ekonomisë dhe të përparimit teknik e kulturor të shoqërisë së sotme. Të tilla janë bujqësia e blegtoaria, prodhimi i qeramikës, tjerrja dhe endja, teknika e ndërtimit të banesave etj.

Përsoset në këtë kohë edhe teknika e punimit të veglave prej kocke dhe prej guri. Hyn në përdorim të gjerë dhe bëhet karakteristike për epokën dhe teknika e lëmimit të gurit. Nga fundi i neolitit (eneolit), për të parën herë dalin dhe veglat e objektet prej bakri, të cilat shënojnë dhe fillimet e metalurgjisë në vendin tonë. Në këto periudha të largëta të prehistorisë, vendbanimet i ndeshim zakonisht nëpër tarraca lumore, pranë burimeve ose në vende me toka pjellore dhe të pasura me pyje që strehonin shumë kafshë të egra. Por krahas këtyre, vazhdonin të shërbenin si vendbanim edhe shpellat (shpella e Velçës, e Trenit, e Konispolit, e Blazit etj.). Banesat paraqiten dy llojesh: në formë gropash nëndhese (Cakran), dhe të tilla të ndërtuara drejt mbi tokë (Maliq, Kamnik, Kolsh etj.). Zakonisht këto kishin planimetri drejtkëndëshe dhe ishin një ose dy dhomëshe. Muret e tyre thureshin me thupra ose me kallama dhe lyheshin pastaj me baltë në njërën ose në të dy faqet e tyre. Dyshemetë ishin gjithashtu prej balte, në disa raste ato vendoseshin mbi shtroje trarësh për të izoluar lagështirën.

## **Kultura e neolitit të vonë të Velçës, mijëvjeçari III p.e.r.**

Lugina e lumit të Vlorës ruan në brendi të vet thesare të pashpallura, që janë thinjur nga ciklet e gjatë të stinëve në muzgje të kohërave. Në rrjedhën e kësaj lugine gjenden disa qyteza ilire që kanë njohur qytetërim, madje kanë pasur zhvillime të fuqishme, siç është kryeqendra Amantia Cerja, Olympja (Mavrova), shpella e shkruar e Lepenicës dhe shpellat prehistorike të Velçës. **Shpellat e Velçës** i përkasin kulturës së neolitit të vonë, të mijëvjeçarit III p.e.s. Për kërkimet arkeologjike dhe kulturën që ka ekzistuar në këtë zonë, na jep një informacion të bollshëm Prof. Dr. M. Korkuti, i cili ka studiuar shpellën e Lepenicës, që gjendet rreth 10 km në vijë ajrore, si dhe në përgjithësi për artin shkëmbor në Shqipëri: "Piktura e Lepenicës". "Lugina, - shkruan M.

Korkuti - nga pikëpamja arkeologjike, është ende e pa studiuar në mënyrë të mjaftueshme. Ne vitet '30 të shek. 20 u bënë kërkime në shpellat prehistorike të Velçës (Mustili 1954-1955). Nga sa mund të gjykojmë nga njoftimet paraprake që janë dhënë, nga disa materiale që ruhen në muzeun historik të Vlorë dhe nga fragmente që kemi patur mundësi t'i mbledhim mbi sipërfaqen e vendbanimit shpellor, kultura e Velçës i takon neolitit të vonë e lidhet në kohë me kulturën Maliq (Prendi, 1976). Epoka e bronzit dhe ajo e hekurit, në luginën e Shushicës, janë të njohura nga zbulimet e bëra në tumat e Vajzës, lënda arkeologjike e të cilave ka tipare të qarta të kulturës ilire (Prendi, 1957).

Edhe gjatë periudhës qytetare e më pas kjo luginë ka qenë banuar pandërprerë. Qyteza e Mavrovës (Olympe), kalaja e Cerjes dhe qyteti i rëndësishëm ilir i Amantias janë dëshmi të zhvillimit dhe të nivelit të lartë që arriti kultura qytetare ilire në këtë zonë (Anamali, 197). Kultura e neolitit të vonë të Velçës, që i takon mijëvjeçarit III p.e.r, karakterizohet para së gjithash nga një qeramikë e pikturuar e cilësisë së lartë, traditë e cila, në një mënyrë ose në një tjetër, duhet të ketë ndikuar qoftë në kohën e vet, qoftë edhe në traditën e mëvonshme të banoreve të epokës së bronzit (d.m.th. të mijëvjeçarit II p.e.r), kulturën materiale të cilëve e gjejmë në tumat e Vajzës (Prendi, 1957). Afërsitë stilistike që ka piktura jonë me ato të zbuluara në Verdi Rock, në Valtellina në Porto Badiscos, si edhe atë të Zhlijebi, gjithashtu edhe afërsia territoriale e saj me Velçën e Vajzën nga ana tjetër, janë tregues të rëndësishëm, që na japin të drejtën të shprehemi se piktura e Lepenices është një krijim i rrallë i artit të vonë prehistorik, që duhet të jetë bërë gjatë neolitit të vonë dhe eneolitit, d.m.th, gjatë mijëvjeçarit III p.e.r, - **konstaton Prof. Dr. M. Korkuti.**

**Si përfundim, konstatimi edhe sipas autorëve të tjerë, të cilët shprehin se Shpellat e Velçës** i përkasin kulturës së neolitit të vonë të mijëvjeçarit III p.e.s. është shkencor dhe i bazuar. Kompleksi i shpellave të Velçës shtrihet në një masiv shkëmbor, ku ato qarkohen në largësi jo shumë larg njëra tjetrës. Ky shkëmb masiv, që zë një sipërfaqe të konsiderueshme, përbëhet nga shtresa me ngjyrë të kuqërremtë, sipër ka një mbulesë shkurre. Shpellat qarkohen rreth perimetrit të shkëmbit. Sipas shënimeve të Prof. Piero Marcone, shkruar në prill 1937, kjo shpellë duhet të ketë qenë banesë 1000 vjet para Krishtit. Shpellat e Velçës, duke radhitur kompleksin e tyre: shpella e Bushit, shpella e Prezaranit, shpella e Skotës janë vendbanime të lashta të banorëve autoktonë. Me këtë kulturë e histori dëshmohet qartazi se asimilimi që është synuar nga armiqtë e kombit nuk do të mund të realizohet. Dëshmi të këtilla mbeten të shkruara në shkëmbinjtë tanë. Sllavët dhe pushtuesit e tjerë, që qëndruan me shekuj në këto troje, ndryshuan emrat e vendbanimeve, besimet, por nuk arritën dot të mbyllin apo të shkatërrojnë gojët e shpellave, sepse do t'u duhej të shkatërronin gjithë shkëmbinjtë e këtij vendi.

## ***Bibliografia***

Cardini, L.: Recenti Scavi dell'Istituto Italiano di Paleontologia Umana alla Barma Grande di Grimaldi. Archivio per l'Antropologia e la Etnologia, 1938, 68:385-9.

Cardini, L.: Culture paleolitiche della Grotta S. Croce a Bisceglie (Bari), 1939. In: Atti della Società Italiana per il Progresso delle Scienze: 28<sup>a</sup> Riunione, Pisa 1939: 85.

Karen Francis: Institute of World Archaeology, University of East Anglia, Norwich

Prof. Dr. M. Korkuti: Piktura e Lepenicës, Arti shkëmbor në Shqipëri. Vëllimi i parë i Historisë së Shqipërisë.

\*Autori është anëtar i Akademisë Europiane të Arteve



## *Diplomacia shqiptare pas viteve 90 dhe disa çështje rajonale*

---

■ *Dokt. Kreshnik RUSHITI*

---

**Abstract.** *Foreign policy has been, is and will always be an important column of the state building. It is easily understandable that's what happens with Albanian politics and its sub-branch these twenty years. Regime changes brings necessarily a transition period and is this phase that characterizes this period in Albania's foreign policy, and here we have to underline that the curve is in a gradual climbing at the same way as its Albanian state policy.*

*Methodology - The methodology used in this paper consists in the combination of a variety of sources, whether official - the data made available by the foreign ministry- or bibliography dedicated to diplomacy and its particular elements.*

*Conclusion - In this short paper will look at the achievements and "failures" derived from diplomacy and its role in the region and beyond. Also briefly we will see the commitment and participation in international structures and efforts to create good neighborly relations.*

**N**ë fillimin e dekadës së fundit të shek. 20 edhe Shqipëria, ashtu si shumë vende ish-komuniste, u prek nga ndryshime rrënjësore përsa i përket rendit dhe politikës së brendshme, ashtu edhe politikës së jashtme.

Në këtë punim të shkurtër do të fokusohemi te politika e jashtme e shtetit shqiptar dhe arritjet e saj në këtë sektor shumë të rëndësishëm. Do të përpiqemi të hedhim një vështrim në lidhjet dhe rolin e saj, jo vetëm në rajon, por edhe më gjerë, anëtarësimin ose bashkëpunimin me organizata të ndryshme ndërkombëtare.

Padyshim, kalimi nga një shtet me një politikë të jashtme pothuajse inekzistente, në një politikë të jashtme me një diapazon të gjerë, ishte sa tronditës aq edhe i vështirë për lidhshimin e ri që u vendos në krye të politikës shqiptare.

Hapi i parë dhe më i rëndësishëm i diplomacisë shqiptare, ishte rivendosja e marrëdhënieve diplomatike me shtetet e Europës Perëndimore dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shumë shpejt Shqipëria bëhet pjesë e Këshillit të Europës, ku dhe anëtarësohet në vitin 1995.

Disa prej nismave rajonale të ndërmarra nga diplomacia shqiptare janë:

- Shqipëria është vend anëtar, që prej vitit 1996, i Nismës së Europës Qendrore (NEQ/CEI), e cila bashkon në gjirin e saj vende anëtare dhe joanëtare të BE, si dhe institucionet e tyre, në trajtën e një bashkëpunimi rajonal pragmatik dhe fleksibël. Objekti i nismës është thellimi i bashkëpunimit ndërmjet vendeve të rajonit në fushën politike dhe ekonomike, sigurimi i marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë ndërmjet tyre si pjesë e proceseve integruese. Shqipëria ka pasur presidencën e kësaj nisme nga maji i vitit 2005 deri në maj të vitit 2006.

- Vendi ynë është anëtar, bashkëthemelues i Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi, ku edhe ka ushtruar presidencën në vitet 2002-2008.

- Në 20 maj themelohet nisma Adriatiko-Joniane, ku përkrah Shqipërisë marrin pjesë edhe Bosnja e Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Greqia, Italia, Serbia dhe Sllovenia. Qëllimi i nismës ishte nxitja dhe thellimi i bashkëpunimit rajonal, i parë ky si një faktor komplementar për integrimin europian të vendeve anëtare.

- Procesi i Bashkëpunimit të Europës Juglindore (SEECP), i cili është dhe mbetet forumi më i rëndësishëm politik në Europën Juglindore, synon bashkëpunim për paqen, sigurinë, stabilitetin, zhvillimin ekonomik, politik e shoqëror të të gjithë vendeve të rajonit tonë. Presidencën e kësaj organizate vendi ynë e ka mbajtur gjatë vitit 2001.

Përsa i përket organizatave ndërkombëtare, Shqipëria është pjesë e Aleancës së Atlantikut Verior (NATO) prej vitit 2009, e prej vitit 1955 anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Marrja e ftesës së anëtarësimin

në NATO (në Samitin e Bukureshtit, 2 prill 2008) dhe anëtarësimi me të drejta të plota në Samitin e Strasburg&Kehl, 2 prill 2009, finalizoi ato përpjekje dhe atë aspiratë mbarëshqiptare për anëtarësim në NATO. Po të shihet kultura dhe mendësia shqiptare, Shqipëria bashkë me Kosovën, ndër të parat kanë merituar të jenë anëtare të NATO, por ishte politika e keqe ajo që mbante në vend numëro dhe degjeneronte një qasje të tillë ndaj botës. Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO, është vetëm një konfirmim i realitetit shqiptar dhe padyshim njëra ndër arritjet më të mëdha të shtetit shqiptar në fushën e integritimeve ndërkombëtare.

Rrugëtimi i Shqipërisë drejt Bashkimit Europian nis qysh prej vitit 1992 falë marrëveshjes për tregti dhe bashkëpunim midis shtetit shqiptar dhe BE. Në vijim të takimit të Këshillit Europian, që u mbajt në Selanik në qershor 2003, Shqipëria është vend kandidat potencial për në BE. Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (MSA) me Shqipërinë u firmos më 12 qershor 2006 dhe hyri në fuqi në 1 prill 2009. Më 18 shkurt 2008, Këshilli adoptoi një partneritet të ri Europian me Shqipërinë. Ai zëvendëson Marrëveshjen e Ndërmjetme për çështjet tregtare, e cila hyri në fuqi në dhjetor 2006. Marrëveshja e lehtësimit të vizave midis Shqipërisë dhe BE, hyri në fuqi në janar 2008. Një tjetër hap është ai i 8 nëntorit 2010, kur Këshilli i Bashkimit Europian miratoi vendimin për udhëtimin pa viza në zonën Shengen për qytetarët shqiptarë. Sot Shqipëria gëzon marrjen e statusit me kusht të kandidatit për hyrjen në BE.

Problematikat e diplomacisë shqiptare janë të shumta, sepse vetë historia e këtij kombi në këtë 100 vjetor është e mbushur me ngjarje dhe episode të panumërta. Diplomacia shqiptare ka shumë çështje për t'i kushtuar vëmendje, ose më mirë për të zgjidhur; një pjesë të mirë të problematikave që kanë shqiptarët në Maqedoni, Mal të Zi dhe çështja e krahinës së Çamërisë dhe kufijve detarë në Greqi<sup>1</sup>, të zgjidhen në frymën e bashkëpunimit dypalësh dhe

---

*1 - Greqia operon në zonën detare me Shqipërinë, mbi bazën e marrëveshjes së vitit 2009 për kufirin, e cila është cilësuar si antikushtetuese nga ana e Gjykatës Kushtetuese në Shqipëri. Ministri i Jashtëm i Greqisë, Stavros Dimas, në Parlamentin grek, gjatë interpelancës së thirrur nga deputeti i Partisë së LAOS, Ioannis Korantis, në lidhje me çështjen e kufirit detar me Shqipërinë, tha se: "Problemi në zonën ekonomike ekskluzive nuk është konsideruar në vetvete, por në kontekst më të gjerë të krijimit dhe caktimit të zonave detare në përpunime me dispozitat e ligjit ndërkombëtar, dhe në veçanti Konventës së vitit 1982 mbi ligjin e detit".*

*Deri në fillim të viteve '90, kaloi gati gjysmëshekulli gjatë të cilit nuk flitej fare për Çamërinë. Ky problem u rimor, u ringjall pas shumë përpjekjeve të bashkësisë çame për ta rindërtuar vizionin e Çamërisë para vetes, para gjithë shqiptarëve, por edhe në sytë e diplomacisë ndërkombëtare. Një hap i madh në këtë drejtim është sigurisht dhe miratimi i rezolutës çame në parlamentin shqiptar në vitin 2004, fakt ky që i hap rrugën një force veprimi nga ana e shtetit shqiptar.*

rajonat. Roli i diplomacisë shqiptare ishte parësor për krijimin dhe njohjen e shtetit kosovar dhe të shpresojmë që ky do të jetë një ogur i mirë për gjithë punën në vijim të diplomacisë shqiptare.

Sigurisht që viti i mbrapshtë 1997<sup>1</sup>, ngjarjet e vitit 1998 nuk ishin një pengesë e lehtë për t'u kapërcyer dhe pasojat e tyre nuk u ndjenë vetëm prej shtetit shqiptar brenda kufijve të tij, por edhe diplomacia pësoi një goditje të rëndë, sepse stabiliteti ekonomik-politik është një kusht i domosdoshëm për një politikë të jashtme frytdhënëse. Ringritja dhe rindërtimi i shtetit shqiptar çoi në riaktivizimin e diplomacisë shqiptare dhe përballjen e saj me realitetin e hidhur të popullit të Kosovës. Në dy dekadat e fundit bilanci i politikës së jashtme është kryesisht pozitiv, por siç e pamë edhe më lart, mbetet ende shumë punë për të bërë.

Gjithë çfarë pamë deri këtu, do t'iu ftoja t'i shihnim thjeshtësisht si përmbushje të detyrimeve dhe jo si arritje. Progresi i diplomacisë shqiptare është në sinkron me arritjet e shtetit shqiptar, prandaj, kur flasim për arritje në diplomaci, duhet të kemi parasysh edhe realitetin e këtij shteti. Njëzet vjet është një periudhë relativisht e shkurtër historike për të pasur ndryshime epokale, por kjo nuk do të thotë që një vend i vogël në qendër të Europës të mos ketë

një nivel të njëjtë ose të përafërt politik-ekonomik-social si pjesëtarët e tjerë të familjes së madhe europiane, gjë që do të çonte - për arsytet që pamë më lart - edhe drejt një diplomacie të nivelit të lartë.

---

*1 - Gjatë këtyre viteve kemi një ngërç politik-ekonomik-social, që çoi në një periudhë mjaft të vështirë për atë çfarë kishte mbetur nga institucionet e shtetit shqiptar. Ngjarjet e pranverës së vitit 1997, në Shqipëri, jo vetëm që e kthyen atë shumë pas, por ndikuan në mënyrë shumë të disfavorshme për shqiptarët në tërësi dhe për zhvlehtësimin e "çështjes shqiptare". Është fakt i pamohueshëm se këto ngjarje e dëmtuan shumë rëndë "çështjen shqiptare" në dy rrafshë: në atë ndërkombëtar dhe në rrafshin e brendshëm. Në rrafshin ndërkombëtar u rigjallërua teza e vjetër se shqiptarët nuk janë në gjendje të ndërtojnë shtet demokratik, sepse në Shqipëri pati rend dhe rregull vetëm gjatë sundimeve të dorës së fortë (1925-1939) dhe gjatë sundimit të diktaturës komuniste (1944-1990). Në rrafshin e brendshëm, ngjarjet e Shqipërisë ndikuan shumë negativisht në demoralizimin e shqiptarëve dhe faktorin politik të tyre.*

## ***Bibliografia***

Reina Zenelaj: Shqiptarët dhe politika e jashtme. Revista Gjeopolitike Shqiptare

Ismet Ramadani: Rivënia e politikës së jashtme shqiptare. Revista Gjeopolitike Shqiptare

Elez Biberaj: Shqipëria në Tranzicion, Politika e jashtme e Shqipërisë në vitet '92- 97

[www.mod.gov.al](http://www.mod.gov.al)

[www.moi.gov.al](http://www.moi.gov.al)

[www.mfa.gov.al](http://www.mfa.gov.al)

[www.gazetashekulli.com](http://www.gazetashekulli.com)

## *Shkolla, laicizimi dhe edukimi*

---

■ *Dokt. Siri HOXHA*

---

**Abstract.** *Political elites see the education as an exclusive field to exercise the power and the security of its longevity, political elites of every time and every country, at least in the concept of western notions for the building of institutions and public politics. They have concretized this with the building of Educational institutions of administration such as schools which are the laboratories where educational politics are protected. Meanwhile the notion of school and national education is closely related to the laic paradigm, so it could not exist without it. Laicization doesn't exclude the interference of state to the religion even this interference is its first and real understanding, marking a heavy implication of the process since at the beginning. Secularism is an unclear process not only in Albania, meanwhile in the case of Albania there isn't a critical similarity for secularization (The Paradigm of Laic State) even an ordinary researching similarity while it lays continuously to traditional situations with a continuously, supposedly social peace but far away realistic judgments (Religious tolerance among Albanians). On the contrary to the case of Albania secularism and secularism are in the new global developments and anti-saying trends a focus on the constant debate. The*

*process has to do with the whole state and it cannot be only concentrated to education system but at the same time we can strongly confess that over education the paradigm takes a more utilitarian understanding, precisely on the elites' aims (purposes). While secularism, modernism, europeanisation and perhaps even globalization as a post-modern term or phenomena are indistinguishably related to each other. Certainly here comes education. We bring all these notions as educational through teaching process. So, the school educate on political purposes while is laic without equivalence.*

**D**uke e parë edukimin si një fushë ekskluzive të ushtrimit të pushtetit dhe të sigurimit të jetëgjatësisë së tij, elitat politike të çdo kohe dhe të çdo vendi, të paktën në konceptin e nocioneve perëndimore të ndërtimit të institucioneve dhe politikave publike, e kanë konkretizuar këtë me ndërtimin e institucioneve të administrimit të arsimit (shkollave), të cilat janë edhe laboratorët ku mbruhën politikat e edukimit, ku qëllimshmëria përcillet përmes programeve shkollore të reformueshme në mënyrë të vazhdueshme dhe vetë sistemit arsimor, që vjen si pasojë e drejtëpërdrejtë e kësaj qëllimshmërie, e cila shprehet hapur në çdo hyrje të ligjeve arsimore.

“Sistemi arsimor parauniversitar ka për qëllim formimin e çdo individi me kompetencat themelore, që nënkuptojnë dijet, aftësitë, vlerat dhe qëndrimet, në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhmes, të jetë i përgjegjshëm për familjen, shoqërinë e kombin...”<sup>1</sup>, është një citim prej ligjit të fundit të arsimit parauniversitar dhe padyshim më i moderuari citim që mund të gjendet, në ilustrim të mënyrës se si formulohet qëllimshmëria, ndërsa ka citime shumë më të drejtëpërdrejta dhe, thënë thjesht, më cinike. Elitat sigurojnë në këtë mënyrë edhe “cilësinë“ e publikut votues dhe zgjedhës. Kështu sistemi demokratik “ecën mjaft mirë”, siç vë re me të drejtë McNair, në përsiatjet mbi konceptet dhe teoritë e demokracisë në komunikimin politik. Kështu sigurohet edhe kushtetutshmëria, edhe pjesëmarrja, edhe “zgjedhja e arsyeshme”<sup>2</sup>.

Ndërkaq nocioni i shkollës dhe arsimit kombëtar është i lidhur ngushtë me paradigmen laiciste, pra arsimin laik dhe as që mund të kuptohet pa të. Këtu duhet të ndalemi në pikëvështrimin mbi emërtesat **shekullarizim** apo **laicizim** dhe ndryshueshmërinë mes tyre në përdorimin terminologjik, e që sigurisht nuk është vetëm kaq. Nëse në konotacionin e vet gjuhësor këto dy fjalë janë shumë afër të shprehurit të të njëjtës paradigme, nuk ndodh kështu me konotacionin konceptual përmbajtësor.

---

1 - Ligji per Arsimin Parauniversitar, 2012.

2 - B. McNair: Hyrje në komunikimin politik, UET Press, Tiranë 2009, fq. 31.

Termi shekullarizëm, përshkroi një lëvizje të shekullit të nëntëmbëdhjetë, që synonte qartë të jepte një teori të sigurt të jetës dhe sjelljes, pa referencë të një hyjni apo jetë e ardhshme. “Shekullarizmi, sidoqoftë, gjatë gjithë ecurisë së tij është ngatërruar keqas me ateizmin. Ndërkaq, i barazvlershmi frëngjisht i shekullarizmit, **laïcisme** (laicizëm), ka një konotacion më radikal se termi anglisht. Laicizmi është konceptuar si doktrinë e lirisë së plotë nga feja dhe mosndërrhyrje prej saj. Ai përfshin besimin se funksionet e kryera më parë nga kleri duhet të transferohen te laikët, veçanërisht në sferat ligjore dhe edukative.”<sup>1</sup>

Laicizmi nuk përjashton ndërhyrjen e shtetit mbi fenë, madje kjo ndërhyrje është kuptimi i parë dhe i vërtetë i saj, duke shënuar një kompromentim të rëndë të procesit qysh në krye të herës. Pikërisht sepse bëhet fjalë për transferim kompetencash dhe jo thjesht për ndarje, për ndërhyrje të njëanshme dhe jo për mosndërrhyrje reciproke, me një ndarje të qartë demarkative mes dy koncepteve institucionale.

Shekullarizimi nuk është një proces me pikëpyetje vetëm në Shqipëri, ndërkohë që në rastin e Shqipërisë nuk ka asnjë qasje kritike mbi shekullarizimin (paradigmën e shtetit laik), madje as edhe një qasje të rëndomtë kërkimore, ndërsa i mëshohet paprerë situatave tradicionale me vijueshmëri kinse paqtuese sociale, por larg gjykimeve realiste (toleranca fetare midis shqiptarëve). Në të kundërt të rastit të Shqipërisë, shekullarizmi dhe shekullarizimi janë në zhvillimet e reja globale dhe rrymat kundërthënëse, një fokus i përhershëm debati. Shekullarizimi apo laicizimi nga ana tjetër, në rrugën e jetësimit të shteteve të mëvetësuar rishtas apo të riformuluara politikisht pas lëkundjeve të fuqishme nga brenda ose nga jashtë, duhet të jetë dhe është përgjithësisht një histori modernizimi. Procesi ka të bëjë me shtetin mbarë dhe nuk mund të përqëndrohet vetëm tek arsimit, por njëkohësisht ne mund të pohojmë fort se mbi arsimin, paradigma merr kuptim më utilitar, pikërisht mbi qëllimshmërinë e elitave, ndërsa shekullarizimi, modernizimi, europianizimi e ndoshta edhe globalizimi si një term dhe fenomen postmodern, janë të bashkëngjitura gati në mënyrë të padallueshme nga njëra tjetra. E padyshim këtu vjen edukimi. Të gjithë këto nocione ne i sjellim si edukuese përmes procesit arsimor.

Pra, shkolla edukon mbi qëllimshmëri politike, ndërsa është laike pa ekuivok.

Është fakt i qenësishëm që në fillimet e shekullit të njëzetë, vetëm Shqipëria në Ballkan dhe Turqia e re e Mustafa Qemalit, zgjodhën si alternativë të

---

1 - Azzam Tamimi: *Origjina e shekullarizmit arab, në Islam and Secularism in the Middle East*; Azzam Tamimi, John L. Esposito, editors: Hurst & Company, London, 2008, fq. 18-19.



modernizimit shekullarizimin e shtetit, përkundër theksimit nga ana e shteteve të tjera ballkanike, krahas elementëve të nacionalizmit, edhe të elementëve atipikë fetarë, deri në forma shtetesh nacionale fetare, me një ngjeshje të lartë mes dy nocioneve të fundit. Në realitet, në Shqipëri, shekullarizimi apo laicizimi pati një natyrë paksa veçantë. I përforcuar me ateizmin dhe idenë e përfaqësimit të prapambetjes nga feja, kurse, të përparimit nga ateizmi, laicizmi u zhvillua në vende të tjera edhe si forcë lëvizëse për të hedhur poshtë një sistem politik të vjetër dhe për të ngritur një sistem politik të ri. Ndërsa e njëjta ide e përballjes së qëllimshme të laicizmit me ateizmin dhe përparimin ka qenë në nënvetëdijen e çdo elite politike shqiptare si një gjendje e nënkuptuar dhe kurrë nuk ka qenë shkak për përmbysje politike, një determinizëm fatkeq në vetvete por efikas.

Në vështrimin historik, Rilindja Kombëtare Shqiptare u zhvillua në gjirin e Perandorisë Osmane, në pajtim dhe krahas lëvizjes politike **Bashkim e Përparim** (Ittihad ve Terakki). Ismail Qemali, si babai i Pavarësisë shqiptare, qe një ndjekës i kësaj lëvizjeje. Po ashtu, edhe tërë inteligjenca “demokratike” shqiptare u formua ose nën ndikimin e lëvizjes **Bashkim e Përparim** në Turqi, ose nën ndikimin e ideve të Revolucionit Francez, që nënkupton elita, veç të tjerash, thellësisht laike. Reformat (një pjesë e tyre) që u imponuan apo u vetimponuan të bënin komunitetet fetare në vend, gjatë dhe krahas procesit të ngritjes së shtetit, kryesisht Komuniteti Musliman Shqiptar, si ato mbi veshjen e femrës muslimane, qenë, në një këndvështrim, reflektive të dobëta të reformave laicizuese në Turqi, dhe një rrugë e nënkuptuar e një shteti gjeografikisht europian dhe të mëtuar institucionalisht si i tillë. Ndërkaq, asnjë reformë laicizuese në Shqipëri s’ka pasur të bëjë me pushtetin, me luftën e mirëfilltë politike për pushtet dhe sendërtimin e tij në përmbysje politike dhe ndërtim të formave modernizuese të shtetit, përveçse me ateizmin si ide përparimtare dhe fetarizmin si ide reaksionare. Në këtë kuadër, veprimtaria e komuniteteve fetare, e shkollave të tyre po se po, por edhe e shkollave publike mbi të njëjtin këndvështrim, ka qenë krejtësisht e kontrolluar nga shteti ateist dhe antifetar, sepse problemi i laicizmit në kuptimin e mirëfilltë të tij, domethënë i ndarjes së Kishës nga Shteti, s’ka ekzistuar kurrë në Shqipëri, as në periudhën 1912-1945, as në periudhën e pushtetit komunist, as edhe tani në tranzicionin demokratik! Sidoqoftë, reminishencat mbi domosdoshmërinë dhe bashkëlidhjen e paradigmave modernizim - laicizim - ateistizim vijojnë të krijojnë situata paradoksale dhe të pakuptimta për parimësinë që buron nga rikthimi i lirisë së besimit dhe i vlerave universale të tij.

Shumë studiues perëndimorë të paradigmës laiciste rreken të na rrëfejnë jo pa arsye, në një përpjekje për “zhveshjen” e problemit teorikisht, se rreziqet që i vijnë rendit botëror dhe sigurisë globale nga fundamentalizmi shekullar janë

paradoksalisht po aq të mëdha, në mos më të mëdha se rreziqet që vijnë prej fundamentalizmit islam apo islamit politik. Për të kundërtën, rasti i Shqipërisë në rrugën e saj të laicizimit është domethënës në këtë argument. Në Shqipëri, ku u ndoq rruga e shekullarizimit “të butë” e me “konsensusin e bashkësive fetare”, përpjekjet për rikthimin kokëposhtë të proceseve shekullore janë pothuaj inekzistente, e për këtë arsye bëhen të pakuptimta stihitë mediatike apo edhe institucionale nën zëdhënien e individëve të acaruar, kundër kinse përpjekjeve për ta kthyer Shqipërinë në një vatër fundamentalizmi fetar (nënkupto islam). “Edhe më tinzar është fundamentalizmi militant shekullar i vendeve si Franca, Turqia dhe Tunizia, ku shekullarizëm nuk është thjesht ndarja e fesë nga politika, por, siç tregon historia e shkuar dhe e tashme, një besim antifetar dhe antiklerikal.”<sup>1</sup>, vëren Xhon Esposito, studiues i pasionuar i problemeve të shekullarizmit.

Këto vende janë përpjekur ta ndalojnë vënien e shamisë për muslimanet, apo i kanë diskriminuar ato që e bëjnë këtë. Franca e ka hedhur poshtë multikulturalizmin dhe ka kërkuar integrim, duke e paralajmëruar popullsinë e saj muslimane se për të qenë francezë dhe të mirëpritur duhet të bëhen muslimanë shekullarë.<sup>2</sup> Në këtë pikë, rasti i Shqipërisë përputhet me sa më sipër, përsa i takon “besimit antifetar dhe antiklerikal”. Franca, nga ana e saj, ka patur ndikimin e saj, të paktën ideologjik, mbi shumë procese në Shqipëri, e veçanërisht mbi laicizimin dhe thellësinë e tij të praktikimit gjatë gjithë kohës, madje edhe gjatë viteve të regjimit komunist. Shqipëria në këtë pozicionim thellësisht shekullar dhe të motivuar antifetar, përveç ndikimit të ideologjisë komuniste, realizoi atë që ndoshta s’do ta kishin ëndërruar shumë ateistë dhe regjime shekullore në botë, një fshirje të plotë nga jeta publike e çdo gjurme të fesë dhe besimit, nëse nuk do ta konsideronim besim edhe vetë ateizmin.

Në Shqipëri s’mund të thuash që qenia nën Perandorinë Osmane kishte lënë ngultësisht traditën e një teokracie. Përkundrazi, që më 1912, ideja e shtetit shekullar (laicist, e nganjëherë ateist) në mes elitës politike shqiptare, për arsye të formimit të tyre politik, ishte e vetëndjerë, si pjesë e konceptimit të shtetit të ri shqiptar, si një model qartas perëndimor. Pjesëmarrja e klerikëve në ndërtimin e shtetit të ri, përmes zënies së posteve, nuk kishte të bënte aspak me elementë të teokracisë, apo ndikimit të drejtpërdrejtë të formimit të tyre fetar në karakteristikat e shtetit të ri. Mund të gjykohet se klasa politike

---

1 - Xhon L. Esposito: *Origjina e shekullarizmit arab, në Islam and Secularism in the Middle East*; Azzam Tamimi, John L. Esposito, editors: Hurst & Company, London, 2008, fq. 13.

2 - Xhon L. Esposito: *vepër e cituar, po aty, fq. 13.*

e vlerësoi seriozisht fuqinë e klerit mbi jetën shpirtërore të popullit dhe, njëkohësisht, nxitoi ta bënte të ndërgjegjshëm atë për peshën dhe rolin që do të duhej të luante në kohërat që po vinin.

Situata e Shqipërisë, me tre fe të mëdha dhe një tjetër (bektashizmi) që për disa arsye paraqitej gati si fe e veçantë, si edhe me disa sekte e urdhra fetare në veprim, të impononte lëvizje të kujdesshme, zgjidhje kompromisi dhe jo force. E gjithë çështja reduktohej në idenë që të nxiteshin vetë klerikët autoritarë për të organizuar nën një frymë të re (laiciste ?!), bashkësitë që mbulonin. Hap pas hapi, me fuqizimin e shtetit, ndërhyrja e këtij të fundit do të ishte një rol gjithnjë e më i madh nxitësi dhe kontrolluesi. Problemi më i madh ishte jetësimi i një pavarësie reale të bashkësive fetare në Shqipëri nga qendra të huaja, marrëdhëniet me të cilat në fund të fundit, po të nxirreshin jashtë vëmendjes, do ta bënin të thyeshëm në çdo situatë dhe në çdo kohë stabilitetin e vendit. Përveç katolikëve, që objektivisht nuk mundën, madje as kërkuan ndonjëherë ta realizonin këtë shkëputje në thelb statistë, nacionalistë, madje modernistë e sigurisht laicistë, porse në këtë rast një precedent i pamundur për ta, dhe bektashinjve, të cilët sidomos pas vitit 1925 nuk patën rrugë tjetër, përveçse t'i referoheshin vetvetes dhe realitetit shqiptar si qendëzim i detyruar, muslimanët dhe ortodoksët treguan pjekuri, duke krijuar bashkësi të mëvetshme, si akte të pastra patriotizmi dhe referimi nacionalist. Ndërkaq brendia thellësisht laicistë, në vetë ndërtimin e këtyre komuniteteve rishtarë dhe formimin e krerëve të tyre, ishte një premisë për një shekullarizim të plotë, të kombinuar mes iniciativave të brendshme dhe akteve imponuese. Nuk mund të quhet rastësi, dhe as nuk është në të vërtetë i tillë fakti që bashkësitë fetare i mbledhin kongreset e tyre të mëvetësimit dhe të vetëorganizimit në të njëjtën periudhë. Është i mirëprovuar po ashtu fakti se shteti i asaj kohe, dhe personalisht Ahmet Zogu, kishin dhe shprehën një angazhim të veçantë në këtë drejtim, duke nxitur procese që më së pari u panë si parakushte të një shteti solid dhe të qëndrueshëm. Muslimanët suni mundën ta realizojnë kongresin e tyre të parë në mars 1923, akt që spikaste me shkëputjen zyrtare nga institucioni qendror i Kalifatit, çka, më së paku, injoronte një traditë disashekullore, për t'iu kthyer një praktike të marrëdhënieve të vartësisë dhe autoritetit drejtuar thjesht shtetit politik shqiptar. I të njëjtës rëndësi qe Kongresi i Ortodoksëve, i mbledhur në Berat më 1922, por me një sfond më të ngarkuar politikisht, për shkak të ndërlikimeve diplomatike dhe fqinjësore me Greqinë. Bektashinjët ndërkaq e kishin realizuar Kongresin e Prishtës në vitin 1921.<sup>1</sup>

---

*1 - Historia e popullit shqiptar, vëll 3, bot. i Akademisë së Shkencave, Toena, 2007, fq. 191-194.*

Pas këtyre akteve jo dhe aq formale pavarësimi, që përmbanin në vetvete simbolika domethënëse nacional-statiste, dhe përsëri laiciste, reformat, në të gjitha bashkësitë fetare të sipërpërmendura, përjashtuar për arsyet që thamë katolikët, ndoqën njera-tjetrën duke ecur hap pas hapi dhe në përpjestim të drejtë me fuqizimin e autoritetit shtetëror.

Reforma arsimore ishte ndër të parat hapa në këtë drejtim dhe u konceptua si një gur prove në shtratin e marrëdhënieve shtet-bashkësi fetare, nën dritën e gjykimit të thjeshtuar shekullar e natyrisht edhe kombëtar, larg arsytimeve fetare tradicionale e nganjëherë edhe me sfond të qartë politik. Nderkohë u konsiderua fundamental mësimbesimi në shkollat fillore duke lëshuar një pe të dobët, njëkohësisht jo të vërtetë. Kur Ahmet Zogu në vitin 1922, në cilësinë e ministrit të brendshëm, shkruante qarkore me këtë përmbajtje: "... Këshilli Ministrues tue mendue se n'Atdheun tonë qysh në kohë të Turqies e deri sot janë luajtë propaganda politike gjithfarëshe, natyrisht del nevojë e madhe që shteti arsimin filluer duhet ta ketë në dorë të vet..."<sup>1</sup>, shprehte më shumë se një koncept personal. Ai, në cilësinë e mesipërme, shprehte gjithë vijën politike që frymëzohej së paku që nga Kongresi i Lushnjës, vijë e cila në trajtimin e bashkësive fetare mëtonte të ishte drejtvizore. Mësimbesimi do të rrënohej nga poshtë, ndërsa shpejt u bë e qartë se reforma arsimore do të ishte një premisë e vazhdueshme përplasjesh midis shtetit dhe bashkësive fetare. Madje, me komunitetin katolik këto përplasje kthehen në një histori më vete, duke sjellë në vitet e mëvonshme edhe situata serioze dhe ndërlikime ndërkombëtare për shtetin shqiptar, siç ishte rasti i krizës me Italinë i vitit 1934.<sup>2</sup>

Pas ndryshimeve politike të ndodhura në Shqipëri më 1925, e sidomos më 1928, formëzimi i bashkësive fetare si organizime të çlirëta dhe të çliruara nga dogma dhe shprehjet e besnikërisë ekumenike, në partneritet me shtetin, u bë i plotë edhe ligjërisht. Personalizimi i autoritetit shtetëror në figurën e Ahmet Zogut, si Kryetar Republike e më pas si Mbret, ndihmoi realisht në përmbylljen e reformave të ndërmarra brenda bashkësive fetare, si iniciativë e tyre apo me inicim nga lart. Kushtetuta e vitit 1928 përcaktoi qartësisht konturet e shtetit laik, për të cilin të gjitha fetë janë njëlloj të respektueshme. Përputhshmërisht me këtë, ligji "Mbi Komunitetet fetare" i vitit 1929, preçizonte hapësirat e bashkëjetesës së feve të ndryshme në shtetin shqiptar, modalitetet ndërvartëse të tyre me njëra-tjetrën, me qendrat e referimit shpirtëror dhe me vetë shtetin shqiptar. Pothuaj i njëjti ligj, në vitin 1949, me shumë pak ndryshime, do të jetë shprehje e "sinqertë" e emëruesit të përbashkët laicist, e shpesh, e përsëris, ateist që kishin elitat dhe regjimet politike në Shqipëri, edhe kur i ndanin mes

---

1 - AQSH, Fondi 482, Dosja 51, Viti 1922, fq. 13.

2 - AQSH, Fondi 482, po aty, fq. 16.

tyre humnera ideologjike.

Asnjëherë në Shqipëri organizimet e bashkësive fetare nuk kishin përbërë problem në vetvete për shtetin. Ato ishin kthyer në problem vetëm kur ishin mpleksur me marrëdhëniet politike ndërshtetërore. Më pak se secila prej bashkësive fetare ekzistuese, kishte sjellë probleme komuniteti i muslimanëve, edhe pse përbënin shumicën, madje ky i fundit nuk kishte qenë asnjëherë dhe as që duket se do të jetë në të ardhmen, i lidhur ekskluzivisht me çfarëdo qendre apo shteti të huaj dhe, si i tillë, nuk do të sjellë asnjëherë ndërlikueshmëri politike. Por pikërisht mbi këtë bashkësi janë drejtuar në të gjitha kohët dhe regjimet që ka kaluar shteti shqiptar, bateritë e sulmit, kurdo kur shteti tenton të merret drejtpërdrejtë me komunitetet fetare. Aq më e gjallë dhe e prekshme është bërë historia pas ngjarjeve tragjike të 11 Shtatorit. Nëse e veçojmë si tepër specifik rastin konkret të sipërpërmendur, në çdo rast tjetër identifikimi i patjetërsueshëm me modernizmin dhe Europën, ka qenë një motiv shpërblyes.

Ndërkohë që është e nënkuptuar, tendenca statiste-laiciste mbi bashkësinë fetare të mësipërme nuk mund të jetë e justifikuar.

Gjatë regjimit komunist, ateizmi mbuloi gjithçka, sidomos në fushën e arsimit. Edukimi ishte një monopol shtetëror dhe askush nuk guxonte të shprehte besimin e vet, veçanërisht në proceset e gjithëmbarshme edukative propagandistike.

Rikthimi i besimit nuk e ka thyer konceptin. Ne vijojmë sot të gjykojmë institucionalisht në mënyrë shekullare (gjegjësisht ateiste), pa i kuptuar dhe vlerësuar përfundimet e terrenit. Shpesh sjelljet tona zyrtare janë përjashtuese ndaj çdo grimase të shfaqjes publike të individuale fetare, duke shkelur padrejtësisht dhe dhunshëm, me frikë të pajustificuar, sentimente të komuniteteve të caktuara. Sprovat e përgatitjes së terrenit për ligje arsimore, spekulative mbi ndjenjat fetare të individëve dhe bashkësive të caktuara, me akte kinse “të forta” individësh në detyra shtetërore, janë më shumë se akte pragmatiste apo spontane iniciativash personale të këtyre individëve.

Shkolla do të vazhdojë të edukojë në mënyrë laike, por individët do të përmbushin liritë e tyre në mënyrë fetare, gjithsesi në një rrymë të kundërt me atë që sugjerojnë elitat. Në një sistem të lirive dhe vlerave demokratike, proceset vetedukuese do të jenë gjithëherë më të rëndësishme se proceset edukuese nga lart poshtë, duke mbyllur me një paradoks të vetëm një mori paradoksesh që do të buronin nga procesi i kundërt.

## ***Bibliografia***

- AQSH, Fondi 482, Dosjet int., Vitet 1921-1939
- Giddens. A.: Sociologjia, Çabej, Tiranë 1998
- Shahinler, M.: Origjina, ndikimi dhe aktualiteti i Qemalizmit, Koha, Tiranë 1998
- Rreth përhapjes së Islamit ndër shqiptarët, Përmbledhje studimesh, Gelenek, Stamboll 2003
- Bajrami, Z.: Qëndrimi i islamit ndaj laicizmit, Furkan, Shkup 2005
- Historia e popullit shqiptar , vëll 3, 4, bot. i Akademisë së Shkencave, Toena, 2007
- Egro, D.: Historia dhe Ideologjia, Maluka, Tiranë 2007
- Azzam Tamimi, John L. Esposito: Islam and Secularism in the Middle East, Hurst & Company, London 2008
- McNair, B.: Hyrje në komunikimin politik, UET Press, Tiranë 2009
- Davutogllu, A.: Vetëperceptimet e qytetërimeve, Logos-A, Shkup 2010
- Kallën, I.: Islami dhe Perëndimi, Logos-A, Shkup 2011
- Ligji për Arsimin Parauniversitar, 2012, në Website të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.









